MBRETNIJA SHQIPTARE
KËSHILLI I SHTETIT

LIGJE DEKRET LIGJE e RREGULLORE

TË VJETIT

1931

BOTIMET E KËSHILLIT TË SHTETIT
VOL. 8 I PËRMBLEDHJES SË LIGJEVE
T I R A N Ë, 1942

BKSH

BKSH

BKSH

BKSH

MBRETNIJA SHQIPTARE
KËSHILLI I SHTETIT

LIGJE DEKRET LIGJE e RREGULLORE

TË VJETIT

1931

BOTIMET E KËSHILLIT TË SHTETIT
VOL. 8 I PËRMBLEDHJES SË LIGJEVE
TIRANË, 1942

BIBL TEKA KOMBETAR
TIRANE

BKSH

BKSH

Nr. 1

LIGJË 2 Kallnuer 1931

Mbi transferimin e nji kredije prej fr. ar 11.500 në Buxhetin e vjetit financjar 1930-31 t' Instituteve të Nalta të Ministrissë Financavet

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 8 Kallnduer 1931, Nr. 1)

Neni 1.

Autorizohet bartja nga kapitulli 11 «rrogë personeli t'Inspektoris», Fr. ari 9000, nga kapitulli 12 «shpenzime udhtimi e djete» Fr. ari 2500, gjithësejt Fr. ari 11.500, e me u veshë kapitullit 2 «shpenzime udhtimi e djete» (Shtëpija Civile) Fr. ari 7500, kapitullit 16 «Shpenzime udhtimi e djete» (Adjudantura) Fr. ari 3500, e Kapitullit 17 «Shpenzime Zyret» (Adjudantura) Fr. ari 500).

Neni 2.

Për zbatimin e kësaj Ligje, ngarkohet Ministrija e Financavet.

Neni 3.

Kjo ligjë hynë në veprim, me datën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e ligjit mbi transferimin e nji krediti prej Fr. ari 11.500, në buxhetin 1930-31 t' Instituteve të Nalta, i votuem prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 879-I- datë 20.XII 1930 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 2 *Kallnduer 1931.*

Z O G

Kryeministri
P. Evangjeli

Ministri i Financavet
K. Thaçi

BKSH

Nr. 2

LIGJË 2 Kallnuer 1931

Mbi perjashtimin nga taksa doganore dhe e magazinazhit si dhe nga ç' do taks tjetër Shtetnore ose Bashkiet, e të gjith materialit që i nevojitet për lidhjen e Hekur-udhes Durres-Tiranë, dhe qe ka arrijtun ose do të arrin në Doganen e Durresit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Kallnduer 931 Nr. 2)

Art. 1.

Gjithë materiali i nevojshëm për lidhjen e hekur-udhës Tiranë-Durrës, qi permendet këtu ma poshtë, dhe qi ka arritun ose do t'arrijë në Doganën e Durrësit, për njihsi të Shtetit, përjashtohet nga taksi Doganuer dhe i magazinazhit, si dhe nga ç'do taksë tjeter Shtetnore ose Bashkije.

Ky përjashtim nuk do të cenojë të drejtat e fitueme të nji të treti.

Materiali i përmendun në këtë artikull qi gjindet dhe, qi do të arrijë në doganë, çdoganohet në bazë të nji urdhni të dhanun prej Ministris së Financavet.

Materiali përmendun në kët artikull përbahet prej :

2 (dy) copë automotrice me avull.
2 (dy) copë Lokomotiva Tondor.
1 (nji) copë Vagon Salon me dy akse.
2 (dy) copë Vagona të përziem per të paren dhe të dyten klasë.
2 (dy) copë vagon për të dytën klasë.
6 (gjashtë) copë Vagona per të treten klasë.
10 (dhet)copë Vagona të mbylluna me frena doret.
4 (katër) copë Vagona të hapët me frena doret.
Gershanza të njitun modelit 24 ex austriak me shina 26, 125 (njiqinde e njizet e pesë) ton. pllaka lidhëse (ganashe).
260 (dyqindegjashtëdhetë) ton. pllaka pshtetëse.
90 (nandëdhetë) ton. klanfi.
28 (njizetetetë) ton. burma.
8 (tetë) copë ndrrruesa (samafori) të përdorun.
40 (dyzet) km. linie shina nga 36 që vyejn ton 2.640.
25 (njizetepesë) copë shina-bajtëse me singjir.

5 (pesë) copë krika per me zhbirue shina.
400 (katërqind) copë kazma forcimit.
200 (dyqind) copë çekiça mberthimi.
20 (njizet) copë kuja me ndalue vagonat.
200 (dyqind) copë spata të vogla.
50 (pesëdhetë) copë spata të mëdhaja.
50 (pesëdhetë) copë çelsa ingliza.
10 (dhet) copë vegla për mbajtjen e gjanësis së rrugës.
10 (dhet) copë terezija ujit.
20 (njizet) copë leva të këthyeme.
2 (dy) copë linie të vdekme (me pritje).
2 (dy) copë Burija per signale.
4 (katër) copë karrela armimit.
20 (njizet) copë leva drunit me hekur.
3 (tre) copë sharra per shina.
50 (pesëdhetë) copë çelsa gyp.
200 (dyqind) copë çekiça me thye gurrë.
200 (dyqind) copë tela sharash per shina.

Art. 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi çë prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Ministrija e P. Botore dhe, ajo e Financavet janë të detyrueme me zbatimin e kësaj Ligjë.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi perjashtimin nga tagri doganuer dhe të magazinazhit, si edhe nga ç'do taks tjetër Shtetnore, ose Bashkije per të gjithë materialet qi nevojitet për lidhjen e Hekur-Udhës Tiranë-Durrës, i votuem prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 748-1. d. 12-12-930 të Kryesis së Tij.

ZOG

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli

Ministri i Fanancavet:
K. Thaçi

Ministri i P. Botore:
Izet Dibra

Nr. 3

REGULLORE 15. Dhetuer. 1930.

Mbi aplikimin e Ligjes 8 Prill 1930 të Statistikës s' Ekonomis Kombtare

(e botueme në Fletoren Zyrtare 15 Kallnduer 931 Nr. 3)

Art. 1.

Në qarqet, Organet e zbatimit të Statistikës së Ekonomis Kombtare, si mbas nenit 1 të ligjës d. 8 Prill 1930, janë Odat e Ekonomis në Prefektura.

Në Prefekturat ku nuk ka Oda t'Ekonomis, detyren e kryen Prefektura nen drejtimin e Prefektit.

Art. 2.

Në Komunet regjistrimi bahet nen drejtimin personal të Kryetarit të Komunës, i cili asht përgjegjes për rregullimin e mirëvajtjes së veprimeve relative.

Art. 3.

Kryetari i Komunes, i ndihmuem prej nji Komisjoni të regjistrimit drejtue nen Kryesin e tij, në të cilen marrin pjesë dy antarë të zgjedhun prej Këshillit Administrativ ne mes të tyne ose nga jashtë, dy antarë të zgjedhun prej Odës Ekonomis Prefekturës, ose prej asajë të Nenprefekturës, në qoftë se janë në qarkun ku ndodhet Komuna funksionarët e Shtetit, që drejtojnë në Komunet sherbimet e mvaruna prej Ministris s'Ekonomis Kombtare dhe, Sekretari i Komunes që fonksionon edhe si sekretar i Komisjonit.

Komisjoni formohet vit për vit me urdher të Prefektit, dhe për aplikim të kësaj Rregullore do të formohet, mbrenda 10 ditëve, me urdhën të Ministris s'Ekonomis Kombtare në të cilin ka me u caktue dita e rregjistrimit.

Komisioni bashkëpunon me Kryetarin e Komunes në të gjitha veprimet që i përkasin regjistrimit, në zgjedhjen e Nepunsave të regjistrimit, në caktimin e mënyrave dhe të instruksioneve, në shperndarjen e mbledhjen e formulareve të rregjistrimit, në kujdesimin që veprimet e regjistrimit të zhvillohen me rregull, e të kryhen në kohën e caktueme dhe në vertetimin e përmbledhjes s'informatave përkatse.

Art, 4.

Kryepleqt e Katundeve, mbas urdhnave të Kryetarit të Komunes në rrethin e Katundit të tyne, kryejnë me rradhë shërbimet mbas nenit 2 të kësaj Rregulloreje tue, drejtue e kqyrë veprimet e regjistrimit të katundit të tyne, dhe tue qenë përgjegjës bashkërisht me Kryetarin e asaj Komune.

Art. 5.

Veprimet e rregjistrimit i dorëzohen nëpunsit të rregjistrimit i cili, asht përgjegjës për rregullimin e veprimit të kryem prej tij.

Nëpunsat e rregjistrimit emnohen prej Prefekturave mbrenda 15 (pesëmbëdhet) ditve passi t'u jetë njoftue urdhni Ministrial që cakton regjistrimin, dhe janë të zgjedhun, mbasi të jenë pëlqye prej Këshillit Administrativ, ndër nepunsa të Komuneve, të Nënprefekturave, të Prefekturave, e ndër mësues e ndër të gjithë ata njerëz, të cilët ndodhen në ndo nji sherbim ose tjetër dhe, kanë njoftim mbi ekonomin e vendit.

Nëpunsat e rregjistrimit për të kryemit e detyrës së tyne, do të kenë nji dishmi njoftimit të lëshuem prej Kryetarit të Komunës, si dhe letër emnimin e Prefekturës ose Nënprefekturës për t'ja paraqitun kujdo që të kërkojë.

Numëri i Nëpunsave të rregjistrimit do të caktohet mbas nevojës të parapame për punën, dhe si mbas largsisë së vendeve ku bahet rregjistrimi.

Art. 6.

Rregjistrimi, do të fillojë e do të kryhet mbrenda kohës që ka me u caktue prej urdhnit Ministrial, për veç zgjatimeve të afatit të bame, mbi proponimin e Prefektit, prej Ministris s'Ekonomis Kombtare.

Art. 7

Rregjistrimi bahet me letër pyetje të veçantë të dërgueme prej Ministris s'Ekonomis Kombtare, por, që mund të modifikohet mbas nevojës vjet për vjet prej asaj në të cilën rastë e bashkanjitun dekretit Mbretnuer që cakton rregjistrimi.

Për shtypshkrimin e përndarjen e këtyne modeleve në Prefektura kujdesohet Ministrija në fjalë.

Art. 8.

Formularët nuk duhet të kenë të fshime; ku ka nevojë për korrigjime, këto do të bahen në mënyrë që të jenë të dukshme, shif-

rat e fjalët e korregjueme e në kët rastë, në fund t'atyre formulareve, do të bahet shënimi i numrit të korrigjimeve me deklarata të formueme prej nëpunsit dhe dëftuësit.

Kryetarët e komuneve së bashku me komisionet që kryesojnë, kanë me u kujdesue që formulet të mos kenë të metë as mos të kenë të dyfishohen dhe, mbasi të kenë shqyrtue gabimet, kujdesen në bazë të gjithë elementave që kanë në dispozitë ose të bajnë të tjera vertetime.

Art. 9.

Kushdo që nuk i jep informatat e i jep të gabueme e të pa kompletueme, do të ndëshkohet në mënyrë të caktueme në ligjën me datë 8 Prill 1930, në bazë të njoftimit të nëpunsit të regjistrimit, i cili do të redaktojë nji verbal të veçantë e do t'ja transmetojë Kryetarit të Komunes.

Në rast ç'rregullimi, u takon Kryetarve të Komuneve e Prefekturave me riferue autoriteteve Gjyqësore fajtorët, të cilet do të ndeshkohen si mbas Ligjës.

Art. 10.

Formularët do të jenë të nënshkruem prej diftuesit, prej Nëpunsit të rregjistrimit edhe prej Kryeplakut të Katundit e Kryetarit të Komunes, ose prej këtij të fundit, në qoftë se asht fjala vetem për rregjistrimin në qendrën t'asaj Komune.

Secili prej nënshkruesve merr për pjesën që i takon përgjegjësin të rregullimit të rregjistrimit.

Art. 11.

Odat e Ekonomis duhet të kujdesohen për nji përfundim të mirë të rregjistrimit, me gjith mjetet që kanë në dispozitë, tue u dhanë instruksionet e nevojshme të dy antarve të emnuem prej komisionit Komunal të regjistrimit dhe, tue vue në dispozitë të Komuneve, ku t'a kerkojë nevoja, ndihmen e Këshilltarve e të Sekretarve të Odave, tuj ba vezhgime në vend, e tuj njoftue mbi këto Prefekturat e Ministrin e Ekonomis Kombtare, për masat që duhen marrë.

Art. 12.

Nëpunsave të rregjistrimit u takon pagimi i shpenzimeve për udhtime, ashtu edhe nji diet për kohën jashtë banimit.

Pagesa e shpenzimeve dhe e dijetës, bahet mbasi të paraqitet nji listë e perpilueme prej t'interesuemve dhe e konfirmueme prej Kryeplakut të katundit, dhe Kryetarit të Komunes ose vetëm

prej Kryetarit të Komunes në qoftë se, veprim i nëpunsit të rregjistrimit asht zhvillue në qendër të Komunes.

Art. 13.

Shpenzimet e bame për rregjistrimin në të gjithë Prefekturat e Mbretnis së bashku me ato ku nuk ka Oda Ekonomike, kanë me u pague prej nji fondi të përbashkët që do të gjendet në Ministrin e Ekonomis Kombtare, të mbledhuna prej Buxheteve të gjithë Odave të Ekonomis, në masë të duhun, dhe në përpjestim të sasies të buxhetit të tyne.

Art. 14.

Mbasi të jenë krye veprimet prej nepunsit të rregjistrimit Kryetarët e Komuneve, do të kujdesohen për mbledhjen e numrimin e të gjithë formularevet, të cilat do vërtetohen nga ana e Komisionit në për verifikimin e deteve që përmbajnë përmbledhjet nëpër Prefekturat përkatse, dhe mbasi të kenë ba kontrollimin ja dërgojnë formularet Odes Ekonomis përkatëse që, të kujdesohet si mbas instruksioneve që do të marrin prej Ministries Ekonomis Kombtare, për shqyrtimin dhe përmbledhjen e datave të qarkut të tyne.

Prefektura, ku Oda Ekonomis, ka me u kujdesue vet për këto veprime veçse, kur Ministria e Ekonomis Kombtare do të disponojë ndryshe.

Art. 15.

Mbasi të jetë ba kontrollimi, shqyrtimi e përmbledhja. Odat e Ekonomis ose Prefekturat i a dërgojnë përfundimin Ministris, e cila kujdeset për kompilimin e Statistikës së përgjithshme për gjithë mbretnin, tuej disponue si mbas rastit kontrollime e inspektime, për me verifikue regullimin e veprimit të bame prej organeve të rregjistrimit.

Krye II

Dispozita të veçanta për regjistrime të ndryshme

a) Regjistrim Bulqesuer

Art. 16.

Rregjistrimi Bulqesuer përfshin : 1) Rregjistrimin e shtëpive Bulqësore përgjithsisht 2) Rregjistrimin e gjasë së gallë.

Ajo do të përbahet në bazë të dy modeleve të veçanta.

Art. 17.

Rregjisrimi i shtëpive Bulqësore, përfshin të gjitha shtëpit të

zotnueme prej privateve dhe prej instituteve të ndryshme që kanë tokë për prodhim bulqësuer e pylluer cila do të jetë gjansija e tyne, edhe në qoftë se prodhimet e nxjerruna prej tyne nuk shiten në treg

Përjashtohet vetëm kopshtet e vogjël e bahçe rreth shtëpive të qendrës së Komunes, e të kryevendit të Prefekturës e Nënprefekturës.

Regjistrimi Bulqësuer, ka për qëllim me njoftue sasien e tokave e mënyrën e shfrytzimit, dasien, personalin që kujdeset për këto, gjendjen e tyne në ujitje, industrinat bulqësore, maqinat ose ndërtesat të përdoruna e forcen matrice të tyne, ssijen e llojin e prodhimevet të nxjerruna në vitin bulqësuer etj. etj. Informatat për rregjistrimin e shtëpive kanë me u dhanë me formulare të veçantë prej drejtuesit shtëpies, ose prej Kryetarit t' administratës nga i cili mvaren shtëpit e ndryshme, ose prej atit që i përfaqeson.

Konsiderohet drejtues, për sa i përket rregjistrimit, ay që administron drejt për së drejti tokën me risk të vet në rast se fitimet u takojnë shumë njerzve, njifet si drejtues, ay që banon në tokën që punon dhe e drejton.

Art. 18.

Rregjistrimi i kafshëve, përfshin kualtë, gomarët, mushkat, qetë, buejt, delet, dhitë, thitë, shpezat shtëpijake, bletat, krymbat e mëndafshit etj.

Janë të përjashtuem prej rregjistrimit vetëm shtazat shtëpijake pulat, lepurat të butë shtëpijake, prodhimet e të cilave nuk shiten në treg, dhe që gjinden në qendër të Komunevet, të Kryevendeve të Prefekturave ose Nënprefekturave.

Shtazat që përfshinë regjistrimi, duhet të numrohen në vend, ku gjenden në kohën e prehjes edhe në qoftë se, gjenden jashtë komunes ku qendrojnë ; por nuk bahet në nji kohë regjistrimi i të gjithë bagtive qi gjenden në Mbretnie. Nëpunësat e rregjistrimit duhet të marrin shenim me kujdes në bazë të deftimeve të pronarve, ose zotnuesve të bagtive që gjinden në Mbretnië.

Nëpunsat e rregjistrimit duhet të marrin shenim me kujdes në baze të deftimeve të pronarve ose zotnuesve të bagtive, që janë largue prej vendit të qendrimit, në mënyrë që të behet e mundshme dhe i volitshme indentifikimi i tyne, ku gjenden efektivisht, në kohë të rregjistrimit, tue u kujdesue që të mos ngelen jashta rregjistrimit ose, mos të rregjistrohen dy a me shumë herë. Do të

rregjistrohet gjithë ashtu edhe gjaja e gjallë, që ndër disa muej, të vjetit, asht e dërguem për me kullot jashta,.

Kualë e mushkët e oficeravet ose të Ushtrisë Kombëtare, kanë me u rregjistrue mbas kujdesjes t'autoriteteve eprore të ushtrisë të gjithë se cilit vend, ose prej Drejtoris të Depove rritjeje, ashtu edhe kuajt hamshore të Qeverisë e të gjitha shtazët e ç'far do llo-ji, qi gjinden pranë instituteve kanë me u rregjistrue mbas kujdesjes së drejtuesave të tyne, dhe shenimet që i përkasin gjasë gjallë, bahen në nji formularë të veçantë.

Art. 19.

Në qoftë se gjaja e gjallë mvaret prej shtëpisë bulqësore që i përfshinë rregjistrimi bulqësuer, do të shenchet si në formularin e bagtis, ashtu edhe n'ato të shtëpive bulqësore me shenim reciprok nder dy modelet.

B. Rregjistrimi Industrial e Tregtar

Art. 20.

Rregjistrimi industrial e Tregtar përfshin Shoqniet Industriale, ushtrimet tregtare e të zejtarëve të instituteve bankare, të shtëpive të transportimit e ç' do lloj tjeter aktiviteti me karakter ekonomik.

Duhet para të rregjistrohen puntoret e Kantjerët, dyqanet, shtëpit tregtare, edhe ushtrimet industriale që tash për tsh janë vendue në banime fikse ose janë në forma shetitëse.

Përfshihen edhe ato ushtrime që e kanë me të paktin karakter tregëtar e industrial, si farmacist, ushtrimet të frizorëve e të rrugëvet.

Nuk përfshihen sypërmarrjet buiqësore, pyllore, e të bagtive, të cilat hyjnë në rregjistrimin bulqësuer e pyllor, por përfshihen në ket rregjistrim disa forma t'aktivitetit të lidhun në bulqësi dhe pyjet, si konçesionet industriale të duhanit, kur flitet për ushtrime që merren ekslusivisht në prodhimin e duhaneve të prodhue prej të treteve ; sipërmarrjet për të premunit e pyjevet për prodhimin e landës; stanet e djathit, kotecet e pulave, krymbat e mendafshit, bletet etj. Kur të jenë të ndertue me cilësi industriale e tregtare ; sharat ose të tjera stabilimente industriale që janë të ndryshme nder pyje etj. Në rast që të çfaqen dyshime mbi përfshimin e rregjistrimit të shtepive bulqësore që kanë dukje industriale e tregtare, do të përjashtohen nga rregjistrimi industrial e tregëtar, e do të rregjitrohen n'atë të bujqësiës ato ushtrime që

përvendojnë një prodhim të punimeve bulqësore të tokës me të madhe se gjysma e punimit komplesiv.

Duhet të shenohen në rregjistrimin industrial e tregëtar ushtrimet e peshkut të çfarë do llojet e me çfarë do mjetit që të bahen, përfaqësuesit tregëtarë, zyrat e këmbimit të hollash, të sigumit ose, të ndo një firmës tjeter t'aktivitetit tregëtar, komisionarët etj. etj. që për zakon ushterojnë këtë profesion ; labortoret pranë Shkollave profesionale ku punojnë refugjatet politik ose të burgosurit.

Nuk i përfshin rregjistrimi profesionet e lira, përveç rastit kur këto t'ushtrojnë aktivitetin e tyne në karakter tregtarë e industrial, si përshembell shtepit e sherimit, edhe kuer drejtimi ju asht besue mjekëve etj.

Nuk i përfshin rregjistrimi punimet e bame me shtëpija për llogari të industrialeve dhe tregëtarëve, si ato që behen në shtëpi, mbas porosis e të tjerëve, që ushtrojnë industrinë e tregetinë, si me thanë bemjen e kemisheve tue qenë që, njerëzit që kryejnë këtë soj punet njihen në numërin të personalit të ushtrimit për të cilin ata punojnë.

Kurse keta në shtepi të vet ushtrojnë nji industri ose tregëti drejt për drejt për publikun, kështu që banimi i tyne funksionon si dyqan, industria ose tregëtia kështu e ushtrueme, përfshihet prej rregjistrimit.

Këto janë punet që behen në shtëpia prej puntorëve ose tregëtarëve e industrive të vogela që kanë një klientellë të tyne direkte, roba-qepës, këpuctar, zdrukthetar, farkëtarë etj. etj.

Përfshihen në rregjistrimin hotelet, gjellëtoret, kafetë, pensionet dhe ato që japin oda me qira, kur këto mbas dukjes e stolies janë si hotele. Gjith-ashtu hyjnë në rregjistrin e sipërmarrësit teatror, cinomatografet, fabrikat e industrinat e transportimit për tokë, për ujë e air, fabrikat e duhanit, stabilimentat e banjave e të ujnave shendetsore, pastertit e petkave, sipërmarrjet e dlirësies së publikut e të mbartjes të ndytsinave të rrugave, ose të shtëpiave, pazaret e kasaphanet etj. dhe në kjofshin prej ndo nji Entit publik.

Art. 21.

Dyqanet e mbyllun në kohen e rregjistrimit, nuk i përfshinë rregjistrimi por, nëpunsat e rregjistrimit do të bajnë shenim për këto, tuj përpilue formularin e tuej shenue vetem emnin adresen e llojen e shtëpis me shenim të mbylljes nga shkaku i stinës, me gjithë ato shenime që i shofin të dobishme.

Dyqanet që nuk punojnë por janë të hapët dhe, at që janë tue u mbyll në kohën e rregjistrimit, janë të përfshime në rregjistrim.

Art. 22.

Për gjith sejcilin ushtrim industrial ose tregtar, do të perpilohet një formular i dalluem nga ushtrimet e tjera t'asaj shtëpi, edhe sikur të ndodhen në ato Komune.

Për gjithë seicilin ushtrim industrial ose tregëtar, nga ana tjeter do të përpilohet një formular i vetem sicili do qe të jetë numri i artikujve që janë objekt i prodhimit ose i tregëtis.

Në rast tregtaresh të ndryeshme t'ushtrueme me nji lokal prej të zotëve të ndryeshme, ashtu edhe në rast të formës të ndryshme të aktivitetit t'ushtruem në stabilimente ose, lokale të bashkueme e të zotnueme prej asaj shtëpije, do të përpilohen aqë formulare sa janë shtëpit e format e ktivitetit të tyne.

Në rast se Drejtorit janë të veçanta nga stabilimentat, ose shtepit qe disponojnë prej tyne o të ngrehuna në Komune të ndryshme nga ato ku gjenden këto stabilimente ose shtepija, do të perpilohen formulare të ndryshme per Drejtorit ose per stabilimentat e shtëpis.

Në rast qe Drejtorija gjendet në ato Komune ku janë Stabilimentat tregtare qe mvaren prej asaj, ato do të rregjistrohen në nji formulare të perpilueme për nji stabiliment ose per nji shtepi.

Per shtepit Bankare ose të transportimeve maritime ajrore etj. etj. gjithë se cila zyrë e mvarun ose kantier ose axhensi e tyne, formon objekt të veçantë, e do të perpilohet në nji formularë të veçantë.

Art. 23.

Rregjistrimi industrial e tregtar ka per qellim me ba të njoftun numrin e dyqaneve, karakteristikat e përgjithshme të tyne, natyren e llojin e aktivitetit të tyne, numrin llojen, moshen, nenshtetsien të njerzve e punimin e tyne, nevojen për nepunësa teknik e për puntorë të specializuem, forcat matrice e mënyrat e transportit qe perdoren prej tyne ; prodhimi e shitja vjetore; tregjet e shitjes ose burimi i mallnave të prodhueme a të shitun; vështirësit qe pengojnë zhvillimin e shtepijve (Tagret dognore, mënyrat e transportimit, e të komunikacioneve, konkurenca puntorije) etj.

Art. 24.

Informatat per rregjistrimin e shtepijve industriale e tregtare

të zejtarve, do të nepen me nji formular prej të zot, ose prej drejtuesit të tregtive, ose prej ati qe i perfaqeson.

Dispozita të Fundit

Art. 25.

Për veprimet e përmbushjes të rregjistrimit bulqesuer, industrial ose tregtar, por se kjo Rregullore nuk cakton dispozita të veçanta, do të aplikohen anallogjisht ata dispozita e instrukcione të adoptueme per rregjistrimin të popullsis, por mos të jenë në kundërshtim me dispoziten qe permban kjo Rregullore.

Kështu edhe Komunet kanë me marrë parasyesh përfundimet e rregjistrimit të popullsies e të eksperiencës të fitueme nga ajo ; per me drejtue e kompletue e kontrollue veprimet dhe perfundimet e rregjistrimit industrial e tregtar. Ministrija e Ekonomis Kombëtare, mund të dërgojë dhe të tjera instrukcione qe kanë me ju duk të nevojshme per mirëvajtjen e rregjistrimit në fjalë.

Art. 26.

Informatat e mbledhun në rregjistrim, do të ruhen në mbesheftësi të posaçme prej zyrtarëve e mund të njoftohen vetëm në formë kolektive, per vend, per natyrë e per lloj.

Asht pra e ndalueme per nepunsat e rregjistrimit, e per ata qe marrin pjesë në veprimin të rregjistrimit në fjalë, me dhanë informata dhe numra qe i perkasin vetem nji shtepije.

Art. 27.

Kjo Rregullore hyn në fuqi diten qi të jetë botue në Fletoren Zyrtare, të Mbretnis, e per zbatimin e saj asht ngarkue këshilli Ministruer.

Kryeministri e
Zav. Ministri i P. të Jashtme
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
V. Avrami

Ministri P. Mbrendëshme:
Musa Juka

Ministri i Arsimit:
H. Mosi

Ministri i Financavet
K. Thaçi

Ministri i Ekonomis Kombtare:
Mehdi Frasheri

BKSH

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e bamun me shkresen Nr. 2238-II D. 4. XII. 1930 të Kryeministris.

Si ndigjoje dhe pelqeje vendimin e Këshillit Ministruer me datë 2. XII. 1930.

DEKRETON

Aprovemin dhe zbatimin e Rregullores mbi zbatimin e Ligjes së Statistikes.

Tiranë, me 15 Dhetuer 1930.

ZOG

Nr. 4.

LIGJË 5 Kallnduer 931.

Mbi shtimin e fjalës „Blemje" në kap. 3, në budgetin e vjetit financjar 1930-31 të Ministris P. Jashtme, dhe të kapitujve 4 po të këtij budgeti të Ministris s' Ekonomis Kombtare dhe t' Arësimit, dhe shtimin e fjaleve „Blemje e mbajtje" në kap. 40 të buxhetit të Ministris së Financavet

(botue në Fletoren Zyrtare 15 Kallnduer 931 Nr. 3)

Neni. 1.

Kapitullit 3 të buxhetit të vitit në udhtim të Ministris së Punëvet të Jashtmë, dhe kapitujve 4, po të këtij buxheti të Ministris s'Ekonomis Kombëtare dhe t'Arësimit, përpara fjalës «mbajtje automobili» i shtohen edhe fjalët «blemje dhe» dhe Kap 40 të budgeti të Ministris së Financavet përpara fjalës «automobili» i shtohen fjalët «blemje e mbajtje».

Shpenzimet e blemjes do të përballohen prej shumës së kredive të caktueme qe ma parë me kapitujt e nalt-permenduna të buxhetit, për ushtrimin financjar 1930-1931 të Ministrivet të nalt-permenduna.

Neni 2.

Ministrija e Financavet, Ministrija e Ekonomis Kombëtare, Ministrija e P. të Jashtme, dhe ajo e Arësimit ngarkohen me zbatimin e këtij Dekret Ligjit.

Neni 3.

Ky Dekret-Ligje hynë në fuqi që prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli

Ministri i P. të Jashtme
e Ministri i P të Mbrendshme:
R. Fino.

Ministri Drejtsis:
A. Avrami,

Ministri i Financavet:
K. Thaçi

Ministri i P. Botore:
Izet Dibra.

Ministri i Ekonomis Kombtare:
Mehdi Frasheri.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1688-II datë 24.VII.1930,
Si ndegjoje dhe pelqeje vendimin e Këshillit Ministruer me datë 22. VII.1930.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi shtimin e disa fjalëve në Kap 3, të budgetit të vitit Financjar 1930 - 1931 të Ministris së P. të Jashtme, në kapitujt 4, po të këtij budgeti të Ministris s'Ekonomis Kombëtare dhe t'Arsimit, dhe në Kap. 40 të budgetit të Ministris së Financavet.

Tiranë, me 11 Gusht 1930,

ZOG.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarve

DEKRETON

Zbatimin e Dekret-Ligjit me datë 11 Gusht 1930, të votuem prej Parlamentit, dhe Urdhënon shtimin e tij në Kodet e Mbretnis si Ligje.

Tiranë, me 5 Kallnduer 1931.

ZOG

Nr. 5.

LIGJË 5 Kallnduer 931.

Mbi bartjen e nji fondi prej fr. ari 10.000 prej kap. 1 në kap. 2 të buxhetit të Ministris së Drejtësis t' ushtërimit 1930-31.

(botue në Fletoren Zyrtare 15 Kallnduer 1931 Nr. 3)

Art. 1.

Autorizohet bartja e Fr. ari 10000 (dhetmij) prej Kap. 1. rrogë personali mbas kuadrit dhe, rrogë zavedësije» të buxhetit t'ushtrimit 1930-931, të Ministris së Drejtësies në Kapitullin 2 shpenzime udhtimi e djetë për emnime e transferime të nëpunsave dhe inspketime » po të ketij budgeti të Ministrisë së përmendun

Art. 2.

Ministrija e Financavet dhe ajo e Drejtësies ngarkohen me zbatimin e kësaj ligjë.

Art. .3

Kjo Ligjë hyn në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi bartjen e nji fondi prej Fr. ari 10.000 në budgetin 1930-31 të Ministriës së Drejtësies, i votuem prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 906-1 datë 29-XII-30 të Kryesis të Tij.

Tiranë, me 5 Kallënduer 1931

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli.

Zv. Ministri i Drejtësies
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
K. Thaçi

BIBLIOTEKA KOMBETARE
TIRANE

BKSH

Nr. 6.

LIGJË, 5. Kallnduer 1931

Mbi bartjen e nji fondi prej fr. ari 6050 të budgetit 1930-31 të Ministris s' Ekonomis Kombtare

(botue në Fletoren Zyrtare 15 Kallnduer 931 Nr. 3)

Art. 1.

Në budgetin preventiv t'ushtrimit 1930-1931 të Ministriës s'Ekonomis Kombëtare, bartet një fond prej fr. ari 6050 (gjashtëmijëpesëdhetë) prej Kap. 8. (Ngrefje bleg. mendafshi, avikulture etj) 11. «Ushqim, veshje, mbathje e shpenz. tjera për Shkollen e Bulqësies».

Art. 2.

Kjo ligjë hyn në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3

Me zbatimin e kësaj Ligjë, ngarkohet Ministrija Ekonomis Kombëtare.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi bartjen e nji fondi prej fr. ari 6050, në buxhetin 1930-31 të Ministriës s' Ekonomis Kombëtare, të votuem prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 901-I datë 29-XII. 930 të Kryesiës së Tij.

Tiranë, me 5 Kallnduer 931

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Financavet:
K. Thaçi

Ministri Ekonomis Kombëtare
Mehdi Frasheri

BkSh

Nr. 7.

LIGJË, 2 Kallnduer 931.

Mbi zgjatimin e afatit të ligjës ndeshkimore për faje politike me datë 23-XII-925

(e botunme në Fletoren Zyrtare Nr. 3 dat 15 Kallnuer 1931)

Neni. 1.

Dispozitat e Ligjës ndeshkimore për faje politike me datë 23-XII-925, qi marrin fund me 29-XII-930, me gjith ndryshimet dhe shtojcat e bamuna në kohera të ndryshme mbi atë ligjë, vijojnë në fuqi edhe për tre vjet të tjera deri me datë 29-12-1933.

Neni 2.

Kjo ligjë hyn në fuqi prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 3.

Ministria e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Drejtësis ngarkohen me zbatimin e kësaj ligjë.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve
DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e ligjit mbi zgjatimin e afatit të ligjës ndeshkimore për faje politike me datë 23-XII-925, e votuem prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 882-1 datë 27-XII-930 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 2 Kallnuer 931.

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Zav. Ministri i Drejtësis
Pandeli Evangjeli

Ministri P. Mbrendëshme:
Musa Juka

Nr. 8.

INTERPRETIM, 2 Kallnuer 1931

Autentik i nenit 63 të ligjës mbi Reformën Agrare

(e botueme në Fletoren Zyrtare Nr. 3 datë 15 Kallnuer 1931)

Neni 1.

Moratoriumi i përmendun në nenin 63 të ligjës mbi Reformën Agrare përmbledh gjith far soj borxhesh qi eksistojnë me ç'do qellim, midis bulqeve dhe hua dhenësve cilet do qi të jenë; gjithashtu me fjalën «bujk» të përmendun ne këtë Nen, përfshihen bujqit qi tregohen në paragrafet a, b, c të Nenit 1 të ligjës Agrare.

BIBLIOTEKA KOMBETARE
TIRANE

Neni 2.

Ky interpretim hyn në fuqi qysh prej datës qi ka me hy në fuqi ligja mbi Reformën Agrare.

Neni 3.

Zbatimi i Nenit 65 të ligjës mbi Reformën Agrare me interpretimin si mbas nenit 1, të sipërme, i ngarkohet trupit Ministruer.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve
DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e interpretimit të nenit 63 të ligjës mbi Reformën Agrare, i votuem prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 775-I datë 2-XII-930 të Kryesis së Tij.

ZOG.

Tiranë, me 2 Kallnuer 1931

Kryeministri
Zav. Ministri P. të Jashtme
Pandeli Evangjeli

Zav. Ministri i Drejtësis
Pandeli Evangjeli

Ministri i Arsimit
Hil Mosi

Ministri P. të Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
K. Thaçi

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri Ekonomis Kombëtare
Mehdi Frasheri

Nr. 9.

LIGJË, 2 Kallnuer 1931

Mbi ndryshimin e pikës 4 të Nenit 3 dhe të Nenit 26 të ligjës mbi themelimin e odave t' Ekonomis me datë 14 Mars 1929

(Botue në Fletoren *Zyrtase* N. 3 datë 15-I-1931)

Neni 1.

Pika 4 e nenit 3 të ligjës për themelimin e Odave t,Ekonomis, me datë 14 Mars 1929, ndryshohet në këtë mënyrë :

Me njeh e regjistrue bujqit (proprietarët, bujqit e qiramarrsit) tregtarët, industrialet dhe çdo lloji Shoqni tregtare ose civile tue, i nda në tri klasë, dhe çdo klasë, mbasi të meret parasysh madhsija e t'ardhunave të çdo antarit të sajë, në katër kategori, dhe tue shenue në rregjistrat të posatshme ndryshimet qi mund të rrjedhin n'aktivitetin e tyne.

BIBL. - TEKA KOMBETARE TIRANE

Neni 2.

Neni 26 i Ligjës për themelimin e Odave t' Ekonomis me datë 14 Mars 1929 ndryshohet në ketë mënyrë :

Të gjithë ata qi janë të detyruem me u shkrue si antarë n'Odat e Ekonomis paguejnë nji pagesë antarije të përvjetshme, për ket qellim antarët ndahen në tri klasë :

Klasa e parë përfshin Shoqerit Anonime, Shoqërit n'Akomandit në aksione, Shoqërit me garanci të kufizueme, të gjithë axhensit detara, proprietaret qi kanë në zotnim dhe personat qi kanë me qira ma shumë se 150 hektar tokë.

Klasa e dytë përfshijnë të gjithë filijalet e Shoqnive të ndryeshme tregtarë, Shoqnit Civile, Shoqnit kolektive dhe n'akomanditë, të gjithë tregtarët e industrialet dhe, proprietaret e tokave qi kanë në zotnimin e vet dhe, ata që kanë me qira jo ma pakë se 40 hektarë, dhe jo ma shumë se 150 hektar tokë.

Klasa e tret përfshijnë bujqit (kjofshin këta proprietarë, ose bujqë preletar ose pujqë qiramarrës) qi kanë nen zotnim ose me qira deri me 40 hektar tokë.

Neni 3.

Si e cila prej klasave të nalt-përmenduna do të ndahet tue marrë për bazë t'ardhunavet e antarve të sajë, në ktegori të cilat do të paguejnë si pagesë antarije të përvjetshme, në mënyrë qi vijon :

Klasa e I.

Kategori e	I.	400	fr. ari	(katerqind
« «	II.	300	« «	(treqind)
« «	III.	200	« «	(dyqind)
« «	IV	100	« «	(njiqind)

Klasa e dytë :

Kategori e	I.	50	fr. ari	(pesëdhetë)
« «	II.	35	« «	(tridhetepesë)
« «	III.	25	« «	(njizetepesë)
« «	IV.	15	« «	(pesëmbëdhetë)
« «	V.	10	« «	(dhetë)
« «	VI.	5	« «	(pesë)

Klasa e tretë

Kategorija e	I.	15	fr. ari	(pesëmbëdhetë)
« «	II.	10	« «	(dhetë)
« «	III.	5	« «	(pesë)
« «	IV	2.50	« «	(dy e pesdhet %)

Këshilli i Odës me iniciativen e vet ose në kërkimin e t'intesuemve mund të përjashtojë nga pagesa anëtaret e kategoris 4, të klasës së tretë në kjoftë se provohet qi fuqija e tyne ekonomike asht fare e dobët.

Neni 4.

Kjo ligjë hynë në fuqi 15 dit mbas shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare.

Neni 5.

Ministrija e Drejtësies ; Ministrija e P. të Mbrendëshme,

Ministrija e Financavet dhe, ajo e Ekonomis Kombëtare janë të ngarkueme me zbatimin e kësaj ligjë.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi ndryshimin e pikës 4 të nenit 3 dhe të nenit 26 të ligjës mbi themelimin e Odave t'Ekonomis me datë 14 Mars 1929, i votuem prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 787-I datë 20.XII. 930 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 2 Kallnuer 1931.

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Zav. Ministri i Drejtësis
Pandeli Evangjeli

Ministri P. Mbrendëshme:
Musa Juka

Ministri i Financavet
K. Thaçi

Ministri Ekonomis Kombëtare
Mehdi Frasheri

Nr. 10.

TRAKTAT, 2 Kallnduer 1931

Miqsije dhe tregtije midis Shqipnis dhe Japonis

(Botue në Fletosen Zystare N. 3 datë 15-I-1931)

Nalt-Madhnija e Tij Mbreti i Shqiptarëvet dhe Nalt-Madhënija e Tij Imperatori i Japonit, të frymëzuem prej dëshirës qi me forcuem marrëdhaniet miqësore qi ekzistojnë midis shtetevet të tyne, dhe me zhvilluem raportet e tyne tregtare, kanë vendosun të përfundojnë nji Traktat Miqësije dhe Tregtije, dhe për ketë qellim kanë emnuem fuqiplotet e vet respektive don me thanë :

Nalt-Madhënija e Tij Mbreti i Shqiptarëvet

Zotin Ali Asllani Minister Residente në Athinë, dhe Nalt-Madhënija e Tij Imperatori i Japonit.

Zotin Nabutaro Kavashima Jushii, i dërguem në klasen e tretë të Urdhunit Imperial të Thesarit të shenjte, i dërguem i Jasht zakonshem e Minister Fuqiplotë në Athinë, të cilët, mbassi i kumtuen shoshoqit letrat fuqiplote të tyne qi u gjeten në formen e mirë dhe të duhun, kanë vendosun nenet qi vazhdojnë :

Neni 1.

Do të ketë paq të perherëshem dhe miqësie të patundëshme midis Mbretnies Shqiptare dhe Imperatoris së Japonit si dhe midis Shteteve respektiv.

Neni 2.

Palët e Nalta kontraktuese vendosin qi përfaqësu sit diplloma-tik të së cilës prej tyne do të qenë, në tokën e tjetres tratamentin e konsakruem prej parimeve të së drejtës komune nderkombë-tare.

Neni 3.

Se cilla prej Palevet të Nalta kontraktuese do të ketë të drejtë me emnuem Krye-Konsuj, Konsuj, Nenkonsuj, dhe Agjente kon-sullore per t'i bamë me qëndruem në të gjitha portet dhe vendet e tokës së palës tjetre kontraktuese, në të cilat kanë leje të qën-drojnë po këta zyrtare Konsullore të ndonji Shteti tjeter.

Këto Zyrtarë Konsullorë do të gëzojnë, nen rezerve recipro-citeti, në tokat e tjetres, po ata të drejta, privilegje dhe eksep-cjone qi u janë ose do t'u jenë akorduem Zyrtarevet konsullorë të Kombit ma të favorizuem.

Neni 4.

Palët e Nalta Kontraktuese detyrohen t'i akordojnë njana tje-tres reciprokisht tratamentin e kombit ma të favorizuem persa i perket tregëtien, të drejtat doganore dhe lundrimi, si dhe lirien me hyem, me udhëtuem me qendruem dhe me banumun, ush-trimin e mjeshtrievet, të tregtimevet dhe t'industriëvet dhe trata-mentin Kombtar ose tratamentin e Kombit ma të favorizuem per sa i perket barrat, taksart dhe impostat direkte ose indirekte.

Neni 5.

Ky traktat do të ratifikohet dhe ratifikimet do të shkëmbehen në Athinë, sa ma shpejtë qi të jetë e mundun. Do të hyjë në fuqi pesëmbdhet ditë pas shkembimit të ratifikimevet dhe do të mbesë në veprim per nji afat prej tre vjetësh, tue nisun prej hymjes së tij në fuqi.

Me gjithë këtë, në qoftë se nuk do të denoncohet gjashtë muej para mbarimit të këtij afati, do të zgjatohet tacitisht per nji afat të para caktuem dhe do të jetë at-herë i denoncueshem në ç'do kohë tue mbetun në veprim për gjashtë muej nisun nga dita e denon-cimit.

Në besim të seciles, Fuqiplotët e kanë nenshkruem dhe e kanë mveshun me vulat e tyne.

Bamun n'Athinë në dy ekzamplarë Frengjisht, diten e njizette të muejit të gjashtë të vitit të pestë të Showas, qi i përgjigjet njizet Qershorit të vitit njimij e nandëqindë e tridhjet.

Per Japonin :
N. Kawashima

Per Shqipnien :
Ali Asllani

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve
DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Traktatit të Miqësies dhe të Tregëtiës lidhun midis Shqipëniës dhe Japonit, i votuem prej Pralmentit si mbas shkresës Nr. 836-1 datë 8-XII-1930, të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 2 Kallnuer 1931.

ZOG

Kryeministri:
Zav. Ministri P. të Jashtme
Pandeli Evangjeli

Nr. 11.

LIGJË, 2 Kallnuer 931.

Shtojcë e Ligjës mbi detyrimin e punimit me vegla moderne bulqësore me datë 19 Prill 1929

(botue në Fletoren Zyrtare Nr. 4 datë 17 Kallnuer 1931)

Neni 1.

Art. 10 ndryshohet në këtë mënyrë: Vegla dhe çdo send tjeter bulqësije qi do t'u ndahen të detyruemve, në rast qi këta vleftjen e paguajnë në dorë do t'u dorëzohet me çmimin e kushtimit deri në depon e Ministries s'Ekonomis Kombëtare dhe në rast qi veglat e sendet e sipëtregueme u shiten të detyruemve me kredi të dame ner kishte, vleftës së kushtimit i shtohet 3% e cila i jepet si shpërblim tagrambledhësve qi nxjerrin këto kredina.

Neni 2.

Art 23, Abrogohet.

Neni 3.

Në rasë qi në bazë të dispozitave të kësaj ligjë, shperndahen në per bujqit t'atilla vegla moderne, qi për reparimin e tyne, mjetet reparuese qi do të ekzistojnë nuk do munden me e bamun këtë sherbim, Ministrija e Ekonomis Kombëtare drejt per drejt ose me anë të dhomave t'Ekonomis Kombëtare, detyrohet me i sigurue reparimin e tyne me mjetet e duhuna.

Neni 4.

Per zbatimin e kësaj ligjë ngarkohet Ministrija e Ekonomis Kombëtare dhe Ministrija e Financavet.

Neni 5.

Kjo ligjë hyn në fuqi 15 ditë mbas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve
DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës si Shtojce e Ligjit mbi detyrimin e punimit me vegla moderne Bulqësore me datë 19 Prill 1929, votuem prej Parlamentit simbas shkresës Nr. 165-III datë 5. XII. 930 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 2 Kallnduer 1931.

ZOG

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet:
K. Thaçi

Ministri Ekonomis Kombëtare
Mehdi Frasheri

Nr. 12.

LIGJË, 2 Kallnuer 931.

Mbi bartjen e nji fondi prej fr. ari 60.000 (gjashtëdhetmijë) në buxhetin 1930-31 prej Kap. 1 të Komandës së Mbrojtjes Kombëtare nen Kap. 26 bis të Ministris së P. të Mbrendëshme.

(botue në Fletoren Zyrtare Nr. 4 datë 17 Kallnuer 1931)

Art. 1.

Bartet nji fond prej Fr. ari 60.000 (gjashtedhetmije) prej Kap. 1 «Rrogë Oficerash e personalit civil» të buxhetit 1930-31 të Komandës së Mbrojtjes Kombëtare në Kap. 26 bis, «Shpenzime gjithfarësh për të damtuemit e termetit të Vlonës e të rrethevet të saja» të budgetit udhtues të Ministris së P. të Mbrendëshme.

Art. 2.

Kjo ligjë hyn në fuqi më ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi bartjen e nji fondi prej fr. ri 60.000 në budgetin 1930-1931 prej Kap. 1 të Komandës së Mbrojtjes Kombëtare në Kap. 26 bis të Ministris së P. të Mbrendëshme, i votuem prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 900-datë 20. XII. 930, të Kryesies së Tij.

Tiranë 2 Kallnuer 931.

ZOG

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli
Ministri i Financavet
K. Thaçi

Ministri P. të Mbrendshme
Musa Juka

Nr. 13.

LIGJË, 2 Kallnduer 931

Mbi zgjatimin e dytë t' afatit të kërkimeve për voj gurin Grupit Franko-Shqiptare qi ka konçesjonin me konvencion me datë 18 Dhetuer 925

(botue në Fletoren Zyrtare Nr. 4 datë 17 Kallnuer 1931)

Art. 1. -- Afati i kërkimeve në thellime e në detajë për vojgurin akordue me konvencion datë 18-XII-925 Grupit Franko-Shqiptar e zgjatue për herën e parë për dy vjet prej 18-VI-930 deri 18 Qershur 931 zgjatohet edhe për herën e dytë për nji kohë tre vjetësh tue fillue prej datës 18 Qershuer 931 deri 18 Qershuer 1934.

Art. 2. -- Kjo Ligjë hyn në fuqi me shpalljen e saj në Fletoren Zyrtare.

Art. 3. -- Me zbatimin e kësaj ligje ngårkohen Ministrija e Ekonomis Kombtare.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e ligjit mbi zgjatimin e dytë t'aftit të kerkuem për voj-gurin Grupit Franko-Shqiptare, qi ka koncesjo-

nin me datë 18 Dhetuer 925 i votuem prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 820[I datë 25-XI-930 të Kryesis së Tij.

ZOG

Tiranë, me 2 Kallnduer 1931
Kryeministri:
Pandeli Evangjeli

Ministri i Ekonomis Kombtare:
Mehdi Frasheri

Nr. 14.

L I G J Ë 12 Qershuer 1930

Mbi zbatimin e P. Kontratës mbi shfrytzimin e Pyellit "Mollung„

(botue në Fletoren Zyrtare Nr. 4 datë 17 Kallnuer 1931)

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarvet
DEKRETON

Zbatimin e Projekt-Kontratës mbi shfrytëzimin e Pyllit «Molung» të votueme prej Parlamentit, dhe Urdhënon shtimin e saj në Kodet e Mbretënis si ligjë.

ZOG

Tiranë, 12 Qershor 1930.

KONTRATË

Në mes të Ministrit t' Ekonomis Kombtare Z. Mehdi Frashëri, si përfaqësues i Qeveris shqiptare me njenën ane, dhe Z. Gr. Uff. Ing. Oreste Jacobini, Administrator i Pergjithshme i Aciendes së Pyjevet në shqipni me tjetrën, vendoset si ma poshtë:

Art. 1.

Qeverija Shqiptare i shet acjendës së Pyjevet në Shqipni (e cila mbas tshit do të quhet A. I. B. A.) të gjitha drut qi mundë të apin traversa traversoni e landa për ndertime, të llojevet të lisit (quercus robur sessiflora quer robur pedunculata) si dhe të qarrit (quercus ceris) qi ndodhen në pjesën shtetnore të pyellit Molung të krahinës se Rubikut të Nenprefekturës së Leshës, pjesë e cila përfshihet mbrenda kufijve tue fillue të qafa e Shparsit e tuej ndjek kështu bregun e djatht të projit Rrasefikut deri ku ky derdhet në Lumin e Fandit, këndej tue ndjekë përsëri bregun e djathtë të Fandit deri në bashkim të tij me Lumin e Matit, tuj vazhdue mandej gjatë bregut të djathtë të Lumit të Matit deri te Ura ZOGU, ku shmanget tuj ndjekë udhen kombtare Tiranë-Shkoder deri në kryqezim të kësaj me pronin e Madh, gjatë të cilit vazhdon përpjetë deri te qafa e Shparsit qi u përmend.

Art. 2.

Mbrenda kufijve të përmendun n'artikullin e sipërme dhe përpara se të fillejnë ç' do veprim punimi në pyllë do të ndahen e të kufizohen të gjitha pjesët qi si mbas Ligjës i takon komunalisht katundevet, si edhe ato pjesë qi zotnohen ligjisht nga privatët ose ndonji Ent tjetër publik, tuej i përjashtuem këto plotësisht nga objekti i kësaj kontrate.

Art. 3.

Qeverija Shqiptare i jepë të drejtë A. I. B. A. me përdorë për të gjithë kohen qi të zgjatet kjo kontratë e pa kurrënji detyrim pagese fuqit e ujnave të prrojeve e lumnave qi ndodhen mbrenda ase për kufi pyllit me qëllim përdorimi të nevojshem për të preme të punueme e transportuem të drujve qi formojnë opjekte të kësaj kontrate përdorim i cili do të bahet gjith-herë në mënyrë qi mos të cenohen në kurrnji pikpamje të drejtat e Shtetit dhe të privateve.

Mundë të kufizohet ose t'i hiqet kjo e drejtë përdorimit A. I. B. A., at-herë, kur se Shteti në ligjët t'imponojnë mbi ata ujna konçesione të veçanta.

Art. 4.

Qeverija Shqiptare detyrohet në favor t' A. I. B. A.-s me përjashtue nga tagri doganuer.

a) të gjithë makinarët, vegla e të tjera mjete punimi të nevojshme për realizimin e kësaj kontrate.

b) të gjithë drutë e punueme qi do t'eksportojnë të cilat formojnë objektet të kësaj kontrate.

Neni 5.

Qeverija Shqiptare i jep të drejtë A. I. B. A.-s me përdorue pa pagesë e mbrenda afatit të kësaj kontrate të gjithë materialin e makinarin për të venduemit të dekovilit qi ndodhet sot gjatë rrugës që prej «Urës ZOGU» e deri në Shingjin me detyrë që në mbarim të afatit të kontratës A. I. B. A. t'a kthejë materialin e sipër-përmendun në gjendje në të cillen ka me u ndodhë n' ate kohë.

Art. 6.

Qeverija Shqiptare detyrohet me i a garantue të drejtat e konçesjonueme A. I. B. A.-s me këtë kontratë kundra çdo pretendimit nga çdo person i tretë fizike e moral qi bahet jashtë udhes legale.

Art. 7.

Qeverija Shqiptare i përjashton A. I B. A.-s kapitalin e fitimit

e kësaj sipërmarrje nga çdo taksë e tashme dhe e ardhëshme.

Art. 8.

Kjo Kontratë zgjatet për 5 (pesë) vjetë, tue fillue ç'prej datës së shpalljes kësaj në Fletoren Zyrtare.

Mbrenda kësaj periudhe A. I. B. A. ashtë e detyrueme me pre, me punue e me transportue jashta zonës së përshkrueme n'artikullin e parë të gjithë drujtë me nji diametër të paken m. 0.30 të matun nji metër nga toka qi si mbas ligjës së Pyjeve Shqiptare qi mundë të priten në mbështetje të kritereve ma të mira me nji minimum prej 10.000, m3 (dhetmij) në dy vjetet e para prej datës sipërthanun e 5000 m3 (pesëmij) për se të cilën vjete vazhdues.

Art. 9.

A. I. B. A. ashtë e detyrueme me i pague Qeveris Shqiptare e për se të cilen metro kub landetore të marun Fr. ari 5.50 (pes e pesdhet) dhe përse të cilen tonelat drue zjarmi Fr. ari 2 (dy).

Çmimi i drues landësore do t' aplikohet vetëm ndër pjesët të trupeve të përdorshme për pregatitjen e traversave për hekurudhë traversoni dhe landë ndertimi edhe ndër degat e nji diametër 26 centimetër gjithnji qi të mundet të pregatiten landë të llojeve të përmenduna.

Mbetja e së cilës dru do të quhet dru zjarmi.

Dorëzimi i drujve do të bahet në kembë dhe mbajtja e tyne do të bahet mbasi të jenë përjashtue trshsija e lëkurës.

Për së të cilin dorëzim do të bahet nji proces-verbal qi A. I. B. A. do t'a nënshkrojë dhe mbassi të jetë ba pagesa mundë të fillohet të premit.

Art. 10.

A. I. B. A. nuk ka me mundë me nxjerë jashtë pyllit landë pa pasë autorizimin e Administratës së Pyjeve për të cilin kontroll të landës do të caktohen depozita fikse në pyllë ndër të cilat do të mbledhet landa para se të nxirret jashtë pyllit.

Art. 11.

A. I. B A. asht e detyrueme me formue e me i a paraqit Ministris së Ekonomis Kombtare, planin pesë-vjeçar të shfrytëzimit të pyllit të konçeduem dhe vetëm mbasi të kenë marrë pelqimin prej kësajë mundë të fillojnë prerjen.

Plani i shfrytëzimit do të hartohet ne bashkëpunim me personal që ka m'u caktue prej Administratës së Pyjeve.

Art. 12.

A. I. B. A. asht e detyrueme me rispektue plotesisht e pa kur-

farë kundërshtimi të gjitha masat teknike qi do t'i përshkruhen nga Administrata e Fyjeve në konformitet të ligjës në vijim të kritereve ma të mira sidocmos per sa i përket rigeneracionit të zonave të Pyllit punucm dhe për sa ky nuk mundet m'u pase natyrisht, asht e detyrueme me ba pyllzime artificjale ku e si t'a lypë nevoja.

Art. 13.

A. I. B. A. detyrohet me i shitë Qeverisë materialet e prodhuem me çëmim të kushtimit, por vetëm në sasi të nevojshme për ndertim rrugash, dhe me masë jo ma tepër se 10% të prodhimit të pergjithshëm vjetuer.

Art. 14.

Për instalacionet e nevojshmë për punim e transportim A. I. B. A, ka të drejtë me pushtue përkohësisht dhe pa kenë e detyrueme me pague kurfarë shperblimit, të gjitha tokat shtetnore qi mundë t'i lypen kurse të jenë të punueme prej A. I. B. A. asht e detyrueme me pague frytin e damtuem.

Për tokat private të nevojëshme per instalacione, per të cilat u ba fjala mâ siper, Qeverija do të ndermjetsohet me ba shpronesimin e perkohëshem, tuj i mbetë A.I.B.A.-s pagimi i shperblimit të shpronësimit, qi do të llogoritet pa mvarisht nga permbajtja e këtij konvencionit.

Art. 15.

As ndonji shperblim nuk mundë t'i paguhet privateve per të vuem të shtyllave të linjeve telefonike dhe transmetimin e fuqis eletrike qi kjo ka me ndertue per shfrytëzimin e pyllit të marrun.

Art. 16.

Të gjithë puntorët e A. I. B. A.-s me përjashtim të personelit mbikëqyrës e drejtues si edhe të specialistavet me punim e transportim të landës, duhet të jenë Shqiptarë; të gjithë personeli tjeter qi u perjashtue, mundë të jenë Italian ose të huej.

Art. 17.

Në mbarim të kontratës, të gjithë instalimet fikse të punimit e të transportit të druejve, vetem qi të jenë të perdoruna së pakut per tre vjet, kanë me mbetë pronë e Qeveris Shqiptare, në vende dhe në gjendje që ndodhen në punimet e fundëshme.

Gjithçka prej instalimeve fikse të shenjueme siper, qi nuk do të jenë perdorë në perjudhen e sipër-permendun, si edhe të gjitha materialet e fundëshme do të merren prej A.I.B.A.-s.

Art. 18.

A.I.B.A. para se të nënshkruhet kontrata, si garanci të detyri-

meve qi rrjedhin nga ky konvencion detyrohet me depozitue në Bankën Kombëtare të Shqipnies, shumen Fr. ari 35.000 (tridhet e pesmij) në vleftë ase në Tituj të Shtetit.

A.I.B.A. asht e lirë me terhjekë shumën e garancies së naltpermendun atëherë kuer të kenë sjellë në Shqipni at sasi makinash qi të kapin vleften Fr. ari 35.000 (tridhet e pesmij) mbi të cillat makina eventualisht Qeverija Shqiptare do të mundet me ushtrue të drejtën e sekuestrimit.

Art. 1.9

A.I.B.A. detyrohet me fillue punimet mbrenda gjashtë muejve ç'prej datës së dorëzimit të ma së pares sasië drujshe, përndryshe, shuma e depozitueme me titull garancijet ose ekuivalenti n'instalime fikse të kësaj shumë, do të sekuestrohen prej Qeveris Shqiptare, pa i mbetë A.I.B.A.-s kurrnjë e drejtë pretëndimit.

Art. 20.

Persa nuk bane fjalë ky konvencion A.I.B.A. asht e detyrueme me i shtrue plotsisht ligjeve të Mbretënis Shqiptare.

Art. 21.

Sejcila prej anëve kontraktuese ka të drejtë me dënoncue tjetrën, në qoftë se ajo i mungon detyrimeve të marruna sypri, kështu edhe ka të drejtë me kerkue në ç'do mënyrë shperblim prej tjetres per damet e shkaktueme në mungimin e përmbushjes së këtyne detyrimeve.

Art. 22.

Për konsekuencat juridike qi rrjedhin nga kjo kontratë A.I.B.A. zgjedhë si banim të vetin qytetin e Tiranës.

Në rasë konflikti në mes të kontraktuesve, këto do t'ja parashtrojnë çeshtjen nji kolegji arbitruer, i përbamë prej tre misëve, prej të cilëve njeni do t'emnohet prej Qeveris, nji tjeter prej Konçesionarit dhe i treti do të zgjidhet prej dy arbitrave të parë. Në qoftë se këta nuk kanë me mujtë me baketë zgjedhje kjo ka për t'u ba prej Gjyqit të Diktimit Shqiptar.

Art. 23.

Me lejen e Qeveris, A.I.B.A. ka me mundë me transferue personat e të tjerë të shoqëninave të gjithë të drejtat dhe detyrimet qi rrjedhin nga kjo Kontratë.

Art. 24.

Ky konvencion asht rredizhuem Shqip dhe Italisht, dhe asht në katër eksamplare të nenshkruem prej dy anëvet kontraktuese. Dy ekzemplare (nji tekst Shqip dhe nji tekst Italisht) do të

ruehen në Arshivat e Shtetit, dhe të dy të tjerët do t'i dorëzohen A. I. B. A.-s.

Në rast dyshimi ose diskutimesh të shkaktueme prej ndryshimeve t'interpretimit ka për t'i u-besue tekstit Shqip.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

Si studjoi Projekt-Kontraten mbi shfrytëzimin e Pyllit «Molung». të paraqitun me shkresën Nr. 1044-IV datë 2-VI-1930 të Kryeministris.

Si ndigjojë dhe pelqejë Vendimin e Këshillit Ministruer me datë 30-V-1930.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Kontratës së lidhun në me të Z. Mehdi Frasherit, Ministri i Ekonomis Kombëtare si përfaqësues i Qeveris Shqiptare, dhe të Z. Gr. Off. Ingjinier Oreste Jakcobini, mbi shfrytëzimin e pjesës Shtetnore të Pyllit Molung të krahinës së Rubikut të Nenprefekturës së Leshes.

Tiranë, me 12 Qershuer 1930.

ZOG

Kryeministri:
Zav. Ministri P. të Jashtme
Pandeli Evangjeli

Ministri i Ekonomis Kombtare
Mehdi Frasheri

Nr. 15.

LIGJE, 20 Kallnuer 1931.

Mbi transferim kreditash të budgeteve të Ministris së P. Mbrendëshme, të Drejt. P. të Shëndetsis, të Komandës Mbrojtjes Kombtare e të Gjindarmeris dhe të Ministris P. Botore ushtrimi 1930-31.

(botue në Fletoren Zyrtare Nr. 5 datë 21 Kallnuer 1931)

Art. 1.

Zbriten prej kapitullit 6 «Fletore Zyrtare» Fr. ari 4.500 të degës Administratës së P. të Mmbrendshme, prej Kap. 13 «Udhtim e djetë» Fr. ari 1.500. Kap. 22 «shpenzime per kater shtreten t'angazhuem për kliniken e syve, Fr. ari 2.000, Kap. 24 «Burse Speciali-

zimi» Fr. ari 4.500. Dhe prej Kap. 28. «qirana të pa pagueshme per mungesë fondi» Spitalit të Shkodrës Fr. ari 670, të degës së Shëndetsies botore ; prej Kap. 23 «Rrogë graduatësh e Gjindarmësh» Fr. ari 35.000, të budgetit të Komandës së P. të Gjindarmeris prej Kap. 6 «shpenzime të përgjithshme të Komandave e të Grupeve e shpenzime per Bandat Mbretnore e Ushtarake Fr. ari 15.000 — prej Kap. 8. «Blemje e përsëritje e mirëmbajtje e mobiljevet e materialit të Kazermavet, kashtë për shtrese ushtarësh, zjermë e dritë» Fr. ari 10.000, të budgetit të Komandës së Mbrojtjes Kombëtare dhe prej Kap. 7 «Ndërtime e mbajtje udhash e urash e blemje e mbajtje kamjonesh» Fr. ari 30.000, të budgetit të Ministris së P. Botore ushtrimi 1930-1931.

Art. 2.

Për mbledhjen e shumave të zbrituna n'art. I. të kësaj Ligje Fr. ari 103.170 i mveshen kapitullit 5 «subvencion komunave» Fr. ari 50.0000 dhe kapitulli 11 «shpenzime të mëshefta» Fr. ari 53.170 (pesdhetetrimij e njiqindeshtatdhetë) të buxhetit të Ministris së P. të Mbrendshme ushtrimi 1930-1931.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi qe me daten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministrija e Financavet e P. Botore, dhe ajo e P. të Mbrendshme.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarvet
DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi transferim kreditash të budgeteve t'instituteve të ndryëshme, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 927-I datë 13-I-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 20 Kallnduer 1931.

ZOG

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri P. të Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
K. Thaçi

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Nr. 16.

LIGJË, 20 Kallnduer 1931.

Mbi bartje fondesh në budgetin e Komandës së P. të Gjindarmaris për ushtrimin financjar 1930-31

(botue në Fletoren Zyrtare Nr. 6 datë 26 Kallnuer 1931)

Neni 1.

Autorizohet bartja e fondeve prej fr. ari 29,600 nga Kapitulli 22 Rrogë oficeri personeli civil, dhe fr. ari 26.400 nga Kapitulli 23 Rrogë Graduati e Gjindarmësh», prej të cilavet fr. ari 10.000, i mvi shen kapitullit 26 «shpenzime Zyre» dhe fr. ari 46.000, i shtohet kapitullit 30 «vesh-mbathje» të buxhetit të Gjindarmeris të vitit va zhdues 1930-31.

Neni 2.

Kjo ligjë hynë në fuqi çë prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 3.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e ligjit mbi bartje fondesh në budgetin udhtues të Komandës së P. të Gjindarmeriës, i votuem prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 926-I datë 12-I-931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 20 Kalldüer 1931.

ZOG

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
K. Thaçi

Nr. 17.

LIGJ 20 Kallnuer 31.

Mbi krijimin e nji Zyre Organizatori

(botue në Fletoren Zyrtare Nr. 7 datë 29 Kallnuer 1931)

Art. 1.

Në Ministrin e P. të Mbrendëshme krijohet Zyra e nji organizatori e cila ka me fonksionue deri me 31 Marc 1931. Mbas kësaj datë zyra syprimohet

Art. 2.

Per me perballue shpenzimet e këtij organizatori specialist t'angazhuem me kontratë nga Ministria e P. të Mbrendëshme, autorizohet Ministria e Financavet me pague nga fondi Rezerv e me titullin «shperblim specialisti» 24.000 Fr. ari deri në mbarim të vitit financjar udhtues me 3.600 fr. ari po mbrenda kësaj kohë për qiranë e banimit të të përmendunit, si edhe shumen 3.600 fr. ari për Dragomanin e këtij specialisti po mbrenda asaj kohë.

Art. 3.

Mënyra e ushtrimit të sherbimit të tij bashkë me menyrën e pagimit caktohen me kontratë, e cila mbetet në veprim deri në datën 31 Mars 1931.

Art. 4.

Ministria e Financavet dhe e P. të Mbrendëshme ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

Kjo Dekret-Ligje hyn në fuqi qe nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri e
Pandeli Evangjeli.

Ministri i P. të Jashtme
Zev. Ministri i P. Mbrendëshme
R. Fico

Ministri i Drejtsis
V. Avrami

Ministri i Arsimit:
H. Mosi

Ministri i Financavet
K. Thaçi

Ministri i P. Botore
Izet Dibra.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1531-I datë 18-VI-930.
Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 9 VI-1930.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi krijimin e Zyres të nji Organizatori pranë Ministris së P. të Mbrendshme.
Tiranë me 23 Qershuer 1930.

ZOG.

BKSH

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit me datë 23 Qershuer 1930, t'aprovuem prej Parlamentit, dhe urdhënon shtimin e tij në Kodet e Mbretnis si Ligje.

Tiranë me 20 Kallnduer 1931.

ZOG

Nr. 18.

LIGJË, 2 Kallnduer 1931

Mbi transferimin e nji fondi prej fr. ari 300 në Buxhetin udhëtues të Ministris së Financavet «Rubrrike Këshilli Kontrollues»

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 7 datë 29-1-1931)

Art. 1.

Gjendjes së parapame të Kap. 35 të budgetit të dalunavet të Ministris së Financavet, rubrik «Këshilli Kontrollues» i shtohet nji fond 300 (treqind) fr. ari.

Art. 2.

Ky fond mbartet nga fondi i Kap. 33 «Rrogë personali, zavendësije e nep, jashtë kuadrit» buxhetit të nalt-permendun.

Art. 3

Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Art. 4.

Kjo Ligjë hynë në fuqi diten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi transferimin e nji fondi prej Fr. ari 300 në buxhetin udhtues të Ministris së Financavet

«Rubrik Këshillit Kontrollues», i votuem prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 85-I datë 12-XII-1930 të Kryesis së Tij.

ZOG

Kryeministri
P. Evangjeli

Ministri i Financavet:
K. Thaçi

Nr. 19

LIGJË, 22 Kallnduer 1931.

Mbi shtimin e nji Kryekonsulli në kuadrin numerik të Ministris P. Jashtme

(Botue në Fletored Zyrtare Nr. 7 datë 29-1-931)

Neni 1.

Kuadrit numerik të Ministris së P. të Jashtme per ushtrimin financjar 1930-31, i shtohet edhe I (nji) Kryekonsul.

Neni 2.

Këjo ligjë hyn në fuqi diten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 3.

Ministrija e P. të Jashtme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligjë.

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

DEKRETON

Aprovimin e zbatimin e ligjës mbi shtimin e nji Kryekonsulli në kuadrin numerik të Ministries së P. të Jashtme, i votuem prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 923-I datë 12-I-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 22 Kallnduer 1931.

ZOG

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Zav. Ministri P. të Jashtme
Pandeli Evngjeli

Ministri i Financavet
K. Thaçi

BKSH

Nr. 20

.RREGULLORE

Mbi nji konkurs në mes të lopëve me provë mjeljeje

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 7 datë 29-1-1931)

Art. 1.

Si mbas Ligjit mbi konkursë e ekspozicion diftime (mostra) Panagjyre e tjera i aprovuem me Nr. 265-I datë 23-IV-929 nga Parlamenti, autorizohet Ministrija e Ekonomis Kombëtare t'organizojë nji konkurs per lopë me provë mjelje në qendrën e Prefekturës Shkodres me daten.....

Art. 2.

Konkurrentave fitues të lopave u jepet çmimet si vijon :

Rendi i I. Per lopët tre vjeçarë qi kanë ndryshue dhambët e dyta me ato të përhershmet.

Çmimi i I. Fr. ar 100 e nji diplomë.
» II. të » » 70 » » »
» III. »të » » 60 » » »

Rendi i II të «Lopët katër vjeçare qe kanë ndryshue dhambët e tretë me ato të përherëshmet.

Konkurrentavet të lopëve fitues u jepen çmimet si vijojnë :

Çmimi i I. Fr. ar 100 e nji diplomë.
» II. të » » 70 » » »
» III. të » » 60 » » »

Rendi i III të Lopët pesë vjeçare qi kanë ndryshue gjithë dhambët e gojës me ato të përherëshmet.

Konkurrentavet të lopëvet u jepet çmimet si vijojnë :

Çmimi i I. Fr. ar 100 e nji diplomë.
» II. të » » 70 » » »
» III. të » » 60 » » »

Rendi IV të Lopët 6 vjeçare e lart u jepen të zotvet të tyne çmimet si vijojnë :

Çmimi i I. Fr. ar 100 e nji diplomë.
» II. të » » 70 » » »
» III. të » » 60 » » »

Rendi i V të Lopët fituese në provë kuintitati e të lartë, e qe kanë shumë të lyn në qumshtin e tyne (prova bahet me methodin Gerber).

Konkurentavet fitues të lopëvet u jepet çmimet si vijojnë :

Çmimi i I. Fr. ar 100 e nji diplomë.
» II. të » » 70 » » »
» III. të » » 60 » » »

Art. 3.

Në konkursin e lopëvet mund të marin pjesë dhe lopët e races së huej, me konditë qi këto të jenë të linduna e të rrituna në Shqipni, si edhe zotnuesi i tyne të jetë shtetas Shqiptar.

Lopët e instituteve qeveritare ose privat e të huej mund të marin pjesë në konkurs pa të drejtë çmimesh në të holla, por u jepet vetem nga nji diplomë.

Art. 4.

Blegtorët me lopët e tyne qi dishirojnë të marrin pjesë në konkurs janë të detyruem t'i sillen Zyres së Veterinaries së vendit tuj lyp pranimin verbalisht ose me shkrim deri 10 ditë para ditës së caktueme qi do të bahet konkursi. Në kerkesët duhet të shenohet sasija e lopëvet qi ka dhe mosha e tyne.

Mbas kësaj kohë kerkesat nuk merren parasyshë.

Marrja pjesë në ketë konkurs nuk ngarkohet me as ndonji taks.

Art. 5.

Lopët konkursë detyrohen të zot e tyne t'i sjellin ma të pakten nji ditë para se të bahet konkursi.

Për të ushqye lopët qi sjellen në konkurs ngarkohen të zot e tyne.

Art. 6.

Lopët qi marrin pjesë në konkurs në katër rendet e dhanuna në Art. 2. të kësaj Rregullore u jepen çmimet si mbas sasis së qumshtit të dhanun mbrenda 24 oreve, ose të dy mjeljevet të mëngjezit e të mbramjes.

Kur të takojnë dy lopë ose ma teper qi japin sasi t'unjishme, qumsht, komisioni gjykues këtyne u jep çmimin asaj lopë qi asht mbajtun ma mirë.

Art. 7.

Komisioni gjykues emnohet nga Ministrija e Ekonomis Kombëtare.

Gjykimet e Komisionit janë të pa apelueshme.

Art. 8.

Autorizohet Ministrija e Ekonomis Kombëtare të bajë shpenzimet e duhuna nga fondi i posaçëm per t'i perballue nevojat të konkursit, si per shpenzime shtypshkrime propoganda e tjera.

Art. 9.

Bashkija e Shkodres detyrohet të japi nji lokal të duhun dhe të japin ndihmat e nevojshme per realizimin e qellimit.

Art. 10.

Ministrija e Ekonomis Kombëtare ngarkohet me aplikimin e kësaj Rregulloreje, dhe per emnimin e Komitetit të Nderit.

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
V. Avrami

Ministri P. Mbrendëshme:
Musa Juka

Ministri i Arsimit:
Hil Mosi

Ministri i Financavet
K. Thaçi

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri Ekonomis Kombëtare
Mehdi Frasheri

Nr. 21

LIGJË, 24 Kallnduer 1931.

E Shtypit

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 8 datë 31.1-931)

Kaptina I.
MBI KONDITAT E BOTIMEVE

Art. 1.

Ç'do fletore e përditëshme ose e përkohëshme duhet të ketë një Drejtor përgjegjës.

Art. 2.

Drejtori Përgjegjës i çdo fletoreje të përditëshme ose të përkohëshme ose rivisteje që do botohet në Shqipni duhet të ketë këto çilësina :

a) Të jetë nënshtetas Shqiptar ;

b) Të ketë mbaruar të paktën një Lice ose një shkollë equivalente me liceun dhe të ketë një praktikë prej tre vjetësh në rasë që ka mbaruar ndonjë degë universiteti, dhe pesë vjetësh në ka mbaruar vetëm liceun.

Nga kjo konditë e kohës së praktikës përjashtohen gazetat dhe revistat skencore dhe literare.

c) Të mos jetë i rrëzuar nga të drejtat qytetnore.

ç) Të mos jetë i dënuar me vepra imorale si për falsifikim, mashtrim, shpërdorim mbesime, vjedhje dhe çpifje.

BKSh

d) Të mos ket një reputasion të keqë dhe të mos jetë i dënuar prej gjyqit dy herë me radhë me një dënim prej gjasht muaj e lart për fajra shtypi mbrenda një kohe dy vjetve.

Art. 3.

Kur kërkohet leja për botimin e një fletoreje ose revisteje, Ministrija e P. të Mbrendëshme asht e detyruar që mbrenda një muaj nga data e paraqitjes të kërkesës t'i përgjigjet kërkuesit me vendimin e vet në se do të mundet t'a botojë ose jo. Në rastin e fundit vendimi i Ministris P. të Mbrendëshme brenda një muaji duhet të marrë aprovimin e Këshillit Ministerial.

Art. 4.

Ai që kërkon të botojë një fletore ose revistë, si garanti për dënímet e tij eventuale duhet, të depozitojë pranë një Banke në Shqipni një shumë prej 5.000 fr. ari ose, t'i paraqes Ministris së P. të Mbrendëshme një garanti bankare për këtë sasi të hollash, garantije në fjalë mund të jepet dhe në pasuni të pa-lujtshme, të ipotekueme rregullisht për këtë qëllim, por në këtë rast të fundit garancia do të jetë prej 10.000 fr. arit.

Përjashtohen nga kjo garanci revistat siantifike dhe literre.

Art. 5.

Gjith fletoret dhe revistat që janë tuke u botuar janë të detyruar mbrenda dy muajve nga data që hyn në fuqi kjo ligjë të konfirmohen me dispozîtat e kësaj ligje.

Art. 6.

Ai që dëshiron të botojë një fletore ose revistë në Kryeqytet duhet t'i drejtoj, Ministris së P. të Mbrendëshme, dhe ay që dëshiron të botojë në ndonjë nga qarket, Prefekturës së qarkut, një kërkesë me nënshkrimin e vet dhe të Drejtorit përgjegjës, e cila duhet të përmbaj këto :

a) Emni i fletores ose i revistës,

b) Vendi i botimit.

c) Kohët e botimit.

ç) Karakteri i sajë.

d) Emni e mbiemni, mosha, vendi i lindjes e i banimit dhe nenshtetsija e pronrait. Kur pronari asht nji shoqëni literare, politike ose tregtare, duhet bashkanjitun Statuti i dekretuem, ose kontrata e shoqënis, dhe lista e emnave t'atyne që formojnë Këshillin Administrativ të shoqënis.

dh) Emni e mbiemni, mosha, bashkë me dokumentat shkollollore dhe praktike si mbas nenit 2 të kësajë ligje, vendi i lindjes banimi dhe nënshtetësija e Drejtorit përgjegjës,

e) Emni i shtypshkronjës ku do të shtypet.

Prefekturat kur nuk ju drejtohen kërkesat me dokumentat dhe akt-hetimet, me të shpejt ja paraqesin Ministris së P. të Mbrendëshme tue shtue dhe mendimin e vet.

Art. 7.

Fletoret dhe revistat politike në Shqipni botohen në gjuhën Shqipe.

Art. 8.

Pronari i një gazete ose revisteje kur ka çilësit e lypuna prej ligjës mund të bëhet Drejtor përgjegjës i asaj gazete ose revisteje.

Art.. 9.

Nëpunsat e Shtetit, të Bashkive dhe të Komuneve, oficerat aktiv dhe ata rezervë që gjinden në sherbim nuk mund të bëhen Drejtora përgjegjës dhe pronar gazeteje ose reviste.

Në rasë qe ndo-njeni nga kategorit e nëpunësave të ma sipër bahet pronar gazeteje me anë trashigimi, ky detyrohet mbrenda gjashtë muejve me ja transferue tjetrit këtë pronësi.

Art. 10.

Ato fletore ose revista që botohen pa pasur lejen si mbas dispozitave të kësaj ligje, me një herë konfiskohen me anën e autoritetit administrativ të vendit dhe, botuesit dënohen me anën e Gjyqit me një gjobë prej 200-1000 fr. arit. Gjith ashtu zbatohen gjith këto dispozita kur një fletore ose revistë botohet në kundërshtim me deklarimet në kërkesë dhe përmbajtjes së lejës. Po me ketë gjobë dënohet dhe shtypshkronja ku asht bamun shtypja e fletores ose e revistës.

Në rastet e ma sipërme, kur lënda e botimit formon edhe faj tjetër, botuesit dënohen edhe me dënimet e caktueme për atë faj.

Art. 11.

Ç'do fletore ose revistë e përditëshme ose e përkohëshme asht pasunia e të zot. Prej këtij mund t'i pronsohet tjetrit. Në raste të vdekjes të së zot si gjithë pasunit e tjera trashëgohen prej trashigimtarëve.

Në qoftë se i zoti i fletores që vdes ka marrë mbi vehte dhe detyrën e Drejtorit përgjegjës, trashigimtarët detyrohen të tregojnë një Drejtor përgjegjës të pajosur me gjith çilësit që kërkon ligja dhe vazhdon botimi i sajë.

Art. 12.

Emni i një fletoreje ose revisteje nuk mund të përdoret prej tjetër kujt ashtu dhe nuk mund të përdoret emni i ndryshuar i saj n'atë mënyrë qi le të kuptohet si kur asht emni i parë. Por

emni i një fletoreje ose revisteje, që asht botuar disa herë dhe ma vonë ka ndaluar botimin, si të kaloj dhjetë vjet ; dhe kur nuk asht botuar fare si të kalojnë tre (3) vjet përdoret prej çdo tjetri.

Kur një fletore ose revistë për ç' do shkak qoftë nuk botohet fare rrjesht 6 muaj, leja e Drejtorit përgjegjës quhet e anulueme.

Art. 13.

Në rastë që Drejtori përgjegjës vdes ose heqë-dorë nga kjo barë ose humbet një nga çilësinat e lypuna prej kësaj ligje, që atë kohë botimi i fletores ose i revistës ndalohet për deri sa të kompletohen formalitetet ligjore për Drejtorin tjetër përgjegjës Për kundravajtësit zbatohen dispozitat e art. 10 të kësaj ligje.

Kaptinë e II.

DISPOZITA PENALE

Art. 14.

Nga ç'do numur i fletores a i revistës të përditëshme ose të përkohëshme duhet t'i dërgohen nga dy copë në Kryeqytet Ministris së P. të Mbrendëshme, dhe ndër qarqe nëpunsit ma të naltë të Administratës, dhe si në Kryeqytet ashtu dhe në qarqe Prokurorit të vëndit ose atij që zen vendin e Prokurorit ; edhe nga nji copë Bibliotekës Kombëtare. Ata Drejtora përgjegjës qi nuk vepronjë në këtë mënyrë, për çdo numur gjobiten me 20 (njizet) fr. ari.

Art. 15.

Fletoret dhe revistat qi botohen pa u shënue sipër a në fund emni i Drejtorit përgjegjës dhe i pronarit ose i pronarve si edhe i shtypshkronjës ku shtypet, gjobiten me 40 fr. ari. Botim i këtyne pa nenshkrim nuk e shpeton Drejtorin përgjegjës nga responsabiliteti ligjuer i landës.

Art. 16.

Ata qi shesin gazeta ndër magazina ose nëpër rruga janë të detyruar të paraqiten në Zyrën e policis e të regjistrojnë vend-banimin e tyne në librin e posaçëm, dhe Zyra në fjalë kundrejt këtij regjistrimi gratis i jep letër dëshmin e duhur.

Asht e ndalueme shitja e gazetave tue thirrë me za të naltë me fjalë kundra moralit ose qi cenojnë nderin të personave, të institutеve, ose që alarmojnë popullin.

Kundra-vepruesit dënohen deri në një muej burg.

Art. 17.

Përgjegjësija që provokohet nga përmbajtja e landës së fleto-

reve a të revistave të përditëshme a të përkohëshme u përket me radhë këtyne :

a) Pik-sëpari Drejtorit përgjegjës dhe artikullshkronjësit me nënshkrim ose me pseudonimin kur ka, si bashkëveprues origjiner ;

b) në gradën e dytë, të zôt Shtypshkronjës;

c) në gradën e IIItë shitësit a përndaesit.

Deri sa mos të jetë e mundur ndjekja penale për persona që janë në shkallë ma të parë, nuk mund të padriten ata qi vinë më pas.

Nga dënimet me dam shperblim nga shpenzimet e gjyqit asht pergjegjës edhe pronari ose pronaret. Kur pronari asht nji shoqëri Këshilltarët administrativ, solidarisht me Drejtorin përgjegjës ose administratorët e sajë.

Art. 18.

Kur nji përson nga botimet e fletoreve a të revistave e quan veten e tij moralisht a materjalisht të damtuem, në mbështetëje t'art. 17 kundra atyne qi janë pergjegjës i drejtohet gjyqit dhe i paditë pa qenë i detyruar ma par t'u komunikojë ndonji protestë dhe kërkon dam-shperblim.

Gjykata mbas Gjykimit nga botimet këso dore (përveç) dënimit me burg e me gjobë si mbas kësj ngjëje, vendosë qi paditësi t'i paguhet edhe nji dam-shperblim i arsyeshëm në proporsion me damin material a moral. Dam-shperblimi i vendosun përballohet me garancinë e Drejtorit përgjegjës, dhe kur kjo nuk mjafton plotsohet nga i dënuemi ose nga pergjegjësit e tjerë solidare si mbas art. 17 të ligjës. Në këtë rast grancia e nevojshme duhet sigurue rishtazi për me mund qi gazeta të vazhdojë botimin e sajë.

Gjykata mund të vendosi qi të botohet tekstualisht vendimin e dënimit në numrin ma të parë ose të dytë t'asajë fletore ose rëvisteje, dhe në rast të kundërte shkaktohet dënimi i Drejtorit përgjegjës me 1000 (njimij) fr. ari gjobë. Mund të vendoset botimi i vendimit në fjalë dhe në nji a dy fletore të tjera duke u paguar shpenzimet e botimit nga i dënuemi.

Art. 19.

Fletoret a revistat mund të botojnë rjedhimin e çdo gjykimi të gjykatave ose bisedimet e vendimet e Parlamentit dhe të këshillave tekstualisht ose shkurtazi. Vetem janë të ndaluar të botojnë bisedimet e mbledhjeve të mshefta të instituteve të permenduna në paragrafin e parë të këtij artikulli. Ata fletore a revista qi botojnë rrjedhjen e gjykimit a të bisedimit, janë të detyruara të botojnë dhe vendimin e dhanun për ate çeshtje.

Ata qi veprojnë kundra dispozitave të këtij artikulli, dhe ata qi ndryshojnë dhe shtremërojnë shpirtin e bisedimevet kësodore, dënohen me nji gjobë prej 100 deri në 500 fr. ari.

Art. 20.

Gjykatoret me vendimin e vet kan të drejtë të ndalojnë botimin e bisedimevet të rrjedhuna faqesisht, që janë kundra edukasjonit botnuer. Kundravajtësit dënohen me 40 deri 200 fr. ari gjobë.

Art. 21.

Asht i ndaluem botimi i Ligjëve dhe i Rregulloreve në formen e tyne definitive, perpara se të çpallen zyrtarisht. Kundravepruesit dënohen me 100 deri 300 fr. ari gjobë dhe fletorja konfiskohet, në Kryeqytet me urdhnin e Ministris së P. të Mbrendshme, dhe në qark me anen e autoritetit ma të naltë administrativ.

Art. 22.

Ato fletore ose revista që me botimet e tyne :

a) diskretitojnë ose poshtërojnë një fé ose sekt të njoftun në Shqipni, dënohen me nji deri gjashtë muej burg e me 400 deri 2000 fr. arit gjobë së bashku ose veç e veç.

b) diskretitojnë dhe poshtërojë një element fetarë dhe që bëjnë propaganda perçarje e armiqësije midis elementave fetare, perveç konfiskimit nga ana e autoriteteve administrativ, dënohen me 6 muej deri 2 vjet burg të randë dhe prej 1000 deri 3000 fr. ari gjobë së bashku ose veç e veç ;

c) e ftohin popullin nga sherbimi ushtarak, per veç konfiskimit si mbas pargrafit b), dënohen me 1 deri 3 (tre) vjet burg të rëndë.

ç) që lëvdojnë e përkrahin veprat, që si mbas ligjës formojnë faj, përveç dënimit për fajin që mund të formojë në vet veten ky botim, dënohet me burg deri 6 muej.

Bisedimet shkencore dhe filozofike, të bazuëme në argumenta për fê e sekt, nuk konsiderohen diskreditim ose poshtrim per deri sa mos të dyshohet se janë personale me para-mendim.

Art. 23.

Ata që me shkrimet e tyne shtytin drejt per së drejti popullin me veprue deliktet e permenduna në titulin e parë të librit II-të, të Kodit Penal, per veç konfiskimit me anë të autoritetit administrativ, dënohen me ndeshkimet të caktuem per atë faj në qoftë se delikti shtytun realizohet, dhe $1/3$ deri në gjysmën e ndeshkimit të caktuar kur nuk realizohet ; në këtë rast të fundit kur ndeshkimi caktuar per fajin e shtytun esht vdekje ose burgim i

perjetshëm shtytesi me anen e botimeve dënohet me 10 deri 20 vjet burg të rëndë.

Art. 24.

Ata qi me friksim se do të zbulojë me anen e shtypit një send që cenon nderin a pakëson prestigjin e një personi, ose që me frigësim se do të shifin gjëra kësodore, kërkojnë ose terhjekin të holla ose sigurojnë ndo nji interes tjeter, dënohet me 1-3 vjet burg të rendë dhe me gjobë 400 deri 2000 fr. arit.

Art. 25.

Ata që botojnë e trnsmetojnë lajme të pa qena ose të falsifikuara ose pa qenë e vertetë ja çpifin dhe ja ngarkojnë një personi dhe, ata që botojnë aktet, ligjeratat dhe bisedimet zyrtare, duke ndryshuar dhe duke falsifikuarë, në qoftë se këto botime dhe transmetime janë në formë për të alarmuar ose gabuar opunionin publik, guximtarët dënohen nga 3 muej deri në nji mot burg, dhe bashkë me ketë deri me 500 fr. ari gjobë.

Botimet ne fjalë në qoftë se kanë shkaktuar prishjen e qetësisë dënimi esht prej 1 deri 5 vjet burg të randë dhe 500 deri 2000 fr. ari gjobë. Në të dy këto raste nji numer i fletores konfiskohet nga ana e autoritetit administrativ.

Art. 26.

Asht i ndaluem botimi i artikujve dhe lajmeve qi kanë të bajnë me sekretet shtetnore dhe ushtarake. Gjithashtu u ndalohet botimi i artikujve të nenpunsave dhe t'oficerave qi kanë krakter politik ose janë kundra disiplinës.

Në rastë kundravajtjeje, gazetari per fajin e permendun në paragrafin e Irë, veç konfiskimit të gazetës, dënohet me 6 muej deri në 3 vjet burg, dhe me 100 deri në 5000 fr. ari gjobë ; dhe per fajin e permendun në paragrafin e IItë, dënohen deri me 6 muej burg, dhe me ketë edhe me 200 (dyqind) deri 1000 fr. ari gjobë. Sa per nepunsinë ose oficerin artikullshkrues, aji perveç që dënohet me dënimet e nalt-tregueme per këto fajra veçanerisht, kur asht nëpunës civil pushohet nga puna, dhe kur asht oficier nxjerret në pension.

Art. 27.

Esht i ndaluar botimi i librave, revistave dhe i artikujve, i fotografive, dhe pikturave që cenon moralin dhe janë kundra edukacionit botuer. Botimet kundra kësaj dispozite konfiskohen me një herë nga Policija e Gjindarmerija dhe përgjegjësit si mbas kësaj ligje, ashtu dhe ata që vazhdojnë në shitjen e shperndamjen e veprave kësodore të konfiskueme, dënohen deri me 1 muaj burg ose me 200 fr. ari gjobë.

Art. 28.

Kuer fletoret ose revistat të perditëshme ose të perkohshme bejn botime kundra një personi, ky, dhe kur asht i vdekun bashkëshortet, prindit, të paslindunit, vllaznit motrat, dhe fëmitj e këtyne, vjehri ose vjehra, dhendri ose nusja dhe trashigimtarët drejt për së drejti të të vdekunit, kan të drejtë të përgjigjen me nji artikull jo ma i gjatë se dyfish nga botimi në fjalë; Drejtori përgjegjës esht i detyruar me e botue ketë përgjegje në numrin ma të parë dhe në ato shtylla dhe me ato shkronja të fletores të botimit pare. Gjithashtu janë të detyruar të botojnë dhe përgenjeshtrimet të Qeveris. Kundravajtësit dënohen me 100 deri 1000 fr. ari gjobë

Art. 29.

Perseritjet e fajeve të tregueme në këtë ligjë, formon shkak rëndues në konformitet me dispozitat e Kodit Penal.

Art. 30.

Ato fletore ose revista që me botimet e tyne mund të cenojnë sigurimin e interesit të mbrendëshem ose të jashtëm të Shetit dhe ndodhen kundra rregjimit, përkohësisht pushohen me vendimin e Këshillit Ministruer dhe pergjegjësit kur e lyp nevoja burgosen dhe i dorëzohen gjyqit.

Drejtorët pergjegjës dhe të zotët e fletoreve a të revistave të pushuem nga Qeveria dhe të dërgueme para gjyqit, deri sa të marë fund gjykimi nuk mund të perdorin sumën e të hollave të lëna si garanti per të botuar një fletore a reviste tjater.

Art. 31.

Gjith dispozitat ndeshkimore dhe të tjerat, të tregueme në ketë ligjë kan aplikimin e tyne dhe, per fletoret e artikujt satirike, humoristike, dhe fotografive, pikturave të botueme nder fletoret ose rivistat të perditshme a të perkohshme dhe, gjith akteve të shkrueme e të shtypuna dhe gjith shtojcave të fletoreve që shifen e shperndahen në publikun a në mbledhje të pergjithëshme, ashtu edhe gjithë tabelave dhe shpalljeve që vihen perpara syve të popullit.

Art. 32.

Gjyqet mund të vendosin bashkë me dënimet e tregueme në ketë ligjë edhe pushimin e gazetës, ose revokimin e lejes të Drejtorit provizorisht, ose definitivisht në rastë që faji perseritet ose dënimi i dhanun do të jet 6 muaj burg e lart.

Art. 33.

Ndalohet të mbledhunit e ndihmave publikisht per me perballue gjobën, shpenzimet e gjyqit ose dam-shperblimet të vendo-

suna prej Gjyqit per faj shtypi. Kundravajtësit dënohen prej 3 deri 6 muaj burg.

Art. 34.

Transmetimet e artikujve që si mbas kësaj ligjë, formojnë faj, nga nji gazetë në tjetren, asht i ndeshkuem po me at dënim që asht caktue per fajin e artikullit të transmetuemun.

Art. 35.

Drejtori pergjegjës i fletores ose i rivistes asht i detyruem me i a njoftue Ministris P. të Mbrendëshme qysh me koh pseudonomet qi ka me i perdorë aji vetë.

Gjithashtu në çdo rast Drejtori pergjegjës detyrohet me i tregue Ministris së P. të Mbrendshme ose të nji pseudonomi i perdorun nën artikujt e botuem në fletoren ose nërivistën e tij.

Në rast qi Drejtori pergjegjës nuk tregon pseudonomusin, ose kuptohet që aj vet ka perdorë nji pseudonom, jashta atyne qi kish lajmerue Ministrin kompetente, vetem per ketë, dënohen me 3 muaj burg.

Kaptina e III

MBI DIFAMATION (SHAMJE) DHE INJURË (ÇNDERIM)

Art. 36.

Difamation (shamje) quhet nji veper me të cilen i atribuohet me anen e shtypit nji personi a instituti nji fakt i caktuem që e ekspozon në poshtrim ose urejtje publike ose i ofendon onorin ose famen e atij personi ose instituti.

Injure (çnderim) konsiderohet nji botim që ofendon në ç'do lloj menyrë onoris, famen ose dignitetin e nji personi a instituti.

Art. 37.

Ata qi me anen e shtypit bejnë difamatione si dhe injurë per të cillat nuk asht caktue ndonji dënim i veçantë me këtë ligjë ndeshkohen si mbas dispozitave të kaptinës XII të titullit IX, të Librit të IItë, të Kodit Penal qi flasin mbi kësilloj fajesh.

Art. 38.

Kur difamationi ose injura bahet kundrejt Mbretit dhe Familjes Mbretnore, dënimi asht nga dy deri në gjashtë vjet burg. Në ketë rast edhe konfiskohet gazeta nga autoritetet administrative.

Art. 39.

Kur difamtaioni ose injura bahet kundrejt Kryetarve të shteteve të huaj ndeshkimi asht si mbas Kodit Penal.

Ngrehja e padies në këtë rast bahet vetem me kerkesen e përfaqesonjësit t'atij shteti dhe në bazë që dhe ay Shtet me ligjët e vetë e dënon ketë faj.

Art. 40.

Difamationet dhe injuret kundrejt personit moral të shtetit dhe të kombit, ushtrisë dhe kundrejtë institutevet të Nalta si Dhoma Legjislative, Gjykata, Këshilli i Shtetit e tjera për veç konfiskimit në rastë që shifet nevoja nga autoritetet administratif ndeshkohen me 6 muaj deri në tre vjet burg.

Kuer bahet kundr zyreve të tjera shtetnore, denimi asht prej 1 muaj deri në nji vjetë burg.

Art. 41.

Kur fajet e parapame në Kptinen VIII. të Titullit III. të Librit IItë, të Kodit Penal, me emertim (çnderime e të tjera delikte kundra personave që kanë autoritet publik), bahen me anen e shtypit dënimet janë ato që caktohen per çdo delikt në kaptinen e nalt-permendun të Kodit Penal tue shtuar minimumin e dënimit tre fish.

Art. 42

Difamationet e bamun kundrejt Nepunsave, Drejtorave, dhe këshillave administrative t'instituteve finncjare, e tregtare, qe janë thmeluar duke nxjerrë aksione nuk janë të ndeshkueshme, në se në perfundimin e gjyqit provohet se janë të verteta.

Art. 43.

Fajet që mund të bahen me anën e botimeve dhe qi nuk parashifen në ketë ligjë, ndeshkohen si mbas dispozitave të Kodit Penal.

Kaptina IV

DISPOZITA TË POSAÇME

Art. 44.

Padinat qe u perkasin fajeve të shtypit shikohen neper gjykatat ordinare dhe si mbas Procedures Penale të pergjithshme.

Vetem per sa kohë qi do të eksistojë gjyqi politik fajet qe bahen me anen e shtypit dhe qi perfshihen me ligjen ndeshkimore mbi fajet politike, do të shikohen prej Gjyqit Politik në bazë të kerkeses të Ministris së P. të Mbrendëshme.

Ndjekja e fajeve të tregueme n'Art. 22, 23, 25, 27, 38, bahet drejt per se drejti nga Prokurori i Shtetit, dhe ndjekjet e difamationevet dhe injuravet, kundrjet kryetarve të Shteteve të huaj, bahen prap prej Prokurorit, por në bazë të nji kerkese të perfaqësonjesit dipllomatik t'atij Shteti i dhanun në Ministrin e P. të Jashtme dhe me konditen e reciprocitetit.

Gjithashtu drejt per së drejti ndiqen prej Prokurorit difama-

tionet dhe injuret kundrejt person moralit të shtetit a të kombit.

Sa per ndjekjet ligjore mbi difamationet dhe injurës kundrejt institutave shtetnore, zyrave qeveritare, si edhe mbi çnderimet të bamuna anonimisht kundrejt disa ose gjith pjestarve ose personelit të ndonji instituti a zyre Shteti, këto ndiqen prej Prokurorit, vetem në bazë të nji kerkeses zyrtare t'atyne institutave ose zyrave qeveritare.

Ndjekjet e tjera mbi difamatione dhe injure të tregueme në ketë ligjë bahen vetem mbi ankimin e t'interesuemve.

Gjith ndjekjet e tjera per fajet e parapame në ket ligje ose në Kodin Penal dhe qi bahen me anen e shtypit, bahen prej Prokurorit mbasi të jetë lajmëruar rregullisht.

Art. 45.

Padinat Penale kundra fajeve të shtypit qe nuk ngrihen mbrenda 6 muejve qysh prej datës së botimit, parashkruhen.

Kur nji gazetë per çdo shkak kjoftë pushon botimin e sajë, garantija mbetet e pengueme per gjith kohen gjashtëmujore të parashkrimit.

Kaptinë V

MBI FLETORET DHE RIVISTAT QE BOTOHEN JASHTA SHTETIT E QI SHITEN NË SHQIPNI

Art. 46.

Hyrja, shitja, dhe shperndarja në Shqipni, e fletoreve a revistave qe botohen në shtetet e huaj, mund të ndalohen me nji vendim të Këshillit Ministruer.

Ministrija e P. të Mbrendëshme per deri sa të dali vendimi i Këshillit Ministruer mund t'a ndalojë vetem nji numer t'asaj fletorëje a të rivisteve.

Ata qi kundra këtij ndalimi futin shesin ose shperndajne fletoret a rivistat kësodore, per veç konfiskimit nga ana e autoriteteve administratif dënohen dhe me 300 deri me 1000 fr. ari gjobë.

Art. 47.

Ata qe nga botimet e fletoreve a rivistave qe botohen jashtë e quajnë vehten e tyne të çnderuem, mund të ngrehin padie në Shqibëni kundra Drejtorit dhe pronarit t'asaj gazetë. Gjyqi kompetent per veç dënimit ligjuer mund të vendosi edhe ndalimin e hyrjes, shperndamjen dhe shitjes së asaj gazetë në Shqipni, provizorisht ose definitivisht, ose të çdo gazetë tjater qe do të ketë atë Drejtor ose pronar.

Qeverija detyrohet me i zbatue vendimet kësodore të gjyqit.

Kaptina VI

MBI PROCEDUREN E GJYKIMIT TË FAJEVE TË SHTYPIT.

Art. 48.

Fajet të provokueme prej shtypit gjykohen si mbas dispozitave të Procedurës Penale dhe në mënyre të poshtë tregueme.

Art. 49.

Faji në qoftë se permban difamatione dhe injure, Prokurori ose aji qe zenë vendin e tij i a sjellë çeshtjen gjyqit kompetent drejt per së drejti, pa referim në Pyetësi.

Art. 50.

Gjykata kompetente qe prej datës qe do të marrë leter-padien e Prokurorit, mbrenda tre ditve ashtë e detyruar të ftojë të pandehunin dhe duke preferuar ketë padie nga çdo tjater do të fillojë me nji herë gjykimin.

Art. 51.

Gjykatësi Hetues per gjith çeshtjet qe i referehen atij asht i detyruar qe prej datës të leter-padies brenda 24 orëve, të thërasi e t'a pyesi të pandehunin, dhe mbrenda nji jave të mbarojë hetimet e të japi vendimin.

Art. 52.

Gjykatat janë të detyruar qe prej datës së komunikimit të tyne mbrenda 5 ditëve të nxjerrin akt-gjykimin.

Art. 53.

Në rast qi vendimet diktohen Prokurori ose ay qe xenë vendin e tij, asht i detyruar brenda 48 orëve qe prej datës qe i dorëzohen aktet me i a paraqitë Kryeprokurorisë.

Art. 54.

Gjyqi i Diktimit asht i detyruar me e perfundue shqyrtimin mbrenda 8 ditëve dhe me dhanë akt-gjykimin e duhun mbrenda 5 ditëve qysh prej datës së vendimit.

Art. 55.

Per gjykimin e fajeve të shtypit asht kompetent:

a) Gjykata ku botohet fletorja ose rivista;

b) Gjykata ku qarkullon fletorëja ose rivistëja:

BKSH

c) Gjykata ku ka banesën pergjegjësi ligjuer i fajit,

ç) Gjykata ku ka qendresën pergjegjësi ligjuer i fajit,

Por për fajet e shtypit ndjekëja e të cilvet bahet direkt prej Prokurorit të Shtetit ose prej atij qe xen vendin e tij asht kompetent gjykatorëja ku shtypet fletorëja ose rivistëja.

Kur i damtuemi drejton ankimin e vet në njanën nga gjyqet kompetentë, si mbas këtij artikulli, ankimi i tij, i pastajshem po per ate çeshtje në ndo nji nga gjyqet e tjera kompetente, ashtë i pa ndigjueshem.

Kaptinë VII.

MBI DISA DISPOZITA NË KOHRAT TË JASHTËZAKONSHME DHE CENSUREN.

Art. 56.

Censura prevantive mbi shtypin vehet:

1) Kur shpallet shtet-rrethimi:

a) Në zonen e shtet-rrethimit;

b) në rast nevojet dhe jashta asaj zone:

II. Kur edhe nuk ka shtet-rrethimi:

a) në kohë lufte.

b) në kohë mobilizimit,

c) në koh kryengritjeje,

ç) në kohë të nji situate luftësjellje.

d) në kohë të nji situate që parashef nji kryengritje.

dh) në kohë të nji kalamiteti publik.

Censura prevantive në ket rast mund të perfshije pjesërisht ose tanësisht token e Mbretnis.

Art. 57.

Në rast shtet-rrethimi qe perfshin gjith token e Mbretnisë, censura prevantive decidohet dhe urdhënohet prej Komandas së P. të Mbrojtjes Kombëtare, dhe kur perfshinë vetem nji pjesë censura mbi shtypin e asaj zonë decidohet dhe urdhënohet prej Komandantit Ushtarak t'asaj Zonë; por në rastë që shifet nevoja si mbas dispozitave të kësaj ligje, me u vue censura tanesisht ose pjesërisht edhe kur e ku nuk ka shtet-rrethimi, atëhere vendimi i censurës jepet prej Këshillit Ministruer.

Art. 58.

Per veç atyne të lejueme nga autoriteti kompetent, asht e ndalueme reptësisht botimi i lajmeve mbi levizjet ushtarake dhe mbi

mjetet mbrojtëse në kohë luftë dhe mobilizimi. Kundravajtësit në se ligja-ushtarake nuk ka ndonji dënim ma të randë, ndeshkohen me burgim të randë prej 3 deri 15 vjet burg, dhe aji numur i fletores konfiskohet.

Art. 59.

Ata qi botojnë fletore ose rivista para se t'i censurojnë ose qi veprojnë kundra urdhënavet të censurës, për veç konfiskimit të gazetës, dënohen edhe me 3 muaj deri me 3 vjet burg.

Kur botimet përmbajnë edhe faje të tjera për ata denohen veçanërisht.

Art. 60

Kur fletoret ose rivistat bajnë ndonji nga fajet e parapame në ketë kaptinë, këto edhe mund të pushohen provizorisht ose definitivisht. Ky vendim në kohë dhe në zonen e shtet-rrethimit jepet prej Gjyqit Ushtarak, dhe kur e ku nuk ka Shtet-rrethimi prej Këshillit Ministruer.

Art. 61

Në rastet që lejohet venja e censurës si mbas dispozitave të kësaj kaptinë, Komanda Ushtarake, për zonat e Shtet-rrethimit dhe Këshilli Ministruer për zonat jasht Shtet-rrethimit, kanë të drejtë me ndalue botimin, shitjen, dhe shperndamjen e librave, rivistave dhe çdo lloj vepër tjater që konsiderohen të dameshme për interesat të Shtetit.

Ata qi veprojnë kundra ketij ndalimi denohen deri me 6 muaj burg, dhe deri me 2000 fr. ari gjobë, dhe botimet kësodore ju konfiskohen.

Art. 62

Kur fajet e përmenduna në ketë kaptinë ngjajnë mbrenda zonës së shtet-rrethimit, gjykohen prej Gjyqit Ushtarak t'asaj zonë.

Kaptina VIII.

DISPOZITA TË NDRYSHME

Art. 63

Janë të përjashtueme nga dispozitat e kaptinës Irë, të kësaj ligjë, fletoret dhe rivistat që botohen nga ana e administratave shtetnore, dhe qi përmbajnë botime zyrtare teknike dhe siendifike.

Fletorja Zyrtarja e Shtetit perjashtohet nga gjith dispozitat e kësaj ligjë.

Art. 64

Në rastet kur vendoset administrativisht pushimi i nji fletoreje ose rivisteje, Qeverija ka të drejtë të bajë edhe kontrollime nder rregjistrat dhe llogarinat e gazetavet të ndalueme.

Kaptina IX.

DISPOZITA TË MBRAME

Art. 65

Gjithë ligjët mbi shtypin abrogohen. Gjithashtu edhe gjith dispozitat e ligjeve të tjera që janë në kundershtim me ketë ligjë, mbeten pa fuqi per sa i përkasin fajeve të shtypit dhe urdhënimeve të tjera të parapame në ketë ligjë; vetem dispozitat e Ligjës Ndeshkimore mbi Fajet Politike janë në fuqi.

Art. 66

Kjo ligjë hynë në fuqi që prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 67

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve.
DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit të Shtypit, e votueme prej Par lamentit si mbas shkresës Nr. 28 datë 20-I-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 24 Kallnuer 1931

ZOG.

Kryeministri:
e Zav. Ministri i P. Jashtme:
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Drejtësis:
V. Avrami.

Ministri i Arsimit:
H. Mosi.

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka.

Ministri i Financavet:
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore:
Izet Dibra

Ministri i Eko. Kombtare
Mehdi Frasheri.

Nr. 22

Ligjë, 15 Kallnuer 1931.

Mbi rregullimin e Shkollës së nxanësave per Oficera plotësimi.

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 9 datë 4 Fruer 1931)

Neni 1.

Shkolla e nxanësve për Oficera plotësimi asht themelue me qëllim qi ata djelmosha qi pranohen n'atë, të bahen t'afte me fitue graden Aspirant plotësimi per njenen nga armat Kambësorie, Artilerie, Xhenios ose per Trupin e Intendances.

Neni 2.

Djelmoshat qi kanë detyrime sherbimi ushtarak, po kje se kanë dipllomë semimature, titer të njivlefshem ose ma të naltë, e po kje se janë me trup e me moral t'aftë, janë qi të gjithë të detyruem me frekuentue kurset pranë Shkollës Nxanësave Plotësimi; ata pa-ndihmes merren vetem në rast kuer sasia e atyne me ndihmës nuk u plotëson numërin e lypun per kurs.

Kurset vazhdojnë 11 muej.

Neni 3.

Eventualisht, mund të çpallen konkurse per pranimin e jashtëzakonshem të djelmoshavet, të cilët tue mos pasun titullin e studimit, qi permendet në nenin e ma-parshem, kalojnë me sukses nji provim të posaçem, si mbas modalitetevet qi do të caktohen prej Komandës së Mbrojtjes Kombtare.

Në konkurset në fjalë mund të marrin pjesë:

a) djelmosha të dat-lindjeve qi kanë detyrime sherbimi të rekrutit të rregullshem;

b) djelmosha të dat-lindjeve qi kanë të drejtë per paksim të sherbimit rekrut;

c) Nenoficera dhe ushtarë trupe qi janë nen armë.

Djelmoshat për të cilët ban fjalë germa b) e këtij neni, në lutjen qi do të bajnë per të marrun pjesë në konkurs, duhet të deklarojnë se hekin dorë nga e drejta e paksimit të sherbimit rekrut, në rast qi pranohen në shkollë.

Djelmoshat per të cilët ban fjalë germa c) e këtij neni, në lutjen qi do të bajnë për të marrun pjesë në konkurs, duhet të dekla-

rojnë se në rast qi pranohen në shkollë, kanë per të hekë dorë nga grada qi kanë dhe, pamvarresisht nga sherbimi qi kanë bà, kanë per t'u detyrue me bâ kohen e sherbimit të parapamun nga neni 4, si dhe kanë per të hjekë dorë nga të drejtat eventuale per paksim te sherbimit rekrut.

Neni 4.

Nxanësit qi në mbarim të kurseve deklarohen t'afte, emënohen Aspiranta Plotsimi, e, me ketë gradë, duhet të bajnë nji sherbim emnimi të parë, pranë reparteve, per nji kohë jo ma shumë se tre muej.

N.M. e Tij Mbreti ka të drejtë me paksue ose me shtye ma tutje sherbimin e emnimit të parë t'Aspirantave plotësimi.

Neni 5.

Per studentat qi kanë fitue vonesen e thirrjes nen armë, vazhdimi në kurset pranë Shkollës së nxanësavet oficera plotsimi, fillon në vjetin në të cilin kanë per t'u thirrë nën armë.

Neni 6.

Komandanti i Mbrojtjes Kombtare mbi propozimin e Komandantit të Shkollës, në bazë të hetimeve të bamuna prej nji komisioni hetues të perbame prej tre oficerave të Shkollës, mund t'urdhënojë perzanjen e atyne nxanësave prej Shkollës të cilët, tue mos u kujdesue per studimet, tue mos perfitue nga stervitjet ushtarake, ose tue mos pasë sjellje të mira, ma nuk i gjykon si t'aftë me ndjekë mësimet e shkollës.

Nxanësat në fjalë dergohen nëpër repartet t'armëve rispektive Kambësorie per nxanësat e kursit t'Intendancës) dhe kanë, si mbas rasteve, tratamentin qi vijon:

Nxanësat per të cilët bajnë fjalë neni 2 dhe germa a) dhe b) të nenit 3:

Dergohen nëpër repartet, me cilësie ushtari, per të bamun nji periudhe sherbimi baras me atë të caktueme per datë-lindjen qi asht thirrë nen armë në vjetin e pranimit të tyne në Shkollë; nuk munden me gëzue asnji paksim sherbimi rekrutë; koha qi ata kanë kalue në shkollë llogaritet si e vlefshme per efektet e sherbimit nen armë;

Nxanësat per të cilët banë fjalë germa c) e nenit 3:

Dergohen nëpër repartet nga të cilët kanë ardhë me graden dhe me detyrimet e sherbimit qi ata kishin para se të pranoheshin

në shkollë; koha qi ata kanë kalue në shkollë llogaritet si e vlefshme.

Neni 7.

Nxanësit të cilët, per shkaqe shëndeti, nuk marrin pjesë në mësimet per nji periudhe kohe, mos qoftë edhe vazhdimisht, ma shumë se 90 ditë, qiten jashtë Shkollës e si mbas rasteve, kanë tratamentin qi vijon:

Per nxanësat per të cilët bajnë fjalë neni 2 dhe germa a) e nenit 3:

Veprohet si mbas ligjës së rekrutimit tue llogaritun si të vlefshme, per ket efekt, kohen e sherbimit qi ata kanë ba me cilësi nxanësi;

Nxanësat per të cilët ban fjalë germa b) e nenit 3:

Në se si nxanës ata kanë ba nji periudhe sherbimi baras ose ma të naltë se ay qe do të bashin tue gëzue paksimin e sherbimit rekrut, dergohen në lirim; në se kanë ba nji periudhe sherbimi ma t'ulët se ay per të cilin ishin të detyruem, tue gezue paksimin e sherbimit rekrut, dergohen si ushtarë në nji repart per të plotsue periudhen po t'atij sherbimi;

Nxanësat per të cilët ban fjalë germa c) e nenit 3:

Dergohen ne për reparta nga të cilët kanë ardhë me graden e me detyrimet e sherbimit qi kishin para pranimit të tyne në Shkollë; koha e kalueme si nxanësa llogaritet si e vlefshme per efektet e sherbimit nen armë.

Nxanësat per të cilët bahet fjalë në këte nen, tue perjashtue ata të pranuem me konkurs të jasht-zakonshem në bazë të nenit 3, munden me kerkue prej Komandës së Mbrojtjes Kombtare qi të lihen per kursin suksesiv; ne ketë rast, ata qiten shpejt në lirim, të perkohëshem, tue pritun qi të thirren per kursin e ri.

Lanja per kursin suksesif mund t'autorizohet vetem nji herë.

Që te dyja periudhat e sherbimit, të bamuna si nxanësa në dy kurse suksesive, konsiderohen të vlefshem per efektet e sherbimit nën armë.

Neni 8.

Nxanësat qi në mbarim të kursit nuk fitojnë aftësin per graden Aspirant, kanë, si mbas rasteve, tratamentin qi vijon:

Nxanësat per të cilët ban fjalë neni 2 dhe germa a) e nenit 3:

Shenjohen me graden kapter i klas. II të, nëpër repartet t'armeve, trupave o sherbimeve rispktive per të bamun nji periudhë sherbimi baras me ate të caktueme per dat-lindjen e thirrun në armë në vjetin e pranimit të tyne në Shkollë, nuk munden me gëzue as nji paksim sherbimi rekrut; koha e kalueme prej atyne ne shkollë llogaritet si e vlefshme per efektet e sherbimit nen arme;

Nxansat per të cillët ban fjalë germa b) e nenit 3:

Dergohen në lirim me graden kapter i klasit II të;

Nxanësat per të cilët ban fjalë germa c) e nenit 3:

Dergohen nëpër repartet nga të cilët kanë ardhë me graden kapter i klasit IIte, (ose me graden ma të naltë qi eventualisht kishin para se të heqin dorë nga grada) e po me ato detyrime të sherbimit nen armë qi ata kishin para pranimit të tyne në Shkollë; koha e kalueme prej atyne si nxanësa, llogaritet si e vlefshme per efektet e sherbimit nen armë.

Neni 9.

Per djelmoshat qi pranohen në kurs, periudha e sherbimit ushtarak, fillon ç'prej datës së paraqitjes në Shkollë.

Neni 10.

Nxanësat e Shkollës konsiderohen ne të gjithë efektet si ushtarë.

Komandës së Shkollës i shenjohen per secilin nxanës:
Fr. ari 20 per shtesë gjellë.
Fr. ari 7 per shpenzimet e vegla shkollore.

DISPOZITA TRANSITORE

Neni 11.

Dispozitat per të cilat bajnë fjalë nenët e ma parshme, janë të zbatueshme edhe per djelmoshat e dat-lindjeve 1908, 1909 e 1910, qe gjinden nen armë prej nji kohë jo ma tepër se 6 (gjashtë) muej me datë 1 Tetuer 1930, ose qe, me gjithë qi e kanë detyrimin, nuk e kanë ba ende sherbimin efektiv.

Per nxanësat qi ndodheshin nen armë para se të pranoheshin

në Shkollë, e qe në mbarim të kurseve nuk deklarohen t'aftë per efektet e sherbimit qi duhet të bajnë si Kaptera të klasit IIte, perveç kohës së kalueme në Shkollë, edhe ajo e kalueme pranë reparteve para pranimit të tyne në Shkollë.

Neni 12.

Dispozitat e ligjës së rekrutimit ose të ligjëve të tjera qi janë në kundreshtim me ketë ligje, mbeten pa fuqi.

Neni 13.

Trupi Ministruer ngarkohet me aplikimin e kësaj ligjë e me plotësimin e gjithë dispozitave per zbatimin e sajë.

Neni 14.

Kjo ligjë hyn në fuqi ç'prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëvet
DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi rregullimin e Shkollës së nxanësave t'Oficerave Plotsimi, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 743-1 datë 5.XII. 930 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 15 Kallnuer 1931.

ZOG.

Kryeministri:
Zav. Ministri i P. Jashtme
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Drejtësis:
V. Avrani.

Ministri P. të Mbrendëshme
M. Juka.

Ministri i Arsimit
H. Mosi.

Ministri i Financavet:
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore:
Izet Dibra.

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Mehdi Frasheri.

Nr. 23

Dekret-Mbretnuer, 26 Kallnduer 1931.

Mbi mënyrën e fillimit të aplikimit, të Reformës Agrare

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 11 datë 12 Fruer 1931)

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve

Mbi propozimin e bamun me shkresë Nr. 5-34 datë 15-I-1931 të Kryesis së Këshillit Ministruer.

DEKRETON

Aprovimin e vendimit Nr. 1080 datë 30-XII-1930 të Këshillit Ministruer, mbi menyren e fillimit t'aplikimit të Reformës Agrare dhe, Urdhënon zbatimin e tij.

Tiranë, me 26-Kallënduer-1931

ZOG.

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli.

Nr. 24

Ligjë, 13 Mars 1931

Mbi bartje fondesh prej Fr. ari 15.000 në budgetin 1930-1931 të Ministrisë së Financavet

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 16 datë 14 Mars 1931)

Art. 1.

Në buxhetin e ushtrimit 1930-1931, të Ministris së Financavet nen Kap. 40 «Shpenzime zyreje»' shtohet një fondë prej Fr. ari 15.000 (pesëmbëdhjetmijë) tue i paksue prej:

Kap. 46 Shpenzime per mbajtjen e pesë Masvet	Fr. ari 7.000
Kap. 47 Kthim tatimesh	Fr. ari 6000
Kap. 50 Dergesë të hollash	» » 1000
Kap. 55 Rregjistrim Pasunish Shteti	» » 1000
Shuma	Fr. ari 15.000

Art. 2.

Kjo ligjë hyn në fuqi me diten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj ligjë, ngarkohet Ministria e Financavet.

Këshilli Ministruer, duke ushtruar Pushtetin Mbretnuer në bazë të nenit 65 të Statutit Themeltar të Shtetit, dhe në konformitet me dispoziten e paragrafit dytë po të ketij neni,

DEKRETON:

Aprovimin e Ligjit mbi bartje fondesh prej Fr. ari 15.000 në budgetin 1930 1931, të Ministris së Financavet, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 4-1-datë 2 II. 1931, të Kryesis së Tij, dhe urdhnon zbatimin e tij.

Tiranë, me 13. III. 1931

Kryeministri e
Zav. Ministri i P. Jashtme
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Drejtësis
V. Avrami.

Ministri i P. Mbrendëshme
Musa Juka.

Ministri i Arsimit
H. Mosi.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra.

Nr. 25

LIGJË, 13 Mars 1931.

Mbi krijimin e Kap. 26-ter. «Subvension e shpenzime gjithfarësh për të damtuemit prej termetit Korçë e rrethe», në budgetin e ushtrimit 930-31 të Ministris së Punëve Mbrendshme

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 16 datë 14 Mars 1931)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1930-31 të Ministris së Punëvet të Mbrendshme, krijohet

Kap. 26-ter «Subvencion e shpenzime gjithëfarësh për të damtuemit prej termetit në Korçë e rrethe», me fondin prej Fr. ari 40.000, (dyzetmij).

Art. 2.

Shpenzimevet të kapitullit të krijuem me artikullin e sypërme u bahet ballë me Fr. ari 20.000 (njizetmij) nga t'ardhunat e realizueme prej konjacionit të Lekëvet, dhe per 20.000, (njzetmij) Fr. ari të tjerë me t'ardhunat kompetencë të vërtetueme per kaq ma tepër nen Kap. 7 «Tatim mbi ndertesa e tokë ndertimi» të parapamjeve për ushtrimin n'udhtim.

Art. 3.

Ministri i P. të Mbrendshme dhe ay i Financavet, janë të ngarkuem me zbatimin e kësaj Ligjë qi ka me hye në fuqi me diten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Këshilli Ministruer, dyke ushtruar Pushtetin Mbretnuer në bazë të nenit 65 të Statutit Themeltar të Shtetit, dhe në konformitet me dispozitat e paragrafit dytë po të ketij neni,

DEKRETON:

Aprovimin e Ligjit mbi krijimin e Kap. 26/ter «Subvencion e shpenzime gjithëfarësh për të damtuemit prej termetit në Korçë e rrethe», në budgetin e ushtrimit 1930-1931 të Ministris së Punëvet të Mbrendshme, pranue prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 25-II datë 8-2-931 të Kryesis së Tij, dhe urdhenon zbatimin.

Tiranë me 13 Mars 1931.

Kryeministri e
Zav. Ministri i P. Jashtme
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Drejtësis
V. Avrami.

Ministri i P. Mbrendëshme
Musa Juka.

Ministri i Arsimit
H. Mosi.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra.

Nr. 26

LIGJË, 13 Mars 1931

Mbi shtimin e nji fondi prej fr. ari 86150 (tetëdhetegjashtëmijenjiqind e pesëdhetë) nen Kap. 37 bis B. «Pensione Ushtarake» të budgetit 1930-931 të Ministris së Financavet

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 16 datë 14 Mars 1931)

Art. 1.

Shtohet nji fond prej fr. ari 86150 (tetëdhetegjashtëmijenjiqindepesëdhet) nen Kap. 37 bis/B. «Pensione Ushtarake»' të budgetit 1930-931 të Ministris së Financavet.

Art. 2.

Shtesa e fondit mbas Art. 1 të kësaj ligjë përballohet me t'ardhunat e vertetueme ma teper se parapa në budgetin udhtues të t'ardhunavet nen Kap. 7 «Tatim mbi ndertesa e toke ndertimi».

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi me diten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligjë ngarkohet Ministrija e Financavet.

Këshilli Ministruer, duke ushtruar Pushtetin Mbretnuer në bazë të Nenit 65 të Statutit Themeltar të Shtetit, dhe në konformitet me dispoziten e paragrafit dytë po të ketij neni.

DEKRETON:

Aprovimin e Ligjit mbi shtimin e nji fondi prej fr. ar 86150 nen Kap. 37 bis B..«Pensione Ushtarake»' të budgetit 1930-931 të Ministris së Financavet, të pranueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 72-I datë 16. II 931 të Kryesis së Tij, dhe urdhenon zbatimin e tij.

Tiranë, me 13. III. 1931

Kryeministri
Zav. Ministri i P. Jashtme
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Drejtësis
V. Avrami.

BKSH

Ministri i P. Mbrendëshme
Musa Juka.

Ministri i Arsimit
H. Mosi.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra.

Nr. 27

Ligjë, 13 Mars 1931.

Per shtimin e nji fondi prej fr. ari 60.000 (gjashtëdhetmijë) në Kap. 26 ter. „Subvecion e shpenzime gjithfarësh për të damtuemit prej termetit të Korçës e rrethe", në budgetin 1930-31 të Ministris së P. të Mbrendëshme

(Botue në Fleroren Zyrtare Nr. 16 datë 14 Mars 1931)

Art. 1.

Në budgetin e ushtrimit 1930-31 të Ministris së P. të Mbrendëshme shtohet nji fond prej fr. ari 60.000 (gjashtëdhetëmijë) në Kap. 26-ter. «Subvension e shpenzime gjithfarësh për të damtuemit prej termetit në Korçë e rrethe».

Art. 2.

Shtesa e fondit si mbas Art. I të kësaj Ligjë, perballohet me t'ardhunat e efektueme ma tepër se parapa në Kap. 7 «Tatim mbi ndertesa e toke ndertimi» të budgetit 1930-31 të t'ardhunavet.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi me ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligjë ngarkohet Ministrija e Financavet e Ministrija e P. të Mbrendëshme.

Kshilli Ministruer, duke ushtruar Pushtetin Mbretnuer në bazë të Nenit 65 të Statutit Themeltar të Shtetit, dhe në konformitet me dispoziten e paragrafit dytë po të ketij Neni.

DEKRETON:

Aprovimin e Ligjit mbi shtimin e nji fondi prej fr. ari 60.000 në Kap. 26-ter «Subvension e shpenzime gjithfarësh për të damtuemit prej termetit të Korçës e rrethe», në budgetin 1930-1931 të Ministris së P. të Mbrendëshme, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 44-III datë 5.II.1931 të Kryesis së Tij, dhe Urdhenon zbatimin e tij.

Tiranë me 13 Mars 1931.

Kryeministri e
Zav. Ministri i P. Jashtme
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Drejtësis
V. Avrami.

Ministri i P. Mbrendëshme
Musa Juka.

Ministri i Arsimit
H. Mosi.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra.

Nr. 28

LIGJË, 13 Mars 1931

Mbi shtesën e nji fondi prej Fr. ari 30.625 (tridhjetmijë gjashtëqintnjizetepesë), nën Kap. 44 „shtypje pullash dhe bandrollash et." të budgetit 1930-1931, të Ministris së Financavet

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 16 datë 14 Mars 1631)

Art. 1.

Shtohet nji fond prej fr. ari 30.625 (tridhjetmijë gjashtëqint e njizetepesë) nën Kap. 44 «Shtypje pullash dhe bandrollash dhe

ngjitje pullash per skrepsa», të budgetit 1930-1931, të Ministris së Financavet.

Art. 2.

Kjo shtesë fondi përballohet me t'ardhunat e efektueme nen Kap. 38 «T'ardhuna prej monedhes» të budgetit udhëtues të t'ardhunave.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi me diten e shpalljes në fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Ministria e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligjë.

Kshilli Ministruer duke ushtruar Pushtetin Mbretnuer në bazë të nenit 65 të Statutit Themeltar të Shtetit, dhe në konformitet me dispoziten e paragrafit dytë po të këtij neni,

DEKRETON

Aprovimin e Ligjit mbi shtesen e nji fondi prej Fr. ari 30.625 në budgetin vazhdues të Ministris së Financavet, e votueme prej Parlamentit si mas shkresës Nr. 43-I date 6-III-931 të Kryesis së Tij, dhe urdhenon zbatimin e tij.

Tiranë me 13 Mars 1931.

Kryeministri e
Zav. Ministri i P. Jashtme
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Drejtësis
V. Avrami.

Ministri i P. Mbrendëshme
Musa Juka.

Ministri i Arsimit
H. Mosi.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra.

Nr. 29

LIGJË, 13 Mars 1931

Mbi bartje fondesh në budgetin e ushtrimit 1930-931

(Botue në fletoren Zyrtare Nr. 16 datë 14 Mars 1931)

Art. 1.

Në budgetin e ushtrimit 1930-31 bahen keto bartje fondesh:

Paksohen nga budgeti i Ministris së Financavet (Kryeministri)

Nga Kap.	28 Rrogë personeli	Fr. ari	2.000
» »	29 Shpenzime zyreje	»	1.000
» »	1 Rrogë personeli etj. (Ministris Drejtësis)	»	6.000
» »	1 Rrogë personeli etj. të Ministris P. Jatshme	»	16.000
» »	5 Shpenzime për mbajtjen e nxanësve nder shkolla Ushtarake, rrogë personeli civil të shkollavet, shpenzime e shperblime per mbajtjen e studentave civila e ushtarake përjashta, shpenzime për kurse t'instruksionit, të Komandes Mbrojtjes Kombetare	»	13.000
		Gjithsejt Fr. ari	38.000

Art. 2.

Shtohen në budgetin udhtues të Ministris së P. të Jashtme

Në Kap.	2 Shpenzime udhtimi e djetë	»	7.500
» »	3 Shpenzime zyreje	»	10.000
» »	6 Shpenzime të mëshefta	»	45.500
		Fr. ari	60.000

Art. 3.

Shuma e fondit prej fr. ari 22.000 (njizetedymijë) shtue në budgetin e Ministris së P. të Jashtme ma tepër se fondet e paksueme si mbas Art. 1 të kësaj ligjë, përballohet me t'ardhunat e verteteume nen Kap. 38 «T'ardhuna prej monedhes» të budgetit t'ardhunavet t'ushtrimit 1930-31.

Art. 4.

Kjo Ligjë hynë në fuqi me diten e shpalljes në fletoren Zyrtare.

Art. 5.

Me zbatimin e kësaj Ligjë ngarkohet Ministrija e Financavet, Ministrija Drejtësis e P. të Jashtme.

Kshilli Ministruer, duke ushtruar Pushtetin Mbretnuer në bazë të Nenit 65 të Statutit Themeltar të Shtetit, dhe në konformitet me dispoziten e paragrafit dytë po të ketij neni.

DEKRETON

Aprovimin e Ligjit mbi bartje fondesh prej fr. ari 60.000 në budgetin 1930-31 të Ministrisë së P. të Jashtme, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 11 - I. datë 12. II. 1931 të Kryesis së Tij, dhe urdhenon zbatimin e tij.

Tiranë, me 13. Mars 1931

Kryeministri e
Zav. Ministri i P. Jashtme
Pandeli Evangjeli.

Ministri Drejtësis
V. Avrami.

Ministri i P. Mbrendshme
Musa Juka.

Ministri i Arsimit
H. Mosi.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra.

Nr. 30

LIGJË, 19 Mars 1931.

Mbi shtimin e fondit prej fr. ari 10.000 në Kap. 36 "rrogë personeli etj", të Gjendjes të parapame të shpenzimevet në budgetin 1930-31, të Ministris së Financavet

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 17 datë 19 Mars 1931)

Art. 1

Në Kap. 36 «rrogë personeli etj.» të gjendjes të parapamjevet të shpenzimeve në budgetin 930-31, të Ministris së Financavet shtohet

nji fondë prej fr. ari 10.000, për të përballue me ketë pagesën e të gjithë rrogave të përsonelit të dikasterit të Financavet deri me 31 III. 931.

Art. 2.

Fondi i shtuem si mbas art. 1 të sipërme përballohet me të ardhunat e të parapame të realizueme nen Kap. 38« t'ardhuna prej Monedhës» në budgetin e të ardhunavet t'ushterimit në udhetim.

Art. 3.

Ministri i Financavet asht i ngarkuem në zbatimin e kësaj ligjë.

Art. 4.

Kjo ligjë hynë në fuqi me ditën e shpalljes së saj në Fletoren Zyrtare.

Kshilli Ministruer duke ushtruar Pushtetin Mbretnuer në bazë të nenit 65 të Statutit Themeltar të Shtetit, dhe në konformitet me dispoziten e paragrafit dytë po të ketij neni,

DEKRETON

Aprovimin e ligjit mbi shtesen e nji fondi prej Fr. ari 10.000 nen Kap. 38 «rrogë personeli etj.» të gjendjes të parapamjevet të shpenzimevet në budgetin 1930-931, të Ministris së Financavet, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 60-1.datë 12.III.931 të Kryesis së Tij, dhe urdhnon zbatimin e tij.

Tiranë, me 13. Mars 1931

Kryeministri e
Zav. Ministri i P. Jashtme
Paudeli Evangjeli.

Ministri Drejtësis
V. Avrami.

Ministri i P. Mbrendshme
Musa Juka.

Ministri i Arsimit
H. Mosi.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra.

Nr. 31

LIGJË, 13 Mars 1931

Mbi shtesa fondesh prej fr. ari 25.000 ne budgetin e ushtrimit 1930-31 të Ministris së P. të Mbrendëshme

(Botue në Fletoren Nr. 17 datë 19 Mars 1931)

Art. 1

Në budgetin e ushtrimit 1930-31 të Ministris P. të Mbrendëshme shtohet nen Kap. 2 «shpenzime udhtimi e djetë» nji fond prej fr. ari 10.500, nen Kap. 3 «shpenzime Zyreje» fr. ari 10.720 dhe në Kap. 4 qira fr. ari 3.780.

Art. 2.

Shtesa e fondeve të siperme prej fr. ari 25.000 përballohet me t'ardhunat e realizueme ma tepër se parapa nen Kap. 7. «Tatim mbi ndertesa e tokë ndertimi»' të budgetit t'ardhunavet t'ushtrimit 1930-931.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi me diten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligjë, ngarkohet Ministrija e Financavet dhe ajo e P. të Mbrendëshme.

Këshilli Ministruer, duke ushtruar Pushtetin Mbretnuer në bazë të Nenit 65 të Statutit Themeltar të Shtetit, dhe në konformitet me dispoziten e paragrafit dytë po të ketij Neni,

DEKRETON

Aprovimin e Ligjit mbi shtesa fondesh prej fr. ari 25.000 në budgetin e ushtrimit 1930-31 të Ministris së P. të Mbrendëshme, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 55-1 d. 12. III 1931 të Kryesis së Tij, dhe udhenon zbatimin e tij.

Tiranë, me 13. Mars 1931

Kryeministri e
Zav. Ministri i P. Jashtme
Pandeli Evangjeli.

BKSH

Ministri Drejtësis
V. Avrami.

Ministri i P. Mbrendshme
Musa Juka.

Ministri i Arsimit
H. Mosi.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra.

Nr. 32

LIGJË, 19 Mars 1931.

mbi bartje e shtesa fondesh në budgetin e ushtrimit 1930-31 të Ministris s' Arsimit

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 17 datë 19 Mars 1931)

Art. 1.

Kapitujve te poshte shenueme te budgetit 1930-31 te Ministris s'Aresimiti i behen keto shtesa fondesh:

Kap. 1. Rroge personeli zevendesie, alokasion e rroge per nepunsa te mbetun jashte kuadrit . . . . . .fr. ari 66.080
Kap. 4. Shpenzime Zyreje . . . . » » 5.250
Kap. 10. Bursa studentash. . . . . » » 50.000
Gjithesejt. » 121.330

Art. 2.

Shtesa e fondeve mbas Art. 1 të kësaj Ligjë përballohet me pakësimet e fondeve t'ekonomizueme në budgetin udhtues të Ministris së Arësimit nga:

Kap. 2. Rrogë personali me kontrate Fr. ari 18.380
Kap. 3. Shpenzime udhtimi e djetë Fr. ari 12.000
Kap. 6. Shpenz. për mbajtje konviktesh Fr. ari. . . . 61.000

e diferenca e Fr. ari 30.000 (tridhetmij) të shtesës së fondeve ma tepër se pakësimet, përballohet nga t'ardhunat e realizueme ma tepër se parapa në budgetin 1930-31 të t'ardhunavet nen Kap. 7. Tatim mbi ndertesa e tokë ndertimi» Fr. ari 20.000
nga Kap. 38 «T'ardhuna prej monedhes» Fr. ari. . . . 10.000
Gjithsej 121.000

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi me daten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligjë ngarkohet Ministrija e Financavet dhe ajo e Arësimit.

Këshilli Ministruer duke ushtruar Pushtetin Mbretnuer në bazë të nenit 65 të Statutit Themeltar të Shtetit, dhe në konformitet me dispozitën e paragrafit të dytë po të këtij Neni.

DEKRETON

Aprovimin e Ligjit mbi bartje e shtesa fondesh në budgetin 1930-31, të Ministris së Arësimit, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 80-I datë 18. III. 1931 të Kryesis së Tij, dhe urdhenon zbatimin e tij.

Tiranë, me 19 Mars 1931

Kryeministri e
Zav. Ministri i P. Jashtme
Pandeli Evangjeli.

Ministri Drejtësis
V. Avrami.

Ministri P. Mbrendshme
Musa Juka.

Ministri i Arsimit
H. Mosi.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra.

Nr. 33

LIGJË, 19 Mars 1931

Mbi transferimin e fondevet të budgetit 1930-931 të Komandës së Mbrojtjes Kombtare

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 17 datë 19 Mars 1931)

Art. 1

Në budgetin e vjetit 1930-931 të Komandes së Mbrojtjes Kombtare paksohen prej:

BKSH

Kapitulli 1. «Rrogë Oficerash e personalit civil (me përjashtim të personalit civil të Spitalevet, të Shkollavet, të Depos së Kafshëvet e t'Ofiçinavet) Fr. ari 10.000

Kapitulli 2. «Rroga graduatesh e ushtarësh me rrogë e rekruta, shperblim per Artileri e Gardë Mbretnore e Roje Mbretnore të Kufinit» Fr. ari 30.200

Kapitulli 4. «Shpenzime për mbajtjen e të sëmundevet nder Spitale e Infermerina garnizonit, ushqim i posaçem për të shëruem, rrogë pesonalit civil të Spitalevet, blemje e mirëmbajtje e shperndamje barnash e materialit shendetsuer, shpenzime të ndryshme shendetsijet» Fr. ari 9.500

Kapitulli 5. «Shpenzime për rimbajtjen e nxanësvet nder Shkolla Ushtarake, rrogë personalit civil të Shkollavet, shpenzime e shperblime për mbajtjen e studentavet civila e ushtarakë perjashta, shpenzime për kurse instruksioni» Fr. ari 20.000

Kapitulli 8. «Blemje» persritje e mirëmbajtje e mobiljevet të materialit të kazermavet, kashtë për shtresë ushtarësh, zjarm e dritë» Fr. ari 20.000

Kapitulli 9. « Ushqim Oficerash, graduatësh e ushtarësh» Fr. ari 82.900

Shuma Fr. ari 172.600

e shtohen në:

Kapitulli 3. «Shperblime për shpenzime të posaçme, Fr. ari 127.000

Kapitulli 12. «Blemje kafshesh, shpenzime për rekuizime kafshesh, shperblim oficierave për humbje kafshesh» Fr. ari 10.000

Kapitulli 15. «Shpenzime për transportime Ushtarake, blemje e mirëmbajtje automjetesh e materialit të ndryshem për sherbimin e auto-transportimevet, shpenzime për funksionimin e auto-repartit e t'Ofiçinës s'automobilavet, shpenzime për transportime me mjete private» Fr. ar 5.600

Kapitullit 34. «Ndertime të reja ushtarake, transformime të medhaja e zgjanim i gjanavet të pa-tundëshme në përdorim ushtarak, blemje e shpronësim gjanash të pa-tundëshme në përdorim ushtarak, linje telefonike e përherëshme» Fr. ari . . . 30.000

Shuma 172.600

Art. 2.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligjë.

Art. 3.

Kjo ligjë hynë në fuqi me ditën e shpalljes së saj në Fletoren Zyrtare.

Kshilli Ministruer duke ushtruar Pushtetin Mbretnuer në bazë të nenit 65 të Statutit Themeltar të Shtetit, dhe në konformitet me dispozitën e paragrafit të dytë po të këtij Neni.

DEKRETON

Aprovimin e Ligjit mbi transferim fondesh në budgetin 1930-931 të Komandes se Mbrojtjes Kombetare, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 71-I datë 18. III. 1931 të Kryesis së Tij, dhe urdhenon zbatimin e tij.

Tiranë, me 19. Mars 1931

Kryeministri e
Zav. Ministri i P. Jashtme
Pandeli Evangjeli.

Ministri Drejtësis
V. Avrami

Ministri P. Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Arsimit
H. Mosi.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra.

Nr. 34

LIGJË, 19 Mars 1931

Mbi shtesa fondesh në budgetin e ushtrimit 1930-931 të Ministris së Financavet

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 19 Mars 1931 Nr. 17.)

Art. 1.

Në budgetin e ushtrimit 1930-31 të Ministris së Financavet shtohen fondet si vijojnë:

Kap. 39 Shpenzime udhtimi e djetë Fr. ari	5.000
Kap. 40 Shpenzime Zyreje fr. ari	15.000
Kap. 41 Qira fr. ari	9.000
Kap. 42 Vertetim tatimesh e taksash fr. ari	17.000
Kap. 43 Skonto pullash fr. ari	6.000
Kap. 48 Ndertime e miratime në Pas. Shteti fr. ari. . .	10.000
Kap. 49 Shpenzime Gjyqi fr. ari	12.000
Gjithsejt fr. ari	74.000

Art. 2.

Shtesa e fondeve mbas Art. 1. të kësaj Ligjë, përballohet me t'ardhunat e vertetueme ma tepër se parapa nen Kap. 7 «Tatim mbi ndertesa e tokë ndertimi» të budgetit të t'ardhunavet t'ushtrimit 1930-931.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi me daten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligjë ngarkohet Ministrija e Financavet.

Kshilli Ministruer duke ushtruar Pushtetin Mbretnuer në bazë të nenit 65 të Statutit Themeltar të Shtetit, dhe në konformitet me dispozitën e paragrafit të dytë po të këtij Neni.

DEKRETON

Aprovimin e Ligjit mbi shtesa fondesh në budgetin e ushtrimit 1930-31 të Ministris së Financavet, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 83.1 datë 18. III 1931 të Kryesis së Tij, dhe urdhenon zbatimin e tij.

Tiranë, me 19 Mars 1931
Kryeministri e
Zav. Ministri i P. Jashtme
Pandeli Evangjeli.

Ministri Drejtësis
V. Avrami

Ministri P. Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Arsimit
H. Mosi.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Nr. 35.

LIGJË, 19 Mars 1931

Mbi shtesën e nji fondi prej Fr. ari 37.800 në buxhetin 1930-31 të Ministris Financavet

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 19 Mars 1931 Nr. 17)

Art. 1.

Shtohet nji fondë prej fr. ari 37.800, (tridheteshtatmij e tetqin-

dë) nen Kap. 32 Shpenzime për Zyrën e shtypit, propagandë Shtypi, shpenzime poste-legrafike» të budgetit 1930-31 të Ministris së Financavet.

Art. 2.

Prej shtesës së fondit mbas Art. 1. të kësaj Ligjë, 35.800, Fr. ari përballohen me t'ardhunat e vertetueme ma tepër se parapae në Kap. 10 «Taiim mbi berre e Thie» të budgetit t'ardhunavet t'ushtrimit 1930-31, e 2000 Fr. ari transferohen prej Kap. 17 «Dhurata për ushtrime, grade e konkurse» të budgetit të Komandes së Mbrojtjes Kombetare.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi me daten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligjë ngarkohet Ministria e Financavet.

Kshilli Ministruer duke ushtruar Pushtetin Mbretnuer në bazë të nenit 65 të Statutit Themeltar të Shtetit, dhe në konformitet me dispozitën e paragrafit të dytë po të këtij Neni.

DEKRETON

Aprovimin e ligjit mbi shtesen e nji fondi prej Fr. ari 37.800, në budgetin 1930-31 të Ministris së Financavet per shpenzime shtypi, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 91-I datë 17. III. 1931, të Kryesis së Tij, dhe urdhenon zbatimin e tij.

Tiranë, me 19. Mars 1931

Kryeministri e
Zav. Ministri i P. Jashtme
Pandeli Evangjeli.

Ministri Drejtësis
V. Avrami

Ministri P. Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Arsimit
H. Mosi.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Nr. 36.

LIGJË, 19 Mars 1931

Mbi shtesë fondesh prej fr. ari 24.821 në budgetin 1930-31 të Ministris së P. Botore

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 19 Mars 1931 Nr. 17)

Art. 1.

Kapitujve të poshtë shenjuem të budgetit 1930-31 të Ministris së P. Botore i bahen këto shtesa fondesh:

Kap. 1. Rrogë personeli mbas kuadrit etj. Fr. ari	17.931
Kap. 4. Shpenzime Zyre fr. ari	1.500
Kap. 5. Qira fr. ari	5.390
Gjithsejt Fr. ari	24821.

Art. 2.

Shtesa e fondeve si mbas Art. 1 të kësaj Ligjë përballohet me t'ardhunat e realizueme ma tepër se parapa prej fr. ari 16000 (gjashtëmbëdhetmij) nen Kap. 7 «Tatim mbi ndertesa e tokë ndertimi» e fr. ari 8821 (tetëmijëtetëqindenjizetenji) nga Kap. 38 «T'ardhuna prej monedhes» të budgetit t'ardhunavet t'ushtrimit 1930-31.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi me daten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligjë ngarkohet Ministrija e Financavet e Ministrija e P. Botore.

Kshilli Ministruer, duke ushtruar Pushtetin Mbretnuer në bazë të Nenit 65 të Statutit Themeltar të Shtetit, dhe në konformitet me dispoziten e paragrafit të dytë po të ketij Neni.

DEKRETON.

Aprovimin e Ligjit mbi shtesë fondesh prej fr. ari 24821 në budgetin 1930-931 të Ministris së P. Botore, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 88 I datë 18.III. 1931 të Kryesis së Tij, dhe urdhenon zbatimin e tij.

Tiranë, me 19. Mars 1931

Kryeministri e
Zav. Ministri i P. Jashtme
Pandeli Evangjeli.

Ministri Drejtësis
V. Avrami

BKSH

Ministri P. Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Arsimit
H. Mosi.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

LIGJË, 28 Mars 1931

Nr. 37.

Mbi plotësimin e fondit të Kap. 9 "Rogë personeli„ të budgetit 1930-31 të Drejtoris së P. të Postelegrafave

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 30 Mars 1931 Nr. 19)

Art. 1.

Kap. 9 «Rrogë personeli zavendëije per nep. të mbetun jashtë kuadrit» të budgetit 1930-1931 të Ministris së Punëvet Botore (Degë Postelegrafike), i shtohet nji fondë prej Fr. ari 12.220 (dymbëdhetmijedyqindenjizet).

Art. 2.

Shtesa e fondit prej Fr. ari, 12.220 (dymbëdhetmijedyqindenjizet), perballohet me pakësimin e fondeve të budgetit 1930-1931 të Ministris së Punëvet Botore, Degë Postelegrafike nga Kap. 10.

Rrogë personeli me kontratë fr. ari	2.400
Kap. 18 «Taksa Nderkombetare Fr. ari	1.000
Kap. 21. «Syrtaksa e Kryqit të Kuq. Fr. ari	4.000
Shuma, ... Fr. ari	7.400
e diferenca prej . . . . »	4.820
Shuma e Pergj. Fr. ari	12.220

Përballohet me t'ardhunat e realizueme ma tepër se parapame nen Kap. 10, «Tatim mbi berre e Thie» të budgetit të t'ardhunavet t'ushtrimit 1930 1931.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi me daten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligjë ngarkohet Ministrija e Financavet e Ministrija e P. Botore.

BKSH

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve
DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi plotësimin e fondit të **Kap. 9** «Rrogë personeli» të budgetit të Drejtoris së P. Post-telegrafike, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 112-I datë 26, III. 1931, të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 28 Mars 1931

Z O G.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra.

Nr. 38.

LIGJË, 28 Mars 1931

Mbi bartje fondesh në budgetin e ushtrimit 1930-31 të Komandës së P. të Gjendarmeris

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 30 Mars 1931 Nr. 19)

Art. 1.

Në budgetin e ushtrimit 1930-931 të Komandës së P. të Gjindarmeris bahen këto bartje fondesh:

Paksohen prej:

Kap. 22 Rrogë Oficeri e personeli civil, Fr. ari . . .	6.000
Kap. 27 Qirá Fr. ari	10,000
Kap. 28 Ndertime Fr. ari	3.000
Gjithsejt fr. ari	19.000

e i shtohen:

Kap. 26 Shpenzime Zyreje Fr. ari	10.000
Kap. 24 Shpenzime udhtimi e djetë Fr. ari	9.000
Gjithsejt fr. ari	19.000

Art. 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Ligjë, ngarkohet Ministrija e Financavet.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve
DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi bartje fondesh në budgetin e ushtrimit 1930-931 të Komandës së P. të Gjindarmeris, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 95-I datë 24. III. 931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 28 Mars 1931

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Nr. 39.

LIGJË, 28 Mars 1931

Mbi bartje fondesh në budgetin 1930-31 të Ministris së Financavet (pjesë e Oborit Mbretnuer

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 30 Mars 1931 Nr. 19)

Art. 1.

Në budgetin 1930-31, të Ministris së Financavet (Obori Mbretnuer) pakësohen prej:

Kap. 13 Shpenzime udhtimi e djete	Fr. ari	600
Kap. 14 Qira	» ari	1080
Shuma	»	1680

e i shtohen

Kap. 8 Shpenzime Udhëtimi e dijete (shtepija Civile	Fr. ar	140
Kap. 12 Shpenzime udhëtimi e djete (Inspektoria)	Fr. ar	1540
Shuma	»	1680

Art. 2.

Kjo ligjë hyn në fuqi me diten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Me zbatimin e kësaj Ligjë ngarkohet Ministria e Financavet.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve
DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi bartje fondesh në budgetin 1930-931, të Ministris së Financavet, (pjesë Obori Mbret-

nuer) e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 113-1 datë 26-III-931, të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 28 Mars 1931

Z O G.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Nr. 40.

LIGJË, 28 Mars 1931

Mbi transferim kreditash në budgetin e Ministris së P. të Mbrendshme ushtrim 1930-31

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 30 Mars 1931 Nr. 19)

Art. 1.

I shtohet Kap. 7 «Mbajtje Burgjesh etj» të budgetit të Ministris së P. të Mbrendshme, Fr. ari 11,600.

Art. 2.

Për përballimin e shumës së siperme pakësohen Fr. ari 2400 prej Kap. 6 «Fletore Zyrtare» Fr. ari 4200, Kap. 8 «Shtypje pasaportash, Qarkore etj». dhe fr. ari 5000, prej Kap. 10 «Kremtime» të budgetit të Ministris së P. të Mbrendëshme.

Art. 3.

Kjo Ligjë hyn në fuqi që me daten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Për zbatimin e kësaj ligjë ngarkohet Ministria e Financavet dhe ajo e P. të Mbrendshme.

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarve

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi transferim kreditash prej Fr. ari 11.600 të budgetit 1930-931, të Ministris së P. të Mbrendëshme, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 111-I datë 26. III 931 të Kryesis së Tij.

Tiranë me, 28 Mars 1931

Z O G.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli.

Ministri P. Mbrend.
Musa Juka.

Ministri i Financavet
K.Thaçi.

Nr. 41.

LIGJË, 28 Mars 1931

Mbi mbartjen e nji fondi prej ari 3000 në budgetin 1930-31 të Ministris s'Ekonomis Kombëtare

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 30 Mars 1931 Nr, 19)

Art. 1.

Në budgetin prevantiv t'Ushtrimit 1930-931 të Ministris s'Ekonomis Kombëtare bartet një fond prej fr. ari 3000 (tremij) prej Kap. 7 «Shpenzime të ndryshme për grupin e punimeve bulqsore» dhe i mveshen Kap. 11 «Ushqim veshje, mbathje e shpenzime tjera për Shkollën e Bujqësis» fr. ari 1800, dhe Kap. VI «Blemie benzine ripaacione e tj.» fr. ari 1200.

Art. 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Ligjë ngarkohet Ministrija e Ekonomis Kombtare.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve
DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi bartjen e nji fondi prej fr. ari 3.000 në budgetin 1930-931 të Ministris s'Ekonomis Kombëtare, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 90-I datë 23-III-931 të Kryesis së Tij.

Tiranë me, 28 Mars 1931.

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli.

Ministri Ek. Kombtare
Mehdi Frasheri.

LIGJË, 14 Mars 1931

Nr. 42.

Mbi Procedurën e akuzimit të Ministravet nga ana e N. M. së Tij Mbretit

(Botue në Fletoren Zyrtara datë 4 Prill 1931 Nr. 20)

Neni 1.

Për ushtrimin e kompetences së parapame në nenin 76 të Statutit Themeltar, formohet me Dekret Mbretnuer dhe për ç'do rast nji komision i përbamë prej nji Anëtari të Diktimit dhe për posë ndihmsave nga nji prej pjersëtarëve të Këshillit të Shtetit dhe të Këshillit Kontrollues, i cili heton fajet e caktueme me ligjen e posaçme mbi përgjegjësinë e Ministrave si dhe për trathti të Naltë, dhe ka kompetencë me kërkue prej ç'do personi ose Zyre shpjegime qi i sheh të nevojshme, Kryetari i Komisionit caktohet me Dekretin Mbretnuer.

Neni 2.

Komisioni ushtron të gjitha ato të drejta qi parashikon në proceduren Penale për Prokuroriet dhe Hetuesit po, nuk mund të vendosë rreshtimin e nji personi ma parë se të merret autorizimi i Mbretit.

Neni 3.

Komisioni plotëson hetimet redakton nji raport t'arësyetuem dhe i a parashtron Mbretit.

Neni 4.

Kur Mbreti çmon se ka vend për akuzim të nji ose ma shumë Ministrave Dekreton ngrehjen e Gjyqit të Naltë, ku i dergon tue i a refue aktet relative Kryeprokurorisë së Shtetit e cila, bashkë me pretencen e vet, i a parashtron Gjyqit të Naltë. Bashkë-vepruesit eventuale gjykohen po n'atë Gjyqë.

Në rast t'akuzimit të Ministrit dhe të dekretimit të Gjyqit të Naltë Qeverija lajmëron Parlamentin.

BKSH

Neni 5.

Në formimin e Komisionit nderpritet parashkrimi i fajeve në fjalë.

Neni 6.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e ketij Dekret-Ligji.

Neni 7.

Ky Dekret-Ligjë hyn në fuqi me daten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Drejtësis
V. Avrami

Ministri i P. të Jashtme e
Zav. Ministri P. Mbrendëshme
R. Fico.

Ministri i Arësimit
H. Mosi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Si ndigjojë dhe pëlqejë Vendimin e Këshillit Ministruer;

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret Ligjit mbi proceduren mbi akuzimin të Ministrave nga ana e Nalt-Madhnies së Tij Mbretit.

Durrës, me 14 Korrik 1930

ZOG.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve
DEKRETON

Zbatimin e Dekret-Ligjit me datë 14 Korrik 1930, të vo-

BKSH

tueme prej Parlamentit, dhe Urdhënon shtimin e tij në Kodet e Mbretnies si Ligjë.

Tiranë, me 24 Mars 1931

ZOG.

Nr. 43.

LIGJË, 24 Mars 1931

Mbi krijimin e nji fondi në budgetin e Komandës së P. të Gjindarmeris për shpërblim t' oficerëve që dërgohen për studim jashtë.

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 4 Prill 1931 Nr. 20)

Art. 1.

Në budgetin 1930-31 të Komandes së P. të Gjindarmeris krijohet Kap 33 bis në emertim «Shperblim për Oficerat qi studjojnë jashtë Shtetit» tue, bartë në ketë nji fond prej fr. ari 13440 (trembëdhetmijëkatërqindedyzet) nga Kap. 22 «Rrogë Oficjeri e personeli civil» po të budgetit të sajë për të përballue me ketë fond pagesen që nga 1 Gusht 1930 të shperblimit mujuer në sasi të rrogës së tyne Oficeravet qi dergohen jasht Shtetit për studim.

Art. 2.

Kjo Dekret-Ligjë ka me i u paraqit Parlamentit për t'a sjellun në ligjë.

Art. 3.

Ky Dekret-Ligjë hyn në fuqi me daten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë ngarkohet Trupi Ministruer.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli.

BKSH

Ministri i P. të Jashtme e
Zav. Ministri P. Mbrendëshme
R. Fico.

Ministri Arsimit e
Zav. Ministri Financavet
H. Mosi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombtare e
Zav. Ministri i Drejtësis
Mehdi Frasheri.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1950-I datë 21. VIII 930,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 17. VIII. 1930

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret Ligjës mbi krijimin e nji fondi në budgetin e Komandes së P. të Gjindarmeris, për shperblim t'Oficerave qi dergohen për studim jashtë Shtetit.

Durrës, me 22 Gusht 1930

ZOG.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve
DEKRETON

Zbatimin e Dekret-Ligjit me datë 22 Gusht 1930 të votueme prej Parlamentit, dhe Urdhënon shtimin e tij në Kodet e Mbretnis si Ligjë.

Tiranë, me 24 Mars 1931

ZOG.

BKSH

Nr. 44.

LIGJË, 24 Mars 1931

Mbi aprovimin e gjendjes së parapamjevet për t' ardhuna e shpenzime t' ushtërimit financjer 1-4-930 deri 31-III-931 të Drejtoris P. të Pensioneve

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 4 Prill 1931 Nr. 20)

Art. 1.

Aprovohet gjendja e parapamjevet për ushtrimin Financjar prej 1. IV. 1930, deri me 31 Mars 1931 të Drejtoris së P. të Pensioneve Civile për të ardhuna prej Fr. ari 625.924 (gjashtëqindenjizetepesmijëenandëqindenjizetekater), e për shpenzime prej Fr. ari 131.642 (njqindetridhetenjimijëgjashtëqindedyzetedy) si mbas listave dalluese e të kuadrit të personelit të bashkengjitun.

Art. 2.

Kjo Dekret Ligjë hynë në fuqi me diten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë ngarkohet Ministrija e Financavet.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Drejtësis
V. Avrami.

Ministri i Arësimit e
Zav. Ministri i P. Botore
H. Mosi.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i Ekonomis Kombtare
Mehdi Frasheri.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 100/37 datë 19.IV. 930,

Si ndigjojë dhe pëlqejë Vendimin e Këshillit Ministruer me datë 11.VI.930,

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret Ligjit mbi aprovimin e Budgetit 1930-931 të Drejtories së P. të Pensioneve Civile së bashku me listat dalluese.

Durrës, me 23 Qershuer 1930

ZOG.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON

Zbatimin e Dekret-Ligjit me datë 23 Qershuer 1930, të votuem prej Parlamentit, dhe Urdhenon shtimin e tij në Kodet e Mbretnies si Ligjë.

Tiranë, me 24 Mars 1931

ZOG.

Nr. 45.

LIGJË, 24 Mars 1931

Mbi perjashtimin e Emigrandëve nga e treta edhe për vitin 1930.

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 4 Prill 1931 Nr. 20)

Art. 1.

Emigrandet e instaluem ner tokat shtetnore qi kanë kalue tri vjetet si mbas Art. 5 të Ligjës s'Emigranteve, përjashtohen edhe për vjetin 1930-1931-1932, nga e treta e tokës qi u asht qenë dhanë me kohë prej Qeveris.

BKSH

Art. 2.

Kjo Dekret-Ligjë hyn në fuqi qysh nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Ministrija e Financavet asht e ngarkueme me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli.

Ministri i P. të Jashtme e
Zav. Ministri P. Mbrendëshme
R. Fico.

Ministri Arsimit e
Zav. Ministri Financavet
H. Mosi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombtare e
Zav. Ministri i Drejtësis
Mehdi Frasheri.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 139-II datë 5. VIII. 1930.

Si ndigjojë dhe pëlqejë Vendimin e Këshillit Ministruer me datë 2. VIII. 930.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret Ligjit mbi përjashtimin e Emigranteve edhe për vjetin 1930 nga e treta e tokës.

Durrës, me 8 Gusht 1930

ZOG.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve
DEKRETON

Zbatimin e Dekret-Ligjit me datë 8 Gusht 1930, të votueme prej Parlamentit, dhe Urdhenon shtimin e tij në Kodet e Mbretnis si Ligjë.

Tiranë, me 24 Mars 1931

ZOG.

LIGJË, 24 Mars. 1931.

Nr. 46.

Mbi rrogat, shpërblime e shpenzime udhëtimi të personelit të Gjindermarisë dhe të Fuqive Ushtarake në shërbim të Gjindermarisë

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 4 Prill 1931 Nr. 20)

Art. 1.

Rrogat e gradat e Gjindarmeve dse graduatve e Ushtarëve në sherbim të Gjindarmeris caktohen si vijon:

a)	Kapter i Kl. I.	në muej	Fr. ari	120
	» » II.	» »	»	110
Personeli në sherbim Aktiv	Reshtar	» »	»	90
	Tetarë	» »	»	80
	Gjindarmë	» »	»	70
Personeli në sherbim provizor	Kaptera	» »	»	100
	Reshtar	» »	»	80
	Tetarë	» »	»	70
	Gjindarmë	» »	»	60
Personeli Artileri infanteri me rrogë	Kapteri i-Kl. I.	» »	»	90
	II	» »	»	90
	Reshtar	» »	»	70
	Tetarë	» »	»	60
Personeli infanteri e artileri rekrutë	Rashter	» »	»	47
	Tetar	» »	»	45
	Ushtar	» »	»	40

B) Personeli artileris me rrogë ka të drejtë me marrë ketë shperblim armet që fiton në Ushtri.

Kapter i Kl. I.	në muej	Fr. ari	20
» » II.	» »	»	15
Reshtari	» »	»	10
Tetari	» »	»	5

C) Graduatet e artileris e të infanteris me rrogë në sher-

BKSH

bim të Gjindarmeris kanë të drejtë ushqimi në bazë të ligjëve e të Rregulloreve Ushtarake në fuqi.

Art. 2.

Shpenzimet eventuale e shpenzimet e udhtimit të personelit të Gjindarmeris, do të paguhen kur do herë në bazë të ligjëve e Rregulloreve në fuqi për degen e Ushtris vetem me kto ndryshime;

Shperblime për pozita të posaçme paguhen vetem:

Komandantit P. Gjindarmeris	Fr. ari 300	në muej	
Adjutantit P. Gjindarmeris	» 60	»	»
Oficerit Shtabit Gjindarmeris	» 80	»	»
Oficerit Departamentit të Gjindar. pranë Oborrit Mbretnuer	» 80	»	»
Aspirantit të Departamentit pranë Oborrit Mbretnuer	» 30	»	»

b) Komandantit P. Gjind. i paguhen për djetet udhtimi fr. ari 22 në dite.

Art. 3.

Ky ligjë hynë në fuqi qe nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare, e ka për t'i paraqit Parlamentit për kthim të sajë në Ligjë.

Art. 4.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligjë.

Kryeministri e
Zav. Ministri i Drejtësis
Pandeli Evangjeli

Ministri i P. Jashtme e
Zv. Ministri P. Mbrendëshme
R. Fico.

Ministri Financavet
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore e
Zav. Ministri i Ekonomis Kombtare
Izet Dibra

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 2239 datë 4. IX. 930,

Si ndigjojë dhe pëlqejë Vendimin e Këshillit Ministruer me datë 3. XI. 930,

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi rrogat, shperblime, e shpenzime udhtimi të përsonelit të Gjindarmeris dhe të Fuqive Ushtarake në sherbim të Gjindarmeries.

Durrës, me 8 Shtatuer 1930.

ZOG.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

D E K R E T O N

Zbatimin e Dekret-Ligjit me datë 8. Shtatuer 1930, të votueme prej Parlamentit, dhe Urdhenon shtimin e tij në Kodet e Mbretnis si Ligjë.

Tiranë, me 24 Mars 1931.

ZOG.

Nr. 47.

LIGJË, 24 Mars. 1931.

Mbi zgjatimin e afatit të tretë të kërkimeve për voj gurin të Konçesionit t' akorduem me konvencjon me datë 12 Mars 1925 Hekur-Udhavet të Shtetit Mbretnuer t' Italis

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 4 Prill 1931 Nr. 20)

Art. 1.

Afati i kerkimeve për voj-gurin të dhanun me konçesjon Hekurudhes së Shtetit Mbretnuer t'Italisë me konvencjon me d. 12 Mars 1925, qi ishte zgjatue për heren e dytë me ligjen me d. 26 Tetuer 1927, zgjatohet për heren e tretë edhe për tre vjet tjera tue fillue prej datës 1 Kallnduer 1931 e deri 31 Dhetuer 1933.

Art. 2.

Me zbatimin e kësaj Ligjë ngarkohet Ministrija e Ekonomis Kombtare.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi me shpalljen e saj në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarvet
DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi zgjatimin e afatit të tretë të kërkimeve të vojgurit dhanun me konvencjon Hekur Udhëve të Shtetit Italian, e Votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 468 III datë 12. II. 1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 24 Mars 1931

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Ekonomis Kombtare
Mehdi Frasheri.

LIGJË, 24 Mars. 1931.

Nr. 48.

Mbi mbrojtjen e Industris së Bulmetit

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 4 Prill 1931 Në. 20)

Art. 1.

Puntorët dhe fabrikatorët e bulmetit «ata qi punojnë djathin dhe te lynin në vendet e posaçme qi quhen «baxho» për jashtohen nga taksa e patentës dhe e tatimit të fitimit dhe nga ç'do lloj takse e detyrim tjeter shtetnore.

Art. 2.

Per nevojat e industris së bulmetit fuçit dhe thasët qi importohen, përjashjohen nga taksi doganuer; kundrejt nji dorëzanije tregtare të dhanun prej importuesit dhe të vertetueme prej Odes s'Ekonomis së vendit, se mbrenda nji viti, që nga

data e importimit, detyrohen t'i eksportojnë përsëri, së bashku-me prodhimet bulmetore të vendit.

Vertetimet kësodore prej Odes s'Ekonomis Kombtare bahen kurdoherë gratis.

Art. 3.

Gjithë veglat e maqinat e ndryshme qi imprtohen per qellime t'industris së bulmetit përjashtohen nga tagri doganuer dhe nga ç'do taksë tjeter e nxjerrun prej Zyrave doganore.

Në rast dyshimi autoritete doganuer kanë të drejtë me kerkue prej importuesit nji dishmi të lëshueme prej zyres së bujqësis ose të veterinaris të vendit qi të vertetojnë se, veglat e maqinat e importueme kësodore janë të vlefshme për industrin e bulmetit.

Art. 4.

Në rast që baxhaxhitë deshirojnë me u lidhun me kontratë me shitsit e qumshtit edhe në qoftë se këtyne kontratave duen me i dhanë formen e shkresave zyrtare, këto i vertetojnë pranë Odes s' Ekonomis Kombtare të vendit gratis, zhe këto kanë fudi provuese si akt-Noteriale.

Art. 5.

Këjo Ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së botimit të sajë në Fletoren Zyrtare.

Art. 6.

Ministrija e P. të Mbrendshme, Ministrija e Financavet, dhe ajo e Ekonomis Kombëtare janë të ngarkueme me zbatimin e kësaj Ligjë.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëvet
DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi mbrojtjen e industris së bulmetit, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 54 I datë 16. II. 1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 24 Mars 1931.

ZOG

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i P. Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
K. Thaçt

Ministri i Ekonomis Kombtare
Mehdi Frasheri

49.

LIGJË, 24 Mars 1931.

Shtojcë e ligjës mbi internimin e familjeve të Ushtarëve të Rekrutave e Rezervistave qi ara isen

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 4 Prill 1931 Nr. 20)

Neni 1.

Rojtarët të kufive të cilët aratisen u internohet familja, si mbas dispozitave të ligjës qi rregullon dizertimin e rekrutave.

Neni 2.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret Lígjë.

Neni 3.

Kjo Dekret Ligjë hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Arësimit e
Zav. Ministri Financavet
H. Mosi

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombtare e
Zav. Ministri i Drejtësis
Mehdi Frasherí

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëvet

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1926 datë 27. VIII. 1930

BKSH

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 20. 7. 930.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit si shtojcë e ligjës mbi internimin e familjeve të ushtarëve të rekrutave e rezervistave qi aratisen.

Durrës, me 30 Gusht 1930.

ZOG

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëvet
DEKRETON

Zbatimin e Dekret Ligjit me datë 30 Gusht 1930 të votueme prej Parlamentit dhe Urdhnon shtimin e tij në Kodet e Mbretniës si Ligjë.

Tiranë, me 24 Mars 1931.

ZOG.

Nr. 50.

LIGJË, 24 Mars, 1931.

Mbi modifikimin e nenevet 1, 2, 11, 12 dhe 16 të Ligjës mbi Pijet Alkoolike me datë 17 Prill 1929.

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 4 Prill 1931 Nr. 20)

Neni 1.

Neni 1, i Ligjës mbi pijet alkoolike ndryshohet në këtë mënyrë :

„Pijet alkoolike të prodhueme mbrenda Shtetit ose t' importueme randohen me nji taksë si mbas neneve 2 e 3 të kësaj Ligjë."

Neni 2.

Neni 2 i ligjës mbi pijet alkoolike ndryshohet në këtë mënyrë :

„Taksa mbi rakin e prodhueme prej çfar do lande mbrenda Shtetit, si edhe mbi rakin qi importohet asht 20 (njizet) qindarka Fr. ari për çdo kilogram."

Neni 3.

Neni 3 i ligjës mbi pijet alkoolike ndryshohet në ketë mënyrë :

„Taksa mbi venën e prodhueme mbrenda Shtetit, si edhe ajo mbi venen qi importohet asht 10 (dhetë) qindarka Fr. ari për çdo kilogram.“

Neni 4.

Neni 11 i ligjës mbi pijet alkoolike ndryshohet në këtë mënyrë :

„Taksa mbi rakin dhe venen qi prodhohet mbrenda Shtetit do të paguhen me tri kiste: në muejin Dhetuer, Kallnuer dhe Fruer, dhe ajo mbi rakin dhe venen e importueme paguhet në rastë t' importimit„.

Neni 5.

Për leshimin e lejeve të transportimit për pijet alkoolike qi bahet fjalë n' Art. 12 dhe 15 të ligjës nalt-përmendun, Ministrija e Financavet autorizohet të hartojë nji Rregullore të posaçme në mënyrë qi transportimi i pijeve të lehtësohet dhe të bahet pa ndonji veshtirësi.

Neni 6.

Neni 16 i Ligjës mbi pijet alkoolike ndryshohet në këtë mënyrë:

„Ç' do zotnues qi, si mbas nenit 6 të kësaj ligjë nuk e deklaron në Financën e vendit sasinë e kazaneve dhe kapacitetin e tyne ndeshkohen me gjobë prej 100-500 fr. ari dhe kazani i konfiskohet.

Në rastë qi kryeplaku i nji katundi nuk i përmbushë detyrimet qi ka si mbas nenit 7 të kësaj ligjë, ndeshkohet me gjobë prej 50 deri 200 fr. ari.

Gjithashtu ndeshkohen me nji gjobë prej 100 deri 500 fr. ari ata qi shesin, blejnë ose transportojnë kazana ose vegla qi përdorin për prodhimin e rakis pa pasun lejen nga Financa e vendit, përveç gjobës konfiskohen edhe veglat e zanuna.

Neni 7.

Kjo Ligjë hynë në fuqie që nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 8.

Ministrija e Financavet, Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe Ministrija e Drejtësiës ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligjë.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve
DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi modifikimin e nenevet 1, 2, 3, 11, 12 dhe 16 të ligjës mbi pijet alkoolike me datë 27 Prillë 1929, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 745-I datë 6. III. 1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 24 Mars 1931.

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri Drejtësis
V. Avrami

Ministri i P. Mbrendshme
Musa Juka

Nr. 51.

LIGJË 3 Dhetuer 1930

Mbi shitjen e pasunive të vogla të pa tundëshme Shtetnore

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 6 Prill 1931 Nr. 20-bis)

Art. 1. — Autorizohet Ministrija e Financavet me shitë pasuniet e pa-tundëshme Shtetnore qi janë të shenueme në tre copë listat anëkse të kësaj ligje.

Listat anekse Nr. 3-1, e 3.2, përbahen prej (40) dyzet faqesh, dhe e treta Nr. 3-3 prej (28) njizetetet faqe të mbushuna, me vertetimin e Ministrit të Financavet, me konformimin në ç'do faqe me vulen e Dhomës së Deputetve, e me nënshkrimin e Kryetarit të saj.

Art. 2. — Mënyra e shitjes, e të gjithë veprimet e tjera relative bahen në bazë të dispozitave të parapaeme në ligjën e posaçme mbi shitjen e pasunive të pa-tundëshme të Shtetit botuar në Gazetën Zyrtare me datë 25 Kallnduer 1927.

Kur në kohen e Adjudikatës del ndoji pretendim zotnimi

mbi tokat e permenduna në listat e tregueme në këtë ligjë, axhudikata azhurnohet dari në mbarim të Gjyqit mbi token e kontestueme.

Art. 3. — Kjo Ligjë hynë fuqi qysh prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. — Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi shitjen e pasunive të vogla të pa-tundëshme Shtetnore, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 591-I datë 25-XI-1930 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 3 Dhtetuer 1930.

ZOG

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavèt
K. Thaçi

BKSH

Pasunit shtetnore të përndame qi duhen shitë

Nr. Renduer	Prefektura ose Nënprefktura	Katuudi ose Lagja	Vendi (pozicjoni)	LLOJI	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M2	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr.ari	K U F I J T	Kjedhja pronësis për Shtet
1	Delv.	Nivicë	Trukth	Arë	Gjith	—	9	450.—	Polo Cico Arat e Mitro Tashit	Nga Banka e Bujqësis
2	»	,,	Kreksa	,,	,,	—	2	100.—	Arat e Manastirit ,, e Jorgaqit	,,
3	»	,,	Haliqe	,,	,,	—	10	1000.-	Haxhi bej Halim Beqo	,,
4	»	,,	Turkth	,,	,,	—	6	300.—	Leko Kumini Vasil Ndrakti	,,
5	»	,,	,,	,,	,,	—	4	200.—	Polo Thomaj Vija	,,
6	»	,,	Krekca	,,	,,	—	1	50.—	Kosta Papadhimna Papajani	,,
7	»	,,	Frovila	,,	,,	—	8	400.—	Pilo Konomi Kol Duka	,,
8	»	,,	Spirash	,,	,,	—	6	300.—	Jorgaq Papa Halim Beqo	,,
9	»	,,	Haliqe	,,	,,	--	4	200.—	Jorgaq Duka	,,
10	,,	,,	Brodila	,,	,,	—	6	300.—	Hark Telha Çamuni Lile Mehmet Beu	,,
11	,,	,,	Qafrrejhe	,,	,,	—	6	300.—	Kosta Kola Pilo Mugaçi Kosta Kola Pilo Mugaçi	Nga detet e Arkës Shtet.
12	,,	,,	Haliqe	,,	,,	—	6	300.—	Thanas Kola Papa Dhima	Nga Banka e Bujqësis
13	,,	,,	Gjullaj	,,	,,	—	5	450.—	Kamena Kol Boxheri Dhimua	»

BKSH

Nr. Renduer	Prefektura ose Nenprefektura	Katundi ose Lagja	Vendi (pozicjoni)	LLOJI	Sa pjesë ka shteti	Sypër-faqja M2	Dynym	ÇMIMI Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhia e pronësis për Shtet
14	Fieri	Çeli-grad	Vendi i shtëpis së Pilo Poros	Truell	Gjith	270	—	140.—	Rruga e lagjës „ e Qanicës „ e shkollës Xhoxh Porua	Truell shtet-nuer mbi të cilin privati ka ngreh godinë
15	„	„	Vendi i shtëpis së Xoxi Miti Poros	„	„	258	—	140.—	Rruga e lagjës „ e Qanicës Pilo Poro Kici Poro	„
16	„	„	Truelli i shtëpis Kiço, Llaz, Uran, Ll-uka e Ma-rica të bijt e Kozma Poros	„	„	139	—	70.—	Rruga e lagës „ e Qanicës Xox Poro Llambi Poro	Si nr. rend. 14
17	„	„	Truelli i shtëpis Llambi Poros	„	„	92	—	35.—	Rruga e lagjës „ e Qanicës Kiçi Poro Tilo Nasto	„
18	„	„	Truelli Tili, Loti të bi-jët e Nasto Çomit	„	„	488	—	160.—	Rruga e lagjes „ e Qanicës Llambri Poro Lil Sotiri	„
19	„	„	Truelli Bijve Llambi Sotira	„	„	420	—	140.—	Rruga e lagjes „ e Qanicës Tili Nasto Papa Vasili	„
20	„	„	Truelli Papa Vasilit	„	„	422	—	130.—	Rruga e lagjes „ e Qaniçës Lil Sotiri Taqi Papapetro	„
21	„	„	Truellt Gaqe PapaPe tros me pjestar	„	„	284	—	120.—	Rruga e lagjës „ e Qanicës Papa Vasili Kilo Gjeçi	„

Nr. Renduer	Prefektura ose Nënprefektura	Katundi ose Lagja	Vendi (pozicjoni)	LLOJI	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M2	Sypërfaqja Dynym	ÇMIMI Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis për Shtet
22	Fieri	Çelig-rad	Truelli i shtëpis së Kilo Tod Gjeçi	Truell	„	526	—	200.—	Rruga e lagjes „ e Qanicës Taqi Papa Petro Rrugicë	Si nr. rend. 14
23	„	„	„ së Llaz e Jani Liç Bulo	„	„	734	—	300.—	Rrugicë Rrugica e Qanicës Ban Gjokazi etj. Rrugica e Qanicës	„
24	„	„	„ së Kiu Kol Blea	„	„	120	—	140.—	Rruga e lagjes Taqi Mandi Rrugicë Peç Qelica	„
25	„	„	„ Peçi Gjiko Qilica me pjestar	„	„	980	—	400.—	Rruga e lagjës Taq Mandi Kiu Bela Shkolla femnore	„
26	„	„	„ Ksenofor Kiço me pjestar	„	„	340	—	140.—	Rruga e lagjes Taq Mandi Shkolla Rruga e shkollës	„
27	„	„	„ Kate Nikoll Çubukut me pjestar	„	„	344	—	100.—	Rruga Sami Bej Taq Mandi Rruga e Shkollës Lek Lakosa	„
28	„	„	„ së Lenka Sako	„	„	133	—	70.—	Rruga Sami Bej Taq Mandi Kosta Çubuku Taq Mandi	„
29	„	„	„ Kolinas Çubukut me pjestar	„	„	151	—	70.—	Rruga Sami Bej Taq Bogaçi Taq Mandi Rrugica	„
30	„	„	„ Taq Mandi Ilia me pjestar	„	„	2054	—	1300—	Rruga Sami Bej Kiçi me pjestar Rruga e Shkollës Taq Bogaçe	„

BKSH

Nr. renduer	Prefektura ose Nënprefektura	Katundi ose Lagja	Vendi (pozicjoni)	LLOJI	Sa pjesë ka Shteti	Sypërtaqja M2	Sypërtaqja Dynym	ÇMIMI Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhia e pronësis për Shtet
31	Fieri	Çeligrad	Truell i shtëpis së Kol Nas Çakërit pj.	Truell	Gjith	151	—	70.—	Rruga Sami Bej Taq Bogaçe Taq Mandi Rrugacë	Si nr. rend. 14
32	"	"	" së Taq Miti Bogaçe	"	"	302	—	150.—	Rruga Taq Mandi Kol Miti Llaz Papallazo	"
33	"	"	" së Llaz Papa-llazi me pjesë	"	"	155	—	70.—	Rrugacë Llaz Bulo Taq Bogaçe Ban Gjorazi	"
34	"	"	" Bon Llambri Gjorazi	"	"	983	—	600.—	Rrugaca Llaz Bulo Ndin Bishka Sotir Bitri	"
35	"	"	"	"	"	72	—	100.—	Bon Gjarazi Llaz Bulo Bon Gjorari Sotir Bitri	"
36	"	"	" Kol Stavro Poros	"	"	1010	—	600.—	Rruga Sami Bej Kol Pali Kol Poro Taq Bozo	"
37	"	"	" së Thimi Na-si Tod Naumit	"	"	230	—	100.—	Rruga Sami Bej Kol Pali Bon Gjorazi Rrugaca Taq Bozo Thim Nazi	"
38	"	"	" së Taq Tas Bozos	"	"	470	—	250.—	Rruga Sotir Bitri Kol Poro Sotir Bitri	"
39	"	"	" Sotir Bitri e Gjergj S. Bitri	"	"	540	—	300.—	Rruga Rruga e Qanicës Taq Bozo Lil Koraçi	"

BKSH

Nr. Rendor	Prefektura ose Nënprefektura	Katundi ose Lagja	Vendi (pozicjoni)	LLOJI	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M2	Dynym	ÇMIMI Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhia e pronësis për Shtet
40	Fieri	Çele-grad	Truelli i shtëpis Mi-ti Jan Ko-raqiame j.	Truell	Gj h	540	—	300.—	Rruga Lil Koraqi Sotir Bitri Vangjel Goxhamani	Si nr. rend. 14
Për të përballuem rrogat e personalit t'asaj Drejtorie nga Kap. 28 i budgetit të Ministris së Financavet bartet nji fond prej fr. ari 4.120, dhe i mveshen Kap. 1 të Ministris së P. të Mbrendëshme, gjithashtu krediti prej fr. ari 5.280 i mbetun nga Kap. 32 i budgetit të vitit në udhtim të Ministris së Financavet transferohet në buxhetin e M. P. të Mbrendëshme ku krijohet Kap. 6 bis në emertim «Shpenzime për Zyren e Shtypit» proapagande shtypi, shpenzime Post-Telegrafe.

Art. 3.

Kjo ligjë hynë në fuqi prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Ministria e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e ktij ligji.

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarvet
D E K R E T O N

Aprovimin dhe zbatimin e ligjit mbi transferimin e Drejtoris

se Shtypit, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 852-I datë 12-II-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 24 Mars 1931.

Z O G.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri P. Mbredëshme
Musa Juka.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Nr. 54.

LIGJË, 25 Kalluer 1931.

Mbi Shpërblime Patriotike

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 21 datë 8 Prill 1931)

Art. 1.

Personave të tregueme n'art. 2 të këtaj Dekret-Ligjë, mbassi ata janë të pajosur me gjithë cilsinat e lypuna prej Art. 1, e 2, të Ligjit me datë 27 Dhetuer 1927, u akordohet nga nji shperblim patriotik me sasinë e shenueme në radhen e emnit të seicilit.

Art. 2.

Si mbas dokumentave dhe hetimeve Zyrtare meritojne akordimin e nje shperblimi muejur personat e poshte-shenueme:

1.—	Z. Bajo Topulli	ne	muej	Fr.	ari	350
2.—	» Mihal Grameno	»	»	»	»	300
3.—	» Xhemal Prishtina	»	»	»	»	300
4.—	» Hamdi Ohri	»	»	»	»	250
5.—	» Dhimitri Ilo	»	»	»	»	300
6.—	Zonja e te ndjerit Çerçiz Topullit	»	»	»	»	120
7.—	Z. Stavro Karoli	»	»	»	»	150
8.—	» Ismail Strazmiri	»	»	»	»	200
9.—	» Asllan Mehmet Starja	»	»	»	»	50
10.—	» Dhimitri Mole	»	»	»	»	140
11. —	Z-a Sofija e veja e dëshmorit At Stahit	»	»		„	100
12.—	» Dani e Simon Arapit	»	»	»	»	100

Art. 3.

Shperblimi i treguem në art. 2, të kësaj Dekret-Ligjë pagu-het nga fondi i posaçme i budgetit të Ministries së Financavet qysh prej ditës I Prill 1930.

BKSH

Art. 4.

Kjo Dekret-Ligje hynë në fuqi preja ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli.

Zav. Ministri i P. Mbrendshme
R. Fico.

Ministri i Drejtësies
V. Avrami.

Ministri i Arësimit
H. Mosi.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra.

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Mehdi Frasheri.

ZOGU.
Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 28-III datë 5. VI. 930.

Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 4 VI. 930.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi Shperblime patriotike.

Tiranë, me 14 Qershuer 1930

ZOG.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarvet
DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit me datë 14 Qershuer 1930, t'aprovueme prej Parlamentit, dhe Urdhenon shtimin e tij në Kodet e Mbretnies si Ligjë.

Tiranë, me 25 Kallnuer 1931.

ZOG.

Nr. 55.

LIGJË, 3 Prill 1931.

Mbi rregullimin e ç' kunorëzimeve të ndodhuna para hymjes në fuqi të Kodit Civil të Ri.

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 21, datë 8 Prill 1931)

Art. 1.

Ata qi figurojnë të rregjistruar si bashkëshorte në rregjistrat e popullis deri në daten e hymjes në fuqi të Kodit Civil të ri dhe, janë ç'kunorizuem para hymjes në fuqi të këtij kodi, në

BKSH

qoftë se nuk ekziston për këte, vendimi i premë ose ç'kunorëzimi nuk asht transkiptue në radhorët e Gjendjes Civile, detyrohen mbrenda gjashtë muejve qysh prej hymjes në fuqi të kësaj Ligjë, në qoftë se paditësi ndohet mbrenta tokës së Mbretnies mbrenda nji vjete, në qoftë se ndodhet përjashta me ju drejtue Gjykatës kompetente për vertetimin e ekzistencës së ç'kunorëzimit.

Neni 2.

Padinat e ngrefuna mbas asaj datë nuk pranohen në qoftë se, nuk bazohet në nji nga shkaqet e tregueme të Kodit Civil.

Neni 3.

Padinat e ç'kunorëzimit qi i referohen nji kohë para hymjes në fuqi të Kodit Civil; nuk janë të ndigjueshme në qoftë se paditësi mbas leshimit të pretendueme ka bashkëjetue me anen tjeter si bashkëshortë.

Neni. 4.

Çdo dispozitë qi vjen në kundershtim me ketë ligjë mbetet pa fuqi.

Neni. 5.

Kjo Ligjë hynë në fuqi ç'prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni. 6.

Ministrija e Drejtësies ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligjë.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi rregullimin e ç'kunorëzimeve të ndodhuna para hymjes në fuqi të Kodit Civil të ri, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 19-I datë 6-III-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 3 Prill 931.

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli.

Minitsri i Drejtësis
V. Avrami.

BKSH

Nr. 56.

LIGJË, 3 Prill 1931.

Mbi ndalimin e bashkjetesave si bashkshorte ilegale

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 22, datë 10 Prill 1931)

Neni. 1.

Ata qi bashkohen si burrë e grue si mbas zakoneve të vendit për martesë, ose ndodhen në posedim, gjendjeje si bashkë-shortë pa e celebruem martesën si mbas ligjës, ndeshkohen, burri me burgim nga nji muej deri në gjashtë, ose me internim nga dy muej deri në nji vjetë, dhe grueja me burgim deri në nji muej ose me gjobë deri në 500 Fr. ari.

Neni 2.

Etnit dhe ata qi kanë kujdesien familjare e atyne qi bashkohen si ma naltë, në qoftë se kanë konstatue për nji bashkim të tillë, ndeshkohen me burgim deri në gjashtë muej ose me gjobë deri 300 fr. ari.

Neni 3.

Pleqësija e Katundit, Kryetari ose Këshilli i Katundaries, që tue pasë dijenie për nji bashkim të tillë, pa shkaqe të justifikueme nuk lajmrojnë autoritetet e Sigurimit Publik ose Prokurorinë e Shtetit denohen me ndeshkimet e caktueme në nenin 208 të Kodit Penal, dhe pleqësija e katundit, Kryetari ose Këshillat e Katundaries dhe me pezullimin nga ofiqi për vitë.

Neni. 4.

Ata që janë bashkue si mbas nenit I, para hymjes në fuqi të kësaj ligjë, detyrohen mbrenda tre muejve ç'prej datës së shpalljes së kësaj Ligjë, me rregullue ketë gjendje në konformitet me ligjat.

Për rregullimin e këtyne bashkimeve me martesa si mbas ligjës pelqimi i personavet, ose i këshillavet qi bahet fjalë në Kodin Civil, prezumohet i dhanun, posë kur keta kundershtojnë para Ofiqarit të Gjendjes Civile.

Me gjithë ketë dispozitat e nenevet 169 e 170 të Kodit Civil mbeten të pa prekuna.

Neni. 5.

Padija penale për personat që përmenden në nenet 1, e 2 të

BKSH

kësaj Ligjë, shuhet me celebrimin e martesës para Ofiqarit të Gjendjes Civile.

Në qoftë se martesa bahet pas denimit, si eksekutimi i denimit si edhe efektet penale t'atij, pushojnë.

Neni. 6.

Çdo dispozitë qi asht në kundershtim me ketë ligjë mbet et pa fuqi.

Neni. 7.

Kjo Ligjë hynë në fuqi që prej datës shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni. 8.

Ministrija e Drejtësies dhe ajo e P. të Mbrendëshme ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligjë.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarvet
DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi ndalimin e bashkjetesave si bashkëshortë ilegale, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 16-I datë 16-III-931 të Kryesies të Tij.

Tiranë, me 3 Prillë 1931.

ZOG.

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Drejtësies
V. Avrami.

Ministri i P. Mbrendëshme
Musa Juka.

Nr. 57.

LIGJË, 24 Mars 1931.

Mbi ndalimin e përdorimit të grizës (semolinës) për bukë

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 22, datë 10 Prill 1931)

Neni. 1.

Përdorimi i grizës (semolinës) i bluem ose i pa bluem, në bukë asht krejtësisht i ndaluem qoftë edhe në proporcion ma të vogël.

BKSH

Neni 2.

Kundravajtësit denohen si vijon:

a) Ata qi përdorin grizen për bukë denohen me gjobë të lehtë nga 100 deri 200 (dyqind) fr. ari;

b) Furtarët ordinar ose me fabrikë denohen me burgim të randë nga tre muej deri nji vjetë ose, me gjobë të randë nga 1000 deri 10000 (dhetëmij) fr. ari ose me të dy denimet së bashku.

Në rast përsëritjeje dyfishohet dhe fura ose fabrika mbyllet për nji kohë nga nji deri në gjashtë muej.

Neni 3.

Ata qi transformojnë farin-grizin (semolinen) (ermikun) me mijell të imtë, ndeshkohen me burgim të randë nga tre muej deri nji vjetë, dhe me gjobë të randë nga 1000 deri 10.000 fr. ari, dhe në rastë qi janë Fabrikanta ose Mulliesa dhe me mbylljen e fabrikës ose të mullinit prej nji kohe nga dy deri në gjashtë muej.

Neni. 4.

Po me ndeshkimet e përmenduna në nenin 3 të kësaj ligjë denohen dhe, ata qi tue dijtun shesin grizë të transformuem me mjellë t'imtë.

Neni. 5.

Autorizohet Ministrija e Ekonomis Kombëtare që me nji Rregullore Ministeriale të saj, t'urdhënojë gjithë dispozitat të nevojëshme për kontrollimin e përdorimit të grizës dhe, përgjithësisht për mirë-aplikimin e kësaj ligjë.

Neni. 6.

Çdo dispozitë qi asht në kundershtim me ketë Ligjë, mbetet pa fuqi.

Neni. 7.

Kjo Ligjë hynë në fuqie nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni. 8.

Ministrija e Drejtësies dhe ajo e Ekonomis Kombëtare ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligjë.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi ndalimin e perdorimit të grizës (semolines) për bukë, e votueme prej Parlamentit si

mbas shkresës Nr. 26-I datë 16-III-931, të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 24 Mars 1931.

Z O G.

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Drejtësies
V. Avrami.

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Mehdi Frashëri

Nr. 58.

LIGJË, 24 Mars 1931.

Mbi përjashtimin nga taksat doganore materialet e importueme nga Misioni Topografik Italjan në Shqipni të parapamë në kontratën me datë 9 Prill 1927

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 22, datë 10 Prill 1931)

Neni. 1.

Përjashtohen nga tagrat doganore të gjithë materialet e punimit të importuara dhe qi do t'importohen, të sendeve përkatëse e ndihmuese të riljevamantit, e qi janë pronë e Institutit Geografik Italian, si dhe veshjet e mbathjet e përsonelit të Misjonit.

Neni 2.

Veshje e mbathje kuptohen; petkat e shtatit të mbrendëshme dhe të jashtëme të ç'do lloji, ashtu dhe këpucët.

Neni 3.

Objekte të tjera jo të konsumueshme qi sjellin me vedi si: Dylbi, aparate fotografie, pushkë gjuetije e revolverë për përdorim vetjak, me konditë qi të kthehen prapë, përjashtohen mbasi të kenë lanë në doganë dorë-detyrimi të nenshkrueme nga Kryetari i Misjonit.

Neni. 4.

Përjashtimi nga taksat doganore i materjaleve qi bahet fjalë në nenin e sipërme, bahet në bazë të nji liste të sendeve t'importueme dhe, e cila verifikohet nga Ministrija e Financavet dhe mbasi të kryhen të gjitha formalitetet Doganore nga i Misjonit ose nga i autorizuemi prej tij si mbas Ligjës.

Neni. 5.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni. 6.

Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi përjashtimin nga tagri Doganuer të materialeve t'importueme nga Misioni Topografik Italian, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 21-I datë 6. III. 931, të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 24 Mars 1931.

ZOG.

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Nr. 59.

LIGJË, 3 Prill 1931.

Mbi modifikimin e Nenit 436 të Shtojcës së dytë të Procedurës Civile

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 22, datë 10 Prill 1931)

Neni 436.

Kreditori mbi kërkimin e vet ka të drejtë të shesë n'ankand pjesa të pandame e një pronë dhe, kur nuk asht kreditor i gjithë bashkë-zotnuesëve, vetem në rast që prona vjen prej trashëgimi, që të mundet kreditori të shesë n'ankand këtillo pjesa të pa-ndame, duhet të vertetohen trashgimtarët dhe të pjestohet trashigimi dhe jo prona.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi modifikimin e nenit 436 të Shojcës dytë të Procedurës Civile, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 1-I datë 29-I-931 të Kryesis së Tij.

Tiranë me 3 Prill 1931.

ZOG.

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Drejtësies
V. Avrami

Nr. 60.

LIGJË, 24 Mars 1931.

Mbi interpretimin autentik të nenit 3 të Ligjës mbi favorizimin e bujqësis me datë 29-I-1923

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 23, datë 15 Prill 1931)

Art. 1.

Interpretimi i nenit 3:

«Veneshtat e pjergullat që do të mbjellen rishtazi janë të përjashtueme nga taksat e të dhetës për shtatë vjetë, tue fillue prej kohes së produktit».

Art. 2.

Kjo ligjë hynë në fuqi prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Ministrija e Ekonomis Kombëtare, dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligjë.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi interpretimin autentik të Nenit 3 të Ligjës mbi favorizimin e Bujqësis me datë 29. I. 923, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 39-I datë 16-III-931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 24 Mars 1931.

ZOG.

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Mehdi Frasheri.

Nr. 61.

LIGJË, 26 Mars 1931.

Mbi përjashtimin nga taksat e pyjeve e guroreve për materjalet e ndr qjes së godinave të damtueme nga termeti

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 23, datë 15 Prill 1931)

Neni. 1.

Përjashtohen nga taksat Shtetnore e komunale landa, gël-

qerja, tullat dhe tjegullat qi kanë me u nxjerrë nga Pyjet Shtetnore, dhe guroret për ndeqjen dhe meremetimin e gjithë shtëpijave të damtueme nga termeti i Vlonës e i Korçës.

Për të përjashtuar nga taksat formohet nji Komisjon prej Prefektit ose Nenprefektit, Drejtorit ose Nëpunësit të Financavet Kryetarit të Bashkies, prej Ingjinjerit ose Nëpunësit të Zyrës Botore. Ky Komision ka për kompetencë të vertetojë damin e shkaktuemun prej termetit, ashtu dhe nevojen ose sasinë e landës së përmendun në ketë nen.

Dhuratat në natyrë që i vijnë nga jashtë të damtuemve nga termeti lirohen pa tager doganuer me urdhën të Ministries së Financavet, mbi propozimin e komisionit të posaçem të qendres te formueme për organizimin e ndihmave qi i drejtohen të damtuemve.

Neni 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare dhe, vazhdon deri në fund të Shtatorit 1932.

Neni. 3.

Ministrija e Ekonomis Kombëtare, dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligjë.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi përjashtimin nga taksat e pjyeve e guroreve për materjalet e ndreqjes së godinave të damtueme nga termeti, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 89-I datë 19-III-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 26 Mars 1931

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli.

Ministri i Financavet
K. Thaçi.

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Mehdi Frasheri.

Nr. 62.

Marrëveshtje Shqiptaro-Austriake për suprimimin reciprok të detyrimit të vizes së pasaportave midis shtetasve respektive

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 23, datë 15 Prill 1931)

Art. 1 - Shtetaset e sejciiit nga të dy shtetet munden, në çdo kohë, të hyjnë në tokën e Shtetit tjeter dhe të largohen prej s'andejmi duke kaluar nga vendet e kufinit zyrtarisht të njoftuna, me konditë që të kenë një pasaportë kombëtare të vlefshme, e cila provon në mënyrë të pa-kundershtueshme shtetësien e titullarit, pa qenë nevoja e marrjes së vizes së Shtetit tjeter.

Vetem mbajtëset e pasaportave kombetare, do të përfitojnë nga ky favorizim, i cili favor nuk do t'u akordohet personavet qi kanë pasaportë për të huej, certifikata identiteti për refugjiatë, pasaporta provizore etj. Pasaportat kombëtare do t'u delivrohen vetem personave, shtetësia e të cilëve provohet në mënyrë të pakundershtueshme.

Në rast se Ligjat e Shtetit t'origjinës e lejon, fëmijët në moshen 15 vjetsh do të munden të paraqesin, në vend të pasaportës një certifikatë të lëshueme në konformitet me dispozitat ligjore të Shtetit të tyne, e cila certifikatë ka me përmbajtë emnin, moshen, shtetësien dhe banesen ose vendin e ndejtjes përmanent të tyne. Kjo certifikatë për fëmijë (KinderanWeis) në rast që u përket fëmijëve në moshen 10 vjeç, duhet të kënë një fotografie mbi të cilen do të vihet vula e autoritetit që ka leshue certifikatën.

Kur grupa personash të përbaeme prej shtetash Austriake ose Shqiptare do të deshirojnë të kalojnë se bashku kufinin, do të mjaftojnë që keta grupa të kenë një listë kollektive, që zen vendin e pasaportës, të delivrueme prej autoritetit kompetent të njanit nga të dy shtetet duke përmbajtë vizen e Përfaqësuesit Diplomatik oshe Konsullor të Shtetit tjeter. Këjo vizë do të vihet pa spoza (të drejta konsulore ose taksë për kryemje formalitetesh).

Kësilloj lista nuk do të mund të leshohen për transportim punëtorësh.

Art. 2.— Ky akord nuk u sjell asnjë ndryshim dispozitavet në

fuqie në token e të dy Shteteve për sa u përkasin mbylljes eventuale të kufinit, dbimi në kufie të udhëtarëve të pa deshirueshem, deklarimit të të huejvet në policie, ndejtjes dhe eksplusimit te të huejve, si dhe mprojtjes së marketit të punëtories kombetare kunder invadimit të punëtorëvet të huej.

Sejcili nga të dy Shtetet ka me u kujdesue qe shtetaset e vetë, në rast qe kerкojnë leshimin e nji pasaporte për të shkue në Shtetin tjeter me qellim që, të hyjnë në sherbim aty, të jenë të lajmeruem se asht nevoja e domosdoshme të kenë një autorizim per ketë fefekt.

Art. 3 - Ky akord do të hyjë në fuqie me 31 Mars 1931; do të pushojë me pasë efekt nji muej pas denoncimit të tij prej njanit ose tjetrit nga të dy Shtetet.

(Mungon Dekreti Mbretnuer, dhe ndodhet vetem Vendimi i Këshillit Ministruer Nr. 158 datë 27-3-1931).

Nr. 63.

LIGJË, 24 Mars 1931

Mbi rregjistrimin e kontrollimin e ndertesave e të tokë-ndertimeve

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 24, datë 23 Prill 1931)

KAPTINA I.

Dispozita e Përgjithshme

Art. 1.

Regjistrimi i përgjithëshem i ndertesavet, qi u ushtrue në vitim 1922 në bazë të Ligjës datë 27-IX-1921, riushtrohet në vjetin 1934 dhe mandej nji herë në krye të çdo dhetë vjetësh.

Art. 2.

Perveç regjistrimit të përgjithshem të përmendun n'art. 1 në krye ç'do pesë vjetësh, ushtrohet nji kontrollim i gjithë mbarshem për me qitë në shesh ndryshimet qi ndodhin mbi ndertesa rrotull perjudhës se pesë vjetvet.

Art. 3.

Kontrollimi i ndryshimevet kësodore, qi ka ndodhun mbrenda perjudhes 1922-1930, do t'ushtrohet në vjetin 1931 tue fillue në muejin Prillë të keti vjeti. Shtimet dhe rreximet e vleftjet të ndertesave qi do të konstatohen me anë të ketij kontrollimi, i përkasin vjetit financjar 1931-1932.

Kontrollimi i ndryshimevet në vjetët e ardhëshem do të filloj në muejin e caktuem prej Ministris së Financavet, të cilat i përkasin ushtrimit qi ndjek vjetin e kontrollimit.

KAPTINA II.

Ndryshimet e ndertesavet dhe kontrollimi i tyne

Art. 4.

Ndryshime quhen të gjitha ato ndodhje qi shkaktojnë shtimin ose rreximin e vleftjes së ndertesavet dhe terthurazi tatimin përkatës të ktyne të caktuem në bazë të vleftjes; quhen ndryshime, gjithashtu dhe ndodhjet e shkaktueme prej shit-blerjevet e të tjera veprimeve kësodore qofshin edhe në vleftje të njinjishme.

Neni. 5.

Shkaqet e shtimit ose të rrximit të vleftjes se ndertesavet dhe të toke-ndertimevet janë këto:

1) ndertesat e reja të mbarueme dhe të bame per përdorim;

2) shtesat qi u bahen ndertesavet të qenuna;

3) transformimi i ndertesës për banim vetjak në banim me qira ose përkundrazi;

4) transformimi i ndertesës per banim vetjak, ose për banim me qira në themelesa tregtare, industriale ose profesjonale;

5) të sosunit e afatit mbi favorizimin të ndertesavet industriale për katër vjet radhasi për të cillat ban fjalë Art. 34 dhe Art. 35 të Ligjës mbi tatimin e ndertesavet;

6) të sosunit e afatit per përjashtimin nga tatimi i ndertesavet te reja në Tiranë e Durrës si mbas Art. 3 të shtojcës datë 28-IX-929 të Ligjës së Bashkivet;

7) të sosunit e afatit për përjashtim të ndertesavet për banim t'emigrandavet si mbas Art. 2 e 5 të Ligjës relative;

BKSH

8) transformimi i tokë-ndertimevet (truell) në shpija banimi, në depo punishta, e për punë të tjera tregtije e industrije qofshin edhe pa ndonji strehë persipër;

9) ndodhjet qi provokojnë ngritjen e ndonji përjashtimi të parapam n'Art. 4 të Ligjës mbi tatimin e ndertesavet;

10) ndodhjet qi provokojnë detyrimin e ndertesavet të pataksueme në kohen e Regjishtrimit të Përgjithshem;

11) ndodhjet si djegeje, shembje pjesërisht ose plotësisht të ndertesës.

Art. 6.

Kontrollimi qi përmendet n'Art. 5, përmbarohet prej Komisionit qi formohen si vijon:

Në qendrat e Prefekturave e Nenprefekturavet përmbahet prej Ingjinerit të Zyres së P. Botore, ose atij të Bashkis, Nëpunësit të tatimevet dhe prej nji Eksperti të thirrun prej Lagjës ku behet kontrollimi; për në katundet prej Kryetarit të Katundaries dhe prej antarve t'asaj Katundarije por me marrëveshtje me financen (shif Art. 11.)

N'ato qendra të Nenprefekturave ku nuk gjendet Ingjinjer i Zyres së P. Botore, ose i Bashkis, në vend të tij zgjidhet prej anës së Finances nji ekspert, në rast që nuk ka, eksperti zgjidhet dhe në popull.

Art. 7.

Veprimet e Kontrollimit të ndryshimevet ne qendra të qytetevet e nder katunde, do të përfundohen mbrenda nji afati të shumten tre-muejshë qi do të caktohet me anë të Këshillavet administrative, tue u pasë parasysh sasija e ndertesavet dhe koha e nevojshme për kontrollimin e regjistrim e tyne.

Zyra e Financës asht e detyrueme me mbikëqyrë e me kontrollue veprimet e Komisjonevet dhe me ba qi këta t'i shtrohen programit të punës që kjo do të pregadisi mbi veprimet e ditës.

Art. 8.

Ingjinerit të P. Botore ose të Bashkis, Kryetarit të Katundaries Nëpunësit të Financës, me detyrë në qendre nuk u jepet as nji shperblim, ekspertat të zgjedhun si nga Financa ashtu dhe nga populli me detyrë në qendre ose jashtë marrim nga nji shperblim në ditë Fr. ari 5 (pesë); ay i Financës nga Arka e Shtetit, dhe ay i Lagjës, nga Lagja zgjedhese.

Kryetari i Katundaries dhe Nëpunësi i tatimit me detyrë jash-

të qendres së tyne marrin nji shperblim në ditë fr. ari 5 (pesë).

Art. 9.

Perpara se Komisjonet të fillojnë në punë, Prefektura ose iNenprefektura e vendit ka për detyrë me lajmue ngutësisht Bashkin e vendit për autorizim t'ingjinjerit ose për emrim t'ekspertit të sajë ashtu dhe per zgjedhjen e ekspertit të Lagjës, dhe nji heri urdhnon Katundarinë me veprue si mbas artikullit 6.

Gjithashtu dhe Ministrija e P. Botore do t'urdhnojë me nji herë Ingjinjeret e vet për bashkëpunim me nëpunësat e Zyres së Tatimevet.

Zyra e Finances së vendit, asht e detyrueme me shpallë me anë të fletorevet të vendit ose me anë të kasnecit fillimin në detyrë të Komisjonevet e se prandej ata pronare qi nuk ndodhen gati në vend në rasë të Kontrollimit duhet; të kenë emnue përfaqësuesi e tyne, perndryshej bjerrin të drejten e kundershtimit.

Art. 10.

Komisjonet do të kenë me vedi kopjet e rregjistravet të ndertesavet në të cillet janë të shpjegueme vleftjet e ndertesavet, pronarët e tyne si edhe regjistrat fletët e shtypuna nga Ministrija e Financavet për regjistrimin e ndertesavet qi do të kontrollohen.

KAPTINA III.

Procedura e kontrollimit

Art. 11.

Komisionet e kontrollimit me të mrritun në vend, ftojnë pleqsit dhe fillojnë me hetuem. Mënyra e hetimit caktohet me Rregullore.

Art. 12.

Komisjoni, në rasë të rregjistrimit të ndertesavet si mbas Art. 2, po kje se i paraqitet ndryshim zotnimi në mënyrë qi ndertesa e rregjistrueme në Zyren të kërkohet me u shenjue në nji emer tjeter veç atij mbi të cillin figuron, lypë dokumentat Zyrtare t'atij ndryshimi dhe në bazë të këtyne merr shenjimet e duhuna në shtyllën «Vrejtje» të rregjistravet-fletë tue, përmendë edhe ish pronarin e asajë ndertese.

Truellet e zanuna prej shtëpijave dhe vjeksavea (dependencave) të tyne, si dhe truelli për obor e kopeshi deri 1000 m2, vleftësohen bashkë me ndertesat.

Truellet mbrenda planit të qytetit me sipërfaqe ma të ma-

dhe se 1000 m2, të rrethueme ose jo me mure, me gardh a por me shenja të tjera, vleftësohen të veçueme nga ndertesa. Veprohet në ketë mënyrë edhe për kopshtat ose truellet qi u nevojiten fabrikavet qofshin edhe jashtë planit të qytetit;

Truellet qi gjinden jashtë planit të qytetit i shtrohen dispozitave të Ligjës se të dhetavet.

Art. 14.

Mbas rezultatit të hetimevet e të shqyrtimevet të bame si mbas Art. 11, 12, e 13, Komisjonet do të çmojnë vleftjet dhe t'ardhunat brutto vjetore të ndertesavet të reja, të shtesavet të tyne dhe të prishunavet, tue pasë parasysh shenjimet e art. 16 e 17. Mbi sa sypri u bahet me dijtë t'interesuemvet tue i dorëzue pleqsivet nga nji kopje të rregjistrit të ndertesavet të kontrollueme.

Art. 15.

Ndertesat ndahen në dy kathegori qi janë:

a) ndertesa të përdoruna për banim vetjak të pronarit;

b) ndertesa të leshueme me qira.

Art. 16.

Në të çmuemit e vleftjes së ndertesavet do të merren parasysh keto:

a) pozicjoni i ndertesës;

b) Lloji i landes me të cilen asht ngrefun ndertesa.

Art. 17.

Në konstatimin e t'ardhunavet brutto vjetore të ndertesavet do të merren parasysh këto:

a) Kontrata e lidhun midis pronarit dhe qiramarrësit;

b) Në mungesë të Kontratës, t'ardhunat vjetore që sjellë nji ndertesë tjeter e gjasueshme;

c) Caktimi direkt i Komisjonit n'anallogji me Art. 18 të Ligjës mbi tatimin e fitimit.

Art. 18.

Ndertesat ku banon vetë i zoti, në bazë të vleftjes se rezultueme si mbas dispozitave të ndryshme taksohen me 5[000 (pesë per mij).

Art. 19.

Në bazë të t'ardhuravet të konstatueme si mbas dispozitave të sipërme, ndertesat si shtëpi, dyqanë, magaze, hotel fabrika, pu-

nishta, mulli, qi pronari i leshon me qira, do t'impozohen me 7% mbi t'ardhunat brutto.

Në mënyrë të sipërme taksohen edhe ndertesat qi përdorë vet i Zoti për ushtrimin e zejes së tij.

Art. 20.

Për të vleftësuar ndertesat qi pronari i jep me qira veprohet si mbas artikullit 16.

Art. 21.

Truellet e përmenduna n'Art 13 në qendre ose rreth qytetit brenda kufirit të qytetit, taksohen me 5[000 (pesë per mij) të vleftjes së caktueme nga Komisioni.

Per kufi qyteti konsiderohet shtëpia ma e fundit e qytetit.

Art. 22.

Ndertesat që banon i zoti dhe qi vleftësohen deri 200 (dyqindë) fr. ari ç'rregjistrohen nga tatimi.

Art. 23.

Për me shqyrtue kundershtimet eventuale t'interesuemvet e për me vendue definitivisht si mbi vleftjet ashtu edhe mbi t'ardhunat e caktueme në bazë të kësaj Ligjë, formohet nga nji Komision apeli në çdo qendre Prefekture e Nenprefekture qi përbahet prej.

1) Drejtorit ose Kryenëpunësit të Financës.

2) Nji eksperti të zgjedhun nga Financa dhe nji nga ana e t'interesuemit. Këto eksperta paguhen si mbas Art. 8 të kësaj Ligjë.

Kundershtimet paraqiten mbrenda 15 ditve nga data e komunikimit nga ana e Pleqësies. Komunikimi bahet atë ditë qi vleftësohet ndertesa prej Komisionit.

Drejtimet qi bahen mbas ketij afati nuk merren parasyesh.

Art. 24.

Vendimet e Komisionit jepen me shumicë, dhe janë të preme.

Art. 25.

Komisioni i apelit detyrohet me shkue edhe në vende në qoftë se nuk-ka posibilitet qi çeshtja të zgjidhet në Zyrë. Komisionit t'apelit i paguhen shpenzimet e udhëtimit dhe djetet në bazë të Ligjës relative, për me i-u ngarkue ma vonë anës qi ka me humbë padinë.

Art. 26.

Mbasi Komisionet e kontrollimit të kenë përfunduem misjonin e tyne, dorëzojnë rregjistrat përkatëse të vertetueme nga ana e tyne Zyravet të Finances se vendit, të cillat detyrohen me kalkulue tatimet përkatse në bazë t'Ar. 18, 19, e 21 të kësaj Ligjë.

Art. 27.

Komisjoni i apelit detyrohet me dhanë vendimin e premë mbrenda dy muejve prej ditës së paraqitjes së kundershtimit.

KAPTINA IV.

Kontrollimi ordinar i përvjetëshem

Art. 28.

Zyrat e Tatimit deri në fund të muejit Dhetuer të çdo vjeti Financjar janë të detyrueme me hetue e me kontrollue ndertesat qi ngrehen të reja në qytet e kuer të ndodhi edhe nder Katunde po me anë të Komisionit të kontrollimit qi formohet në bazë të kësaj Ligjë. Gjithashtu janë të detyruem me caktue edhe vleftjen si edhe t'ardhunat e ndertesavet qi prishen ose rrxohen kuer të zotet e këtyne t'i u-drejtohen Zyravet Financjare me kërkesë për zbritje vleftje deri në mbarim të muejit Dhetuer të çdo vjetë.

Ndryshimet e konstatueme si ma sipër vlejnë për vjetin financjar të ardheshem.

Drejtimet qi bahen mbas mbarimit të muejit Dhetuer nuk merren parasysh për vjetin financjar të ardhëshem.

Hetimet mbi sa sipër, ushtrohen me anë të Tagrambledhesave e të organeve të tjerë Financjar. Kontrollimi i ndertesave në të tilla rase, nuk mund të zgjatet ma tepër se 45 ditë tue fillue prej datës nji Nanduer të çdo vjeti.

Në kohen kuer bahet rregjistrmi o Kontrollimi, në rast qi ndertesat e destinueme për qira janë të zbrazuna dhe mbeten për një kohë deri në gjashtë muej pa u-vendue, ushtrohen Tatimit 5[000 (esë për mijë) mbi vleftën e caktueme. Në rast që në kohen e rregjistrimit e të kontrollimit ndertesat e destinueme për qira ndodhen të venduema, konsiderohen si të tilla për një kohë gjasht muejsh, u shtrohen tatimit 7⁰/₀ (shtatë përqind) edhe ne' qoftë se zbrazen mbas rregjistrimit ose kontrollimit mbeten pa u-vendue për një kohë deri në gjashtë muej.

Gjithë keto veprime behen edhe çdo herë qi të drejtohen t'interesuemit për të tilla ndryshime.

Art. 29.

Vleftjet e caktueme në bazë të art. 28, i njoftohen t'interesuemve me komunikata të veçanta deri me 15 Kallënuer të çdo vjeti dhe këto mund t'a kundershtojnë deri me 15 ditë prej ditës së komunikimit.

Art. 30.

Zyra e Tatimevet deri në mbarim të muejit Mars të vjetit, janë të detyrueme me i dhanë fund vertetimit të tatimit të ndertesave, tue e dorzue Zyren nxjerrese radhoret e bashkadhansavet.

Art. 31.

Drejtoret ose Kryenëpunësit e Financavet qi nuk kujdesen për vertetimin e tatimit me kohë, ose nuk marrin masat e duhuna për nëpunsat Kompetent kundravajtes, ndeshkohen për herën e parë u pritet gjysma e rrogës, për herën e dytë, gjithë rroga, për heren e tretë pushohen nga puna me konditë që të mos merren në sherbim për nji vjetë.

Art. 32.

Zyrat e Tatimevet janë të detyrueme me përdorue nji rregjister mbi ndodhjet qi do të përfshië të gjithë levizjet e vleftjevet të përfundueme rrotull vjetit nga shit-blerjet, ringrehjet, e prej të tjera veprimesh të parapame n'art. 5 të kësaj Ligjë.

Art. 33.

Zyrat e tatimevet detyrohen me kopjue regjistrat e zyres si mbas përfundimit të kontrollimit të përgjithshme, qi do t'ushtrohen në bazë të kësaj Ligjë, jo ma vonë se dy muej mbas mbarimit të kontrollimit.

Art. 34.

Kontrollimi i përgjithshem që do të bahet në bazë të kësaj Ligjë, shtrihet edhe nder ndryshimet e konstatueme me anë të kontrollimevet ordinare t'ushtrueme para zbatimit të kësaj Ligjë.

Art. 35.

Shpenzimet e kontrollimit të ndertesavet u ngarkohen të zotënve të këtyne baras me 5% (pesë për qindë) të tatimit përkatës e, vetem për nji herë të pagueshme së bashkut me kistin e parë.

BKSH

Art. 36.

Dispozitat e ligjēs sē tatimit mbi ndertesa D. 27. XI. 1921 nē kundershtim me ketē ligjē, mbeten pa fuqi.

Dispozitat e shtojcē-Ligjēs me datē 10 Fruer 1930 mbi Ligjen e Bashkive me datē 25. XII. 1921 mbeten pa fuqi.

Art. 37.

Nē qoftē se pēr ngjarje tē jasht-zakonēshme si termet, tē djegun, et tē tjera kēso dore, vleftja e ndertesavet zbret ma tepēr se gjysa, ktyne i u caktohet nji vleftē e re.

Tatimi i ndertesavet kēsodore vertetue pērpara ngjarjes, zbritet pēr kistin e ardhēshem qi ndjek kistin e ngjarjes. Kjo zbritje tatimi vazhdon deri sa ndertesa tē rindreqet e tē pērdoret pēr banim.

Art. 38.

Ministrija e Financavet ngarkohet me hartue nji Rregullore pēr mirē zbatimin e kēsajē Ligjē.

Art. 39

Kjo Ligjē hynē nē fuqi qē nga data e shpalljes nē Fletoren Zyrtare.

Art. 40.

Ministrija e Financavēt, Ministrija e P. tē Mbrendēshme, dhe Ministrija e P. Botore janē tē dētyrueme me zbatimin e kēsaj Ligjē.

ZOGU 1,

Mbreti i Shqiptarēve

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi rregjistrimin kontrollimin e ndertesave e tē tokē ndertimevet, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresēs Nr. 843-I datē 17-II-931, tē Kryesis sē Tij.

Tiranē, me 24 Mars 1931

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i P. Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
K. Thaçi

Ministri P. Botore
Izet Dibra

BkSh

LIGJË, 18 Prill 1931.

Nr. 64

Mbi ratifikimin e Marrëveshtjes Arësimore Bujqësore ndërmjet Qeveris Mbretnore Shqiptare dhe Fondatës Amerikane Near East të New York-ut

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 26 datë 5 Maj 1931)

Art. 1.

Ratifikohet Marrëveshtja Arësimore Bujqësore ndermjet Qeveries Mbretnore Shqiptare dhe Fondatës Amerikane « Near East » të NeW York-ut, për ngrefjen e Instituti Arësimuer-Bujqësuer Shqiptar-Amerikan, në qarkun e Kavajës si mbas modelit të bashkangjitun.

Art. 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi qysh prej datës së shpalljes së Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Këshilli Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligjë.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi ratifikimin e Marrëveshtjes Arësimore-Bujqësore ndermjet të Qeveris Mbretnore Shqiptare, dhe Fondatës Amerikane Near East të NeW York ut, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 5-1 datë 8-IV-1931 të kryesis të Tij.

Tiranë, me 18 Prill 1931.

ZOG.

Zav. Kryeministri e
Zav. Ministri i P. Jashtme
Pandeli Evangjeli

Zav. Ministri i Drejtësis
V. Avrami

Zav. Ministri i P. Mbrendshme
Musa Juka

Zav. Ministri i Arësimit
H. Hosi

Zav. Ministri i Financavet
K. Thaçi

Zav. Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Zav. Ministri i Ekonomis Kombëtare
Mehdi Frasheri

Marrëveshtje Arësimore-Bujqësore
ndermjet Qeveris Mbretnore dhe Fondatës Amerikane Near-East të New-Yorkut

Art. 1.

Zotni Hil Mosi Minister i Arësimit, si përfaqësues i Qeveris Mbretnore Shqiptare, nga nj' anë, dhe Z. Dr. James R. Barton dhe Dr. Barceley Acheson, si Përfaqësues të Fondatës Near-East të New- Yorkut, të rekomanduem prej Shkelqësës së Tij Herman Berstein, Ministrit Përfaqësues të Shteteve të Bashkueme t'Amerikës, nga ana tjeter, ngrefin Institutin Arësimuer Bujqësuar Shqiptar Amerikan në qarkun e Kavajës.

Art. 2.

Qeverija Shqiptare, i jep Institutit për përdorim e shfrytzim të plotë tokat, të cilat deri me sot i kanë qenë dhanë në konçesjon Z. Irwin e Z. Erickson, me konditë që mbrenda nji vjeti pas datës se ratifikimit të kësaj marëveshtjeje, Qeverija tuë marrë për vehte token e quajtun « Çajire e Beut » me gjith ç ka përsipër në qytetin e Kavajës që, i kje dhanë Z. Erickson, ka me i lëshue Institutit për përdorim e shfrytzim të plotë tokat që mbesin brenda kufijvet të shenjueme prej tokës të tanishme

që i kje dhanë në korçesjon Z. Irwin, nga nj'anë, t'udhës Durrës-Kavajë, nga ana tjater, dhe e treta në (Jugë) tokat e « Malit Robit » (të Konçesjonit Erickson), dhe nga ana e katertë (Lindje) deri në kandet e brigjëvet ku ndodhet shtëpija e Hamdi Agajit, nga Kavaja, tue përfshijë brenda këtyne kufijve Kodren e Hamdi Agajit në fjalë, Sipërfaqja e kësaj tokë të re do të jetë së paku pesëdhetë hektarësh (125 acres) tokë të livrueshme.

Ekspropriјimi i tokavet në fjalë do të bahet pasi të konstatohet se nder këto vende ndodhet sasija e ujit e mjaftueshme për nevojat e Institutit. Në rast të kundertë, Ministrija e Arësimit merr përsipër që, deri në nji kohë ekzaminimi maksimum gjashte muejsh prej datës së ratifikimit të kësaj Kontratë, t'ekspropriјoje një sipërfaqje tokash po me atë sasi në një vend ma të përshtatëshme.

Art. 3.

Mbi këto, tue marrë para syesh ndertesat e para, do të ngrefen në një periudë t' arsyeshme ndertesat e tjera të nevojshme për njiqindë djelmë e njiqindë vajza, dhe të ndaeme si mbas zakoneve të mira. Përdorimi i tokavet ka për qellim kryesuer stervitjen e nxanësvet në bujqësi. Prodhimet e tokavet do të përdoren krejt për dobi të Shkollave t'Institutit Shqiptar-Amerikan.

Art. 4.

Nxanësit e nxanëset do të mbahen me bursa të Qeveries Mbretnore dhe t'Institutit, me konditë që as njana anë të jetë e detyrueshme me dhanë ma tepër bursa se sa mund, por numuri minimum i secilës anë të jetë njizetëpesë (25) bursa për se cilen Shkolle, tuë fillue qysh në vitin Shkolluer 1930-1931. Për nxanësit e nxanëset që kanë me u pranue me mjete të veta, taksi vjetuer për ushqim, mësime e të tjera do të caktohet vjet për vjet prej Administratës s'Institutit në marrëveshtje me Ministrin e Arësimit.

Art. 5.

Ana që jepë bursa ka të drejtë me i dhanë me ato kondita që i duken t'arësyeshme e që nuk janë në kundershtim me ligjët Shqiptare në fuqi.

Art. 6.

Programi arësimuer dhe administrimi i Institutit janë në dorë t'administratës së këtij, i cili ashtë i detyruem me u a për-

shtatë Ligjëve në fuqi dhe zakoneve të mira të vendit. Inspektorët e Qeveries kanë të drejten e inspektimit si-pas dispozitave ligjore në fuqi.

Mësimi i Historisë dhe i Gjeografis së Shqipnies, ka me u zhvillue gjith-monë Shqip prej mësuesish Shqiptare.

Art. 7.

Mësuit Shqiptarë për mësimin e gjuhës, t'Historisë dhe të Gjeografisë së Shqipniës emnohen dhe paguhen prej Ministriës së Arësimit, prej së cilës konsiderohen si nëpunës të Mbretnies Shqiptare. Instituti rezervon të drejten me u dhanë mësuesve Shqiptare nji shpërblim në rasë sherbimi të mirë e të çmueshem.

Pas pesë vjetsh prej datës së hymjes në fuqi të kësaj Marrëveshtjeje, Ministrija e Arësimit merr për sipër pagimin e rrogave, në bazë të Ligjës së Kategorizimit t'Arësimtarëve, e jo ma tepër se dhjetë Mësuesve Shqiptarë.

Në rasë se mbas gjykimit t'Institutit ka prova t'arësyeshme mbi keq sjelljen ose mbi pa-kujdesien, ose pa-aftësien në detyrë të mësuesve Shqiptare, ka të drejtë me kërkue transferimin prej Qeverisë, e cila ashtë e detyrueme mbrenda nji afati jo ma tepër se 15 ditësh t'a verë në zbatim kërkimin e Institutit.

Art. 8.

Çdo send që do t'i duhet Institutit për ngrehjen e ndertesave për arësim, për stervitje dhe orëndit Shkollore, përjashtohen nga çdo taksë doganuer dhe bashkijak të tashme dhe të ardhëshme. Dokumentat për ketë përjashtim taksash do të kenë visten e Ministriës së Arësimit dhe të Financavet.

Në rasë kur Instituti ka me pasë nevojë t'importojë qymyr-gurit, ndonji artikull shendetsije, ushqimi ase veshjeje e mbathjeje për përsonelin dhe nxanësit e nxanëset, e kuer këto gjana nuk prodhohen ose gjinden në Shqipni, por me nji çmim 20% e ma tepër sa shiten sendet e nji llojëshme jashtë Shtetit. taksat doganore e Bashkijake për importimin e këtyne gjanave, do të paguhet nga shuma e parapaeme në nji Kapitutt të budgetit të Ministriës s'Arësimit për ketë qellim.

Përjashtohen nga taksi doganuer, bashkiak e Komunal plaçkat që përsoneli i huej dotë sjelliё në Shqipeni për nevoja vetjake dhe shtëpijake ekskluzivisht.

Dokumentat për ketë përjashtim taksash do të kenë visten e Ministris s'Arësimit dhe të asaj të Financavet.

Ndertesat ushtrimit bujqësuer dhe çdo pasuni e tundëshme, si bagëti auto, maqinat e të tjera si edhe prodhimet e Institutit, kanë me u perjashtue nga çdo taksë qeveritar e bashkiake si të tashme ashtu edhe t'ardhëshme.

Art. 9.

Pranimi, pezullimi ose përjashtimi ose heqja e bursës së nxanësvet dhe nxânësevet, do të bahet në bazë të Rregullorës s'Institutit, e cila do të jetë në konformitet m'atë t'instituteve Shtetnore që janë në përdorim e në fuqi.

Art. 10.

Kjo marrëveshtje ka vleftë për (20) njizetëvjetë tue fillue prej datës së ratifikimit, por mbi propozimin e njanës anë, kater, (4) vjet para mbushjes s'afatit dhe, me pelqimin e anës tjater, mund të përsëritet për nji kohë që ka me u caktue midis dy palëve kontraktuese; por në rasë që qendra e Institutit në New-York e shef t'udhës që të mbyllet para kohës së caktueme degën e sajë në Shqipni, kjo e drejtë do t'i njifet asaj kur Qeverija të jetë e para lajmërueme nji vit Shkolluer ma parë.

Në ketë rastin e fundit dhe kur afati i caktuem mbaron dhe, nuk përsëritet marrëveshtja, pasunija e pa-tundëshme me të gjitha përmirësimet bujqësore, i mbeten Shtetit pa ndo-nji shperblim.

Art. 11.

Qeverija e garanton Institutin dhe nga çdo dame që mund të pesojë me ndryshime Ligjore në posedimin e pronavet dhe e përjashton nga aplikimi i çdo ligjë te rè për kohen e ardhëshme, për sa i përket arësimit ose ekonomis Kombëtare, në qoftë se Instituti e shef se damtohet në nji mënyrë ose në nji tjeter.

Art. 12.

Për të gjitha efektet ligjore Instituti kategorizohet si Shkollë e mesme bujqësore, në konformitet me programin t'aprovuem prej Ministris s'Arësimit dhe t'Ekonomis Kombëtare.

Art. 13.

Çdo Kontratë e maparëshme me Z.Z. Eriskon dhe Liwin mbetet pa fuqi, mbassi të drejtat e tyne i transferohen Institutit.

Art. 14.

Të drejtat e detyrimet e korporatavet të bashkueme (fon-

data e Near East dhe korporata e Shkollës Shqiptare-Amerikane e Bujqësiës për djem e vajza, mbeten në fuqi dhe në rasë që ato të ndahen e të mbetet në Shqipni vetëm njana nga ato, të drejtat e detyrimet me këtë rasë ngelin plotësisht në fuqi për atë që mbetet.

Art. 15.

Kjo Marrëveshtje hynë në fuqi kurse t'i dorëzohet Qev-riës Shqiptare deklarata e Z. Erickson edhe e Z. IiWin, që heqin dorë nga kontratat e posaçme.

Art. 16.

Kjo Marreveshtje ka me i u paraqit Parlamentit për aprovim.

Art. 17.

Kjo Marrëveshtje u hartue në tekset Shqip dhe anglisht me vleftë t'asajë në gjuhën Shqipe.

Nr. 65

SHTOJCË-RREGULLORE, 18 Prillë 931

Mbi ndryshimin e art. 11 të Regullores mbi Llotarin e Kryqit të Kuq

Artikulli 11 i Regullores mbi eksekutimin e ligjës së llotaris Kryqit Kuq Shqiptar më datë 3. Maj 1930 shpallun në Fletoren Zyrtare Nr. 46 datë 30. Korrik 1930, anulohet dhe zavendsohet si vijon:

Art. 11. Shitja e biletave të llotaris kryhet me anë të arkëtarit të llotaris tue i dhanë blersit nji agjio 10% për çdo shumë qi ka me shit.

Kthimi i biletave të shituna ndalohet.

Me vendim të komisionit të llotaris zyra përkatse mund te vijë në marëvesstje me tregtarët ose me agjencitë për shitjen e biletave të llotaris me konditë këthimi në mënyrë qi, këta të para paguajnë vleftën e tyne, të sigurojnë administratën me garanci bankare, garanci Noteriale ose, garanci të Dhomës së Ekonomis së vendit me pasuni të patundëshme.

Këthimi i biletave të pashituna nuk mund të bahet ma vonë se dy dit para datës së heqjes, në rast të kundertë biletat quhen si të shituna definitivisht, agjoa për të tillë blersa asht po ajo e sipërmja.

Këjo mënyrë vendimi mund të zbatohet dhe për autoritetet qeveritarë, të cilat munt të kërkojnë shitjen e biletave pa parapague vleftën.

Shitja nga ana e arkës rë llotaris mund të bahet dhe me anën e postës mbasi, të ketë marë në dorëzim vleftën e biletave dhe shpenzimet e postës për to. Reziqet e dërgesës randojnë për mbi blersin.

Kryeministër e zav. Minis. i Jashtme
P. Evangjeli

Ministri i P. të Mbrendëshme
M. Juka

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
K. Thaçi

Minittri i P. Botore
Izet Dibra

Ministër i Ekonomis Kombtare
M. Frashëri

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 492/I datë 2-4-931 të kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e këshillit Ministruer më datë 26-3-931.

D E KR E T O N

Aprovimin dhe zbatimin e Shtojcë-Rregullores mbi ndryshimin e Art. 11 të Rregullores së Llotaris së Kryqit të Kuq.

ZOG.

Tiranë, 18 Prill 1931

Nr. 66

LIGJË, 25 Prillë 931

Mbi aprovimin e Traktatit të Naturalizimit midis Shqipnis dhe Shteteve të Bashkuara t'Amerikës

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 28 datë 11 Maj 1931)

Neni. 1.

Pranohet Traktati për Naturalizim midis Shqipnis dhe Shteteve të Bashkuara t'Amerikës, i nënshkruar në Tiranë me 21 Kallnuer 1931, si mbas kushteve qi përmban teksti këtu bashkuar i marreveshtjes.

Neni 2.

Ministri i Punëve të Jashtme dhe Ministri i Punëve të Mbrendëshme ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligje.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi aprovimin e Traktatit të Naturalizimit midis Shqipnis dhe Shteteve të Bashkueme t'Amerikës, e votueme prej Parlamentit si mbas shkreses Nr. 79/I datë 4-IV-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 25 Prill 1931.

ZOG.

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli

Ministri i P. Jashtme:
H. Vrioni

Ministri i P. Mbrendëshme:
Musa Juka

Traktatet Naturalizimi midis Shqipris dhe Shteteve të Bashkuar

Qeverija Mbretnore Shqiptare dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuar t'Amerikes, dyke patur deshirë t'arrijnë në nji marreveshtje qi i përket pozitës së qytetasve ose të shtetasve të natu- ralizuar të njerit ose tjetrit Shtet, të cilët më parë ishin shtetas të tjatri, dhe përgjithësisë për sherbim ushtarak edhe për të tjera veprime besnikërije nga ana e këtyne personave, ose e personave të lindur në token e njerit ose tjetrit Shtet prej prindësh qi kanë shtetsinë e tjetrit, kanë vendosur të lidhin nji Traktat mbi këto pika; edhe për ate qëllim kanë emruar fuqiplotët e tyre, domethanë:

Nalt Madhënia e Tij Mbreti i Shqiptarëve: Shkelqesën e Tij Pandeli Evangjeli, Kryeminister dhe Minister i Punëve të Jashtme ad interim, edhe;

Presidenti i Shteteve të Bashkuara t'Amerikës: Z. Herman Bersien, i derguar i Jashtëzakonshem dhe Minister Fuqiplotë i Shteteve të Bashkuara t'Amerikës në Shqipëri.

Të cilët, passi i-a komunikuan njeritjatrit fuqitë e tyre të

plota, që u-gjenden në formë të mirë dhe të regullshme, ranë në marreveshtje mbi Artikujt që vazhdojnë:

Artikulli I.

Shtetasit e Shteteve të Bashkuar të cilët janë naturalizuar ose do të naturalizohen në tokë Shqiptare do të quhen prej Shteteve të Bashkuar si persona q'e kanë humbur shtetësinë e tyre të mëparëshme dhe qi janë shtetas Shqiptarë.

Reciprokisht shtetasit e Shqipërisë të cilët janë naturalizuar ose do të naturalizohen në tokë të Shteteve të Bashkuar, do të quhen prej Shqipërisë si persona q'e kanë humbur shtetësinë e tyre origjinale dhe qi janë shtetas të Shteteve të Bashkuar.

Dispozitave të sipërme të këtij Artikulli u poshon fuqia, si për njerën ashtu edhe për tjatren Anë të kësaj ujdije, kurdoherë qi kjo të ndodhet në luftë.

Fjala «shtetas» ashtu si kunder përdorohet në ketë Ujdi tregon nji personë e cila i-a detyron pergjithëhere basnikërinë, ose e cila ka shtetësinë, respektivisht, të Shteteve të Bashkuar ose të Shqipërisë, si mbas ligjeve të tyre.

Fjalët « i naturalizuar » ashtu si kunder përdorohen në këtë Ujdi u referohen vetem naturalizimit të personave në moshë të plotë, që janë naturalizuar me dëshirën e vet, dhe naturalizimit të prindërvë të tyne. Këto fjalë nuk i aplikohen fitimit të shtetësisë prej nji grueje me anën e martesës. Fëmijët të mitur të personave të naturalizuar në njerin ose tjatrin Shtet, nuk do të fitojnë shtetësin e atij Shteti, gjerë sa të mos e kenë stabilzuar banesën e tyre të regullshme në të.

Artikulli II.

Shtetasit e njerit ose tjetrit Shtet, të cilët janë naturalizuar ose do të naturalizohen në tokë të tjatrit, sikunder u-projektue në Artikullin I, kur të kthehen në Shtetin e Kombësies së maparëshme, nuk do të ndeshkohen, sa për vepren origjinale t'emigrimit, ose për shkak qi munguan t'i përgjigjen thirrjes për sherbim ushtarak, të bërë passi këta të kenë fituar qendresen rregullisht në token e Shtetit, shtetësia e të cilit ka qenë fituar me anën e naturalizimit.

Artikulli III.

Në qoftë se nji shtetas i njerit ose tjatrit Shtet, i cili perfshihet mbrenda kufijve të Artikullit I, do të përsëritë banimin në Shtetin e origjinës së tij, pa patur qëllim të këthehet në Shte-

tin në të cilin ka qenë naturalizuar, ay do të quhet se ka hequr dorë nga naturalizimi i tij.

Qëllimi i mos-kthimit mund të quhet që ekziston kur nji person i naturalizuar me njerin Shtet, do të ketë banuar me tepër se dy vjet në Shtetin tjatër; por ky presumim mund të mposhtet kur ka prova për të kunderten.

Artikulli IV.

Një person i lindur në tokë të njerës Anë prej prindersh që janë shtetas të anës tjetër, dhe që, si mbas ligjeve të tyre, ka banimin e sajë të rregullshme domethanë, vendin ku përgjithësisht e ka qendren e ndenjes së saj, në token e Shtetit ku ka lindur, nuk do të quhet qi asht e detyruar të bajë sherbim ushtarak, ose çfarëdo tjater vepër besnikërije, në nji kohë banesë të përkohëshme, në token e Anës tjeter.

Artikulli V.

Ky Traktat do të hyjë në fuqi me nji herë passi të bahet kembimi i ratifikimeve, dhe do të vazhdojë të ketë fuqi për dhjetë vjetë. Në qoftë se as njera as tjatra Anë nuk do t'i ketë njoftuar Anës tjeter me gjashtë muej paralajmerim qëllimin e sajë për t'a pushuar Traktatin, ky do të mbetet në fuqi deri në fund të dymbëdhjetë muevje, passi njera ose tjatra. Anë kontraktonjëse, t'a ketë lajmeruar Anën tjetër për nji qëllim të këtillë.

Për të deshmuar këto, fuqiplotët përkatës e nënshkruan këtë Traktat dhe e vulosen me vulat e tyne.

Bërë në dy kopje, në Tiranë, sot me 21 të muejit Janar 1931.

Nr. 67

LIGJË, 18 Prillë 1931

Për transferimin e fondeve në budgetin 930-931 të Komandës së Mbrojtjes Kombëtare

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 29 datë 13 Maj 1931)

Art. 1.

Në budgetin 1930-31 të Komandes së Mbrojtjes Kombëtare pakësohen prej:

Kap. 4. «Shpenzime per mbajtjtn e të s'mundevet nder

Spitale e infermerina garzonit, ushqim i posaçem për të shtruem, rroga personalit civil të Spitalevet, blemje, mirëmbajtje e shperndamje barnash e materialit shendetësuer, shpenzime të ndryeshme shendetësijet Fr. ari 12.000

Kaq. 8. « Blemje persëritje e mirëmbajtje materialit të kazermavet, kashtë për shtresë ushtarash, zjarmë e dritë

Fr. ari 16.000

———

Shuma Fr. ari 28.000

tue u shtue ne:

Kap. 12. « Blemje kafshesh, shpenzime për rekuizime kafshesh, shpërblim oficerave për humbje kafshesh»

Fr. ari 3.000

Kap. 16. « Qirana ushtarake » Fr. ari 5.000

Kap. 34. « Ndertime të reja ushtarake, transformime të medhaja e zgjanim i gjanavet të pa-tundëshme në përdorim ushtarak blemje e çpronesim gjanash të pa-tundëshme në përdorim ushtarak, linje telefonike të përherëshme Fr. ari 20.000

———

Shuma Fr. ari 28.000

Art. 2.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligjë.

Art. 3.

Kjo Ligjë kynë në fuqi me diten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit për transferime fondesh në buxhetin 1930-31 të Komandes së Mbrojtjes Kombëtare, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 103-I datë 2-IV-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 18 Prillë 1931.

ZOG.

Zev. Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
K. Thaçi

Nr. 68

LIGJË, 25 Prillë 931

Mbi shlyemjen e 1800 fr. ari prej vërtetimit të sipërmarrjes së Lytfullah Stërmazit dhe për çlirimin e dorzanis

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 29 datë 13-V-931)

Art. 1.

Autorizohet Ministrija e Financavet t'i shlyejë dhe t'i shlirojë garancin Z. Lutfullah Stermasit, sipërmarrësit të tokave shtetnore në Laprakë, fr. ari 1.800 (njimijeteqindë) damin e shkaktuem me rastin e marrjes së nji pjesë të tokës se kontraktueme tue i a dhanë Z. Banush Hamdi përfaqësuesit të Zojës Shazie Toptani, përpara mbarimit t'afatit të kontratës.

Art. 2.

Kjo Ligjë hynë fuqi që prej datës së shpalljes së saj në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Ministrija e Financavet autorizohet me zbatimin e kësaj Ligjë.

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëve
DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi shlyemjen e 1800 fr. ari prej vertetimit të sipërmarrjes të Z. Lutfullah Stermasit, dhe për çlirimin e dorëzanis, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 426-III datë 1-IV-1931 të Kryesis së Tij.

ZOG.

Tiranë, me 25 Prill 1931.
Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 69

LIGJË, 18 Prillë 931

Mbi rregjistrimin e Gjendjes gjyqsore

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 30 datë 16 Maj 931)

Neni. 1.

Pranë Ministris së Drejtësis, themelohet një Zyrë Rregjistri të Gjendjes gjyqsore, e cila mbledh dhe ruen shkurtimet e vendimeve gjyqsore të numruemë në nenin 2, që u perkasin shtetasve Shqiptarë dhe të huej.

Neni 2.

Në Rregjistrin e Gjendjes gjyqsore inkriptohen këto shkurtime:

1) në landë ndeshkimore: vendimet dënimi të dhanuna prej gjykatave penale mbassi, të kenë marrun formen e preme; vendimet dënimi të dhanuna prej gjykatave kolegjale n'arratiën e të pandehunit; gjithashtu edhe masat e marruna per të dobtë nga mendë, për të mitunit dhe per shurdh-memecat si mbas neneve 47, 54 dhe 57 të Kodit Penal;

2) në landë civile: vendimet e preme që përmbajnë ndalimin (interdiktionin) ose; pa-aftësiën (inhabilitationin) (nenet 380 dhe 397 të Kodit Civil;

3) në landë tregtare: vendimet me të cilat tregtari deklarohet ose konsiderohet i falimentuem.

Vendimet e nalt-përmënduna inskriptohen në Rregjistrin e Gjendjes gjyqsore cilido të ketë qenun autoriteti gjyqsuer shqiptar që i ka dhanun, ordinar ose i posaçëm; gjithashtu inskriptohen edhe vendimet e dhanuna kundra shtetasve shqiptarë nga autoritete gjyqsore të hueja, në rast që komunikohen zyrtarisht.

Në rast dënimi ndeshkimuer, shenohet në Rregjistrin e Gjendjes gjyqsore edhe vendi e koha ku dhe kur asht vuejtun ndeshkimi, ose se nuk asht vuejt krjt ose një pjesë per efekt amnistije, faljeje ose të një shkaku tjetër.

Në Rregjistrin e Gjendjes gjyqsore inskriptohet edhe revokimi i vendimeve në landë civile dhe tregtare që tregohen në Nr. 2 dhe 3.

Neni. 3.

Shkurtimi i vendimeve dhe i masave të tregueme në Nr. 1,

2 dhe 3, të nenit të ma parshëm shkruhet respektivisht, në buletina, forma e të cilëve caktohet me Dekret të Ministris së Drejtësis.

Çdo buletin asht personal dhe duhet të përmbajë në shkrònja të qarta emnin, mbiemnin, emnin e atit dhe të nanës, datën dhe vendin e lindjes, banimin, mjeshtërien dhe shtetsien e personit të cilit i referohen, si dhe të gjitha cilësiët personale që janë të nevojshme për identifikimin e tij.

Neni 4.

Mbushja e buletinave u perket Kryesekretarve të Gjykatave, të cilët, mbassi t'i mbushin dhe t'i nenshkruejn në vendin e shenjuem për këtë, perpilojnë një listë në dy kopje, e cila duhet të përmbajë emnin dhe mbiemnin e personave të cilëve u referohen, dhe i a parashtrojnë për vertetim Gjykatësit që ka dhanë vendimin. Gjykatësi kontrollon regularitetin e tyne dhe i verteton tue vuem nenshkrimin e tij në vendin e shenjuem për këtë. Buletinat dhe një kopje e listës i dergohen Zyrës së Rregjistrit të Gjendjes gjyqsore pranë Ministris së Drejtësies.

Të gjitha këto veprime duhet të kryhen mbrenda 15 ditëve ç'prej asaj në të cilën akt-gjykimi ka marrun formen e preme ose i ka arrijtun n'atë forme gjykatëse perkatëse.

Neni. 5.

Buletinat duhet të mbushen pa ndonjë të metë.

Në rast që nga aktet dhe dokumentat e procesit nuk asht e mundun të nxjerret ndonjë lajm, duhet me i u sjellun Zyrës që mund t'a api.

Porse, si të kalojnë 15 ditët e caktueme në nenin e ma siperm, buletinat duhet të mbushen dhe të dergohen edhe në qoftë se mungon ndonjë lajm, i cili duhet të komunikohet ma vonë po sa t'arrij nga Zyra kompetente nga e cila asht kerkuem.

Në qoftë se për lajmin që mungon i asht drejtue Zyrës kompetente, në rubrikën përkatëse shkruhet (*me lapës*): kerkuem; në qoftë se nuk ka qenë ose nuk asht e mundun m'u pasun ay lajm, shkruhet (*me bojë*): nuk rezulton; dhe në qoftë se ay lajm nuk ka të bajë me personin, shkruhet (*me bojë*): s'ka vend.

Neni. 6.

Zyra e Regjistrit të Gjendjes gjyqsore duhet të mbajë këta radhorë:

a) një radhuer alfabetik kontrollimi;
b) një radhuer për ndreqjet;
c) një radhuer për dergimin e dëshmivet.

Neni. 7.

Buletinat që u perkasin të huejve rishkruhen në një buletin të posaçem i cili, me anën e Ministris së Punve të Jashtme, i komunikohet Qeverisë së Shtetit të huej në konformitet me konvencjonet internacionale ose per reciprocitet.

Neni. 8.

Buletinat ruhen në kasetina druni të fortë, të cilat duhen të kenë në ballë një shkronjë si mbas rendit alfabetik.

Kasetinat duhet të mbyllen me çels dhe të mbahen në një lokal ku mos të mundet me hye tjetër njeri përveç nëpunsave të Rregjistrit të Gjendjes Gjyqsore.

Buletinavet që i përkasin po një personi i vehet një numur renduer si mbas datave të vendimeve dhe bashkohen në një dosje.

Neni 9.

Lajmet që i përkasin ekzekutimit të dënimeve dhe pikave të tjera që nuk mund të dihen në kohen e mbushjes së buletinit, plotsohen me fletët plotësuese.

Neni 10.

Drejtoriet e burgjeve janë të detyrueme me i komunikuem me një herë Ministris së Drejtësis vdekjet e personave të burgosun.

Neni 11.

Inskriptimet tërhiqen nga Rregjistri i Gjendjes Gjyqsore po sa të merret lajmi zyrtar i vdekjes së personit të cilit i përkasin.

Gjithashtu tërhiqen këto inskriptime:

1) të dënimeve për delikte mbasi të ketë kalue një kohë aq sa personi i inskriptuem arrijn moshën e 80 vjetve;

2) të dënimeve për kontravencione si të kalojnë 5 vjet nga dita në të cilen ndeshkimi asht vuejtun ose dënimi asht shuem;

3) të masave të marruna në bazë të neneve 47, 54 dhe 57 të Kodit Penal dhe, t'atyne në landë civile dhe tregtare si të kalojnë 5 vjet nga data e revokimit të tyne.

Mbi tërheqjen e inskriptimeve merret shenim në radhorin alfabetik të kontrollimit.

Neni 12.

Përveç inskriptimeve të tregueme në nenin e ma sipërm, tërhiqen edhe inskriptimet mbi vendime t'anulueme, të revokueme ose të modifikueme nga një vendim i mapastajshëm që i përket po atij personi dhe po asaj vepre, dhe ky vendim duhet të zavendësojë inskriptimin që tërheqet.

Inskriptimet tërhiqen edhe në rast riaftësimi.

Neni 13.

Gjithashtu tërhiqen buletinat që u referohen personave që nuk ekzistojnë ose që janë inskriptuem gabimisht në Rregjistrin e Gjendjes Gjyqsore për shkak deklarimesh falsó mbi gjendjen civile të një të pandehuni.

Neni 14.

Në rast që masat e marruna për të dobtë nga mendet, në bazë të nenit 47 të Kodit Penal, nuk janë revokuem, buletinat perkatës terhiqen si të kalojnë 10 vjet nga data në të cilen vendimi ka marrun formen e preme, përveç kur padija penale nuk asht parashkruem ende, dhe në një rast të tillë terhiqen si të mbushet parashkrimi.

Neni 15.

Per sa u perket masave të marruna për të mitunit dhe për shurdh-memecat në bazë të neneve 54 dhe 57 të Kodit Penal, në qoftë se nuk revokohen, buletinat perkatës tërhiqen si të kalojnë 5 vjet nga marrja fund e afatit që u ka caktue atyne gjykatësi për qendrim n'institutet edukimi ose përmirësimi, ose për ndryshe si t'arrijnë moshen madhore.

Neni 16.

Autoritetet gjyqsore si ordinare si të posaçme janë të detyrueme me kerkue nga Ministrija e Drejtësis një deshmië për të gjitha inskriptimeve që ekzistojnë n'emën të personit që merret si i pandehun dhe t'i a bashkojnë akteve të procedimit si hetimuer si gjyqsuer para se të lidhin çeshtjen në vendim.

Çdo autoritet civil ose ushtarak i cili ka përsipër dhanëjen, pezullimin ose revokimin e një të drejte, ofiqi, sherbimi ose në punësije publike, grade, titulli, dinjiteti, cilsie, dekorate pensioni, ose benefici, ka të drejtë me kerkue dhe me pasun një dishmië të të gjitha inskriptimeve që i përkasin një personit të caktuem, kur, për një dispozitë të Ligjës ose të një Rreguloreje, dhënja, pezullimi ose revokimi ka për konditë qënjen ose

mos-qenjen të vendimeve që përfshijhen n'ato që duhet t'inskriptohen në Rregjistrin e Gjendjes Gyjqsore.

Neni 17.

Dishmija lëshohet edhe mbi kërkesën e pa arësyetueme të personit të cilit i përket.

Dishmija që i përket një personi tjetër mund të kerkohet nga një privat vetëm për t'a parashtruem në gjyq penal ose civil, ose për arësye zgjedhjesh politike ose administrative, ose për dhanjen ose ushtrimin e një ofiqi publik; në kerkesën duhet të shprehet qëllimi.

Neni 18.

Në dishmiët që u lëshohen mbas kerkesës privatve, perveç sa urdhërohet në nenin 20 nuk shenohen:

1) vendimet efektet e të cilave quhen si të shueme në bazë të neneve 392 dhe 397 atë K. Penal;

2) një dënim i parë me gjobë ose me ndeshkim kundra liris personale i cili vetëm ose i bashkuem me ndonjë ndeshkim tjeter nuk kalon tre muej burgimi të randë ose gjashtë muej burgimi, dhanë kundra një personi që nuk ka mbushun 18 vjetët, në qoftë se kundra tij nuk rezulton një dënim i ma pastajshem me ndeshkim kundra liriës personale;

3) dënimet e shueme me amnistië;

4) dënimet për fakte të cilat ligja nuk i parashikon ma si faje ose që nuk parashikohen si të tilla nga ligjët e Mbretniës në qoftë se dënimi asht vendosun jashtë;

5) vendimet e posaçme për të dobtë nga mendte, të mitunit dhe shurdh-memecat që përmenden në Nr. 1 të nenit 2;

6) vendimet në landë civile ose tregtare që përmenden në Nr. 2 dhe 3 t'atij neni kur të jenë revokue.

Neni 19.

Në rast që një person asht dënuem për herë të parë me gjobë që nuk kalon Fr. ari 5000 ose, me një ndeshkim kundra liris personale që nuk kalon 3 vjet, dhe përgjithsisht për çdo faj që rrjedh nga mos-kujdesija, Gjykatësi, tue marrë parasyesh si sjelljen e ma parëshme të të dënuemit ashtu edhe cirkonstancat e veprës, mund të vendosi që të pezullohet shenimi i dënimit në dishmiën që epet nga Rregjistri i Gjendjes Gjyqsore, deri sa i dënuemi mos të bajë një vepër tjetër që formon delikt.

Neni 20.

Në dëshmiët që lëshohen për arësye zgjedhjesh politike ose administrative, mbi kerkesën e kuejtdo, nuk përmenden vendimet e tregueme në Nr. 3, 4, 5 dhe 6 të nenit 18, as dënimet për kontravencjone, as ato në të cilat ndeshkimi asht çkëmbye në qortim-gjyqsuer, përveç dënimesh për lypsië ose vagabundazhë.

Neni 21.

Kërkesat për lëshimin e dëshmivet duhet t'i drejtohen Ministris së Drejtësis.

Autoritetet civile ose ushtarake që kërkojnë një nxjerrje të Rregjistrit të Gjendjes Gjyqsore si mbas nenit 16, duhet të shprehin në kerkesë qellimin për të cilin e kërkojnë. Gjithashtu kerkesa duhet të përbajë emnin dhe mbiemnin e personit të caktuem, emnin e atit dhe të nanës, datën dhe vendin e lindjes, banimin, shtetsiën dhe mjeshtriën e tij.

Neni 22.

Kur kerkesa parashtrohet prej një privati që nuk asht personi të cilit i referohet dishmija, duhet të përmbajë, si mbas nenit 17, qellimin për të cilin kerkohet.

Neni 23.

Në qoftë se nga Rregjistri i Gjendjes Gjyqsore nuk rezulton ndonjë shenim mbi personin e kerkuem, dishmiës i vehet një vizë diagonale.

Në rast të kundert shkruhen në dishmi vendimet, që lejon ligja, si mbas datës.

Në rast dënimi penal duhet shenuem lloji i fajit me cirkonstancat randësore dhe lehtësore dhe, nenet e ligjës që janë aplikuem.

Në dishmiët që kërkohen nga autoritetet gjyqsore duhet shenuem edhe dita në të cilen ka marrun fund vuejtja e ndeshkimit ose se dënimi asht shuem.

Mbi leshimin e dishmisë merret shënim në radhorin perkates.

Neni 24.

Në rast që kerkohen ndreqje inskriptimesh ose dishminash të Rregjistrit të Gjendjes Gjyqsore, mbi kerkimin e Prokurorit të Shtetit ose të palës, vendos gjykata që ka dhanë dënimin.

Këto vendime duhet t'i komunikohen Ministris së Drejtësis po sa që të kenë marrë formen e preme, për ndreqjet eventuale.

Mbi këto merret shenim në rradhorin alfabetik kontrolimi dhe n'atë mbi ndreqjet.

Neni 25.

Ay që tue deklarue një emën falso ose tue treguem falso emnin e një tjetri në vend të vetit, ose me deklarime falso mbi gjendjen civile të një të pandehuni, shkakton që mos t'inskriptohet emni i vërtetë i të dënuemit, ose shkakton inskriptimin e një personi tjetër në Rregjistrin e Gjendjes gjyqsore, ndeshkohet, përveç kur vepra e tij sjell një ndeshkim ma të madh, me burgim të randë nga një deri në tridhetë muej.

Neni 26.

Ay që tue pasun dijenië mbi inskriptimet e përmbajtuna në Rregjistrin e Gjendjes Gjyqsore i publikon ose i çpallë pa qenë i lejuem, ndeshkohet me burgim deri në një vjet dhe me nji gjobë deri në 500 Fr. ari.

Neni 27.

Ay që me dhelpnië ban që t'i lëshchet një dishmië që i përket një personi tjetër, ose e përdorë jo për atë qëllim për të cilën e ka kerkuem, ndeshkohet me burgim të randë deri në gjashtë muej dhe me gjobë deri në 300 Fr. ari.

Neni 28.

Mbushja e buletinave duhet të fillojë:

a) për krime që prej 1 Janar 1921;

b) për delikte që prej 1 Janar 1926;

c) për kontravencjone me ditën e hymjes në fuqi të këasj Ligjë.

Neni 29.

Personeli i Zyrës së Rregjistrit të Gjendjes Gjyqsore përbahet prej një nëpunësi të Zyrës së Rregjistrit të Gjendjes gjyqsore me rrogë muejore prej Fr. ari 320, dhe prej një Sekretari me rrogë muejore prej Fr. ari 250.

Neni 30.

Kjo Ligjë hynë në fuqi një muej mbas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 31.

Ministrija e Drejtësis ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligjë.

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi Rregjistrin e Gjendjes Gjyqsore, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 52/I datë 4-IV-931, të Kryesis së Tij.

Z O G.

Tiranë, më 18 Prill 1931
Zav. Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis:
V. Avrami

Nr. 70

KONÇESION, 3 Prillë 931

Mbi ngrehjen e një fabrike Birre në Prefekturën e Korçës

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 31 datë 29 Maj 931)

Ndermjet të Ministris t'Ekonomis Kombëtare Z. Mehdi Frasheri që mbas këndej do të quhet «Qeverija» në njanen anë, dhe të Z,Z. Umberto Umberti e Selim Mborja që mbaskëndej do të quhet «Konçesjonare» në tjetren anë, sot me 21 Mars 1930 u lidhë kjo Kontratë:

Art. 1

Qeverija Shqiptare i jep Konçesjonervet të drejten me ngrefun nje fabrikë per me produktue birrë në Prefekturen e Korçës, dhe angazhohet gjatë kohës të këtij Konçesjoni të mos japi as nji Konçesjon me as nji far privilegji në qarkun e Prefekturës të Korçës per fabrikimin e birrës.

Art. 2

Gjasht muej mbasi të jetë ratifikue e shpallun kjo Kontratë në Fletoren Zyrtare, Konçesjonarët detyrohen me fillue së ndertuemi binanë e fabrikës, dhe mbrenda 24 (njizetekatër) muejve mbas kësaj datë t'a kenë mbarue e të kenë fillue me fabrikue birrë.

Art. 3

Afati i Konçesjonit fillon 2 (dy) vjet mbassi të jetë ratifikue

e shpallun kjo Kontratë në Fletroen Zyrtare dhe zgjatë 25 (njizetepesë vjet).

Art. 4

Qeverija i perjashton per gjithë kohen e Konçesjonit nga tagri Doganuer dhe nga taksat e tjera suplementare që janë vue në favor të Bashkive ose të Komuneve dhe të Lulzimit, perveç asaj që asht vue në favor t'Arësimit, sendet e posht-shenueme që Konçesjonarët do t'importojnë per qellime të fabrikës së birrës:

a) gjithë materialin e veglat e nevojshme per ngrefjen e per s'madhimin eventual të fabrikës dhe per instalimin e maqinave perveç materialit që prodhohet në Shqipni dhe që vlenë per ketë qellim.

b) Maqinat e sendët e tjera të nevojshme per fabrikimin e birrës si edhe sendet e nevojshme per shitjen e këti produkti të cilat janë, fuçij dhe shishe, në qoftë se nuk fabrikohen në Shqipni;

c) Landen e parë (materie premiere) d.m.th. Hupulus, dhe Malto.

Per landen e parë u falet Konçesjonarëvet tagri Doganuer dhe taksat e tjera suplementare, vetem në qoftë se kje nuk mund të produktohet në Shqpini ose mund të produktohet por jo aqë mirë dhe e vlefshme per birrë të cilësis së mesme.

Art. 5.

Landa e parë e përjashtueme nga tagri doganuer e nga taksat e tjera suplementare do të shkojë drejt për së drejti në magazinen e posatçme të fabrikës dhe, të shpenzohet vetem për fabrikimin e birrës që ka për qellim kjo Kontratë. Materiali në fjalë nuk mund të nxjerret e të mbahet n'asnji mënyrë jasht magazinës së caktueme, përndryshe do të konsiderohet kontrabandë dhe, do të veprohet si mbas ligjës përkatse.

Art. 6.

Mbasi të jetë krye ndertimi i fabrikës e të jenë ba të gjithë instalimet e maqinave, Konçesjonarët detyrohen t'i paraqesin Qeverisë nji pasqyrë me të cilen do të provojnë se gjithë materialet e nevojshme për ngrefjen komplet të fabrikës qi janë importuem pa pague tagrin doganuer e taksat e tjera suplementare janë përdorë për ketë qellim.

Në rast që nga hetimet që do të bahen nga ana e Qeverisë provohet se, materialet në fjalë janë përdorun edhe për qellime

të tjera, Qeverija Shqiptare ka të drejtë t'i gjobisi konçesjonarët me dyfishimin e tagrit doganuer e të taksavet të tjera t'importimit të materialit që u përdorë për qellime të tjera.

Art. 7.

Në qoftë se kuptohet që materiali, veglat e maqinat e importueme pa tager doganuer, kapercejnë sasinat e nevojshme për ngrefjen e fabrikës dhe landa e parë, e importueme pa tager doganuer kapërcen sasien e shpenzueme për birren e produktueme dhe ato të depozitueme në magazinen e posaçme, Konçesjonarët për tepricen janë të detyruem me e pague dy fish tagrin doganuer dhe në rast përëritje, përveç se këto do t'a paguejnë dy fsh por do të kenë dënime të tjera të paraname prej ligjeve përkatse.

Art. 8.

Produkte e fabrikës që do të eksportohen, përjashtohen nga taksa e eksportimit përveç kësaj Konçesjonarvet u këthehet përsëri edhe taksa e fabrikimit që përmendet n'Art. 10, të kësaj Kontratë, me kusht që t'i paraqesin Qeveries dokumentat e nevojshme që deshmojnë për sasinë e birrës që asht eksportue.

Art. 9.

Përveç përjashtimit nga tagri doganuer e nga taksat e tjera suplementare të përmenduna n'Art. 4. të kësaj Kontratë, të 15 (pesëmbedhet) vjetet e para, konçesjonarët përjashtohen edhe nga Tatimi i fitimit për kapitalin e investuem në fabrikimin e birrës.

Për kohen tjetër të Konçesjonit, Konçesjonarët do t'u shtrohen tatimit të fitimit si gjithë sipërmarrësit e tjerë pa ndo nji ndryshim.

Art. 10.

Për sasien e birrës së produktueme, konçesjonarët detyrohen me i pague Qeveriës krye çdo tre muejve, gjatë 17 (shtatëmbëdhjetë) vjetëve të parë 2,75 (dyeshtatëdhetepesë) fr. ari për hektoliter, dhe për gjith kohen tjetër të Konçesjonit 3.75 (tre e shtatedhetepesë) fr. ari për hektoliter.

Në qoftë se Konçesjonarët nuk i bejnë pagesat e sipër-tregueme në afatin e caktueme, atëherë detyrohen me pague edhe kamaten 15%.

Art. 11.

Përjashtimi i landes së parë nga tagri doganuer dhe nga taksat e tjera suplementare, hynë në fuqi mbasi konçesjonarët t'a ke-

në përmbushun detyrimin e përmendun n'Art. 2, të kësaj Kontratë, kuerse përjashtimi i sendevet, që përmenden në pikat A. edhe B, t'Art. 4, të kësaj Kontratë, nga tagri doganuer dhe nga taksat e tjera suplementare hynë në fuqi dy jave mbasi të jetë shpallun këjo Kontratë në Fletoren Zyrtare.

Art. 12.

Konçesjonarët i shtrohen Kontrollimit të nevojshme që ka me u ba nga ana e Qeveris për konstatimin e sasies së materialit të fabrikuem, në bazë të cilës kanë me u nxjerrë taksat e përmëndun n'Art. 10 të kësaj Kontratë.

Art. 13.

Konçesjonarët u shtrohen taksave, të konsumit dhe të tjerave që ndodhen sot në veprim ose që kanë me u vue në kohen e arthme, me përjashtim t'atyne taksave që u përmendën n'Art. 4, 8, 9, e 10 të kësaj Kontratë.

Art. 14.

Qeverija gjatë kohës të këtij Konçesjonit detyrohet me i vue birrës një tager importimi jo ma të ulët se 20 Fr. ari kuintalit mbi atë që vjen nder fuçija, dhe 30 Fr. ari për kuintal asaj me shishe.

Art. 15.

Konçesjonarët detyrohen me marrë në punë në fabrikën e birrës vetem punëtorë (të ç'do cilësije që të jenë) të nenshtetësis Shqiptare.

Të pesë vjetët e para të koncesjonit Konçesjonarët mund të marrin në punë në fabrikën e birrës puntorë teknik të nenshtetsiës të huej, në qoftë se nuk gjinden të ketij lloji në Shqipni.

Konçesjonarët, per ketë, duhet të kërkojnë leje nga Ministrija e Ekonomis Kombëtare nji muej para se t'i venë t'interesuemit në punë.

Ashtu edhe nëpunësit e Administratës duhet të jenë të gjithë nenshtetas Shqiptarë, që në fillim deri në fund të Konçesjonit. Me lejen e Ministriës s'Ekonomis Kombëtare mund të bahet përjashtim vetem për nji ose dy Drejtorë.

Art. 16.

Konçesjonarët detyrohen me i mjekue gratis puntorët e sëmuet e të plagosun dhe, me i sigurue kunder ç'do infortuni, kuer smundja ose infortunet janë shkaktue nga puna.

Art. 17.

Konçesjonarët detyrohen me sigurue për kapitalistat Shqiptar jo ma pak se 40% të kapitalit që do të investohet në këtë industri.

Në rast që mungon kapitali Shqiptar, Konçesjonarët detyrohen me i a lajmerue këtë Ministriës Ekonomis Kombëtare, e cila do të përkujdeset për me interesuem kapitalin Shqiptar dhe simbas rastit e nevojës me disponue mbi rregullimin definitiv të kësaj çeshtje, tue shlirue Konçesjonarët prej ketij obligimi, mbasi të kenë kalue 12 muej pa dobi prej datës së thirrjes për marrje pjesë të kapitalit Shqiptar.

Art. 18.

Për administrimin e fabrikës, Konçesjonarët detyrohen me mbajtë gjithë librat tregtare të parapame prej Kodit Tregëtar e prej Ligjëve të tjera të posaçme, ashtu edhe rregjistrat e tjera që Ministrija e Ekonomis Kombëtare, do të vejë në zbatim ma vonë.

Me këto rregjistra do të shenohen:

1) Sasija dhe vlefta e landës së parë që do të importohet ç'do vjet pa pague tagrin doganuer,

2) Sasija dhe vlefta e prodhimit të përvjetshem, duke shenue veçanërisht vleften e landes së parë të vendit në barasim me ato të huejen që asht përdorë në fabrikë,

3) Sasija e vlefta e prodhimit të përvjetshem që asht shit në Shqipëni eksportue jashte dhe teprica që ka mbet pa u shitun,

4) Maqinat, veglat e materiali që janë importue për fabriken, vlefta e tyne dhe sasija e tagrit doganuer të falun,

5) Taksat Shtetnore që paguhen për vjetë,

6) Numuri i puntorëve dhe i nëpunsavet që sherbejnë në fabrikë, nenshtetësija seksi dhe, shperblimi i tyne i përmuejshem.

Art. 19.

Konçesjonarët zgjedhin për banesë ligjore të firmës tyne Korçen.

Në rast qi len nji konflikt midis Qeveriës dhe Konçesjonarvet për çka i përket interpretimit e aplikimit të kësaj Kontratë, të dy palet konraktuesa para se t'i drejtohen Gjyqit Kompetent, detyrohen me i u shtrue nji pleqsimit (arbitrazh) të formuem prej dy anëtarëve të emnuem respektivisht prej të dy palëvet, të cilët do të emnojnë super-arbitrin, dhe në rast që nuk ujdisen, ky

do t'emnohet prej Kryetarit të Gjyqit Shkallës së I rë, të Korçës. Arbitazhi duhet me marrë fund mbrenda 6 (gjashtë) muejve.

Art. 20.

Konçesjonarët, tue qenë vetë fondatorë, do të formojnë një Shoqëri në konformitet me ligjet, dhe me t'aprovuemit të Shoqëniës në format e duhuna, ky konçesjon do të rregjistrohet n'emnin e Shoqniës.

Në rast qi Shoqnija qi do të formohet ma vonë do të ketë çilësinë anonime, konçesjonarët si inisiatorët e Shoqnis s'arthme, do të rrjeshtojnë në aktin konstitues konditen që (40%) dyzetë për qind të kapitalit të jenë në aksionë nominative.

Art. 21.

Kjo Kontratë hynë në fuqi që prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve
DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e kontratës mbi ngrefjen e nji fabrikë birre në Prefekturën e Korçës, lidhun midis Qeveris' e Konçesjonarve ZZ. Umbreto Umberti e Selim Mborja, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 733-I dat 27-I-1931 të Kryesis të Tij.

Tiranë,3 Prill 1931

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Mehdi Frasheri

Nr. 71

LIGJË, 14 Maj 1931

Mbi krijimin e Kryeministris

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 31 datë 20-V-931)

Art. 1.

Me kompetencat dhe atributat të ektuem në Statutin Themeltar të Shtetit dhe të Ligjit Organik relativ qi do të viret në zba-

tim prej 1 Shtatorit krijohet Kryeministrija e Mbretnies Shqiptare.

Art. 2.

Titullari i Kryeministris merr nji rrogë të përmujëshme prej 1500 Fr. ari; dhe 300 Fr. ari alokasion e cila fillon çprej ditës së proklamimit të Manarchis dhe krijimit të sajë (1 Shtatuer 1928).

Art. 3.

Kryeministrija përveç përsonelit të shenuem në kuadron e budgetit të vitit 1928-29, në mënyrë trasferimi, i shtohet dhe përsoneli i Zyrës së jetëshkrimit që ka ekzistuar deri sot prane Kshillit Kontrollues, Zyrë e cila me atë përsonel ketej e tutje do të funksionojë pranë Kryeministriës.

Art. 4.

Përveç shumës së rrogave dhe t'alokasionit të shenuem n'-Art. 2 të ketij Dekret-Ligji, budgetit 1928-1929 të Kryesis së Këshillit Ministruer i shtohet edhe nji fond prej 10.000 Fr. ari për « mobilje », e 700 Fr. ari për « veshtje e mbathje Sherbëtorësh » dhe 20.000 Fr. ari për shtypjen Kodeve të Shtetit.

Art. 5.

Ky Dekret-Ligjë hynë në fuqi prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 6.

Me zbatimin e ketij Dekret-Ligji ngarkohet Kryeministrija e Ministrija e Financavet.

Kryeministri e
Ministri i P. të Mbrendshme
K. Kotta

Ministri i P. të Jashtme
I. Vrioni

Ministri i Drejtësis
H. Delvina

Ministri i Arësimit
Xhafer Ypi

Ministri i Financavet
M. Tutulani

Ministri i P. Botore
S. Vuçiterni

Ministri Ekonomis Kombëtare
Musa Juka

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministriës Nr. 1548-I datë 5. XI. 1928.

Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer;

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi krijimin e Kryeministris.

Tiranë, me 12-XI-928

ZOG

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON:

Zbatimin e Dekret-Ligjit me datë 12-XI-1928, e aprovueme prej Parlamentit, dhe Urdhënon shtimin e tij në Kodet e Mbretnis si Ligjë.

Tiranë, me 14 Maj 1931

ZOG

Nr. 72

LIGJË, 14 Maj 1931

Mbi ndryshimin e pjesës së Instituteve Shkollore e bursavë të jashtme të Komandës së Mbrojtjes Kombëtare

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 32 datë 25 Maj 921)

Art. 1.

Në kuadrin e Komandes së Përgjithshme të Fuqis Armate ndryshohet pjesa qi i përket institutеve shkollore e bursave të jashtme, si mbas pasqyrës qi bashkangjitet kësaj Dekret-Ligjë, e në mënyren e posht-tregueme nder artikuj qi vijojnë:

Art. 2.

Krijohet Shkolla Mbretnore Ushtarake që me daten 1 Nanduer 1928, Shkolla e Artilaries që me 15 Tetuer 1928.

Pakësohet numuri i nxanësve të shkolles Aspirantave nga 200, nxanës në 125 që nga data 1 Nanduer 1928.

Naltësohet numuri i bursave të studentave ushtarake të Jashtme nga 27 nxanës në 81 që nga data 1 Tetuer 1928.

Gjimnazi ushtarak suprimohet fare që nga data 1 Nanduer 1928.

Art. 3.

Për me plotsue shpenzimet e ma tepërme qi rrjedhin nga ndryshimet e përmenduna n'art. 2 të kësaj Dekret Ligjë, transferohet në budgetin e Komandes së Përgjithshme të Fuqis Armate nji shumë prej Fr. ari 45,850, tuej e bartë prej Kap. 11 hesë kafshesh, e tuj ja mveshë kapitujve të posht-shenuem:

Ne kapitullin 5 Art. 3	Fr. ari	1000
» » 6 » »	»	19.150
» » 6 » »	»	25.700
	Shuma Fr. ari	45.850

Art. 4.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi që me datën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 5.

Me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë ngarkohet Trupi Ministruer.

Kryeministri e
Ministri i P. të Mbrendshme:
K. Kotta

Ministri i P. Jashtme
I. Vrioni

Ministri i Drejtësiës
H. Delvina

Ministri i Arësimit
Xhafer Ypi

Ministri i Financavet
M. Tutulani

Ministri i P. Botore
S. Vuçiterni

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Musa Juka

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1979 datë 22-XI-1928.

Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 17.XI.1928,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret Ligjit mbi ndryshimin e pjesës s'instituteve shkollore e bursave të jashtme që i përket budgetit të Komandes së P. të Fuqis Armate bashkë me pasqyren relative.

Tiranë, me 23 Nanduer 1928.

ZOG.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON

Zbatimin e Dekret-Ligjit me datë 28 Nanduer 1928, e aprovueme prej Parlamentit, dhe Urdhenon shtimin e tij në kodet e Mbretnies si Ligjë.

Tiranë, me 14 Maj 1931.

ZOG.

Nr. 73

RREGUELORE, 12 Maj 1931

Për zavendësimin e disa neneve të Rregullores datë 7 Fruer 1930, për zbatimin e Ligjit mbi Adminis. e Pasunis e Kontabilitetin e Shtetit

(Botue në Fletorem Zyrtare Nr. 32 datë 25 Maj 931)

Neni 1.

Deri me nji dispozitë të re, abrogohen nenet që prej 155 deri në 160 të Rregullores 7 Fruer 1930 mbi administrimin e paspunës e kontabilitetin e Shtetit.

Për llogaritjen e për pagesen e të mbrapa-mbetunave qi rrjedhin:

1) prej mandateve direkte (individual e kolektiv) qi kanë ngelun pa u pague deri me 31 Marsë të ç'do vjeti;

2) prej urdhen-pagesavet, të leshueme mbi çelje krediti, të ngeluna pa u pague deri me 31 Mars të ç'do vjeti; duhet të ndjeken dispozitat e neneve qi pasojnë.

Neni 2.

Mandatet direkte (individual e kolektiv) qi dalin te pa-pagu-

eme krejtësisht ose pjesërisht me 31 Mars të ç'do vjeti, paguhen gjatë vjetit qi të vinë, me shumat e te mbrapa-mbetunave.

Kurse këto tituje të paguhen krejtësisht, duhet të paraqiten me llogarina t'Arkës si mbas dispozitës së nenit 201 dhe llogariten, në shumën e tyne të përgjithshme, nder pagesat e pagueme në llogari të mbrapa-mbetunavet.

Neni 3.

Mbrenda 31 Marsit të ç'do vjeti, Drejtorinat e Nen-Drejtorinat e Financës kan me urdhenue lëshimin e urdhnave-pagese mbi mandatë per çelje krediti qi, i refrohen shpenzimeve rregullisht të dokumentueme, edhe kurse këto urdhen-pagesa nuk mund të paguhen për mungesë të hollash n'arkë.

Neni 4.

Urdhën-pagesat qi, me 31 Mars të ç'do vjeti, dalin të pa-pagueme krejtësisht ose pjesërisht, paguhen gjatë ushtrimit qi vjen me shumat e të mbrapa-mbetunavet.

Kuerse këto tituj të jenë pague krejtësisht, duhet të paraqiten nder llogarina t'arkës sikurse mbas dispozitës së nenit 201 dhe llogariten, për shumën e tyne të pergjithshme, nder pagesa të bame ne llogari të mbrapa-mbetunavet.

Neni. 5.

Të mbrapambetunat qi duhet të dalin nga Zyrat kontable të Ministrinavet në llogarinë konsumtive prebahen, posë shumavet qi cakton neni 154 i Rregullores:

1) prej shumës së përgjithshme të mandatevet direkte (individual e kolektiv) qi me 31 Mars dalin të pa pagueme;

2) prej shumës së përgjithshme t'urdhen-pagesavet mbi mandatë për celje krediti, të cilët nuk janë pague gjatë ushtrimit të mbaruem. Këjo shumë e përgjithëshme del prej diferencës në mes t'urdhunave-pagese të leshuem mbi seicilin mandat per çelje krediti, të cillat shifen (rilevohen) nga përmbledhja e llogarivet që përmendë neni 138, dhe t'urdhunave-pagese, të cillat dalin nga listat qi përmendë neni 204.

Diferenca në mes të shumës së përgjithëshme të mandateve per çelje krediti dhe t'urdhunave-pagese të lëshuem, duhet të mbahet (konsiderohet) si nji ekonomi.

Kryeministri e M. P. Mbrendshme
K. Kotta

Ministri i P. Jashtme
I. Vrioni

Ministri i Drejtësis
H. Delvina

Ministri i Arsimit
Xhafer Ypi

Ministri i Financavet
M. Tululani

Ministri i P. Botore
S. Vuçiterni

Ministri i Ekonomis Kombtare
Musa Juka

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresen Nr. 346-III datë 27-IV-1931, të Kryeministris,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Regullores për zavendësimin e disa neneve të Rregullores me datë 7 Fruer 1931, për zbatimin e Ligjit mbi Administratimin e Pasunies e të Kontabilitetit të Shtetit.

Tiranë, me 12 Maj 1931

ZOG.

Nr. 74

LIGJË, 14 Maj 1931

Mbi transferimin e një kredije prej fr. ari 8080 në budgetin 1928-929 të Komandës së P. të Fuqive Armate

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 32 datë 25 Maj 1931)

Art. 1.

Për të përballue rrogat e përsonelit të Bandës Mbretnore qysh prej 1 Korrik deri në fund të Tetorit 928, si mbas kuadros së bashkangjitun, autorizohet Ministrija e Financavet me trasferue nji shumë prej 8080 Fr. ari, nga Kapitulli 39 të budgetit 928-29,

BKSH

të Komandes së P. të Fuqis Armate, në Kap. 1 Art. 3 po t'atij budgeti.

Art. 2.

Ky Dekret-Ligjë hynë në fuqi qysh prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e ketij Dekret-Ligji.

Kryeministri e
Ministri i P. të Mbrendshme
K. Kotta

Ministri i P. të Jashtme
I. Vrioni

Ministri i Drejtësis
H. Delvina

Ministri i Arësimit
Xhafer Ypi

Ministri i Financavet
M. Tutulani

Ministri i P. Botore
S. Vuçiterni

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Musa Juka

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministriës Nr. 1746 datë 31-X-1928.

Si ndigjojë dhe pelqejë Vendimin e Këshillit Ministruer me datë 30-X-1928,

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi transferimin e nji krediti prej 8080 Fr. ari, në budgetin 1928-29, të Komandës së P. të Fuqis Armate.

Tiranë, me 3-XI-928

ZOG.

BKSH

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON

Zbatimin e Dekret-Ligjit me datë 3-XI-1928, t'aprovueme prej Parlamentit, dhe Urdhenon shtimin e tij në Kodet e Mbretniës si Ligje.

Tiranë, më 14 Maj 1931.

ZOG.

Nr. 75

LIGJË, 14 Maj 1931

Mbi bartjen e një fondi prej fr. ari 3860 në budgetin e ushtrimit 1928-1929 të M. së Financavet

(Botue në Fletosen Zyrtare Nr, 32 datë 25 Maj 931)

Art. 1.

Mbahen për sherbim për muejin Qershuer, Korrik, Gusht, Shtatuer, 1928, Nëpunesat e Banderollit të duhanit qi mbas Budgetit të ushtrimit 1928-1929, kanë mbetë jashtë kuadrit.

Nëpunsat për t'u mbajtë në shërbim janë:

Nëpun.	të Klasit	Ire,	3 a	Fr.	ari	200.—	600.
»	»	IItë,	5 a	»	»	160.—	800.
»	»	IIItë,	7 a	»	»	120.—	840.
Kryerojtës			1 a	»	»	150.—	150.
Rojtar			15 a	»	»	100.—	1500.

Art. 2.

Për t'i u ba ballë pagesës së rrogavet katër muajvet të përmendun bartet nji fondë prej Fr. ari 8360 (tetmijtreqindegjashtëdhetë) mbrenda ushtrimit 1928-29, të Ministriës së Financavet prej Kap. 34 «Rroge» në Kap. 46 «Banderoll».

Art. 3.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi me ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë ngarkohet Ministrija e Financavet.

Ministri i Drejtësiës e
Zv. Ministri i Arsimit
H. Delvina

Ministri i P. të Mbrendëshme e
Zav. Ministri i P. Jatshme:
K. Kotta

Ministri i Financavet
M. Tutulani

Ministri i P. Botore
S. Vuçiterni

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Musa Juka

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqit Sovrane të Shtetit.

Mbi proponimin e Ministriës së Financave;

Mbasi u ndigjue e u pelqye Vendimi i Këshillit Ministruer me datë 16-VIII-928.

DEKRETON

Zbatimin e Dekret-Ligjit mbi bartjen e nji fondi prej Fr. ari 3860 nga Kap. 34 «Rrogë» në Kap. 46 «Banderoll» t'ushtrimit Financiar 1928-929, të Budgetit të Ministriës së Financavet.

Tiranë, me 21 Gusht 1928.

ZOG.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve
DEKRETON

Zbatimin e Dekret-Ligjit me datë 21 Gusht 1928, t'aprovueme prej Parlamentit, dhe Urdhënon shtimin e tij në Kodet e Mbretniës si Ligjë.

Tiranë, me 14 Maj 1931

ZOG.

Nr. 76

LIGJË, 14 Maj 1931

Mbi të vuemit dorë në tokat Shtetnore të grabituna prej privatëve

(Botue në Fletorcn Zyrtare Nr. 33 datë 29 Maj 931)

Neni 1.

Ministrija e Financavet për me zbulue tokat e grabituna të Shtetit prej privateve, dhe per me i vue në dorë autorizoahet me formue nji komision hetues në mënyren e posht shenueme:

Prej nji kryetari i cilli të jetë person i provuem në karieren e Drejtësies, dhe prej dy antarëve prej të cileve nji të jetë Agronom dhe tjetri të ketë qenë Nepunës i Kadastres.

Për emnimin e Kryetarit propozimi bahet nga ana e Ministris së Drejtësis në marrë-veshtje me Ministrin e Financavet. Anëtari Agronom propozohet prej Ministris së Ekonomiës Kombëtare, dhe tjetri prej Ministris së Financavet.

Neni 2.

Ministrija e Financavet, para se të fillojë hetimet e nevojshme per me zbulue tokat e grabituna me anen e Komisionit të siper permëndun, detyrohet me ba nji shpallje me anen e Komuneve dhe, në gjithë gazetat e vendit të gjithë Mbretnin Shqiptare. tue thanë se, grabitësit në qoftë se çe prej datës së kësaj shpalljeje mbrenda në nji mueji nuk tregojnë dhe nuk ja këthejne Shtetit tokat e grabituna me hirin e tyne, kanë me u ndjekë penalisht si grabitës, dhe në qoftë qi grabitësit me hirin e tyne i dorëzojnë financës tokat e grabituna, falen nga ndeshkimet penale dhe nga qira e tokës.

Neni 3.

Komisioni i siper-permendun tue pasë në dorë rregjistrat respektive të kadastres, të pasunis së Shtetit dhe, gjithë dokumen-

BKSH

tat provuese të tokave në fjalë, ka me shkue në vende dhe ne praninë e Pleqësies së katundit ka me aplikue kufijt e tregueme në rregjistra ose në dokumenta të tjera në vende mbi tokë.

Komisioni për me ba hetimet e duhuna detyrohet me thirrë t'interesuemit, gjysmateret ose tretaret ose qesimtarët qi i kanë punue ato toka qyshë me kohë, personat e tjerë prej atij katundi ose prej katundeve fqij, me i lyp dhe në raste qi konstaton se ka grabitje, ka me kerkue prej t'interesuemve në asht se kanë dokumenta të ligjëshme; Gjithashtu mjetet provuese dhe në bazë të këtij hetimi ka me redaktue nji proces verbal në të cillin do të rrjeshtojë menyrën e grabitjes, kohen, provat prej të cillave rezulton grabitja, sasinë e tokës së grabitun dhe kufijt e shdukun; këtij proces-verbali ka me i ngjitë edhe nji kroqi (haritë), të përpilueme prej Agronomit.

Neni 4.

Ministrija e Financavet me anen e perfaqësuesvet ligjuer të sajë, në baza të këtij proces-verbali ka me ngreh gjyqe në gjykatoren kompetente të qarkut ku ndodhet prona Shtetnore.

Neni. 5.

Gjykatorja ç'prej ditës së kerkeses mbi padinë e sipër-tregueme detyrohet t'a preferoje nga çdo padie tjetër dhe të japë sa ma shpejtë vendimin definitiv mbi çeshtjen.

Në raste se konstatohet qi vonesa mbi perfundimin e padiës ka rrjedhun prej neglizhences së gjykatores, aplikohen kundra gjykates masat disiplinore deri në pushim.

Neni 6.

Kohet e kalueme që nga 28 Nanduer 1912 e deri në mbarim të vitit 1924, nderpresin parashkrimin për çka i perket tokave Shtetnore; gjith-ashtu parashkrimet e pretendueme para 28 Nanduer 1912, pa mos me qenë të bazueme mbi trashigim, cedim, nga ana e Shtetit, ose mbi shit-blemje me titull zotënimi, nuk merren parasyshë për ketë.

Neni 7.

Gjithë dispozitat e Ligjëve tjera që vijnë në kundershtim me ketë Ligjë, mbeten pa fuqi qysh prej datës së hymjes në fuqi të kësaj Ligje.

Neni 8.

Ministrija e Financavet passi të marrë fund definitivisht e vuemja në dorë e tokave Shtetnore të grabituna, detyrohet me

propozue me nji Projekt-Ligje abrogimin e kësaj Ligje transitore.

Neni 9.

Kjo Dekret-Ligje hynë në fuqi 15 ditë mbas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 10.

Ministrija e Financavet, Ministrija e P. Mbrendshme, dhe ajo e Drejtësies dhe e Ekonomiës Kombëtare ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli

Ministri i P. të Jashtme e
Zv. Ministri i P. Mbrendshme:
R. Fico

Ministri i Arsimit e
Zav. Ministri Financavet:
H. Mosi

Ministri i Punëvet Botore:
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombëtare:
e Zv. Ministri i Drejtësis:
Mehdi Frashëri

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 723-I d. 7.-VIII-1930,

Si ndigjojë dhe pelqejë Vendimin e Këshillit Ministruer me datë 2-VIII-1930.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi të vuemit dorë në tokat Shtetnore të prevetueme prej privatesh.

Durrës, më 26 Shtatuer 1930.

ZOG.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve
DEKRETON

Zbatimin e Dekret-Ligjit me datë 26 Shtatuer 1930, t'aprovu-

eme prej Parlamentit, dhe urdhnon shtimin e tij në Kodet e nis si Ligjë.

Tiranë, më 14 Maj 1931,

ZOG.

Nr. 77

LIGJË, 14 Maj 1931

Mbi transferimet e fondeve nga fondi rezervë me vendim të Këshillit Ministruer

(Botue në Flotoren Zyrtare Nr. 34 datë 3 Qershor 931)

Art. 1.

Deri sa të hyjë në fuqi ligja mbi Administrimin e Pasuniës e mbi kontabilitetin e Përgjithëshem të Shtetit, transferimet e fondeve nga fondi rezerve nder kapituj të tjerë të budgetit t'ushtrimit 1929-1930, bahen me vendim të Këshillit Ministruer.

Art. 2.

Këjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi për veprimet që me 1 Prill 1929.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë, ngarkohet Trupi Ministruer.

Kryeministri e
Ministri i P. të Mbrendshme
K. Kotta

Ministri i Drejtësis
H. Delvina

Ministri i P. të Jashtme
R. Fico

Ministri i Arësimit
A. Dibra

Ministri i Financavet
M. Tutulani

Ministri i P. Botore
S. Vuçiterni

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Musa Juka

BKSH

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministriës Nr. 1536 datë 30-X-1930 Si ndigjojë dhe pelqejë Vendimin e Këshillit Ministruer me datë 28-V-1929.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret Ligjit mbi autorizimin deri sa të hyjë në fuqi ligja mbi Administrimin e Pasuniës dhe mbi Kontabilitetin e Përgjithshmen të Shtetit, transferimet e fondeve nga fondi rezervë bahen me Vendim të Këshillit Ministruer.

Tirnë, me 13 Qershuer 1929

ZOG.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON

Zbatimin e Dekret-Ligjit me datë 13 Qershuer 1929, t'aprovueme prej Parlamentit, dhe Urdhenon shtimin e tij në Kodet e Mbretniës si Ligjë.

Tiranë, me 14 Maj 1931

ZOG.

Nr. 78

LIGJE, 30 Maj 1931

Mbi syprimimin i titullit të Prefektit të Kryeqytetit

(Botue në Fletoren *Zyrtare* Nr. 35 datë 6 Qershor 1931)

Neni 1.

Kryesija e Bashkis së Kryeqytetit me titull «Prefekti i Kryeqytetit», suprimohet.

Neni 2.

Prefekt' i Administratës në Tiranë ushtron edhe gjithë detyrat e kompetencat e Prefektit të Kryeqytetit të caktueme në ligjin mbi Bashkinë e Kryeqytetit, i jepet vetem nji alokasion mujor 200 Fr. ari nga Arka e Bashkis së Kryeqytetit.

Neni 3.

Art. 1, i ligjës mbi Bashkine e Kryeqytetit, per sa i perket titullit «Prefekt i Kryeqytetit» edhe ç'do dispozitë në kundershtim me kete Dekret Ligjë, anullohet.

Neni 4.

Ky Dekret-Ligjë hynë në fuqi që prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni. 5.

Ministrija e P. të Mbrendshme dhe Ministrija e Financavet ngarkohen me zbatimin e ketij Dekret-Ligji.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i P. të Jashtme
e Zav. Ministri i P. Mbrendshme
R. Fico

Ministri i Drejtësis
V. Avrami

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
K. Thaçi

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1450-1 datë 27-V-1930 si ndigjojë dhe pelqejë vendimi n e Këshillit Ministruer me datë 24-V-1930.

DEKRETON:

Aprovimi dhe Zbatim e Dekret-Ligjit mbi disa ndryshme në Ligjin Organike të M. P. Mbrendeshme dhe të Bashkis Kryeqytetit.

Tiranë, me 30 Maj 1931.

ZOG.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve
DEKRETON

Zbatimin e Dekret-Ligjës me datë 31 Maj 1930, t'aprovueme

prej Parlamentit, dhe Urdhenon shtimin e tij në kodet e Mbretënis si Ligjë.

Tiranë, me 30 Maj 1931

ZOG.

Nr. 79

RREGULLORE, 2 Qershor 1931.

Mbi zbatimin e ligjës mbi ndalimin e përdorimit të grizës për bukë

(Botue në Fletoren Zyrtare Fr. 36 datë 11 Qershor 1931)

Art. 1.

Janë të detyrueme të gjith zyrat doganore me i njoftue Ministriës s'Ekonomis Kombetare krye çdo jave emnat e importuesavet të grizës si dhe sasin, e grizës s'importueme prej tyne veçanërisht.

Art. 2.

Janë të detyruem të gjithë importuesat e grizes me i njoftue Ministries, Ekonomis Kombëtare sasin e grizes që kanë importue dhe emnat e atyneve që eventualisht u a kanë shitun bashkë me sasinat përkatëse.

Njoftimi do të bahet mbrenda javës mbas importimit ose mbas shitjes, si mbas rastit.

Art. 3.

Të gjithe importuesat e grizes janë të detyruem me mbajtun nji rregjistër posaçërisht për grizen e importueme, në të cilën do të marrin në shënim sasinat e grizës s'importueme dhe të shitun, veç këtyneve rregjistri dotë përmbajë edhe gjith datat e tjera që janë të nevojshme per me provue importimin edhe shitjen e sasis së grizes.

Fletet e rregjistrit duhet të jenë të numrueme dhe numri i tyne i legalizuem prej Kryetarit e Sekretarit dhe N.Kryetarit të Odës Ekonomis së vendit, dhe në mungesë të kësaj prej gjykatores.

Në rregjistrimin dituer të hyrjevet dhe të të dalunavet nuk do do të lihen pjesë të bardha të faqeve dhe, nuk do të ketë shenja shlymjeje shifrash. Në rast se konstatohen të ketilla, këto formojnë presumim dheli (dolus), dhe fajtoret denohen si mbas ligjëve në fuqi, gjithashtu dhe furtaret detyrohen me mbajtë rregjistra në konformitet me rregullat e caktueme në ketë nen.

Art. 4.

Tregtarët që kanë ble grizë prej importuesavet me qellim për me shitun perseri duhet të mbajnë nji rregjister të posaçme, në të cilin do të marrin shenim sasinat e grizës së bleme dhe të shitun.

Për përmbajtjen e ketij rregjistri do të veprohet pikërisht si mbas porosive të përmenduna në nenin 4.

Art. 5.

Importuesat dhe tregtarët e grizës nuk do t'i shesin kurkujt grizë veçse atyneve që do t'e paraqesin nji dishmi të leshueme prej Odave t'Ekonomis, e në mungesë të këtyneve, prej Prefektuarve ose Nenprefekturave, dhe prej Ministries s'Ekonomis Kombëtare. Dishmitë kësodore do të leshohen vetem per sasina të caktueme. Odat e Ekonomis ose Prefekturat dhe Nenprefekturat mund të leshojnë dishmi kësodore per nji sasi jo ma të naltë se, 100 kg. Për sasina ma të nalta se kjo, dishmitë leshohen prej Drejtorisë së Tregtis në Ministrin e Ekonomis Kombëtare.

Dishmiët leshohen dy llojsh:

1) Dishmi qi lejon t'interesuemin me ble grizë me qëllim shitjeje.

2) Dishmi qi lejon t'interesuemin me qellim konsumi.

Art. 6.

Autoritetet e përmenduna në Nenin 5 të kësaj Rregulloreje nuk do t'i lëshojnë kërkujtë dishmi per me ble grizë, përpa u sigurue se keta do t'a shesin perseri, si mbas dispozitave të kësaj Rregullorje ose nuk do t'a perdorin per me e ba buhë.

Art. 7.

Fabrikantat e makaronave dhe të biskotave qi përdorin grizë për fabrikimin e makaronave dhe të biskotave, detyrohen me marrë prej Drejtoris se Tregtis në Ministrin e Ekonomis Kombëtare, kry ç'do tre muejve, nji leje per sasinë e grizës qi kanë me ble, tue tregue sasinë e makaronave ose të biskotave qi kanë me fabrikue mbrenda kësaj periudhe, dhe tue respektue proporsionin e mjellit, dhe të grizës qi ka për t'u caktue prej Ministries s'-Ekonomis Kombëtare.

Art. 8.

Fabrikatorët e makaronave dhe të biskotave detyrohen me mbajtë nji radhuer të ditës, ku kanë me shenue të hymet e mjellit

dhe të grizës dhe të dalunat e produkteve të fabrikuem me këto landë.

Radhoj do të permbajë të gjitha shenimet të cilët janë të nevojshem per me provue sasinë e grizit e të mjellit të blemë dhe sasinë e makaronave ose të biskotave të shituna.

Në mbajtjen e radhojt do të veprohet pikërisht si mbas porosive të përmenduna në Nenin 4.

Art. 9.

Tregtarët qi importojnë dhe shesin grize si dhe fabrikatoret qi blejnë grize dhe shesin makarona ose biskota, detyrohen me marrë dhe me ruejtë të gjitha diftesat e shit-blemjevet të tyne si të grizës ashtu edhe të makaronave ose të biskotave.

Art. 10.

Në rast qi Ministrija e Ekonomis Kombëtare ose i deleguemi i sajë konstaton se, nga shifrat e marruna prej sajë me ato të inskriptueme nepër radhojt e tregtareve qi shesin ose blejnë grizë dhe të fabrikatorve qi blejnë grizë dhe shesin makarona ose biskota del nji diferencë, e cila presumon përdorimin e grizës per qëllime të tjera, aplikohen penalitetet e parapame në Nenin 3 të Ligjës mbi ndalimin e përdorimit të grizës për bukë.

Art. 11.

Furrtarët, fabrikatorët dhe tregtarët mbrenda 5 ditëve mbas ç'palljes së kësaj Rregullorje në Fletoren Zyrtare, detyrohen me i njoftue Ministris, s' Ekonomis Kombëtare ose Odave t' Ekonomis sasinë e grizit qi kanë në depozitë, tue dallue pjesën qi kanë pasë importue ose ble para d. 13 Prill 1931.

Art. 12.

Bashkitë, Komunat, Prefekturat dhe Nënprefekturat janë të ngarkueme me kontrollimin e furave qi të mos pjekin ose mos të gatujnë bukë me miellë grizi, dhe në rast ndryshimi me i dergue Ministris s' Ekonomis Kombëtare nji copë bukë për analizim.

Kryeministri e
Zv. Min. Ek. Kombtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. Jashtme
H. Vrioni

Ministri i P. Mbrendshme
M. Juka

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministries Nr. 74-IX datë 28-V-1931

Si ndigjojë dhe pelqejë Vendimin e Këshillit Ministruer me d. 25-V-31

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Rregullores mbi zbatimin e Ligjës për ndalimin e përdorimit të grizës per bukë.

Tiranë, me 2 Qershuer 1931

ZOG.

Nr. 80

RERGULLORE, 1 Qershor 1931

E Mbrendëshme e Këshillit Kontrolluës

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 37 datë 15 Qershor 1931)

KAPTINA I.

Sherbimet e Këshillit

Art. 1.

Sherbimet e Këshillit Kontrollues përbahen prej:

Seksionit A, Seksionit B, Prokuroris dhe Sekretaris.

Art. 2.

Sekcioni A i përket revizioni dhe Kontrollimi i akteve të Ministries së Financavet, Ministris së P. të Jashtme, Ministries Drejtësi, Ministris Arësimit, Ministris P. Mbrendëshme, dhe Komandës së P. Gjindarmeris.

Seksioni B, i përket revizioni dhe kontrollimi i akteve të Ministris P. Botore, Ministris Ekonomis Kombëtare, Komandës së Mbrojtjes Kombtare dhe Huas Publike.

Revizioni dhe kontrollimi i llogarive giudiziale të paraqitu-

na prej agjentave që kanë në perdorim ose në dorzim te holla dhe gjana me vleftë të Shtetit si dhe revizioni dhe regjistrimi i dorzanive relative të tyne, bahen prej seksionit kompetente, i cili asht ngarkue me revizionin dhe kontrollimin e akteve të Dikasterit prej të cilit mvaren agjentat në fjalë.

Kompetenca e secilit Seksion si mbas nevojavet të sherbimit mund të modifikohet me autorizim të Kryetarit pasi të jetë marrë dhe mendimi i Këshillit.

Art. 3.

Secili Seksion me Referendarët, Krontrollorët dhe ndihmes Kontrollorët përkatës asht nen-drejtimin e nji Antari me cilësi Drejtori i Seksionit.

Art. 4.

Prokuroris i përket ndjekja e çeshtjeve dhe e akteve për të cilat si mbas Ligjës duhet të çfaqë mendimin.

Shenim: Me fjalën ligjë që përmendet në kete Rregullore kuptohet ligji i Këshillit Kontrollues.

Art. 5.

Sekretaris i përket rregullimi i akteve të Korispondencës dhe mbi shikimi i Protokolit, Archivit dhe Kopistëries.

KAPTINA II.

Personeli dhe Detyrat e tij

Art. 6.

Personeli i Këshillit ndahet me dy kategorië:

Kategorija e Irë e perbame prej Magjistraturës me prerogativat e caktueme në nenin 2 të Ligjës përfshinë: Kryetarin, Antarët dhe Prokurorin. Kategorija e II të përfshin personalin e Zyrave d.m.th. Referendarët, Kontrollorët, Llogaritarët Kryesekretarin, Sekretarin e Protokollit — Archivistin dhe Kopistin të cillët emnohen, gradohen dhe pushohen si mbas Ligjës për nëpunsat e tjerë të Shtetit.

Art. 7.

Kryetari ka për detyrë të rregullojë dhe të survejojë sherbimet e ndryshme të Këshillit dhe veçanërisht:

a) Te mbledhë dhe të kryesoj mbledhjen e Këshillit për të shqyrtue çashtjet për të cilat si mbas ligjes lypet vendimi kolegjial, dhe kurdoherë që si mbas gjykimit të tij e shef t'arsyeshme;

b) Të nënshkruej korispondencën me Kryesin e Këshillit Mi-

nistruer dhe me dikasteret dhe administratat e ndryshme të Shtetit, qarkoret për intepretimet dhe zbatimin ekzakt të Ligjevet dhe Rregullorevet me qellim Administrativ kontabel; vistimin e madateve të pagesës dhe deklaratat të konformitetit mbi llogariet e paraqituna prej funksjonarëve:

c) Të caktojë formën e rregjistrimeve dhe të rregjistrave që kanë me u mbajtë prej Këshillit për të ushtrue detyren e kontrollit në marreveshtje me antarët drejtues të Seksioneve;

ç) Të aprovojë instruksionet e sherbimeve dhe në rastë nevoje t'u ngarkojë Seksionevet dhe sherbime të cillat nuk janë në kompetencën normale të tyne.

d) Të caktojë të damit e nepunsave ndermjet Zyrave të ndryshme dhe, në rastë nevoje të caktojë Antarët drejtues të Seksionëve.

dh) Të proponojë emnimet gradimet dhe pushimet të nëpunsavet të marrij masa disiplinore kundrejt tyne; të japë leje mbrenda kufive të Ligjave në veprim si për gjithë nëpunsat e Shtetit, dhe të caktojë zavendsat e nëpunsave qi mungojnë provizorisht.

e) Të disponojë rregullimin e ç'do sherbimi ose çashtjes tjatër qi u parashikohet në ketë rregullore.

Art. 8.

Antarët marrin pjesë në mbledhjet kolegjiale të Këshillit dhe si drejtues të Seksionit nën përgjegjesin e tyne kanë për detyrë:

a) Të kujdesohen për mirë-sherbimet e Seksionit me drejtimin e të cillës janë ngarkue tue drejtue dhe udhëheqë nëpunsat qi mvaren prej tyne.

b) Të caktojnë sherbimet e Referendarve, Kontrollorave dhe ndihmës Kontrollorave të Seksionit dhe të survejojnë rregullisht veprimet e tyne.

c) Të nënshkruejnë aktet si flet përcjellëset dhe flet-qortimet që kanë për qëllim plotsimin e të metavet, gabimeve, skjarimin e dyshimeve mbi mandat-pagesat të lëshueme dhe mbi llogarit e paraqituna prej funksionarëve për kontrollim. Në rast plotsimi aktet ndjekin rrugen normale dhe, në raste të kundertë çashtja i referohet Kryetarit për zgjedhje ligjore.

ç) Të s[illegible]tojë të metat e relevueme prej Referendarve në kontrollimin e llogarive tue shtri kontrollimin dhe n'ato pjesë

që shofin vetë t'arsyeshme dhe i parashtrojnë Kryetarit relacionet e Referendarve mbi llogariet e kontrollueme.

d) Të kontrollojnë korispondecën e pregatitun prej Referendareve dhe nëpunësave të tjerë të Seksionit të vetë.

dh) Të revizojnë konsumtivin e administratave që i përkasin Seksionit të tyne.

e) Të proponojnë me shkresë ose verbalisht modifikimet eventuale për semplifikimin e sherbimeve të Seksionit qi drejtojnë, dhe të lajmerojnë Kryetarin kuer-doherë që rivelojnë ç'rregullime në sherbimet qi survejojnë, dhe të provokojë masat e nevojsh me të përmirësimit.

f) Të kontrollojnë respektimin e orarit dhe vazhdimin në detyrë të përsonelit qi drejtojnë.

g) Të çfaqin mendimin e tyne mbi të gjitha aktet dhe llogarit e Administratave Shtetnore të ndryshme që u referohen prej Kryetarit për studim të veçantë.

Art. 9.

Antarët si drejtuesa të Seksionit në rastë mungese provizore zavendosohen në sherbimet e tyne prej nji Referendarit të zgjedhun prej Kryetarit mbi proponimin e tyne.

Art. 10.

Referendarët me ndihmen e kontrollorave dhe ndihmës kontrollorave që u janë caktue, kanë për detyrë nën përgjegjësinë e tyne të kontrollojnë zi mbas ligjave dhe Rregulloreve në veprim të gjitha aktet dhe llogarit e Administratave të ndryshme qi i përkasin Seksionit ku sherbejnë dhe veçanërisht :

a) Të bajnë revizionin e imtë të llogarive të të ardhunave dhe të përmbledhësave të tyne, të cillat si mbas dispozitave të ligjës së kontabilitetit të Përgjithshëm dhe të Pasunis Shtetit duhet t'i paraqiten Këshillit Kontrolluës.

b) Të kontrollojnë gjithë mandatat e pagesave në lidhje me Ligjen e budgetit dhe me legalitetin dhe legjitimitetin e shpenzimit.

c) Të kontrollojnë llogaritë dhe aktet mbi shpenzimet e bame me urdhëna për pagesë mbi çelje krediti të paraqituna prej funksionarëvet të deleguem.

ç) Të rikqyrin llogarin konsumtive të sejcillës Ministri dhe Administratë.

đ) Të shqyrtojnë llogarite gjudicjale të axhentave kontabel qi

kanë në përdorim të holla ose materjale të Shtetit të kontrollojnë dhe të regjistrojnë dorëzanit relative të tyne.

dh) Të pregatisin dhe t'i paraqitin me anën e Antarit drejtues relasionet mbi llogarit e kontrollueme prej tyne.

e) Të pregadisin korispondecën relative me veprimet kontabel të Seksionit.

f) Të mbajnë eviduencën e regjistrasioneve të nevojshme mbi t'ardhunat e vërtetueme dhe nxjerrjet e bame në bazë të llogarive përmbledhëse, dhe mbi shpenzimet si mbas kapitujve të Budgetit, si edhe mbi gestionin e llogarive të funksionarëve të deleguem.

g) Të kryejnë çdo sherbim tjatër qi u ngarkohet prej superiorëve.

Referendarët janë bashkë përgjegjës me kontrollorët dhe me ndihmës kontrollorët dhe, janë të detyruar të revizojnë plotësisht ose pjesërisht kontrollimet e kryeme prej tyne.

Art. 11.

Kontrollorët dhe ndihmes kontrollorët kanë për detyrë me ndihmue Referendarët në detyrat e tyne si mbas instruksioneve të marruna prej Referendareve dhe prej drejtuesit të Seksionit dhe janë përgjegjës për veprimet e kryeme prej tyne.

Art. 12.

Prokurori mer pjesë në të gjitha mbledhjet kolegjiale të Këshillit dhe ushtron detyrat qi i janë ngarkue prej ligjës në lidhje me funksionet kontenzioze të ngarkueme Këshillit si mbas Kap. IV dhe V të Ligjës, dhe asht i detyruem të referoj me shkresë përmbi çeshtjet për të cilat asht i detyruem me dhanë mendimin e tij.

Për të ushtrue detyrat e tij, Prokurorit duhet të i komunikohen të gjitha aktet qi kanë lidhje me çeshtjen në kontestim dhe ka për detyrë të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit, ku diskutohen kontestime dhe diferenca me llogaritarët dhe funksionarët e Shtetit.

Art. 13.

Prokurori ka për detyrë të ndjekë që Administratat e ndryshme të zbatojnë vendimet e dhanuna prej Këshillit Kontrollues në çeshtjet kontensioze dhe veçanërisht të mbi keqyrë që të jenë derdhë shumat qi i përkasin:

a) Detyrimeve të vertetueme në ngarkim të axhentave kontable si mbas neneve 23, dhe 27, të Ligjës.

b) Dameve dhe gjobave në të holla të vueme në ngarkim të funksionarëve si mbas nenit 31 të Ligjës.

Gjithashtu Prokurori i referon Ministris Drejtësiës aktet qi përmbajnë shperdorime, fallsifikime ose ç'do krim tjeter po t'asaj natyre të rilevueme në kontrollimin e llogarive të bame prej Këshillit., tue lajmërue dhe Ministrinë Kompetente prej të cillës mvaret nëpunësi për të ba ndjekjet penale si mbas nenit 29 të Ligjës.

Art. 14.

Kryetari ka të drejtë me i ngarkue Prokurorit kuer detyrat e Zyrës se tij e lejojnë, shqyrtimin e çeshtjeve me randesi të veçante e që nuk janë në kompetencen e veçantë të ndonji Seksionit.

Përjashtohen ato çeshtje për të cilat Prokurori asht i detyruem me ç' faqë gjykimin e tij në lidhje me atribucionet e tij.

Në rastë mungese ose ndonji dalimi Prokurori zavendsohet prej nji Referendari të shenuem prej Kryetarit.

Referendari duhet të jetë prej nji Seksioni ki nuk ka lidhje me çeshtjen në bisedim.

Art. 15.

Kryesekretari i Këshillit ka për detyrë:

a) Të survejojë veprimet e personelit qi mvaret prej Sekretariës dhe, të kujdesohet për nxjerrjen me kohë të akteve të Korispondencës.

b) Të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit tue mbajtë shenime mbi çashtjet në diskutim dhe mbi vendimet e marruna, të cilat i rregjistron në rregjistrin e posaçme të vendimeve.

c) Të vejë në zbatim urdhnat e Kryetarit prej të cillit mvaret.

ç) Verteton kopjet konformë të vendimeve dhe akteve të ndryshme.

d) Mbi shikon pastrimin e Zyrave dhe veprimet e personelit sherbyes.

dh) Ushtron detyren e Ekonomatit për blemjen e landës të nevojshme të shkrimit, mobiljave, rregjistrave, shtypshkrimeve dhe, kujdeset për mbledhjen e ligjave dhe Regulloreve dhe për mirëmbajtjen e bibliotekës tue, mbajtë dhe inventarët pëskatës.

e) Kujdeset për mbledhjen e vendimeve dhe të akteve relative për rregjistrimet e bame me rezervë.

Art. 16.

Sekretar-llogaritari ka për detyrë të ndihmojë Kryesekretarin në detyrat e tij dhe të sherbejë pranë Seksioneve për të krye sherbime llogaritari, që mund t'i ngarkohen dhe të mbajë n'evidencë rregjistrin e biografies të nëpunsave të Këshillit.

Art. 17.

Protokolist - Archivisti ka për detyrë të mbajë n'evidencë dhe të protokolojë aktet e hyeme dhe të daluna si dhe të kujdesohet për mirëmbajtjen e Archivit të Këshillit. Kopisti merret me kopjimin e akteve dhe nxjerrjen e shpejtë të tyne.

Art. 18.

Personeli i Sekretariës asht i detyruem të sherbejë në cillsin e vetë dhe per veprimet e Prokuroris.

Art. 19.

Gjith nëpunëst e Këshillit detyrohen të respektojnë orarin Zyrtar, dhe të kryejnë detyrat e tyne mbrenda ligjave dhe Rregulloreve në veprim dhe, nuk munden të largohen nga Zyra as për një kohë të shkurtër pa marrë lejën e Kryetarit të vetë ma t'aferm gjithashtu detyrohen të respektojnë msheftësin e akteve, të sillen mirê dhe në armoni me shoqi shokin dhe të mbajnë respektin dhe bindjen kundrejt superiorëve të tyne.

Art. 20.

Me urdhen të Kryetarit per t'u dhanë kur shfaqet nevoja personali ç'do kategorjë asht i detyruemun me punue edhe jashtë orarit Zyrtar pa ndonji shperblim të veçantë, dhe me krye ç'do sherbim qe i u ngarkohet prej Kryetarit.

KAPTINA E III.

Atríbusionet Kologjiale të Këshillit

Art. 21.

Këshilli Kolegjal perbahet prej personelit të Magjistratures dhe prej Referendarit relator.

Art. 22.

Atribusjonet e Këshillit per të cillat si mbas Ligjes asht e nevojshme vendimi Kolegjial janë:

a) Komunikatat që duhet t'ju bahen Ministrive-Kompetente për mos respektimin e Ligjave dhe Rregulloreve administrativ,

kontabile të rilevueme n'ushtrimin e detyrave të tji dhe të propozimeve të nevojshme për ndalimin e tyne. (Art. 7 i Ligjës).

b) Raporti informativ që duhet t'i paraqitet N.M. Tij Mbretit mbi mënyrën e ushtrimit të gjestionit buxhetur të Shtetit (Art. 8 i Ligjës).

c) Refuzimi i rregjisrimit të akteve të pa rregullta që përmenden në nenin 9 të ligjës dhe rregjistrimi i tyne me reservë (Art. 11 i ligjës)

ç) Vendimet për anulimin e titujve të shpenzimit qi shkapërcen shumen e buxhetit ose nuk i përshtaten rregullisht kapitujve (Art. 12 i ligjës).

d) Raporti qi duhet t'i parashtrohet Parlamentit si mbas Art. 116 e 155 të Statutit (Art. 18 i Ligjes).

dh) Aprovimi i buxhetit Konsumtiv dhe vendimin relativ (Art. 19 i ligjës).

e) Likuidimi i detyrave të axhentave kontabël (Art. 23 i ligjës.)

f) Pezullimi i eksekutimit për denim (Art. 25 i Ligjës)

g) Gjykimi definitiv mbi llogarit e paraqituna prej axhentave kontabël të Shtetit (Art. 26 i ligjës.)

gj) Kërkesat e drejtueme Ministris së Drejtësiës dhe asaj Kompetente për marrjen e masave penale kundrejt axhentave kontabël në rasat e nji shperdorimit, falsifikimit ose ç'do krimit tjatër të ngarkueme atyne (Art. 29 i Ligjës).

h) Gjykimet mbi caktimin e pergjigjesis të funksionareve të deleguem (Art. 31 i Ligjës).

Këshilli mund të mblidhet edhe në ç'do rast tjatër për të diskutuar çashtje të dyshimta që i përkasin atributave të tij.

Art. 23.

Relacionet e paraqituna prej Antarëve për t'u bisedue në Këshillë mund të bahen verbalisht ose me shkresë.

Vendimet e Këshillit jepen me shumicë absolute votash dhe në rastë barasimi të vótave ka preferencën ana qi ka votue Kryetari.

Ma parë voton Referendari relator i çeshtjes dhe mandej të tjerët me radhë si mbas grades tue fillue nga ma e vogla.

Art. 25.

Vendimet e Këshillit duhet të permbajnë:

a) Emnin dhe mbiemnin e pjestarëve qi kanë marrë pjesë

në mbledhjen tue shenue dhe Referendarin relator si dhe gjindjen e Kryesekretarit.

b) Expozen te shkurten të çeshtjes dhe emnin e paleve t'interesueme.

c) Shenim të relatorit Referendar.

ç) Arsyetimin e pakices dhe të shumices.

d) Mendimin e Prokurorit.

dh) Vendimin e marrun, daten dhe nenshkrimet e pjestarëve.

Art. 26.

Vendimet e marruna prej Këshillit i komunikohen Ministris Kompetente, me anen e Kryetarit, perveç atyne të marruna në konformitet me nenin 29 të Ligjës për të cilat aplikohet neni 13 i kësajë Regullore.

KAPTINA IV.

Dispozita të ndryshme

Art. 27.

Me vendim të Këshillit Kolegjial rregullohen lejet e pushimit të personelit magjistraturës; gjithashtu me vendim të këtij pregatitet buxheti parashikues i tij.

Art. 28.

Kjo Rregullore hynë në fuqi me daten e Dekretimit.

Kryeministri e
Zv. Ministri P. Jashtme
Pandeli Evangjeli

Ministri P. Mbrendshme
M. Juka

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
K. Thaçi

Ministri P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ek. Kombtare
M. Frashri

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministries Nr. 2723-II datë 3-II-1931

Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me d. 27-I-931

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Rregullores së mbrendëshme të Këshillit Kontrollues.

Tiranë, me 1 Qershuer 1931.

ZOG.

Nr. 81.

LIGJË, 24 Qershor 1931.

Autorizuese për kontraktimin e dhetë huanave vjetore për nga fr. ari 10.000.000 maksimum se e cila

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 39 datë 24 Qershor 1931)

Art. 1. — Qeverija Mbretnore autorizohet me kontraktue për nji periudë dhjetë vjet huana të jashtme të pervjetëshme pa kamatë prej Fr. ari, 10.000,000 — maksimum sejcila, me qëllim qi të balancohen budgetet e Shtetit dhe për të sigurue zhvillimin ekonomik të vendit, punrat Botore dhe përmirësimin Arësimuer:

Art. 2. — Huanat në fjalë kanë me u kontraktue vjetë për vjetë tue fillue prej ushtrimit financjar 1931-932 me konditë qi:

Shuma e përgjithshme e këtyne huanave qi ka me rezultue e marrun në mbarim të dhjetë vjetve, do të amortizohen me keste të përvjetëshme dhe në kohen kur Qeverija Shqiptare do t'a shofi të mundëshme këte gabim pa damtue situacjonin ekonomik dhe financjar të vendit dhe kurdoherë mbassi t'ardhunat e buxhetit të Shtetit të kenë arrijtë në shifrën Fr. ari 50.000.000 në vjetë.

Art. 3. Kjo ligjë hynë në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. Trupi i Këshillit Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e ligjit mbi kontraktimin e dhetë huanave prej fr. ari 10.000.000, sejcila maksimum, e votueme prej

Parlamentit si mbas shkresës Nr. 179-I datë 23 Qershuer 1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 24 Qershuer 1931

ZOG.

Kryeministri e
Zav. Ministri Ekonomis Kombtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis e
Zav. Ministri Arsimit
M. Tutulani

Ministri P. Jatshme
H. Vrioni

Ministri i P. Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
Lame Kareco

Ministri P. Botore
I. Dibra

82.

DEKRET-LIGJË, 30 Qershuer 1931.

për kalimin e Milicis Paraushtarake nën mvarësinë e Komandës së Mbrojtjes Kombëtare

(Botuu në Fletoren Zyrtare Nr. 40 datë 30 Qershuer 1931.)

Art. 1.

Me datë 30 Qershuer 1931 Komanda e Përgjithshme e Milicisë Paraushtarake ka me pushue të funksionojë.

Atributat e ngarkueme me ligjë Komandës në fjalë, me 1 Korrik 1931 kanë me i-u transferue Komandës së Mbrojtjes Kombëtare.

Prej kësaj date të fundit, organet që mvareshin prej Komandës Milicisë Paraushtarake kanë me kalue nën mvarësinë e Komandës së Mbrojtjes Kombtare.

Art. 2.

Tue fillue me 1 Korrik 1931, Koamanda e Mbrojtjes Kombta-

re ka me u kujdesue gradualisht për me sigurue, me mjetet e veta, zhvillimin e kurseve paraushtarake dhe ikuadrimin e Milicisë

Art. 3.

Për me zhvillue e me bashkë-rregullue aktivitetet e ndryshme që kanë lidhje me kurset Paraushtarake e të sherbimit të Milicisë, ka me u themelue pranë Komandës së Mbrojtjes Kombtare, me datë 1 Korrik 1931, nji Zyre e veçantë «Stervitje Paraushtake e Miliciё».

Art. 4.

Si rrjedhje mbi sa asht disponue me artikujt e ma-parshëm 1 e 2, Komanda e Mbrojtjes Kombtare asht e ngarkueme me i paraqitë Këshillit Ministruer, mbrenda vjetit 1931, propozime për dispozita legjislative me qellim që të disponojë sistemimin e ri të funksionimit të kurseve Paraushtarake e të shërbimit të Milicisë.

Art. 5.

Për sa i referohet detyrimeve të shërbimit, fitimeve (avantaggit) e sanksioneve disiplinare e penale të parapame për Paraushtarakët e milicët, kanë me mbetë në fuqi, për deri sa të shtypen dispozita legjislative që bahen fjalë në artikullin e ma-parshëm, rregullat e caktueme prej ligjëve mbi themelimin e Milicisë e mbi funksionimin e kurseve Paraushtarake, me detyrimet si mbas artikullit që vijon:

Art. 6.

Si ndryshim mbi sa asht disponue prej ligjëve mbi funksionimin e kurseve Paraushtarake e mbi themelimin e Milicisë, me këtë caktohet sa vijon:

a) Nenshtetasit që banojnë në Mbretnië e që janë fizikisht t'aftë, kanë detyrë me frekuentue kurset Paraushtarake tue fillue me 1 Tetuer të vjetit në të cilën mbushin 16 vjet të moshës. Ky detyrim pushon me 30 Shtatuer të vjetit në të cilën ato mbushin të 18 vjetë të moshës.

b) Tue fillue me 1 Tetuer në të cilën mbushin 18 vjetë të moshës, nenshtetasit qi banojnë në Mbretnië e që janë fizikisht t'aftë, kanë detyrë me ba shërbim milicie. Ky detyrim pushon në çast në të cilën po keta nenshtetas thirren nën armë për me ba sherbimin ushtarak aktiv.

Për ato që janë të shliruem me báe sherbim ushtarak efektive ose,. tue kenë të detyruemë me báe sherbim, nuk thirren nen armë mbrënda vjetit në të cilën mbushin të 20 vjet të moshës,

detyrimi me báe sherbim në Milicië, pushon me 30 Shtatuer të vjetit në të cilën mbushin të 21 vjet të moshës.

c) Rekrutat që kanë frekuentue për dy vjet, e me përfundim të favorshëm, kurset Paraushtarake, si dhe të kenë báe dy vjet sherbim të lavdueshëm në Milicie, do të fitojnë nji paksim sherbimi ushtarak prej 6 muejsh, në se janë të detyrueme me bae sherbim normal; kanë me u përjashtue prej sherbimit ushtarak aktiv,. në se kanë detyrim ushtarak të paksuemë.

Për nevojat me karakter të jashtzakonshëm, do të mundë t'u jepet kolektivisht, me dekret Mbretnuer, paksim shërbimi ose shlirimi edhe, të rregjistruemve me detyrim normal o detyrim të paksuem mjaftë që të kenë krye vetëm nji pjesë të detyrimeve që bahen fjalë nër germat a) e b).

d) Djelmeve të rregjistueme në Milicië kanë me i-u shpërndae sendet që përbajnë uniformën, falas nga Komanda e Mbrojtjes Kombtare.

Djelmeve të rregjistruemë nër kurset Paraushtarake nuk ka me i-u dhanë uniformë por si shënjë dalluese që kanë me u caktue e me u shperndae, edhe këta falas, prej Komandës së Mbrojtjes Kombtare.

Art. 7.

Personeli (civil e ushtarak) i Milicisë, si dhe personeli Ushtrisë e i Gjindarmersë që sherben sot në Milicië, ka me kalue, me 1 Korrik 1931, në dispozision të Komandës së Mbrojtjes Kombëtare.

Pozisioni definitiv i personelit të Milicisë ka me u rregullue me dekret Mbretnuer, e, për deri sa nuk kanë me u dhanë dispozita për sa i përket, ky personel ka me vazhdue me gëzue tratamentin që ka sot.

Art. 8.

Oficerave dhe graduatëve në shërbim të përhershëm t'ushtrisë të përdorun në stërvitjen e Paraushtarakve e të Milicëve, tue fillue me 1 Korrik 1931, nuk ka me i-u dhanë ma shpërblimi i caktuemë prej artikullit 18 të Ligjës mbi Organizimin dhe funksionimin e Kurseve Paraushtarake.

Por këto shpërblime kanë me vazhdue me i-u dhanë Oficerave dhe graduatëve t'ushtrisë e të gjindarmerisë në lirim. të cilët tue bae flië detyrimet e tyne të jetës civile, kanë me u përdorë pas kërkesës tyne, nër stërvitjet e nalt përmenduna.

Art. 9.

Dispozita që bahet fjalë n'Artikullin 27, numur 2) të ligjës mbi themelimin e Milicisë, për sa i përket ndihmës që japin Bashkiët e Komunat në favor të Milicisë, pushon me pas fuqië.

T'ardhunat e parapame prej numurave 3) 4) 6) 7) t'Artikullit 27 të ligjës mbi themelimin e Milicisë Paraushtarake kanë me u derdhë Drejtorive e Nën-drejtorive të Financës kompetentë të cilat i shenojnë kapitullit të veçantë të gjendjes përvjetore të parapaeme të t'ardhunave.

Art. 10.

Tue fillue prej ushtrimit financjar 931-932 fondet që nevojiten për funksionimin e kurseve Paraushtarake e të shërbimit të Milicisë kanë me u vue në gjendjen e parapameve vjetore të Komandës së Mbrojtjes Kombtare.

Gjestioni i këyne fondeve ka me u ba nga ana e Intendancës së Përgjithshme, si pas rregullave në fuqië për ushtrinë, tue pushue prandej rregjimi autonom parapae për Milicinë.

Art. 11.

Me datë 30 Qershor 1931 Komandanti i Përgjithshëm i Milicisë Paraushtarake i tashëm ka me mbyllë gjestionin administrativ të veten dhe, ka me disponue mbylljen e kontkorjentit që ka kenë hapë pranë Bankës Kombtare dega e Tiranës tue, derdhë të hollat që eventualisht kanë mbetë, bashkë me shumat që ndodhen pranë arkës së Komandës së Përgjithshme e pranë organeve mvarës, Drejtorisë Financës Tiranës, e cila ka me dhanë diftesë-marrje për t'i-u bashkue pasqyrës siç shpjegon Artikulli 12 që vijon.

Materialet e ç'do iloji qi gjinden nër magazina e të shpërndame Repartave e zyrave të Milicisë, kanë me kalue në ngarkim, me dorëzim të rregullt, Komandës Mbrojtjes Kombtare; verbalet relative kanë me i-u bashkue llogarive siç shpjegon artikulli 12 që vijon.

Po me këto formalitete ka me u bae kalimi, prej Komandës së Përgjithshme të Milicisë në Komandën e Mbrojtjes Kombëtare i akteve t'archivës.

Art. 12.

Mbrenda 10 Korrik 1931 Komanda pushuese e Milicisë i transmeton Këshillit Kontrollues pasqyrësn për të cilën flet neni 30 i Ligjës mbi themelimin e Milicisë.

Kjo pasqyrë do të duhet t'i referohet gjestionit të 7 muejve, prej Dhetorit 1930 deri në Qershuer 1931.

Mbrenda 10 Gusht 1931, Komanda e Përgjithshme e Milicisë e nalt-përmendun ka me i transmetue Ministrisë së Financavet llogariët për të cilat ban fjalë artikulli 31 i Ligjës mbi themelimin e Milicisë. Kjo llogari do të duhet t'i referohet gjestionit prejfíllimit t'ushtrimit financjar 1930-931 e deri më 30 Qershuer 1931.

Art. 13.

Kjo ligjë hynë në fuqi me 30 Qershuer 1931 e prej kësaj date duhet të quhen t' abrogueme dispozitat që kësaj i kundɹë shtojnë.

Art. 14.

Të gjith Ministrat janë të ngarkuemë me zbatimin e kësaj Ligje.

Kryeministri e
Zev. Ministri i Ekonomis Kombtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
e Zev. Ministri Arsimit
M. Tutulani

Ministri P. Jashtme
H. Vrioni

Ministri P. Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Financave
L. Kareco

Ministri P. Botore
Izet Dibra

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 657-III datë 26-VI-931.
Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 24-VI-931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-ligjit mbi kalimin e Milicis Paraushtarake nen mvaresin e Komandes së Mbrojtjes Kombëtare.

Tiranë, me 30 Qershuer 1931.

ZOG.

Nr. 83

DEKRET-LIGJË 30 Qershuer 1931

Mbi Rregullimin e Ushtrisë Kombëtare

(Botue në Fletoreu Zyrtare Nr. 40 datë 30 Qershor 1931)

KRYE I.rë

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Personeli

Neni 1.

Ushtria Kombtare asht e perbaeme prej personelit ushtarak e prej personelit civil.

Neni. 2.

Personeli ushtarak perfshinë:

a) oficera
b) Nenoficera
c) Trupa.

a) Oficera

Jerarkija nër grada të oficerave asht si vijon :

1º) Oficera Generala:

General Armate
General Divizioni
General.

2º) Oficera eprorë:

Kolonel - Kapiten anije
Nenkolonel - Kapiten fregate
Major - Kapiten korvete.

3º) Oficera inferiorë:

Kapiten i Kl. I. - Toger anije i Kl. I. Kapiten porti i Kl. I.;
Kapiten i Kl. II. - Toger anije i Kl. II. Kapiten porti i Kl. II.;
Toger - Nentoger anije - Toger porti;
Nentoger - Flamurtar - Nentoger porti;
Aspirant - Aspirant anije - Aspirant porti.

Togerat, Nentogerat Aspirantat dhe gradat që i gjegjen ketyne, perbajnë oficerat subalternë.

b) Nenoficəra

Jerarkija për grada të Nenoficerit asht si vijon:
Kapter i Kl. I. - Kapter anije i Kl. I. Kapter porti i Kl. I.;
Kapter i Kl. II. - Kapter anije i Kl. II. Kapter porti i Kl. II.;
Reshtar - Reshtar anije - Reshtar porti.

c) Trupa

Jerarkija nër grada të trupes asht si vijon:
Tetar - Tetar anije - Tetar porti;
Nentetar - Rrojes Kufinit;
Ushtar - detar - nxanes Rrojes Kufinit.

Grada nentetar i jepet vetem personelit Artileris e togës kalorës të Gardës Mbretnore.

Tetarët e nentetarët përbajnë graduatët e trupës.

Neni. 3.

Organikat e Oficerave janë të caktueme prej kesaj ligje.

Organikat e Nenoficerave e të Trupes kanë me u caktue me dispozita të veçanta.

Neni 4.

Jerarkija e organika e personelit civil kan me u caktuë me ligje të veçantë.

PËRBAESIA E USHTRISË KOMBTARE

Neni 5.

Ushtria kombtare asht e përbaeme prej:
— Komanda e Mbrojtjes Kombtare
— Fuqiët toksore
— Fuqiët detare
— Fuqiët ajrore.

KOMANDA E USHTRISË KOMBTARE

Neni 6.

Komanda e Mbrojtjes Kombtare mbahet prej nji oficeri General.

Perbaesija e Komandës në fjalë ka me u caktue me dekret Mbretnuer.

Po kësaj Komande i shenjohen oficera të armeve e trupave të ndryshme të perfshime uër organikat e parapaeme prej kësaj Ligje.

KRYE II.

FUQIËT TPKSODE

Neni 7.

Fuqiet toksore janë të permbledhuna në:

— 2 Diviziona

— 6 Grupa të perzieme.

Trupat e sherbimit që bajnë pjesë në secilin Divizion e në secilin Grup të perziem janë të caktueme me dekret Mbretnuer.

KOMANDA E DIVIZIONIT

Neni 8.

Komanda e Divizionit mbahet prej nji Generali.

Perbaesija e Komandës së nalt-permendun ka me u caktue prej Komandës së Mbrojtjes Kombtare.

Komandes Divizionit i shenjohen oficera eprorë dhe inferiorë të armeve e trupave të ndryshme, të përfshime nër organikat e armeve e trupave rispektive.

OFICERA GENERALA

Neni 9.

Organika e oficerave Generala për Komanden e Mbrojtjes Kombtare e për Komandat e Divizionit asht si vijon:

Generala Divizioni	1
Generala	2
SHUMA	3

KOMANDA E GRUPIT TË PËRZIEM

Neni 10.

Komanda e Grupit të përziem asht e mbajtun prej nji Koloneli o Nen-Koloneli të armës kambësorisë.

Perbaesija e kësaj Komande ka me u caktue prej Komandes së Mbrojtjes Kombtare.

Komandes Grupit i janë shenjue oficera të armeve e trupave të ndryshme, të përfshime nër organikat e armeve e trupave rispektive.

BKSH

ELEMENTAT E FUQIVET TOKSORE

Neni 11.

Fuqiët toksore janë të perbaeme prej elementave që vijojnë:

a) Garda Mbretnore
b) Shkolla Ushtarake
c) Arma e kambësorisë
ç) Arma e artilerisë
d) Arma e xhenjos
e) Trupi i Brojës Kufizore
f) Trupi shëndetsuer
g) Trupi veterinar
h) Trupi intendancjer
i) Zyrë-stabilimenta e reparte të ndryshme.

Perpjestimi i elementave të nalt-përmënduna në elementa ma të vogla, ashtë caktue prej artikujve që vijojnë:

Formacionet e elementave ma të vogla kanë me u caktue, në hollësiët e tyne, prej Komandes së Mbrojtjes Kombtare.

Veç elementave të armeve, trupave e sherbimeve të ndryshme të konsiderueme në këtë ligjë e qi mbahen përhersisht, formohen në rast nevojash të veçanta elementa të tjera t'armeve, të trupave e të sherbimeve të ndryshme. Numuri dhe perbaesija e ketyne elementave caktohn me dekret Mbretnuer.

Per mbrojtjen kombtare, në kohë lufte, mund të marrin pjesë, me rregulla që do të caktohet me dekret Mbretnuer, trupa vullnetarësh që kanë me kenë nën mvarësin e Komandes së Fuqive Armate të mobillizueme.

GARDA MBRETNORE

Neni 12.

Garda Mbretnore perfshinë:

a) 1 Komande
b) 1 Kompanië
c) 1 Skuadron kalorës.

Oficerat e shenjuem Gardes Mbretnore janë të përfshiem në organiken e oficerave të kambësorisë.

SHKOLLA USHTARAKE

Neni 13.

Shkollat ushtarake perfshijnë :

a) 1 Shkollë Mbretnore ushtarake
b) 1 Shkollë njanësa oficera plotësimi
c) 1 Shkollë perfeksionimi për oficera
ç) 1 Shkollë nxanësa nenoficera
d) 2 Qendra stervitjeje për artilerie pozisioni.
e) 1 Qender stervitjeje të Rrojës Kufizore.

Oficerat që shërbejnë nër shkolla ushtarake janë të perfshiem në organiken e armëve e të trupave të ndryshme.

ARMATA E KAMBËSORISË

Neni 14.

Arma e kambësorisë perfshinë:
a) 6 bataljona efektivë
b) 12 bataljona kuadër
c) 2 eskadrilë autoblindë e tanks.

Neni 15.

Organika e oficerave të kambësorisë asht si vijon:

Kolonela	5
Nenkolonela	8
Majora	21
Kapitena të Kl. I.	56
Kapitena të Kl. II.	72
Togera, Nentogera e Aspiranta	229
SHUMA	391

Në organiken e oficerave të kambësorisë janë perfshië 8 oficera në sherbim të Shtatit Madhnuer.

ARMA E ARTILERISË

Neni 16.

Arma e artilerisë perfshinë:
a) 1 Komandë artilerije
b) 4 Komanda artilerije pozisioni
c) 2 Komanda artilerije divizioni
ç) 6 Batterie kanona 65/17 efektivë
d) 12 Batterie kanona 65/17 kuadër
e) 6 Batterie obiçi 75/13
f) 2 Batterie kanona 75/27 auto-bartun
g) 1 Batterie kanona 75/27 e terhjekun me kuaj.

BKSH

Neni 17.

Organika e oficerave t'Artilerisë asht si vijon:

Kolonela	1
Nenkolonela	4
Majora	8
Kapitena të Kl. I.	24
Kapitena të Kl. II.	38
Togera, Nentogera e Aspiranta	125
SHUMA	200

Në organiken e oficerave të artilerisë janë të perfshiem 4 oficera në sherbim të Shtatit Madhnuer.

ARMA E XHENIOS

Neni 18.

Arma e Xhenios perfshinë:

a) 1 Komandë e Xhenios
b) 2 Kompanie Z.M. Divizioni efektivë
c) 3 Kompanië Z.M. Grupi efektivë
ç) 3 Kompanië kuadër Z.M. Grupi
d) 1 Kompanië telegrafista
e) 1 Kompanie radiotelegrafista
ë) 1 Kompanië lidhje kuadër
f) 1 Kompanie teleferista
g) 1 Repart pompjer

Neni 19.

Organika e Oficerave të Xhenios asht si vijon:

Nenkolonel	1
Majora	2
Kapitena të Kl. I.	7
Kapitena të Kl. II.	14
Togera, Nentogera e Aspiranta	45
SHUMA	69

Në organiken e oficerave të xhenios janë të perfshiem 2 oficera në sherbim të Shtatit Madhnuer.

TRUPI I ROJËS MBRETNORE TË KUFINIT

Neni 20.

Trupi i Rojës Mbretnore të Kufinit perfshinë:

BKSH

a) 1 Komandë e trupit
b) 4 Bataljona.

Atributat e mvarrësiet e trupit për sa i përket sherbimit të instituti, janë të caktueme me ligje të veçantë.

Neni 21.

Organika e oficerave të Rojës Mbretnore të Kufinit ashtë si vijon:

Nenkolonel	1
Majora	5
Kapitena të Kl. I.	7
Kapitena të Kl. II.	8
Togera, Nentogera e Aspiranta	50
SHUMA	71

TRUPI SHËNDETSUER

Neni 22.

Trupi shëndetsuer përbahet prej:
a) oficera mjek
b) oficera kimiko-farmaçista
c) 1 Kompanië shendetsije.

Neni 23.

Organika e oficerave mjekë asht si vijon:

Nenkolonela	1
Majora	2
Kapitena të Kl. I.	9
Kapitena të Kl. II.	16
Togera	29
SHUMA	57

Organika e oficerave kimiko-farmaçista ashtë si vijon:

Kapitena të Kl. II.	1
Togera	4
SHUMA	5

TRUPI VETREINAR

Neni 24.

Trupi veterinar asht i perbaem prej oficerave veterinarë.

Neni 25.

Organika e oficerave veterinar asht si vijon:

Majora	1
Kapitena të Kl. I.	2
Kapitena të Kl. II.	4
Togera	8
SHUMA	15

TRUPI INTENDANCJER

Neni 26.

Trupi intendancjer prebahet prej:

a) Oficera intendancjer

b) 1 Kompanië e intendancës.

Neni 27.

Organika e oficerave intendancjer ashtë si vijon:

Nenkolonel	
Majora	2
Kapitena të Kl. I.	8
Kapitena të Kl. II.	13
Togera, Nentogera e Aspiranta	37
SHUMA	61.

ZYRA REPARTE E STABILIMENTA TË NDRYSHME

Neni 28.

1 Inspektorië mobilizimi
3 Drejtorina rekrutimi
34 Zyra rekrutimi
1 Gjyqë ushtarakë
1 Autorepart
1 Repartë garnizoni
1 Spitale ushtarake
5 Revire garnizoni
1 Oficinë e sherbimit të artilerisë
1 Oficinë e sherbimit të xhenios
1 Ofiçinë automobilistike
1 Puntoraië ushtarake
1 Bukë-pjekëse ushtarake

BKSH

3 Revire kafshesh
1 Depo e përgjithshme me ofiçinë
2 Magazina divizioni
1 Bandë ushtarake.
1 Shtypshkronjë Ushtarake

Oficerat që shërbejnë nër zyra, reparta e stabilimentat e naltpërmenduna janë të përfshiem në organiken e armeve e trupave të ndryshme.

KRYE III.

FUQIET DETARE

Neni 29.

Fuqiet detare janë të përfshieme prej elementave që vijojnë:

a) 1 Komandë Marine
b) 1 Bazë detare
c) 1 Eskadrilë M.A.S.
ç) 3 Batterie kundra-aerore
d) 1 Sherbim i komunikasioneve
e) 1 Inspektor i kapitenerive porti
f) 4 Kapitenerië Porti
g) 5 Zyra Porti.

Nji ligje e veçantë ka me caktue atributat dhe mvarrësiët e elementave të sherbimit të Kapitenerive të Portit.

Neni 30.

Organika e oficerave të marinës asht si vijon:

a) Oficera anije

Kapitena korvete	1
Togera anije të Kl. I.	2
Togera anije të Kl. II.	2
Nentoger anije- Flamurtar-Aspiranta anije	3
SHUMA	8

b) Oficera porti:

Kapitena porti të Kl. I.	1
Kapitena porti të Kl. II.	3
Togera, Nentogera e Aspiranta porti	5
SHUMA	9

BKSH

KRYE IV
FUQIT AJRORE
Neni 31.

Formimi i fuqieve ajrore ka me u caktue me ligjë të veçantë.

KRYE V.
DISPAZITA TË NDRYSHME
Neni 32.

Përpjestimi i oficerave të seciles arme o trup ndermjet elementave të ndryshme të parapaeme prej kësaj ligje, caktohet prej Komandes së Mbrojtjes Kombtare.

Neni 33.

Nër organika të oficerave të armeve e trupave të ndryshme të caktuem prej kësaj ligje, nuk janë perfshië oficerat e plotësimit.

Numri i oficerave të plotsimit asht i ndryshueshem pse ndryshon për ç'do vjet numuri i djelmoshave me detyrim që kanë cilesiet e kerkueme për pranimin nër kurse të rekrutimit për të tillë oficera.

Neni 34.

Oficerat që merren në sherbim për nji afat të caktuem me kontratë të veçantë si mbas artikullit 185 të Statutit Themeltar konsiderohen si Organizatora të armeve e të trupave t'Ushtrisë kombtare, e prandej nuk janë të perfshiem ner organikat e parapaeme nga këjo Ligjë.

Neni 35.

Rajoni ushtarak toksuer dhe Entet e ushtrisë që kanë juridiksion toksuer kanë me u caktue me dekret Mbretnuer.

KRYE VI.
Neni 36.

Rregullimit t' Ushtrisë e organikave t' oficerave të parapaeme prej kësaj ligje ka me i-u arrijtë gradualisht, me dispozita të veçanta që kanë me u dhanë me dekret Mbretnuer.

Neni 37.

Për deri sa mos t'i arrihet organikes t'oficerave që ashtë parapae në këtë ligjë për armet e trnpat e ndryshme, me dekret Mbretnuer mundet t'i besohet oficerave detyra e grades ma e naltë prej asaj që ata mveshin.

Neni 38.

Kjo ligje hynë në fuqië qysh prej 1 Korrik 1931.

Po prej kësaj date duhet të kuptohet e abrogueme ligja e rregullimit të Fuqive Armate me datë 16 Nanduer 1929.

BKSh

Neni 39.

Këshilli Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

Kryeministri e
Zev. Ministri i Ekonomis Kobmtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis e
Zev. Ministri Arsimit
M. Tutulani

Ministri P. Mbrendshme
Musa Juka

Ministri P. Jashtme
H. Vrioni

Ministri P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Financavet
L. Kareco

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 657/III datë 26-VI-931.

Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 24-VI-931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-ligjit mbi rregullimin e Ushtris.

Tiranë, me 30 Qershuer 1931.

ZOG.

Nr. 84

LIGJË 30 Qershor 1931

Mbi pëlqimin dhe ratifikimin të Huanave të kontraktueme si mbas ligjës autorizuese me datë 24-6-1931

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 41 datë 1 Korrik 1931)

Neni 1.

Pelqehen dhe ratifikohen huanat të kontraktuem me 24-VI-1931, në bazë të Ligjës autorizuese me datë 24-VI-1931, ndermjet Qeveris Mbretnore të Italisë të përfaqsueme prej S. T. Markesit

Meli Lupi di Soranga Ministër fuqi-plotë dhe i derguem i Jasht-zakonshem i N. M. Tij Mbretit të Italisë në Tiranë, dhe Qeverisë Mbretnore të Shqipnis të perfaqsueme prej Z. Hysen Vrionit Ministër i P. të Jatshme të Shqipnisë si mbas dy notavet që i aneksohen kësaj Ligje.

Neni 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 3.

Trupi i Këshillit Ministruer ngarkohet me zbatimin e kesaj Ligje.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e ligjit mbi pelqimin dhe ratifikimin e huanavet të kontraktueme si mbas ligjës autorizuese me date 24. VI. 931, të votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 183-I datë 26-6-31, të kryesis së Tij.

Tiranë, me 30 Qershuer 1931.

Z O G.

Kryeministri
e Zev. Ministri Ekonomis Kombtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i P. Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Drejtësis
e Zev. Ministri i Arsimit
M. Tutulani

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri P. Jashtme
H. Vrioni

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

NOTË-Ç'KEMBIMI

Zoti Minister,

Në vazhdim të fjalimeve t'ona mbi bashkëpunimin e Italis dhe të Shqipnis, në fushën e interesavet të tyre të bashkta, Shkelqesa e Juaj me bëri të konstatoj se zhvillimi i Ekonomis Shqiptare nuk ka mundur gjer më sot me pasë një reperkusion të mjaftueshëm mbi t'ardhunat e Shtetit, sa që të lejojë atë zhvillim

ekonomik, që pasqyron për Italinë një interes të gjallë e miqësore

Për këtë arsye Shkelqesa e Juaj me propozoj t'interesohem për marrjen nga Qeverija Mbretnore aleate Italiane, një hua me karakter të tillë që të mundij të lehtësojë në mënyrë të dobishme detyren rindertimore të Qeveris Shqiptare dhe përparimin e Kombit.

Qeverija Mbretnore Italiane, të cilen e vura në korrent mbi kërkesën e Shkëlqesës s'Uaj u interesua me një herë për këtë gja dhe, si miq aleate, ashtu dhe si Shtet fqinj dhe Adriatik; dhe jam i auktorizuarë të lajmoj Shkelqesën t'Uaj, se ajo Qeveri pranon t'i përgjegjet deshirës s'uaj me qellim të ndihmojë, për realizimin e rregullimit financjar dhe të zhvillimit t'Ekonomis që Qeverija Shqiptare ka në program.

Pra, Qeverija Mbretnore, duke aprovuar sa u vendosen midis nesh, i akordoj Shtetit Shqiptar huana per shumen maksimum 10 miliune (Dhjetë milune) franga ari, duke filluar prej ushtrimit financiar 1931-1932 që ka për t'u persëritur nende vjetë të tjera. Huanat e lart-përmënduna do të jenë pa kamatë. Per sa i perket datës së modaliteteve të kthimit të tyre, Qeverija Italiane len inisiativën në dorë të Qeverisë Shqiptare, e cila do të mendohet me marrë masat e pagimit kur t'a gjykoj të mundëshme pa lenduar gjendjen ekonomike dhe financjare të vendit, por kurdoherë jo ma parë se t'ardhunat buxhetore të Shtetit Shqiptar të kenë mbritur shumen vjetore pesëdhjetë milione fr. ari.

I konfirmoj Shkelqesës s'Uuej se, në pershtatje me karakterin e këtyre huanave, sasija e se cilave nuk do të jetë kurr më tepër se 10 miliun franga ari për çdo ushtrim financjar, këto kanë me u paksue proporsionalisht me shtimin e të ardhunavet ose pakësimin e shpenzimevet, të çdo natyre qofshin, të Shtetit Shqiptar; dhe se, ma së fundi, këto huana, në pjesën e madhe, do të përdoren në zhvillimin e punëvet botore, t'Ekonomis dhe t'Edukatës Kombëtare.

Përfundoj Zoti Minister duke deklaruar Shkelqesisë s'Uaj se kejo veper e Qeverisë Mbretnore Italjane, mbeshtetet në vazhdimin e plotë e të sinqertë të bashk-punimit teknik dhe politik midis dy Qeverive dhe çfaq besimin se miqësija e tyre do të ketë, nga këjo provë e madhe vëllazërimi, një konsakrim moral të rij në shpirtin e popullit Shqiptar, jasht traktatevet e per mbi traktatet dhe interesat praktike që prej kohe na lidhin aq intimisht.

Përfitoj nga ky rast për t'i përsëritur Shkëlqesës s'Uaj, sigurimin e konsideratave të mija ma të larta.

Antonio Meli Lupi di Soragna

Shkelqesis së Tij
Z. Hysen Vrioni
Ministër i P. Jashtme i Shqipnis
Tiranë

TEKSTI I NOTËS NË GJUHËN ITALISHTE

Signor Ministro,

Nel corso delle nostre conversazioni relatíve alla collaborazione dell'Italia e dell'Albania nel campo dei loro communi interessi, Vostra Eccellenza mi ha fatto constatare che lo sviluppo dell'economia albanese non poteva ancora avere una ripercussione sufficiente sulle entrate dello Stato, per permettergli quel progresso economico che rappresenta per l'Italia un interesse vivo ed amichevole.

Vostra Eccellenza mi ma perció proposto di interessarmi per ottenere dal Regio Governo Italiano Alleato un prestito di carattere tale da facilitare efficacemente il compito ricostruttivo del Governo Albanese ed il progresso della Nazione.

Il Regio Governo Italiano, che ho messo al corrente della richiesta di vostra Eccellenza, vi si è immediatamente interessato e come amico ed alleato e come stato vicino ed adriatico io sono autoriëzato ad informare Vostra Eccellenza che esso acconsente a venirvi incontro, allo scopo di venire in aiuto all realizazione del programma di assestamento finanzario e di sviloppo economico che il Governo Albanese si propone.

Il Regio Governo quindi, approvando quanto è stato fra noi convenuto, concede allo Stato Albanese dei prestiti për la cifra massima di franchi oro 10 milioni (Dieci Milioni) a comincore dall'esercizione finanzario 1931-32, da rinovarsi për altri 9 anni. I detti prestiti saranno senza interessi. Për quanto riguarda la data e le modalitá della loro restituzione il Governo Italiano ne lascia l'iniziativa al Governo Albanese, il quale penserá a provedervi quando lo riterrá possibile senza pregiudizio della situazione economica e finanziaria del Paese, e in ogni mido, non prima che le entrate del bilancio dello Stato Albanese abbiano raggiunto la cifra di Cinquanta milioni di franchi oro annui.

BKSH

Confermo a Vostra Eccellenza che, in conformitá al carattere di questi prestiti, l'ammontare dei quali non sará mai superiore ai dieci milioni di franchi oro per esercizio, essi dovranno essere diminuiti proporzionalmente all'aumentare dei redditi o alla diminuzione delle spese, di qualsiasi natura, della Stato Albanese; e che, infine, e si saranno per la maggior parte devoluti allo sviluppo dei Lavori Pubblici, dell'Economia e dell'Educazione Nazionale.

Passo infine, Signor Ministro, a dichiarare a Vostra Eccellenza che questo atto del Regio Governo Italiano si basa sulla continuitá della piena e sincera collaborazione tecnica e politica fra i due Governi; ed esprimo la fiducia che la loro amicizia avrá, da questa grande prova di fraternitá, una nuova consacrazione morale nello spirito del apopolo albanese, al di fuori ed al di sopra dei trattati e degli interessi pratici che già ci legano cosi intimamente».

Aprofitto dell'occasione per rinnovarle, Signor Ministro, gli atti della mia piu alta considerazione.

Antonio Meli Lupi di Soranga

A sua eccellenza
Signor Hysen Vrion
Ministro degli affarri Esteri Albanese
Tirana

Zoti Ministër,

Kam nderin të lajmeroj Shkelqesën t'Uaj për marrjen e notës së Zotris s'Uuaj Nr. 1460 d. 24 Qershuer 1931, me përbajtjen që vijon:

«Në vazhdim të fjalimeve t'ona mbi bashkëpunimin të Italis dhe të Shqipnisë, në fushen e interesavet të tyre të bashkëta. Shkelqesa e Juaj më bëri të konstatoj se zhvillimi i Ekonomisë Shqiptare nuk ka mundur gjer më sot me pasë një reperkusion të mjaftueshem mbi t'ardhunat e Shtetit sa që të lejojë atë zhvillim ekonomik, që pasqyron për Italinë një interes të gjallë miqësore».

Për këtë arsye Shkelqesa e Juaj me pranoni t'interesohem për marrjen nga Qeverija Mbretnore aleate Italiane një hua me nji karakter të tillë që të mundij të lehtësojë në mënyre të do-

bishme detyren rindertimore të Qeveris Shqiptare dhe përparimin e Kombit».

«Qeverija Mbretnore Italiane, të cilën e vura në korrente mbi kerkesën e Shkëlqesës s'Uaj u interesua me një herë për këtë gja dhe, si miq dhe aleate, ashtu dhe si Shtet fqinj dhe Adriatik: dhe jam i autorizuar të lajmoj Shkelqesën t'Uuaj se ajo Qeveri pranon t'i përgjegjet deshirës s'uaj me qëllim të ndihmojë për realizimin e rregullimit financjar dhe të zhvillimit t' Ekonomisë që Qeverija Shqiptare ka në program».

«Pra, Qeverija Mbretnore, duke aprovuar sa u vendosen midis nesh, i akordoj Shtetit Shqiptar huana për shumen maksimum 10 miliun (Dhjet miliune) fr. ari, duke filluar prej ushtrimit financjar 1931-1932 që ka me perseritur nendë vjetë të tjera. Huanat e lart-përmënduna do të jenë pa kamatë. Për sa i përket datës së modalitetevet të kthimit të tyre, Qeverija Italiane len inisiativen në dorë të Qeveris Shqiptare, e cila do të mendohet me marrë masat e pagimit kur t'a gjykojë të mundëshme pa lenduar gjendjen ekonomike dhe financiare të Vendit, por kurdoherë jo ma parë se t'ardhunat buxhetore të Shtetit Shqiptar të kenë mbritur shumen vjetore pesëdhjet milione fr. ari».

«Konfirmoj Shkelqesës s'Uaj se, në përshtatje me karakterin e këtyre huanave, sasija e së cilave nuk do të jetë kurr më tepër se 10 miliun fr. ari për çdo ushtrim financiar, këto kanë me u paksue proporsionalisht me shtimin e të ardhunavet ose me pakësimin e shpenzimevet, të çdo natyre qofshin, të Shtetit Shqiptar; dhe se, ma së fundi, këto huana në pjesën e madhe, do të përdoren për zhvillimin e punëvet botore, t'Ekonomis dhe t'Edukatës Kombëtare».

«Përfundoj Zoti Ministër, duke deklaruar Shkelqesisë s'Uaj se këjo vepër e Qeverisë Mbretnore Italiane mbështetet në vazhdimin e plotë e të sinqertë të bashkëpunimit teknik dhe politik midis dy Qeverive dhe çfaq besimin se, miqsija e tyre do të ketë, nga këjo provë e madhe vëllazërimi, një konsakrim moral të rij në shpirtin e popullit Shqiptar, jasht traktatevet dhe për mbi traktatet dhe interesat praktike që prej kohe na lidhin aq intimisht».

Qeverija Mbretnore Shqiptare, duke falenderuar Shkelqesën t'Uaj për këtë komunikim, deklaron se asht në një mëndje mbi sa përmban letra e Shkelqesës s'Uaj posaçërisht për sa i përket kushtit të miqsisë së perzemërt dhe të bashkëpunimit teknik e

politik, të plotë e të sinqertë, mbi të cilat Qeverija Mbretnore Italiane e mbeshtet veprën e saj, dhe e falenderon kombin e madh aleat për ndihmen aq të dobishme që i dha Shqipërisë, me sigurij se këjo duke krijuar një titull të rij mirënjohësije të paharrueshem, do t'i forcojë gjithmonë ma tepër lidhjet morale dhe politike që bashkojnë të dy popujt fqinj.

Përfitoj nga ky rast për t'i përsëritun Shkelqesis s'Uaj, sigurimin e konsideratave të mija ma të larta.

Ministri i P. të Jashtme
H. Vrioni

Shkelqesës së Tij
Markezi Antonio Melli Lupi di Soranga
I Derguar Jashtzakonshem e Ministër
Fuqi plotë i N. M. T. Mbretit t'Italisë.
TIRANË

Signor Ministro,

Ho l'onore d'informare Vostra Eccellenza che ho ricevuto la Sua nota Nr. 1460, del Giugno 1931-IX, del seguente tenore:

«Nel corso delle nostre conversazioni relative alla collaborazione dell' Italia e dell' Albania nel campo dei loro communi interessi, Vostra Eccellenza mi ha fatto constatare che lo sviluppo dell' economia albanese non poteva ancora avere una ripercussione sufficiente sulle entrate dello Stato, per permettergli quel economico che rappresenta per l'Italia un interesse vivo ed amichevole».

«Vostra Eccellenza mi ha percio proposto di interessarmi per ottenere dal Regio Governo Italiano Alleato un prestito di carattere tale da facilitare efficacemente il compito ricostruttivo del Governo Albanese ed il progresso della Nazione».

„Il Regio Governo Italiano, che ho messo al corrente della richiesta di Vostra Eccellenza, vi si è immediatamente interessato e come amico ed alleato e come stato vicino ed adriatico: e sono autorizzato ad informare Vostra Eccellenza che esso acconsente a venirvi incontro, allo scopo di venire in aiuto alla realizzazione del programma di assestamento finanziario e di sviluppo economico che il Governo Albanese si propone».

«Il Regio Governo quindi, approvando quando è stato fra

noi convenuto, concede allo Stato Albanese dei prestiti per la cifra massima di franchi oro 10 milioni (Dieci Milioni) a cominciare dall' esercizio finanziario 1931-32, da rinnovarsi per altri 9 anni. I detti prestiti saranno senza interessi. Per quanto riguarda la data e le modalita della loro restituzione il Governo Italiano ne lascia l'iniziativa al Governo Albanese, il quale pensera a provvedervi quando lo riterrá possibile senza pregiudizio della situazione economica e finanziaria del Paese, e in ogni modo, non prima che le entrate del bilancio dello Stato Albanese abbiano raggiunto la cifra di Cinquanta milioni di franchi oro anni».

«Confermo a Vostra Eccellenza che, in conformitá al carattere di questi prestiti, l'ammontare dei quali non sará mai superiore ai dieci milioni di franchi oro per esercizio, essi dovranno essere diminuiti proporzionalmente all'aumentare dei redditi o alla diminuzione delle spese, di qualsiasi natura, dello Stato Albanese; e che, infine, essi saranno per la maggior parte devoluti allo sviluppo dei lavori Pubblici, dell'Economia e della'Educazione Nazionale».

«Posso infine, Signor Ministero, a dichiarare a Vostra Eccellenza che questi atto del Regio Governo Italiano si basa sulla continuitá della piena e sincera collaborazione tecnica e politica fra i due Governi; ed esprimo la fiducia che la loro amicizia avrá, da questa grande prova di fraternitá, una nuova consacrazione morale nello spirito del popolo albanese, al di fuori ed al di sopra dei trattati e degli interessi pratici ehe giá ci legano cosi intimamente".

Il Governo Reale d'Albania, ringraziando Vostra Eccellenza per la comunicazione, si dichiara d'accordo con quanto è espresso nella lettera dell' Eccellenza Voastra, specialmente per quanto riguarda la condizione di cordiale amicizia e di piena e sincera collaborazione tecnica e politica su cui il Regio Governo d'Italia basa il suo atto, e ringrazia la Grando Nazione Alleata, per l'aiuto cosi efficace che esso ha voluto portare all' Albania, nella certezza ch'esso, costituendo un nuovo indimenticabile titolo di riconoscenza, rinsaldera sempre piu i vincoli morali e politici che uniscono giá i due popoli vicini.

Approfitto dell' occasione per rinnovarle, Signor Ministro, gli atti della mia più alta considerazione.

Ministro degli Affari Esteri
H. Vrioni

A sua eccellenza
Il Marchese Antonio Meli Lupi di Soaranga
A sua Eccellenza
Il Marchese Antonio Meli Lupi di Soragna
Inviato Straordinario e Ministro Plenipotenziario
di S. M. il Re d'Italia
TIRANA

Nr. 85

LIGJË 15 Qershor 1931

Mbi Avokatët

(Botue në Fletoren Zyrtae Nr. 42 datë 4 Korrik 1931)

TITULLI I.

Avokatët dhe Përfaqsuesit në Gjyq

KAPTINA I.

Dispozita të Përgjithshme

Neni 1.

Ushtrimi i profesionit t'avokatit e të Përfaqsuesit në Gjyq rregullohet si mbas dispozitave të kësaj Dekret-Ligje.

Neni 2.

Për me ushtrue avokatinë në Shqipnië, duhet:

1) me qenë shtetas Shqiptar;

2) me pasë mbushë moshën 24 vjeç;

3) me folë lirisht dhe me këndue e shkrue gjuhen Shqipe;

4) me gëzue të drejtat civile e politike;

5) mos me qenë i dënuem për ndonjë delikt, për të cilin ligja cakton ndeshkimin me ndalim të përhershem nga ofiqet publike, ose të përkohëshem, për sa kohë vazhdon ndalimi, ndeshkimin me vdekje ose me burgim të përhershem ose me nji ndeshkim tjetër kundra liriës personale në minimum jo ma pak se tre vjet, dhe sikur për shkak cinkonstancash lehtësore të jetë vue nji ndeshkim per ma pak se tre vjet; gjithashtu mos me qenë i dënuem për falsifikim monedhash ose kartash me kredie publike,

për falsifikim vule, timbrash dhe figurash të tyne, aktesh, pasaportash, letër-lejimesh e kalimesh dhe deshmiësh për simulim faji, për çpifje dhe të rremun në gjyq, për lypsi, vagabondazh, për vjedhje, prè, shtrengim, mashtrim, keq përdorim besimi fshehje sendesh të vjedhuna, spekullim, mitë, dhuntim, kondrabandë, për goditje të cipës publike, demoralizim fizik i të vegjëlvet, turpnim me violencë, pederasti, dhe për shtyrje në turpnim dhe luksur me violencë.

6) me pasë mbarue nji fakultet të Drejtësis dhe me pasë sherbye të pakten gjashtë muej si Gjyqtar, Ndihmës Gjyqtar, Noter, ose Kryesekretar Gjyqi ose me pasë vazhdue stazhin një vjet pranë një avokati, që ushtron këtë profesion prej dy vjet e gjysmë pranë nji gjykate të Shk. I. ose me pasë ushtrue stazhin nji vjet pranë nji Gjykate, në raste kur avokatatët e nji qarku refuzojnë të pranojnë kandidatin në zyrat e tyne për stazhin e lypun sipër; ose me pasë plotësue këtë periudhë pjesërisht në këto detyra në të cilën rast një muaj gjyqtari ose funksionari i Gjyqit si ma nattë konsiderohet e barabartë me dy muaj ushtrim ose stazh pranë nji avokati ose stazh pranë nji gjykate.

Neni 3.

Kanë të drejtë me ushtrue profesionin e avokaties dhe ata që tue pasë cilësinat e caktueme në numurat 1-5 të nenit të ma sipërm, kanë mbarue para datës 30 Dhetuer 1922 një Shkollë administrative Mylqije ose Nuvabi, ose tri klasë të nji fakulteti të Drejtësiës dhe, kanë ushtrue avokatiën ose gjyqtarinë, e qi kanë hye në të pestin vjet të avokatiës dhe (3) tre vjet të gjyqtarisë, para hymjes në fuqi të kësaj Dekret-Ligje, ose sa do qi nuk kanë nji diplomë shkollore por kanë ushtrue profesionin e avokatiës ose kanë sherbye si gjyqtar ose si avokat, e qi kanë hye në të pestin vjet si gjyqtar dhe, në të dhjetin si avokata para hymjes në fuqi të kësaj Dekret-Ligje.

Neni 4.

Profesioni i avokatiës asht i pa pajtueshem me cillësin' e Noterit dhe me çdo nëpunësië publike a të veglohet me shperblim si edhe me cilësiën e fetariës, pos profesorve të Drejtësies, të Liceut dhe të shkollave të tjera të mesme, ku mund t'apin mësime me orë ndër shkolla.

KAPTINA III.
FORMALITETET E LYPUNA PËR USHTRIMIN E AVOKATIES

Neni 5.

Askush nuk mundet me ushtrue profesionin e avokatiës pa marrë leje prej Ministriës së Drejtësies dhe pa u regjistrue në radhorin e posaçëm t'asajë Ministrie.

Neni 6.

Ay që do të marrë leje avokatie dhe m'u inskriptue në radhorin e përmendun në nenin e ma sipërm, detyrohet me i paraqit istris së Drejtësis me anë të Prokurorit të Shtetit të qarkut të Gjyatës pr anë së cilës don me ushtrue avok itiën nji kerkese së bashkume.

1) Nji certifikat të zyrës së Gjendjes Civile që tregon Shtetësien Shqiptare dhe moshën e kerkuesit;

2) Nji certifikat të Prokuroriës së Shtetit të qarkut, nga e cila rezulton se kërkuesi nuk asht i dënuem për ndonjanin nga fajet e tregueme në numrin 5 të nenit 2.

3) Diplomen ose kopjen autentike të kësaj bashkë me përkëthimin perkatës të legalizuem;

4) Kuer kërkuesi ka diplomë fakulteti të Drejtësies, certifikaten e leshueme prej avokatit ose prej Sekretariës së gjykatës, pranë të cilit ka krye stazhin e urdhënuem në numurin 6 të nenit 2 ose shenimet e nëpunësis se tij.

Prokurori i Shtetit, mbassi të marri informatat e duhuna mbi ketë kërkim, tue çfaq edhe mendimin e vet, aktet përkatëse i a dergon Ministriës së Drejtësies, e cila i a parashtron Këshillit të Eperm Gjyqsue.

Këshilli i Eperm passi të studjojë aktet vendos me shumicë ose bashkerisht mbi akordimin e lejes dhe mbi inskriptimin e kerkuesit në radhorin e posaçem ose refuzimin e kërkimit, tue i a njoftue t'interesuemit përfundimin.

„Gjith aktet q'i përkasin ç'do leje ruhen në Archivin e Ministriës së Drejtësiës.

Neni. 7.

Inskriptimi i avokatit në radhorin e posaçem bahet tue vue për seicilin Inskriptim nji numur renduer dhe tue shenue emnin, mbiemnin, dat-lindjen banesen ose qendresen e avokatit. daten që ka mbarue Shkollen e Drejtësiës dhe Universitetin nga i cili ka marrë diplomë dhe kur nuk asht i diplomuem këtë permendje, daten e lejes t'avokaties, dhe mâ në fund daten e Vendimit të Këshillit të Eperm Gjyqsuer.

Radhori do të përmbajë dhe nji shtyllë të posaçme ku do të shenohet ç'do ndeshkim, që mund t'i vehet avokatit n'ushtrimin e profesionit të tij.

Neni. 8.

Në rast që vendoset akordimi i lejes, para se të jepet leja dhe të kryhet inskriptimi në radhorin e posaçem, kërkuesi detyrohet me paraqitë diftesen e Arkës së Financavet për pagimin e taksës së lejes prej Fr. ari 100 (njiqind), e cila deftesë ka me u bashkue me aktet relative.

Pas marrjes së lejes dhe para fillimit në ushtrimin e profesionit, avokati ka me ba, para trupit gjykues të gjykatës kolegjiale të qarkut ku ka me ushtrue avokatiën, bèn e poshtëshenueme:

«Betohem n'emën të Perendies dhe mbi nderin t'em se kam me qenë besnik i Mbretit dhe kam me respektue Statutin dhe gjith ligjët e Shtetit dhe, se kam me ushtrue profesjonin t'em me ndergjegje të plotë».

Neni. 9.

Emnat e avokatëve që marrin leje pas shpalljes se listës do t'ju njoftohen prej Ministries së Drejtësies gjykatevet të Shk. Irë, të qarkut, ku avokati ka me ushtrue profesionin e vet.

Neni. 10.

Avokati që pranon në zyrën e tij një stazhier i cili do të bajë stazhin e caktuem në numrin 6 të nenit 2, do t'i japë këtij nji certifikatë, e cila duhet të regjistrohet në thembrën e emnit të atij avokati, në radhorin që mbahet në Sekretarin e Gjykatës së vendit për avokatët e qarkut tue, shenue emnin e pratikantit dhe Shkollen që ka mbarue. Stazhi konsiderohet se fillon në daten e këtij regjistrimi.

Neni. 11.

Stazhi duhet të jetë vazhdues dhe i pa-nderpremë.

Në rast nderpremjeje, pratikanti që do me vazhduë stazhin detyrohet me i provue kryetarit ose gjyqtarit shkaqet e arësyeshme t'asaj nderpremjeje, dhe me plotësue stazhin per sa kohë asht nderpre. Kur shkaqet e parashtrueme nuk janë të drejta nuk merret parasyesh stazhi i kaluem, dhe në ketë rast duhet të bajë nji stazh të ri.

Neni. 12.

Stazhieri që kalon nga nji avokat tek nji tjeter detyrohet

me i a deklarue këtë transferim me shkresë Kryetarit të gjykatës mbrenda nji muaji, tue i paraqitë certifikatën e avokatit që len, si dhe certifikaten e avokatit tjeter, nga e cila rezulton pranimi i këtij per vazhdimin e stazhit.

Të dyja këto certifikata do të vistohen prej Kryetarit ose gjyqtarit dhe do të ruhen.

Për transferimin e stazhierit do të bahet shenim në rregjistrin e treguem në nenin 10.

Neni. 13.

Stazhi në gjykaten qe si mbas numurit 6 të nenit 2 lejohet vetem në rast kur avokatët refuzojnë të marrin stazhierin në zyrat e tyne, duhet të provohet me nji certifikatë të krye-sekretariës së gjykatës, të vistueme prej kryetarit ose Gjyqtarit.

Per këtë gja do të mbahet në sekretarië nji listë ku do të tregohen audiancat në të cilat eksiston stazhieri.

Stazhierit nuk do t'i epet çertifikate në qoftë se nuk ka asistue të pakten në gjysmen e audiencavet që ka mbajtë gjykata në vazhdimin e dy vjetve.

Neni. 14.

Në vendet ku ka edhe gjykata te Shk. Irë, dhe të Paqit Pratikanti duhet t'asistojë gjashtë muej në të paren dhe gjashtë muej në të dyten.

KAPTINA IV.

Të drejtat dhe deryrat e Avokatëvet

Neni. 15.

Avokatet që kanë cilësiet e tregueme në nenin 2 si dhe ata të përmendun në nenin 3 që kanë marrë lejen përkatëse tue u inskriptue në radhorin e posaçem të Miministriës së Drejtësiës, kanë të drejtë me ushtrue profesionin e tyre përpara çdo gjykatë dhe autoriteti të Shqipniës.

Neni. 16.

Avokatët kanë të drejtë shpërblimi për çeshtje qi mbrojnë dhe për mendimet që çfaqin me shkrim ose gojas.

Por këto detyrohen me i u dhanë sherbimin e tyne profesional pa shpërblim personave të vobeket, si mbas dispozitave të caktueme në titullin II të kësaj Dekret Ligjë.

Në rast që avokati rezulton me dhanë sherbimin profesional

si mbas paragrafit të sipërme, ndeshkohet me ndalimin e ushtrimit avukatuer për një javë deri në tre muej. Në ç'do rast përseritjeje ndalimi dyfishohet.

.Kundra vendimeve të sipërme avokati ka të drejtë rekurimi në bazë të dispozitave proceduriale.

Neni. 17.

Avokatët detyrohen me mbajtë msheftësiën në çashtjet që u besohen, dhe me ruejt gjithë aktet, deftesat, kopjet e shkresat që u përkasin çeshtjevet të mbrojtuna prej tyne. Kontravajtësit denohen si mbas dispozitave të Kodit Penal.

Neni. 18.

Avokatët do të mbajnë nji radhor të përgjithshem ku do të shenojnë padiënat që marrin përsipër, emnin dhe mbiemnin e ndergjyqësvet, landen e padiës, dokumentat që kanë marrë në dorëzim dhe përfundimin e padiës; si dhe nji radhor tjetër në të cilin do të shenojë shperblimin avokatuer të paktuem, shumat qi marrin dhe shpenzimet gjyqsore që kanë pague.

Këta radhorë do të vistohen prej Gjyqtarit të Paqit të vendit.

Këta radhorë do të vistohen prej gjyqtarit të paqit të vendit.

Neni. 19.

Avokatët munden mos me pranue përfaqësimin e nji padie, pa qenë të detyruem me tregue arësyenat e refyzimit. Në rastet kur përfaqesimi u ngarkohet detyrimisht, këta do të çfaqin shkaqet e refyzimit të cilat kur shifen t'arsyeshme, pranohen prej gjyqit ose refuzohen.

Neni. 20.

Per veprimet e avokatëve dhe të përfaqsuesve të tjerë aplikohen nenet 256, 257, 258, të Kodit Penal.

Neni. 21.

Avokatët qi kanë shoqënie midis tyne, mund të marrin mbrojtjen vetëm të njanës anë nga palet, dhe jo njani të bashkohet përfaqësues i paditsit e tjetri i të paditunit.

Neni. 22.

Avokatët, qi kanë çfaqë mendimin e tyne me shkrim me një çeshtje nuk munden po për ate çeshtje me pranue barren e arbitrit, përndryshe vendimi arbitruer mund t'atakohet si i pa vlefshem.

Neni. 23.

Avokatët passi të kryejnë përfaqësimin e çashtjes që kanë marrë persipër dhe të marrin shperblimin perkatës, detyrohen

me i kthye të përfaqsuemve të tyne në qoftë se i kerkojnë, diftesat dhe aktet origjinale t'asaj çashtjeje, si edhe leter përfaqsimin kur këtë e kanë ende.

Neni. 24.

Avokatët kanë tagrin me i'a renoncue klienteve të tyne përfaqësimin po në ket rast obligohen me përfaqsue klientin edhe katermbëdhetë ditë ç'prej komunikimit të renoncionit, kur këjo asht e nevojshme si mbas dispozitave të procedurës civile, për me i sigurue të drejtat klientit. Ketë obligim nuk e ka kur përfaqësimi revokohet nga ana e klientit.

Neni. 25.

Sa për detyrat e të drejtat e tjera midis avokatit dhe klientit, aplikohen me sa asht e mundun, dispozitat e Kod. Civil q'i përkasin kontratës së punës (pajtim).

Neni. 26.

Shperblimi i avokatit me raportë me klientin e tij caktohet prej konvensionit dhe në mungesë të këtij prej gjykatës.

Neni. 27.

Gjykata cakton shperblimet e avokatëve të cillat mund t'u ngarkohen të denuemvet, me shpenzime. Me ket caktim merr parasysh zotsiën dhe cillësiën e tyne si avokatë ose përrfaqësuesa në gjyq, vleften e padiës, studimet dhe kohen qi kanë humbë per përpilimin e akteve për m'u pregatitë, në mbrojtjen e çashtjes para gjyqit, ose për me plotësue ndryshe detyrat e tyne në veprimet, në të cilat marrja pjesë e tyne kërkohet ose autorizohet prej ligjës; por në ket rast nuk do të llogariten veprimet e tepërta.

Këto rregulla aplikohen dhe në caktimin e shperblimeve q'i detyrohen avokatit prej klientit të tij, kurdoherë që mungon nji konvencjon i lidhun midis tyne.

Neni. 28.

Avokatët mbajnë një sikuestro legale, mbi dokumentat që ju dorëzojnë klientat, deri sa ju paguhet shperblimi. Ana e klientit në rasë që kerkon dorëzimin e dokumentave i drejtohet Gjyqit Paqit, i cili decidon lirimin e dokumentave tue marrë çdo mënyrë garantie.

Neni. 29.

Kur avokati kërkon pagimin e shperblimit të tij të bazuem me nji akt noterial ose në pohim para Gjykatës, Kryetari Gjy-

katës ose Gjyqtari Paqtues kompetent urdhnon nxjerrjen e shper blimit me anën e Zyrës së Përmbarimit pa formalitete të tjera.

Kur shperblimi nuk asht lidhë në një akt detyrimi të legalizuem prej Noterit ose nuk pohohet prej të përfaqësuemit, caktohet prej gjykatës që ka gjykue çashtjen ose prej asajë q'asht kompetente si mbas ligjës. Vendimi që cakton shperblimin në ketë rast asht i eksekutueshem përkohësisht.

Neni. 30.

Avokati ose përfaqësuesi në gjyq qi pa arsye nuk i bindet thirrjes të Kryetarit të Gjykatës me zevendësue gjyqtarin që mungon me vendimin e atij gjyqi ndalohen nga ushtrimi i profesionit deri në 6 muej. Në rastë perseritjeje, ky ndeshkim dyfishohet.

I ndeshkuemi ka të drejtë rekurimi kundra këtyne vendimeve si mbas dispozitave proceduriale.

Neni. 31.

Munden me qënë përfaqësuesa në Gjyq:

1) Ata që tue pasun përpara 30 Dhetuer 1922 nji diplomë prej Mylqije, Nuvabi, Shkence politike, nuk kanë ushtrue profesionin e avokatiës ose të Gjyqtaries.

2) Ata që tue mos pasun nji diplomë kanë ushtrue avokaturen jo ma pak se (5) pesë vjet ose gjyqtarien për nji kohë jo ma pak se (3) tre vjet para hymjes në fuqi të kësaj Dekret-Ligjë;

3) Ata që kanë mbarue nji Fakultet Drejtësije dhe, nuk kanë çilsinat e tjera të tregueme në numrin 6 të nenit 3 të kësaj Dekret-Ligje.

Neni. 32.

Përfaqësuesit në gjyq kanë të drejtë t'ushtrojnë profesionin e tyne përpara ç'do gjykate, posë Gjykatës Kolagjale dhe asaj të Dikitimit.

Me gjithë këtë, në rastin që ka ma pakë se pesë (5) avokata, këto kanë të drejtë t'ushtrojnë profesionin e tyne edhe para gjykatave kolegjiale.

Neni. 33.

Cilsija e përfaqsuesit në gjyq asht e pa-pajtueshme me nëpunësi publike, me profesjonin e noteriës si dhe me cilsien e fetaries.

Neni 34.

Ay që don me marrë leje për me ushtrue profesionin e përfa-

qësuesit në gjyq, detyrohet me i paraqit Prokurorit të Shtetit të gjykatës Shk. Irë nji kerkesë tue bashkanjitë dokumentat justifikues që përmenden në nenin 6 të kësaj Dekret-Ligje.

Prokurori i Shtetit passi të marri informatat e duhuna, këtë kërkesë bashkë me dokumentat dhe me mendimin e vet i a referon Këshillit Drejtësis t'asaj gjykate, e cila vendosë mbi akordimin ose jo të lejës dhe i a transmeton Ministrit të Drejtësiës për veprim. Por Ministri kur nuk e shef të justifikuem vendimin e këtij Këshilli, ose kur i interesuemi nuk i bindet atij vendimi kanë të drejtë me kundershtue dhe m'e çue përpara Këshillit t'Eperm Gjyqsuer i cili vendosë definitivisht.

Afati i rekurimit asht 20 (njizet) ditë.

Në rast që akordohet leja, Ministri urdhnon inskriptimin e përfaqsuesit në Gjyq në radhorin e posaçëm të mbajtun për këta, passi të jetë pague në Arkën e Shtetit nji taks Fr. ari 50 (pesëdhetë).

Pas marrjes së lejes dhe para fillimit nga ushtrimi i profesionit përfaqsuesi në gjyq, detyrohet të bajnë bénë si mbas nenit 8 të kësaj Dekret-Ligje.

Neni 35.

Dispozitat e nenevet 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, e 28 e 29 të kësaj Dekret-Ligje, aplikohen analogjikisht dhe për përfaqësuesit në gjyqe.

KAPTINA V.

Shkruësët Publik

Neni 36.

N'ato qendra të gjykatave kur avokatet dhe perfaqësuesit në gjyqe nuk kapercejnë numurin pesë, kanë të drejtë me redaktue për tjetrin akte ose shkresa të drejtueme në nji gjykatë, dhe shkruesit publik të lejuem.

Kundravajtësit ndeshkohen me gjobë të lehtë nga 10 deri në katerqindë (400) Fr. ari ose me burgim të lehtë deri në nji muej. Në raste perseritjeje këto ndeshkime dyfishohen.

Shkresat qe nuk i perkasin gjyqevet mund të shkruhen prej cilido.

Shkresat dhe aktet që i paraqiten gjykatavet, do të kenë nenshkrimin e shkruesit ose vulen e Zyrës.

Perjashtohen nga këjo dispozitë ata të cilët redaktojnë për

vehte, bashkëshortin, të paralindunin, të paslindunin; gjinien deri në shkallën e katertë ose për krushqit deri në shkallën e dytë, aktet dhe shkresat e nalt-permenduna qi i perkasin gjykatave.

Neni 37.

Kanë të drejtë të jenë shkruesa publikë ata që:

1) kanë konditat e tregueme në numurat 1,3 4, e 5 të nenit 2.

2) kanë mbushë moshen 23 vjeç dhe kanë moral të mirë;

3) kanë marrë leje avokatie me ligjën e ma-parshme t'avokatvet pa pasë konditat e lypuna me atë ligjë, ose kanë mbarue të pakten nji Shkollë plotore dhe kanë sherbye pranë nji avokati të Kl. Irë ose gjykate tri vjet si pratikant, ose pranë nji Noteri si Sekretar, ose kanë sherbye si Sekretar ose Protokolist Kopist pranë nji gjykate të pakten dy vjet ose si sekretar ose pratikant pranë nji autoriteti tri vjet.

Neni 38.

Këshilli i Drejtësies i formuem prej Kryetarit, Prokurorit të Shtetit dhe Gjyqtarit të Paqit të vendit, në qarkun e të cilit i interesuemi don me ushtrue ket profesion mbasi të ketë konditat e kërkueme në nenin e ma sipërme, propozon në Ministrie për t'i dhanë leje për t'ushtrue profesionin si shkrues publik.

Këjo leje mund t'i hiqet shkruesit publik nga Ministrija me propozimiu e Këshillit të sipër-treguem, për shkak pa zotësije ose imoraliteti.

KAPTINA VI.

Vezhgim mbi Avokatët e Përfaqsuesat në gjyq dhe ndeshkimet disiplinore për këta

Neni 39.

Vezhgimi mbi avokatët dhe përfaqsuesat në gjyq ushtrohet prej Prokurorit të Shtetit, dhe në Nënprefekturat prej Gjyqtarit të Paqit.

Avokatët ose përfaqsuesat në gjyq që lëndojnë detyrat e ofiqeve të tyne ose me sjelljet e tyne mbrenda ose jashtë sferës të avokaturës cenojnë nderin ose famën e profesionit ndeshkohen disiplinisht.

Neni 40.

Ndeshkimet disiplinore që u vehen avokatëve ose përfaqsuesavet në gjyq janë:

1) vërejtja;

2) qortim;

3) pezullim nga ushtrimi i profesjonit;

4) heqja e lejes:

Vërejtja konsiston në njoftimin me shkresë të mungesës të bame dhe me këshillimin për mos m'e përsëritë ma atë mungesë.

Qortimi asht nji deklarim formal q'i bahet avokatit ose përfaqësuesit në gjyq, kur ky persërit fajin që ka shkaktue vërejtjen ose sillet në mënyrë të pa-pajtueshme me profesionin e tij. Qortimit mund t'i shtohet dhe gjoba deri me 300 fr. ari.

Pëzullimi nga ushtrimi i profesionit nuk mund të vendoset për ma tepër se nji vjet.

Randësija e fajit dhe e damevet të rrjedhuna prej atij faji do të shërbejë si kriter për me çmue cila nga ato ndeshkime duhet t'i vehen avokatit ose perfaqsuesit në gjyq.

Neni. 41.

Heqja e lejes do të vendoset sidomos kur:

1) me mënyra të jashtë-ligjëshme dhe kundra nji ndalimi I gjuer ka marrë leje, ose;

2) ka ushtrue avokatiën në kohen q'asht pezullue nga ay ushtrim.

Neni 42.

Ndeshkimet disiplinore mbi kerkimin e t'interesuemit ose të Prokurorit të Shtetit ose të Gjyqtarëve të Paqit të Nenprefekturave ose dhe kryesisht vendosen në Këshillë prej Gjykatës Kolegjiale në qarkun e së cilës ushtron profesjonin avokati ose përfaqsuesi në gjyq, dhe mbassi të ndigjohet edhe Prokurori i Shtetit.

Këto ndeshkime i njoftohen Ministris së Drejtësis.

Neni 43.

As nji ndeshkim nuk mund të vendoset pa i u komunikue me anë ftuesi avokatit ose përfaqësuesit në gjyq nji letër-thirrje për t'u paraqit përpara gjykatës tue, i shenjue nji afat të paktën dhetë ditësh për me parashtrue mbrojtimet e veta.

Neni 44.

Vendimet mbi gjykimet për ndeshkime disiplinore mund të atakohen përpara Këshillit t'Epërm Gjyqsuer, mbrenda dhetë ditëvet prej datës së komunikimit të vendimit.

Vendimi i Këshillit t'Epërm asht i premë.

Neni 45.

Avokati ose përfaqësuesi në gjyq kundra të cilit asht vendo-

së heqja e lejes, mund të pranohet përsëri me ushtrue profesionin mbas nji vendimi favorabel të gjykatës kolegjiale që ka pasë vendos atë ndeshkim:

1) kur ay avokat ose përfaqsues në gjyq tue qenë i denuem për nji faj që shkakton fshimjen e tij nga radhori asht riaftësue si mbas dispozitavet të procedures penale;

2) kur në rastet e tjera kanë kalue tre vjetë çprej heqjes së lejes;

Në rastet e sipër tregueme vendimi i Gjykatës Kolegjiale duhet të vërtetohet prej Këshillit t'Epërm Gjyqsuer, dhe në këto raste nuk merret rishtazi taks.

Neni 46.

Kryetari i Gjykatës Kolegjiale të cillit drejt për së drejti i bahet nji ankim kontra nji avokati ose i referohet prej Prokuroris së Shtetit n,ë kerkim për nji ndeshkim disiplinuer nga ato të përmenduna në nenet e ma sipërme. ka të drejtë me hetue vetë ose me anë të ndihmësit të tij faktet që formojnë objektin e pandehsis tue, marrë informatat e duhuna. Këto hetime i a raporton gjykatës e cila mbrenda njëzet ditëve çprej ankimit ose akuzes të Prokurorit, detyrohet me vendosë mbi çeshtjen.

Vendimi i Gjykatës i komunikohet mbrenda dhet ditëve Prokurorit dhe ankuesit, dhe kur përmban dënim; të dënuemit.

Neni 47.

Kur vendimi i dhanun në çeshtje disiplinore atakohet prej Prokurorit të Shtetit ose prej ankuesit, nji kopje e kerkesës do t'i komunikohet mbrenda tre ditëve avokatit ose përfaqsuesit në gjyq për me dhanë ky përgjegjen e vetë.

Neni 48.

Vendimet mbi ndeshkime disiplinore q'u vehen avokatëvet dhe përfaqësuesve në gjyq shenohen me datën dhe llojin e ndeshkimit që përmbajnë në thembrat e emnavet të tyne në radhorin e mbajtun për këto në Sekretarien e gjykatës Shk. I; dhe n'atë të Ministris së Drejtësies.

KAPTINA VII

Dispozita transitore

Neni 49.

Mbrenda pesëmbëdhetë ditëve çprej hymjes në fuqie të kësaj Dekret-Ligje. gjith ata që kanë marrë leje avokatije detyrohen

me i a paraqitë Prokurorisë së Shtetit të vendit ku ushtrojnë profesjonin bashkë me dokumentat justifikues në qoftë se nuk i kanë parashtrue me parë.

Ata që nuk i binden kësaj dispozite ndalohen nga ushtrimi i profesionit deri sa të konformohen.

Ministrija e Drejtësiës me të marrë lejet nga Prokuroriët e ndryshme mbrenda pesë ditëve do t'i a paraqesi Këshillit t'Epërm Gjyqsuer për me dhanë vendimin e tij.

Neni 50.

Këshillit t'Epërm mbas shqyrtimit që ban klasifikon secilin prej tyne që kanë marrë leje në kategorinë e avokatve ose të përfaqësuesvet në gjyq si mbas dispozitave të kësaj Dekret-Ligje, ose vendos heqjen e lejës së dhanun.

Neni 51.

Taksa e pagueme për lejet e dhanuna ma parë llogaritet, por nuk këthehet taksa e pagueme simbas ligjës të pa-parëshme, kur paguesit i hiqet leja.

Gjithashtu përfaqsuesat në gjyq që kishin ma parë leje avokatije nuk kanë të drejtë me kërkue këthimin e diferencës së taksës së pagueme.

Neni 52.

Me gjith ç'ka urdhënohet në nenin 32 përfaqsuesat në gjyq kanë të drejtë me vazhdue deri në përfundimin definitiv ato padiëna, mbrojtjen e të cilave e kanë fillue para hymjes në fuqie të kësaj Dekret ligje para gjykatavet kolegjiale.

Neni 53.

Në qendrat e Gjykatavet Fillore dhe Kolegjiale ku mungojnë avokatë dhe përfaqsuesa në gjyq në çashtjet penale të parapame në nenin 128 të Statutit Themeltar të Mbretniës Shqiptare, Kryetari ka me shenue si përfaqësues mbrojtës për të pandehunit nj nin nga personelin e Sekretaries t' asaj gjykate ose Noterin.

TITULLI II.

Benefici i vobekësiës

Neni 54.

Ay që nuk mundet me i ba ballë shpenzimeve të një padije pa damtue ushqimin e domosdoshëm për të ose për familjen e tij, mundet me obtenue beneficin e vobektësiës.

Ky benefic i akordohet të huejvet vetem me kusht recipro-

citeti. Në qoftë se reciprociteti asht i dyshimtë, pyetet për ketë Ministrija e Drejtësies, deklarimi i së cilës asht i detyrueshem per gjykaten.

Neni. 55.

Me koncedimin e beneficit të vobekësiës, ana fiton per padiën e caktueme:

1) Shkarkimin përkohësisht nga timbrat dhe taksat e tjera, që kishin me u pague per shkak të padiës;

2) Përjashtimin nga prestimi i garanciës për shpenzime gjyqësore;

3) Të drejten për me kërkue emnimin e nji avokati për me mbrojtë të drejtat e tija përkohësisht pa shperblim, në qoftë se ligja urdhënon që n'atë padië duhet të përfaqësohet me anë avokati;

4) Tagrin me ba padiën me proces-verbal në gjykaten Paqtuese të vendit të banesës ose të ndenjes së qendrueshme të tij në raste kur në një padië, për të cilen ligja nuk urdhënon perfaqësimin me anë avokati, kerkesa duhet t'i paraqitet një gjykate që ndodhet jashtë vendit të banesës ose të ndenjes të qendrueshme të kësaj anë, dhe të drejten me kërkue që ky proces-verbal t'i dergohet gjykatës që ka me shikue padiën dhe këjo t'i emnojë një përfaqsues që t'i mbrojë pa shperblim të drejtat e tija në gjyq;

5) Shkarkimin përkohësisht nga pagimi i shperblimeve q'i takojnë nëpunësave gjyqësorë të deleguem, të drejtavet t'organevet t'eksekutimit, të deshmitarëvet dhe t'ekspertavet, i shpenzimeve për kopjet për botimet e nevojshme dhe ma së fundi i shpenzimeve tjera të nevojshme të bame nga ana e përfaqësuesit t'emnuem për të vobektin. Këto të drejta dhe shpenzime paguhen përkohësisht prej Arkës së Shtetit.

Neni 56.

Kërkimi për koncedimin e beneficit të vobekësiës bahet me shkresë ose me proces-verbal perpara gjykatës q'asht kompetente per me shikue padiën. Në qoftë se ana që kërkon këtë beneficic, nuk ka banesen dhe qendresen ose ndenjen e qendrueshme në qarkun e Gjykatës, mundet m'e ba me proces-vrbal kërkimin për koncedimin e beneficit të vobekësis pranë Gjykatës së Paqit të vendit, ku ka banesen ose qendresen ose ndenjen e qendrueshme të saj.

Neni 57.

Në kërkesë do të tregohet çashtja gjyqësore për të cilën duhet t'i koncedohet benefici i vobekësiës. Njëkohësisht do të paraqitet nji çertifikatë mbi gjendjen e pasunies s'anës, të cilës duhet t' i akordohet ky benifice. Më këtë çertifikatë duhet të tregohen t'ardhunat që këjo anë mbledh nga mjetet e fitimit ose nga të tjera burime dhe të vertetohet shprehimisht bashkë me tregimet nominale të personave për ushqimin e të cilëvet ana detyrohet eventualisht, pa zotësija e tij me prokurue shpenzimet gjyqësore.

Certifikata do të leshohet nga ana e Kryetarit të Bashkiës ose të Katundariës (Komunës) së vendit, në të cilen ajo anë ka n'atë kohë banesën ose qendresen ose ndenjen e saj; këjo certifikatë duhet të vertetohet prej Prefektit ose Nenprefektit.

Neni 58.

Gjykata që ka me shikue padiën do të vendosë edhe në se anës që kërkon koncedimin e beneficit të vobekësiës, duhet t'i shenohet nji avokat ose përfaqësues. Po këjo Gjykatë asht kompetente me vendosë mbi ç' ka u tha ma sipër, edhe kur shkaku i emnimit të nji avokati ose përfaqësuesi për nevojë të nji procedimi në rrugët ligjore ose për të tjera arësyena, lind mbassi i asht koncedue benefici i vobekësiës.

Neni 59.

Vdekja e anës se cilës i asht koncedue benefici i vobekësiës, si edhe ndryshimet që mund të ngjajnë në gjendjen e pasuniesë së kesaj te cilat ma pas ngrehin konditat që kanë shkaktue koncedimin e beneficit të vobeksis sjellin shuemjen e këti benefici. Në ketë rastin e fundit shuemja e beneficit të vobeksis vendoset, kryesisht ose mbi kerkim prej gjykatës që shikon padiën.

Benefici i vobekësis revokohet mbi kërkim ose kryesisht me nji vendim të gjykatës që shikon padien, posa që rezulton se qysh në kohën e koncedimit nuk ekzistojshin konditat, për të cilat ishte koncedue benefici.

Neni 60.

Palët që kanë obtenue, pa të drejtë tue tregue faktet jo të vërteta, koncedimin e benificit të vobekësis ; ndeshkohen me gjobë të lehtë deri në treqind fr. ari.

Ay që tue dijtun parashtron fakte jo të vërteta ose tue dijtun konformon si të vërtetë një gja që s'asht e vertetë në certifikatën

e tregueme në Nenin 55, përveç konsekuencavet të Kodit Penal, asht pergjegjës, në qoftë se asht koncedue benefici i vobekësiës, për shumat nga pagimi i të cilave ishte nderkohesisht i perjashtuëm për shpenzimet e nji perfaqësimi eventual me anë avokati, dhe për ç'do dam tjetër të shkaktuem.

Neni 61.

Kur kundërshtarit t' anës që ka obtenue benificin e vobekësiës i ngarkohet pagimi i shpenzimeve të padies, shpenzimet e treguemë në nenin 55. Nr. 1 dhe 5, nga pagimi i të cilëve ana e vobekët nderkohesisht ishte e shkarkueme, si edhe shpenzimet që kanë ba avokatët e emnuem për anen e vobektë, mund t'i nxirren drejtë për së drejti prej kundershtarit.

Avokatit mund t'i kundershtohen në ketë rastë prapësime që rrjedhin nga raporte juridike të ndodhme midis anës së vobektë dhe kundershtarit t'asaj, vetem kur bahet fjalë nji llogari shpenzimesh, pagimi i të cilavet i asht ngarkue anës së vobekët po në atë padië, në dobië të kundërshtarit të sajë.

Neni 62.

Kuer eksistojnë shkaqe për revokimin e beneficit të vobekësiës, ana së cilës i asht akordue ky benefic, detyrohet mbi kërkimin e t'interesuemit, me pagimin plotësues të shumavet, nga të cilat ishte shkarkue përkohësisht, në bazë të beneficit të vobekësiës si mbas gjendjes së pasuniës s'anës së vobekët, mund t'i ngarkohet kësaj edhe vetem nji pjesë e plotësueses.

Në rasë të nji obligimi për pagim plotësues i ngarkohet anës, piksëpari pagimi i shpenzimevet që janë në kurriz t'arkës së Shtetit si mbas Nenit 55 Nr. 5, mandej pagimi i shperblimit avukatuer, dhe ma së fundi pagimi i pullavet dhe i taksavet.

Neni 63.

Në ç'do rast, gjykata, para se të vendosë, mundet kryesisht me kerkue shpjegimet, q'i konsiderohen eventualisht të nevojshme.

Vendimi me të cilin i koncedohet njanës prej palëvet benefici i vobekësies, si edhe vendimi që urdhëron për anën e vobektë emnimin e nji avokati nuk mund t'atakohet me asnji rrugë ligjore.

Për veprimet e procedimit që do të bahet përpara gjyqtarëvet si mbas rregullave të caktueme në këtë titull, nuk asht nevojë që palet të përfaqësohen me anë avokati edhe kur gjykata që

vepron asht nga ato, në të cilat asht i nevojshëm përfaqësimi me anë avokati.

TITULLI II.

Dispozita të veçanta

Neni 64.

Ligja e Avokatëve me datë 30. XII. 1922 si edhe të gjitha ligjët e tjera që janë në kundershtim me ketë Dekret Ligjë mbeten pa fuqië.

Neni 65.

Kjo Dekret Ligjë hynë në fuqi që nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 66.

Ministrija e Drejtësies ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-ligjë.

Zav. Kryeministri
Ministër i Drejtësies e
Zav. Ministri i P. Mbrendshme
H. Delvina

Ministri i Financavet
M. Tutulani

Ministri i P. Botore
S. Vuçiterni

Ministri i Ekonomis Kombëtare
M. Juka

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministriës Nr. 1937 datë 11. II. 929,
Si ndigjojë dhe pelqejë venpimin e Këshillit Ministruer.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi avokatët.
Tiranë, me 18-VII 1929.

ZOG.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON

Zbatimin e Dekret-Ligjës me datë 18-VII-1929, mbi avokatët,

BKSH

t'aprovueme prej Parlamentit, dhe Urdhenon shtimin e saj në Kodet e Mbretnis si Ligjë.

Tiranë, me 15 Qershuer 1931

Z O G.

Nr. 86

RREGULLORE 30 Qershor 1931

E komisionit për pjestimin dhe përdorimin e Huave të akordueme prej Italisë Shqipnis, në vjetin 1931-32 dhe për vitet që pasojnë

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 43 datë 6 Kosrik 1931)

Neni 1. Themelohet nji Komisjon i përhershem për pjestimin dhe përdorimin e shumave që përbëjnë huat vjetore të përmenduna në Ligjen me 24 Qershuer 931.

Neni 2. Komisjoni përbahet prej kater antarësh, t'emnuem me Dekret Mbretnuer. Dy nga antarët do të zgjidhen midis organizatorave Italjan në sherbimin e Shtetit Shqiptar.

Neni 3. Antarët qi kanë me pushue, përkohësisht ose definitivisht prej detyrës, kanë me kenë të zevendesuem, përkohësisht ose definitivisht me aq antarë qi emnohen edhe këta me Dekret-Mbretnuer, në menyrë që të përbamunit e Komisionit të jetë si asht i vendosun në Nenin 2. ,

Neni 4. Nalt-Madhënija e Tij Mbreti, emnon nji prej antarëve të Komisjonit si Kryetar. Vota e Kryetarit asht baras me voten e secilit do antar të Komisionit.

Neni. 5. Vendimet e Komisjonit kanë me u marrë me shumicë votash dhe për vleftësin e këtyne vendimeve duhet marrja pjesë e kater antarëvet.

Gjith vendimet e maruna si të kalojnë neper kanalet e ndryshme si mbas ligjëve të Shtetit, marrin formen e preme mbas pelqimit të Nalt-Madhnies së Tij Mbretit.

Neni 6. Detyrat dhe të drejtat e Komisjonit janë:

a) Vendosë dhe merr masa për të marrë nga huat shumat qi do të vehen në dispoziten e administratave të ndryeshme dhe cakton administratave pjesat e shumave që u përkasin. Për me krye ketë qëllim, Komisjoni ka me ekzaminue kërkesat e shumave dhe programet e përdorimit të tyne, që secilla admnistratë detyrohet me i parashtrue. Komisjoni mundet me i aprovue

Neni 10. Kjo Rregullore hynë në fuqi që ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 11. Trupi Ministrave ngarkohet me zbatimin e kësaj Rregullorje.

Kryeministri e
Zav. Ministri Ekonomis Kombëtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësies e
Zav. Ministri i Arësimit
M. Tutulani

Ministri i P. Jashtme
H. Vrioni

Ministri P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministries Nr. 1178 VIII datë 24.VI 931.

Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 24 Qershuer 1931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Rregullores mbi funksionimin e Komisionit të posaçëm për pjestimin dhe përdorimin e huanavet.

Tiranë, me 30 Qershuer 931

ZOG.

Nr. 87

DEKRET-LIGJË 6 Korrik 1931

Mbi zgjatimin e afatit të Fabrikës së Birrës në Shkodër

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 44 datë 10 Korrik 1931)

Art. 1

Mbi afatin e fillimit të fabrikimit të birrës në Shkoder prej anës së Vllazerve Kakariqi, për të cilën ban fjalë Art. 11 i Akt-konvencionit të shpallun në Fletoreu Zyrtare Nr. 2 datë 7. I. 927,

e n' art. 1 të Ligjës mbi Zgjatimin e afatit të fabrikimit të birrës shpallun në Fletoren Zyrtare Nr. 37 datë 8 Korrik 1929, autorizohet Ministrija e Ekonomis Kombëtare me ba nji zgjatim afati prej dy vjetë e 10 Mujëshë.

Art. 2.

Konçesjonarët janë të detyruem me fillue në punimet e fabrikës mbrenda 10 muejve prej datës qi të shpallet ky Dekret-Ligje në Fletoren Zyrtare, dhe prej mbarimit të këtij afati mbrenda në dy vjet me kompletue fabriken dhe me fillue fabrikimin e Birrës. Në rastë të kundertë, konçesjoni quhet i anuluem.

Art. 3.

Ky Dekret Ligjë hynë në fuqi që me daten e shpalljes së tij në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Ministrija e Ekonomis Kombëtare dhe ajo e Financevet ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

Kryeministri e
Zav. Ministri Ekonomis Kombëtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësie
M. Tutulani

Ministri i P. Jashtme
H. Vrioni

Ministri i P. Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i Arsimit
Hil Mosi

Ministri i Punëve Botore
Izet Dibra

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 914 datë 27-VII-931, Si ndigjoj dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 26-VI-1931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi zgjatimin e afatit të Fabrikës së Birrës në Shkoder.

Tiranë, me 6-Korrik 1931.

ose me i ndryshue kto kërkesa dhe programe, dhe me parashtrue me iniciativen e vet administratave kompetentë, propozime për përdorimin ma të mirë të këtyne shumave.

Me urdhënin e Nalt-Madhënies së Tij Mbretit, mundet me kontrollue drejt për drejt ose me ndermjetesin e delegatve të posaçem, dokumentat shkrimet, dhe kontabilitetet të çdo natyre qi gjinden pranë administratave dhe që kanë lidhje me përdorimin e shumave të huanavet

b) Përpara se të paraqiten për shqyrtim Këshillit të Shtetit, me urdhënin e Nalt-Madhënies së Tij Mbretit, Komisjoni ka të drejtë me ekzaminue proceduren, formimin e akteve, kontratave të konçesjoneve dhe emnimet e ndryshme, që angazhojnë administratat Shtetnore, gjithmonë me sa këto i përkasin përdorimit të shumave të huanavet.

Komisjoni do t'api mejtimin e vet mbi konfliktet të çdo nature që munden të lindin mbi aktet si kontrata, konçesjone emnime etj. qi kanë lidhje me huat. Do t'api mejtimin e vet edhe ë rast të nji konflikti që mundet të lindi në kohën e zbatimit të këtyne tue respektue kurdoherë organave Shtetnorë të drejtat që u apin ligjët në fuqi.

c) Gjithmonë me urdhen të Nalt - Madhnies së Tij Mbretit, Komisioni do t' i njoftojë Qeveriës, dhe kjo asht e detyrueme t' i ekzaminojë, proponimet prej të cilavet mundet me rrjedhë nji përmirësim të situatës Financiare si edhe ato qi për natyren e tyne munden me e ligshtue.

Per ketë qellim mundet me marrë njoftim drejt për së drejti ose me anen e delegateve të posaçem mbi aktet relative të ndryshme qi gjinden pranë administratave.

Neni 7. Komisjoni, perevç personalit të Zyrës, ka me mujt me përdorue edhe vepren e nëpunsave administrative dhe teknike për me mujt me mbarue detyrat qi janë të njoftuna prej kësaj Rregulloreje.

Neni 8. Shpenzimet e çdo natyre për funksionimin e Komisjonit si edhe shperblimet qi kanë me u dhanë antarve të Komisjonit, përsonalit të Zyrës dhe nëpunsave që munden të merren në sherbim do të paguhen prej Arkës së Shtetit.

Neni 9. Me mbarimin e huavet t'akordueme, funksionimi i Komisjonit merr fund me nji Dekret-Mbretnuer.

Nr. 88.

SHTOJCË - 22 Kallnduer 1931

Mbi Konçesionin për shfrytzimin e Pyjeve gjatë dy luginave të Drinit të lidhun ndërmjet Ministris së Ekonomisë Kombëtare, dhe të Z. Fuad Zembrak Dibrës

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 44 datë 10 Korrik 1931)

Art. 1.

Afatet e caktuem në Nenin 2, 3 e 18, zgjaten edhe nji vit tue fillue që nga data e shpalljes të kësaj Shtojcë.

Art. 2.

Kjo shtojcë hynë në fuqí që prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3

Ministrija e Ekonomis Kombtare dhe ajo e Financavet ngarket me zbatimin e kësa Shtojcë

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e shtojcës mbi konçesjonin për shfrytzimin e Pyjeve gjatë dy luginave të Drinit, të lidhun ndermjet të Ministris së Ekonomis Kombtare e të Fuad Zembrak Dibra e votuem prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 597-1, d. 12-I. 31 të Kryesies së Tij.

Tiranë, me 22-Kallnduer-931.

ZOG. I.

Nr. 89

DEKRET-LIGJË 30 Qershor 1931

Mbi përjashtimin nga tagra doganore e të tjera të misrit që ka me importue Ministrija e Financavet

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 44 datë 15 Korrik 1931)

Neni 1.

Ministrija e Financavet autorizohet me importue me përja-

shtim nga taksat doganore e të tjera taksa suplementare, nji sasi miser që ajo ka me gjykue të nevojshme, për me i ba ballë nevojave ushqimore të popullit qarqeve Vlonë dhe Gjinokastër.

Neni 2.

Misri i importuem ka me u shitë në skelet të shkarkimit jo ma tepër se fr.ari 20 ç'do kuintal. Bashkive mund t'i nepet në rasë nevoje me kredi nji afat nji muajit.

Neni 3.

Ministrija e P. Mbrendshme ngarkohet me rregullue me anën e Bashkive përkatese çperdamjen dhe shitjen e misrit nga skelet e shkarkimit në qarkun e Prefekturës të Gjinokastres dhe të Vlonës.

Neni 4.

Për blemjen e misrit qi do të importohet në budgetin e Ministries së Financavet dhe në pjesën e spenzimeve, Kapitulli «59 bis» të cilit i caktohet nji fonde i parapamë prej Fr. ari 60.000. Këtij Shpenzimi i bahet ball me t' ardhunat qi kanë me rezultue nga shitja e misrit dhe për ketë qellim krijohet në pjesën e t'ardhunave Kapitulli «56» me emertimin «Të hyeme nga shitja e misrit» të cilit i caktohet nji fond i parapamë prej Fr. ar 60.000

Neni 5.

Fitimet netto eventuale qi kanë me rrjedhë prej importimit dhe shitjes të misrit kanë me shkue në favor të Bankës Agrare Kombëtare.

Neni 6.

Ministrija e Financavet dhe ajo e P. të Mbrendëshme ngarkohen me zbatimin e këtij Dekret-Ligjit.

Neni 7.

Ky Dekret-Ligjë hynë në fuqi që nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri e
Zav. Ministri i Ekonomis Kombtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësies e
Zav. Ministri i Arësimit
M. Tutulani

Ministri i P. Jashtme
H. Vrioni

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
L. Kareco

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Ksyeministries Nr. 1192.-I datë 24. VI .931. Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 24 Qershuer 1931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret Ligjit mbi përjashtimin nga taksa doganore dhe të tjera tagra suplementare të misrit qi ka me importue Ministrija e Financavet.

Tiranë, me 30 Qershuer 931.

ZOG.

Nr. 90

LIGJË 30 Qershuer 1931

Mbi aprovimin e buxhetit preventiv t'ushtrimit 1931-32

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr· 45 datë 13 Korrik 1931)

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresen Nr. 75-23 date 24 VI 1931 të Kryeministries,

DEKRETON

Aprovimin e budgetit preventiv per vjetin Financiar 1931-32 me nji gjendje të parapame të hyemesh prej 29.097.000, (Njizetenandëmilion e nandëdhet e shtatëmijë) Fr ari e të shpenzimeve 31-533-422 (Tridhjet e njimilion e peseqindetredhetetrimijë e katerqindenjizetedy) Fr. ari bashkë me ligjen relative, të votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 151-I datë 24. VI. 1931, të Kryesies së Tij, dhe Urdhenon zbatimin e tyne.

Tiranë, me 30 Qershuer 1931

Kryeministri e
Zav. Min. Ekonomis Kombëtare
Pandelí Evangjelí
Ministri i Drejtsis
e Zav. Ministri i Arsimit
M. Tutulani
Ministri i P. Jashtme
H. Vrioni

Ministri i P. të Mbrendshme
Musa Juka

L. Kareco
Ministri i P. Botore
Izet Dibra

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E PARAPAMJEVE PËR T'ARDHUNA E SHPENZIME REALE PËR USHTRIMIN FINANCJAR 1931 - 32

	2	3	4
	Kompetenca si mbas gjendjes së parapamjeve për ushtrimin financjar 1930-31	Ndryshime qi propozohen	Kompetenca rrjedhse për ushtrimin financjar 1931-32 (shtylla 2+3)
	Fr. ari	Fr. ari	Fr. ari
T'ardhuna reale	31.385.000	— 2.288.000	20.097.000
Shpenzime reale.	31.385.000	+ 148.422	31.533.422
Diferenca	—	— 2.436.422	2.436.422

BKSH

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E PARAPAMJEVE PËR T'ARDHUNA E SHPENZIME EFEKTIVE TË RENDËSHME PËR USHTRIMIN FINANCJAR 1931 - 32

	2	3	4
	Kompetenca si mbas gjendjes së parapamjeve për ushtrimin financjar 1930-31	Ndryshime qi propozohen	Kompetenca rrjedhse për ushtrimin financjar 1931-32 (shtylla 2+3)
	Fr. ari	Fr. ari	Fr. ari
Kategori I.			
T'Ardhuna e Shpenzime efektive			
PJESË E RENDSHME			
Shpenzime:			
Ministri e Financavet	4.118.274	+ 1.123.776	5.242.050
Ministrí e Drejtsís	1.230.120	— 3.000	1.227.120
Ministri e P. të Mbrendshme e Drejt. P. Shndetsís	1.492.600	+ 109.380	2.051.980
Ministrí e P. Jashtme	800.000	+ 6.180	806.180
Ministrí e P. Botore e Drejt. e Përgj. e Post-Telegrafavet	2.498.200	— 230.473	2.267.727
Ministri e Ekonomis Kombtare . . .	1.031.400	— 30.897	1.000.503
Ministrí e Arsimit	3.533.980	— 367.171	3.166.809
Kom. e Mbrojtjes Kombtare dhe e Gjindarmeris	14.230.241	+ 869.959	15.100.200
Shuma	29.384.815	+ 1.477.754	30.862.569
T'ardhuna	31.170.000	— 2.098.000	29.072.000
Diferenca	+1.785.185	— 3.575.754	— 1.790.569

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E PARAPAMJEVE T'ARDHUNAVET E SHPENZIMEVE EFEKTIVE TË PA RENDSHME PËR USHTRIMIN FINANCJAR 1931-32

	2	3	4
	Kompetenca si mbas gjendjes së parapamjeve për ushtrimin financjar 1930-31	Ndryshime qi propozohen	Kompetenca rrjedhse për ushtrimin financjar 1932-33 (shtylla 2+3)
	Fr. ari	Fr. ari	Fr. ari
Kategori I.			
T'Ardhuna e Shpenzime efektive			
PJESË E PA RENDSHME			
Shpenzime:			
Ministri e Financavet	1.288.567	— 1.107.767	180.800
Ministrí e Drejtsís	38.580	—	38.580
Ministrí e P. të Mbrendshme e Drejt. e P. e Shndetsís	65.000	— 55.000	10.000
Ministrí e P. të Jashtme	—	—	—
Ministri e P. Botore e Drejt. e P. Post-Telegrafavet	—	+ 50.473	50.473
Ministrí e Ekonomís Kombtare . . .	116.000	— 116.000	—
Ministrí e Arsimit	—	—	—
Kom. e Mbrojtjes Kombtare dhe e Gjindarmerís	492.038	— 101.038	391.000
Shuma	2.000.185	— 1.329.332	670.853
T' ardhuna	215.000	— 190.000	25.000
Diferenca	—1.785.185	+ 1.139.332	— 645.853

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E PARAPAMJEVE T'ARDHUNAVE E SHPENZIMEVET EFEKTIVE TË RENDSHME E TË PA-RENDSHME PËR USHTRIMIN FINANCJAR 1931 - 32

	2	3	4
	Kompetenca si mbas gjendjes së parapamjeve për ushtrimin financjar 1930-31	Ndryshime qi propozohen	Kompetenca rrjedhse për ushtrimin financjar 1931-32 (shtylla 2+3)
	Fr. ari	Fr. ari	Fr. ari
Kategori I.			
T'Ardhuna e Shpenzime reale			
PJESË E RENDSHME DHE E PA-RENDSHME			
Shpenzime:			
Ministrí e Financavet	5 406 841	+ 16.009	5.422.850
Ministrí e Drejtsís	1.268.700	— 3.000	1.265.700
Ministri e P. të Mbrendshme e Drejt. P. Shndetsís	2.007.600	+ 54.380	2.061.980
Ministrí e P. Jashtme	800.000	+ 6.180	806.180
Ministrí e P. Botore e Drejt. e Përgj. e Post-Telegrafavet	2.498.200	— 180.000	2.318.200
Ministri e Ekonomis Kombtare . .	1.147.400	— 146.897	1.000.503
Ministrí e Arsimit	3.533.980	— 367.171	3.166.809
Kom. e Mbrojtjes Kombtare dhe e Gjindarmeris	14.722.279	+ 768.921	15.491.200
Shuma	31.385.000	+ 118.422	31.533.422
T'ardhuna	31.385.000	— 2.288.000	29.097.000
Diferenca	—	— 2.436.422	— 2.436.422

GJENDJA E PARAPAMJEVET E T'ARDHUNAVET

Gjendja e parapamjevet e t'ardhunavet për ushtrimin financjar 1931-1932 e vume në përballim me atë t'ushtrimit 1930-1931, paraqet rezultatet e shtrime në prospektin që ndjekë.

BKSH

	T'ARDHUNA TË RENDSHME			T'ARDHUNA TË PARENDSHME			TOTALE		
	SHUMA			SHUMA			SHUMA		
	të parapame për ushtrimin 1930-31	të parapame për ushtrimin 1931-32	Diferenca	të parapame për ushtrimin 1930-31	të parapame për ushtrimin 1931-32	Diferenca	të parapame për ushtrimin 1930-31	të parapame për ushtrimin 1931-32	Diferenca
KATEG. I t'ardhuna efektive	31.170.000	29,072,000	— 2,098,000	215,000	25,000	— 190,000	31,385,000	29,097,000	— 2,288,000
Total' i t'ardhunave reale	31.170.000	29,072,000	— 2,098,000	215,000	25,000	— 190,000	31,385,000	29,097,000	— 2,288,000

GJENDJA E PARAPAMJEVET E T'ARDHUNAVET
PËR USHTRIMIN FINANCJAR 1931 - 32

1	2	3	4	5	6
Nr. i ushtr. 1930-31	1931-32	KAPITUJ EMERTIM	Kompetenca si mbas gjendjes së parapamjeve për ushtrimin financjar 1930-31	Ndryshime qi propozohen	Kompetenca rrjedhse për ushtrimin financjar 1931-32 (shtylla 4+5)
			Fr. ari	Fr. ari	Fr. ari
		Titull I. T'ARDHUNA TË RENDSHME			
		KAT. I. T'ARDHUNA EFEKTIVE			
		T'ardhuna prej pasunis së Shtetit			
1	1	Qira tokash, kullotash dhe ndertesash Shtetnore	100.000	— 15.000	85.000
2	2	Të treta	270.000	— 30.000	240.000
3	3	T'ardhuna peshku	350,000	—	350.000
4	4	T'ardhuna prej pyjevet Shtetnore .	80.000	+ 25.000	105.000
5	5	T'ardhuna prej tokve të pajtueme për shfrytzime minerale si dhe prej konçesjonevet për të nxjerrë gurë e metale dhe t'ardhuna të ndryshme pasunije Shtetnore	400.000	— 170.000	230.000
6	6	Interesë mbi Kontin-Korent të fondevet të Trezorerís në depozitë . . .	pro me moria	—	pro memoria
		Total	1.200.000	— 190.000	1.010.000
		Tatime të drejta			
7	7	Tatime mbi ndertesa e tokë ndertimi	1.000.000	+ 150 000	1.150.000
8	8	Tatime mbi prodhime pyjesh e gurorresh nder prona private	100.000	—	100.000
9	9	Të dheta mbi drithna, pemë, bár, ullij, e zhugë	4.200.000	— 400.000	3.800.000
10	10	Tatim (xhelep) mbi berra, thij . . .	2.000.000	+ 30.000	2.030.000
Mbi krijimin e kap. 4 bis «shpenzime për dekoracjone» në rubrikën «Pallati Mbretnuer„ të budgetit 931 - 932 të Ministris së Financavet tue bartë në kte nji fond prej fr. ari 20.000 nga Kap. 55 «Fond rezervë»

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 50 datë 31 Korrik 1931)

Art. 1.

Krijohet Kap. 4 bis Shpenzime për dekoracione në rubriken «Pallati Mbretnuer» të budgetit 1931-1932 të Ministris së Financavet tue, bartë në këtë kapitull nji fond prej Fr. ari 20.000 (njizetmij) nga Kap. 55 «Fond rezervë».

Art. 2.

Kjo Dekret-Ligjë hyne në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë ngarkohet Ministrija e Financavet.

Kryeministri e
Zav. Ministri i Ekonomis Kombtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. Jashtme
H. Vrioni

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i Punëve Botore
Izet Dibra

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1300-II datë 21-VII-931.
Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 20-VII-931.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi krijimin e Kap. «4 bis. Shpenzime për dekoracione» në rubriken «Pallati Mbretnuer» të budgetit udhtues të Ministries së Financavet, tue bartë në këtë Kapitull nji fond prej Fr. ari 20.000 (njizetmijë) nga Kap. 55 fond rezervë po të Ministris së Financavet.

Durrës, me 25 Korrik 1931.

ZOG.

Nr. 97

DEKRET-LIGJE 25 Korrik 1931

Mbi syprimimin të shperblimit për graduatët me rrogë t' Armës s' Artileris, parapa prej Ligjës 2 Qershuer 1928, mbi rrogat e Graduatve dhe t'Ushtarëve

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 50 datë 31 Korrik 1931)

Neni 1.

Shperblimi për graduatët me rrogë t'armës s'Artileris parapa prej artikullit 6 të ligjës 2 Qershuer 1928, mbi rrogat e graduatëve e ushtarëve, suprimohet.

Neni. 2.

Ky Dekret-Ligjë hyne në fuqi me 1 Gusht 1931.

Neni 3.

Të gjithë Ministrat ngarkohen me zbatimin e këtij Dekret-Ligji.

Kryeministri e
Zav. Ministri i Ekonomis Kombtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
e Zav. Ministri Arsimit
M. Tutulani

Ministri i P. Jashtme
H. Vrioni

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Punëve Botore
Izet Dibra

Ministri i Financavet
L. Kareco

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1274 datë 3-VII-1931.
Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 30-VI-931.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi suprimimin e shperblimeve të graduatëve me rrogë t'Artileris.

Durrës, me 25 Korrik 931.

ZOG.

Nr. 98

DEKRET-LIGJE 20 Korrik 1931.

Mbi shtojcën e nji paragrafi n' Artikullin 9. të Ligjës Ndeshkimore për Faje Politike me datë 29 Dhjetuer 1925

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 51 datë 3 Gusht 1931)

Art. 1.

Nenit 9 të Ligjës Ndeshkirore për faje politike, me datë 29 Dhetuer 1925; i shtohet ky paragraf: «Ç'do njeri qi merr me

postë ose me ç'do mjet tjetër botimet e permenduna në paragrafin e parë, dhe këto nuk i a dorëzon autoritetit kompetent mbrenda nji afati dhjet ditësh, dënohet me gjysmen e ndeshkimit të caktuem në kategorin e propagandave për të cilat flasin botimet.

Art. 2.

Ministri i P. të Mbrendëshme dhe ay i Drejtësis, ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë.

Art. 3.

Kjo Dekret-Ligjë, vehet në zbatim, 15 ditë mbas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri e
Zav. Ministri i Ekonomis Kombtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. Jashtme
H. Vrioni

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i Punëve Botore
Izet Dibra

ZOGU I
Mbreti i Shqiptarve

Mbi proponimin e Kryeministries Nr. 873-II datë 24.VII.931.

Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 30 VI 931.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi shtesen e nji paragrafi n'artikullin 9 të Ligjës Ndeshkimore per faje Politike me datë 29 Dhetuer 1925.

Durrës, me 20 Korrik 1931.

ZOG.

Nr. 99

DEKRET-LIGJË 30 Korrik 1931

Mbi shpërblime patriotike

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 51 datë 3 Gusht 1931)

Art. 1.

Tue marrë parasysh sherbimet patriotike të bamuna prej tyne, u lidhet nga nji shperblim patriotik ZZ. Muhtar Axhemit fr. ari 80 në muej, e Asllan Mehmet Starjes, fr. ari 50 në muej; gjithashtu u lidhet nga nji rrogë jetike të përmuejshme edhe familjes së të ndjerit Spiro Naço fr. ari 200; familjes së të ndjerit Jusuf Gjinalit ish Deputet, fr. ari 300; familjes së të ndjerit Nikolla Frroku, fr. ari 60; Zonjës së të ndjerit Sotir Ollani, fr. ari 40 Zonjës Çile Spiro Krastafilakut, fr. ari 40, Zonjës Xhevrije e vè e të ndjerit Kamber Dishnica, fr. ari 40; Zonjës Marigo Pozio fr. ari 150; Zonjës Niqke Grameno e ve e të ndjerit Mihal Grameno, fr. ari 200. Zonjës Leopolda Noga, fr. ari 100. Zonjës Nore e shoqja e djalit të ndjerit Ded Gjon Lulit, fr. ari 80; familjes së të ndjerit Hajdar Hidit, fr. ari 100; Filip Krajës fr. ari 200, Ded Ujkës, fr. ari 80; Hafiz Ibrahim Dalliut, fr. ari 150; Stefan Postenanit, fr. ari 150; Fejzullah Guranjakut nga Elbasani, fr. ari 100; Vasil Zografit, fr. ari 200; Ikonom Papapano, fr. ari 120, dhe Zonjës Nazmije e ve e të ndjerit Sabri Dibrës, fr. ari 100.

Art. 2.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi që nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare

Art. 3.

Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e këtij Dekret-Ligji.

Kryeministri e
Zav. Ministri i Ekonomis Kombtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. të Jashtme
H. Virioni

Ministri P. Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Arsimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri P. Botore
Izet Dibra

ZOGU I
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresen Nr. 1337 14-XII 1931, dhe shkresa të tjera të ndryshme të Kryeministris.

Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Kshillit Ministruer me d. 7. VII 931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi lidhje shperblime patriotike e rrogë jetike të personave qi permenden në ketë Dekret Ligjë.

Durrës, me 30 Korrik 1931.

ZOG.

Nr. 100

DEKRET-MBRETNUER 30 Korrik 1931

Mbi transferimin e nji fondi prej fr.ari 18.000 nga kap. «55 «fond rezervë» të budgetit 1931-32 të Ministris së Financavet në kap. 10 «Shpenzime të fshehta» të budgetit të Min. së P. Mbrendshme

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 51 datë 3 Gusht 1931,

Këshilli Ministruer në mbledhjen e Tij të sotshme të mbajtun nen Kryesin e Z. Pandeli Evangjeli, Kryeminister e Zv. Ministri Ekonomis Kombëtare, me antar Z.Z. Milto Tutulani, Ministri Drejtësis. Hysein Vrioni, Ministri P. të Jashtme, Musa Juka, Ministri P. të Mbrendëshme, Hil Mosi, Ministri Arësimit, Lame Kareco, Ministri Financavet, Izet Dibra, Ministri P. Botore, mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 4459-I datë 16.VII.931, të Ministris së Financavet.

Vendossi:

Transferimin e nji shume prej Fr. ari 18.000 (tetëmbëdhetmijë) nga Kap. 55 «Fond rezervë» të budgetit 1931-932 të Ministris së Financavet, në Kap. 10 «Shpenzime të mëshefta» të budgetit të Ministris së P. të Mbrendëshme, dhe ky vendim në bazë t'artit 31, të Ligjës së Kontabilitetit të Përgjithshem të Shtetit i paraqitet Ministris s'Oborrit Mbretnuer për t'i parashtrue Nalt-Madhnies së Tij Mbretit për dekretim.

ZOGU I

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e bamun më shkresën Nr. 1427 datë 24.VII. 931 të Kryeministris.

Tue pamë dhe Art. 31 të Ligjës së Kontabilitetit të Përgjithshem të Shtetit,

DEKRETON

Aprovimin e vendimit të sipër-permendun, dhe Urdhenon zbatimin e tij.

Durrës, me 30 Korrik 1931.

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri P. Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 101

DEKRET-LIGJË 4 Gusht 1931

Mbi pensionimin e Z. Dr. Rifat Frasherit ish Drejtor i P. i Shëndetsis

(Botue në Fletcren Zyrtare Nr. 53 datë 12 Gusht 1931

Art. 1.

Tue marrë parasysh sherbimet e vlefshme qi ka bamë Z. Dr. Rifat Frasheri në degën e Shëndetsis si Drejtor'i Përgjithshëm i asaj organizate, si edhe moshën e tij tepër të kalueme e cila e pengon n'ushtrimin e profesionit të vet, i lidhet këtij nji rrogë je-

tike prej Fr. ari 450 në muej, dhe mbas vdekjes së tij kjo rrogë tue, u zbrit në 350 Fr. ari i kalon familjes së tij qi kanë të drejtë prefitimi si mbas Art... të Ligjit të Pensioneve në fuqi.

Art. 2.

Ky Dekret-Ligjë hynë në fuqi qysh nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.
Dekret-Ligji.

Art. 3.

Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e këtij
Kryeministri e
Zav. Ministri i Ekonomis Kombtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. të Jashtme
H. Virioni

Ministri P. Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Arsimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri P. Botore
Izet Dibra

ZOGU I
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1500 datë 1 VIII-1931,
Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 29-VII-931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi lidhëjen e nji rroge jetike prej fr. ari 450 në muej Z. Dr. Rifat Frashëri, ish Drejtor' i Përgjithshëm i Shëndetsis, dhe mbas vdekjes së tij kjo rrogë tue u zbrit në 350 fr. ari i kalon familjes së tij qi kanë të drejtë profitimi si mbas Art. . . . të Ligjit të Pensioneve në fuqi.

Durrës, me 4 Gusht 1931.

ZOG.

Nr. 102

DEKRET-MBRETNUER 8 Gusht 1931

Mbi çmimet që do epen për konkursin e kuajve

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 53 datë 12 Gusht 1931)

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mi proponimin e bamun me shkresen Nr. 14751 datë 30.VII. 931 të Kryeministris.

Tue pamë nesin 3 të Ligjit me d. 23 Prill 1929 mbi konkurse, diftime, (mostra) panagjyrë e ekspozisione.

DEKRETON

Aprovimin e çmimit të shperblimeve për t'i u dhanë atyne qi do të marrim pjesë në Konkursin e kuajve, me qellim qi të përmirësojë gjendjen e rracës së tyne, qi do të mbahet në qendren e Nenprefekturës së Fierit në mënyrë e sasi qi permendet në listen e bashkangjitun.

Durrës, më 8. Gusht 1931.

Z O G.

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli

Ministri i Ekonomis Kombtare
Said Toptani

L I S T Ë

e çmimevet për të ju dhanun fituesve qi do të marrin pjesë në konkursin e kuajve me provë funksionalë

SEKSJONI I KUAJVE

Rendi i I.

Çmimi	I.	Fr'ari	100	e nji	diplomë
„	II.	»	60	„ »	„
„	III.	„	40	» „	„

Rendi i II.

Çmimi	I.	»	100	„ »	»
„	II.	»	60	» »	„
»	III.	»	40	» „	»

BKSH

Rendi i III.

Çmime	I.	Fr.ari	100	e nji	diplomë
„	II.	»	60	» »	»
»	III.	»	40	» »	»

Rendi i IV.

„	I,	»	100	» »	»
»	II.	»	60	» »	»
»	III.	»	40	„ „	»

Shtesë për pelat qi janë ndër-
zye me Hamshorët Qeveritar Fr.ari 100

Grupe shtazësh të formuem prej 6 krenë shtazësh

Rendi i V.

Çmimi i	I	Fr.ari	200	e nji	diplomë
„	II.	»	100	„ »	»

SEKSJONI I GOMARVE

Rendi i I

Çmimi i	I.	Fr.ari	60	e nji	diplomë
„	II.	„	40	» „	„
„	III.	„	30	„ „	„

Rendi II

„	I.	„	50	» „	„
„	II.	„	30	„ „	„
»	III.	„	20	„ »	„

SESIONI I MUSHKAVET

Rendi i I.

Çmimi i	I.	Fr.ari	50	e nji	diplomë
„	II.	„	30	» „	„
„	III.	„	20	„ „	„

SEKSIONI PROVËS FUKSIONALE

Rendi i I.

Çmimi i	I.	Fr.ari	150	e nji	diplomë
„	II.	„	100	„ „	„
„	III.	„	85	„ „	„

Rendi i II.

»	I.	„	150	„ „	„
„	II.	»	100	„ »	„
„	III.	„	85	» »	„

BKSH

Nr. 103

DEKRET-LIGJË 12 Gusht 1931

Mbi disa ndryshime të Ligjës mbi zgjanimin e tokavet Shtetnore nga ekspropriijim tokash private të Kryeqytetit për instalimin e Nëpunsavet etj. me datë 13-V-1927, dhe 14 Maj 1929

(Botue në Flctoren Zyrtare Nr. 54 datë 18 Gusht 1931)

Art. 1.

Prej tokavet Shtetnore që gjinden në lagjen e destinueme per instalimin e nëpunsavet etj. të Kryeqytetit, ato pjesë qi si mbas planit të Lagjes Tirana e Rè, nevojiten për çeljen e boulevardevet, rrugavet, parqeve, sheshеve të lira dhe për rregullimin e Lanës, i falen Bashkis së Tiranës.

Art. 2.

Pjesa e tokavet Shtetnore qi si mbas artikullit të sipërme të kësaj Dekret-Ligjë, do të mbeten dhe do të përdoren per shtepijat e nëpunsavet, do i paguhen Ministriës së Financavet, prej Komisionit të posaçem në bazë të çmimit të caktuem n'art. 2 të Ligjës mbi zgjanimin e tokavet Shtetnore me ekproprijim tokash private në Kryeqytet per instalimin e nëpunsavet etj. me datë 17 Maj 1927.

Art. 3.

Ministrija e Financavet detyrohet me i transkiptue tokat e permenduna n'Art. 1 të kësaj Dekret-Ligjë, n'emnin e Bashkis së Kryeqytetit.

Art. 4.

Ç'do ligjë qi asht në kundershtim me dispozitat e kësaj Dekret-Ligjë, mbetet pa fuqi.

Art. 5.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi qysh prej datës së shpelljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 6.

Ministrija e Financavet, Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e P. Botore, ngarkohen me zbatimin e sajë.

Kryeministri:

Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësies
M. Tutulani

Ministri i P. të Jashtme
H. Virjoni

Ministri P. Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombtare
Seid Toptani

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1428.I datë 4.VIII.931. Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 28.VII.931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi disa ndryshime të ligjës mbi zgjanimin e tokavet Shtetnore me ekoprorijim tokash private në Kryeqytet për instalimin e nëpunsavet etj. me datë 13. V. 1927, dhe 14 Maj 1929.

Durrës, me 12 Gusht 931.

ZOG.

Nr. 104

DEKRET-LIGJË 12 Gusht 1931

Mbi krijimin e kapitullit 15 «Shpenzime gjithfarësh» për të marrunit pjesë në Panajirin e Barit, në budgetin 1931-32 të Ministris. së s'Ekonomis Kombëtare

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 54 datë 18 Gusht 1931

Art. 1.

Në budgetin 1931-32 të Ministris s'Ekonomis Kombta-

re krijohet nen titullin «Shpenzime të pa rendëshme» Kap. 15 «Shpenzime gjithfarësh për të marrë pjesë në Panajirin e Barit».

Art. 2.

Në kapitullin e krijuem si mbas Art. 1. të kësaj Dekret-Ligje, bartet nji fond prej fr. ari 10.000 (dhetmijë) nga Kap. 55 «Fond Rezervë» të budgetit 931-32 të Ministris Financavet.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë ngarkohet Ministrija e Financavet dhe Ministrija e Ekonomis Kombëtare.

Art. 4.

Kjo Dekret-Ligjë hyne në fuqi me ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. të Jashtme
H. Vrioni

Ministri P. Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Arsimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombtare
Said Toptani

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1435/II datë 4 VIII-1931,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 25. VII. 1931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret Ligjit mbi transefrimin e 10.000 Fr. ari nga Kap. 55 «Fond Rezervë», në kapitullin e krijuar nën Nr. 15 «Shpenzime gjithfarësh», për të marrun pjesë në Panairin e Barit.

Durrës, me 12 Gusht 1931.

Z O G.

Nr. 105

DEKRET-LIGJË 8 Gusht 1931.

Mbi përjashtimin nga tagrat doganore e taksat tjera për materjale Ushtarake

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 55 datë 22 Gusht 1931)

Neni 1.

Perjashtohen nga tagrat doganore të të hyemit dhe nga të tjerat shtesa taksash e të drejta qi nxjeren nga doganat per llogari të shtetit, të Bashkive o për të tjera Ente publike, ç'do lloj materiali lande e parë, gjanat e punueme (me perjashtim të mobiljeve) gjymës të punueme e të pa-punueme, ashtu dhe kafshet që inportohen nga ana e Komandes së Mbrojtjes Kombëtare, për nevojat ushtarake që bahen prone e Shtetit.

Gjanat ushqimore ashtu dhe ushqimet për kafshet e ushtris nuk perjashtohen zakonisht nga tagrat doganore të të hyemit, por kuer nevoja të posaçme t'a kerkojnë, dhe vetem për disa artikuj e per nji kohë të caktueme, mund të perjashtohen me vendimin të Këshillit Ministruer.

Neni 2.

Materjalet që bahen fjalë në nenin e parë, qi të gëzojnë nga perjashtimi, duhet me doemos të jenë të drejtueme, nga vendet e blemjes n'emen të Komandes së Mbrojtjes Kombëtare.

Neni 3.

Doganat, i dorzojnë materjalet vetëm personit ose Komisionit që autorizon Komanda e Mbrojtjes Kombëtare i cili, per të paraqitun diftimin doganor n'emën të Komandë, duhet të jetë i deleguem me prokure.

Neni 4.

Mbeten në fuqi dispozitat e ligjës dhe të Rregullores doganore për sa i perket kontrollimit, vertetimit e të kryemit e të gjitha formaliteteve doganore: si për shgarkimin, depozitime, paraqitje e diftimit me hollësirat e duhura e tjera veprime perkatese.

Nuk i shtrohen formaliteteve të permenduna në këtë nen materjalet luftarake, kuer kjo kërkohet nga Komanda e Mbrojtjes Kombëtare. Në këtë rast, në diftimin doganor mjafton të deklamaterjale luftarake».

Neni 5.

Në rast të çdo dyshimit per mashtrim dogana, nuk i liron materjalët, dhe me nji herë lajmëron Ministrin e Financavet; njikohësisht dhe Komanden e Mbrojtjes Kombëtare.

Neni 6.

Kurse materjalet e destinueme për Ushtrin Kombëtare refuzohen prej Administrates Ushtarake pjeserisht a tanesisht, mbasi të jetë marun nga dogana, Komanda e Mbrojtjes Kombetare ndalohet qi ato materjale të nxjeren nga Depot e saja dhe të shtihen në tokën e Mbretnis, pa u paguar ma parë tagra doganore e të tjera. Per këtë qëllim ato materjale do t'i kthehen fornitorit ose shtëpis blerse ose doganës për t'i a dorëzuem fornitorit.

Hollësirat perkatëse kanë m'u caktuem ndermjet Administratës Ushtarake e asaj të Doganave.

Neni 7.

Dokumentat doganore që paraqet Komanda e Mbrojtjes Kombtare per materjalet e sipër-përmenduna perjashtohen nga pullat.

Neni 8.

Ligja me datë 19 Nanduer 1929 çpallun në Fletoren Zyrtare Nr. 67 t'atij vjeti, dhe çdo dispozitë tjetër në kundershtim me ketë Ligjë, asht e abrogueme.

Neni 9.

Kjo Ligjë hynë në fuqi që nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 10.

Ministrija e Financavet dhe Komanda e Mbrojtjes Kombëtare ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligje.

Kryeministri
e Zav. Ministri i Ekonomis Kombtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. të Jashtme
H. Virioni

Ministri i P. Mbrendëshme
M. Juka

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 606-II datë 25 VIII-1931,
Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 21-VII-931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi perjashtimin nga tagrat doganore e taksat tjera për materjalet Ushtarake.

Durrës, me 8 Gusht 1931.

Z O G.

Nr. 106

DEKRET-LIGJË 4 Gusht 1931.

Shtojcë e art. 41 të Ligjës me datë 4 Qershuer 1928 mbi Bashkin e Kryeqytetit

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 56 datë 25 Gusht 1931)

Neni 1.

N'Art. 41 të ligjës me datë 4 Qershuer 1928 mbi Bashkin e Kryeqytetit shtohet kjo dispozitë:

«Ndertimi dhe mirë-mbajtja e pjesave të rrugave të Kryeqytetit të poshtëshenume i ngarkohen Ministris së P. Botore.

a) Pjesa e rrugës prej fundit të Bulevardit Mussolini deri ke kazermat Ushtarake në lidhje me rrugen e Kavajës.

b) Pjesa e rrugës prej rojes së Policis së rrugës së Durrësit deri ke Autoreparti me lidhje me rrugen Durrës-Tiranë.

c) Pjesa e rrugës prej urës së Terzive deri në lidhje me rrugen Elbasan-Tiranë.

d) Pjesa e rrugës prej Spitalit Civil deri në lidhje me rrugen e Tujanit.

e) Pjesa e dytë e Bulevardit ZOG. I. prej sheshit të Pallateve

Ministerjale gjatë Tiranës së Rè deri në krye të Bulevardit ZOG. I. dhe kanalizimi i Lanës .

Neni 2.

Ky Dekret-Ligjë hynë në fuqi që nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 3.

Qeverija ngarkohet me zbatimin e këtij Dekret-Ligji.

Kryeministri e
Zav. Ministri Ekon. Kombtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. Jashtme
H. Vrioni

Ministri i P. Mbrendëshme
M. Juka

Ministri i Arsimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeminstris Nr. 1387 datë I-VIII-1931,
Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me date 16.VII.1931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret Ligjës si shtojcë e Art. 41 të Ligjës me datë 4 Qershuer 928 mbi Bashkin e Kryeqytetit.

Durrës, me 4 Gusht 1931.

ZOG.

Nr. 107

DEKRET-MBRETNUER 4 Gusht 1931.

Mbi çpronsim toke në Laprak

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 56 datë 25 Gusht 1931)

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 1035-II datë 31 VII. 931 të Kryeministris.

Tue pamë edhe nenin 2 të Ligjit në fuqi mbi çpronesimin e tokave.

DEKRETON

Aprovimin e vendimit Nr. 770 datë 16. VII. 931 të Këshillit të Shtetit, mbi çpronsimin e tokës së Laprakës ku asht ferma e Shkollës Teknike, nevoja këto qi konsiderohen për utilitetin publik, dhe Urdhënon zbatimin e tij.

Durrës, me 4 Gusht 1931,

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Arësimit:
H. Mosi

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Nr. 108

RREGULLORE

Mbi nji konkurs në mes të lopve me provë mjeljeje

(Botue në Flotoren Zyrtare Nr. 56 datë 25 Gusht 1931)

Art. 1

Si mbas ligjit mbi konkurse e ekspozicione diftime (mostra) Panagjyre e tjera i aprovuem me Nr. 265 I datë 23. IV. 929 nga Parlametni, autorizohet Ministrija e Ekonomis Kombëtare t'organizojë nji konkurs për lopë me prove mjeljeje në qendren e Prefekturës Shkodrës me datën 31. III. 932.

Art. 2

Konkurentave fitues të lopëve u jepet çmimet si vijon:

Rendi i Irë. Për lopët tre vjeçarë qi kan ndryshue dhambët e dyta me ato të përhershmet.

Çmimi i Irë Fr. ari 100 e nji diplomë.
» IItë » 70 » »
» IIItë » 60 » »

Rendi i IItë, Lopët kater vjeçare qi kan ndryshue dhambët e tretë me ato të përhershmit.

Konkurentavet të lopëve fitues u jepen çmimet si vijojnë:

Çmimi i Irë Fr. ari 100 e nji diplomë.
» IItë » 70 » »
» IIItë » 60 » »

Rendi i IIItë, Lopët 5 vjeçare qi kan ndryshue gjith dhambët e gojës me ato të përhershmet.

Konkurentavet fitues të lopëve u jepet çmimet si vijojnë:

Çmimi i Irë Fr. ari 100 e nji diplomë.
» IItë » 70 » »
» IIItë » 60 » »

Rendi i IV të Lopëvet 6 vjeçarë e lartë u jepen të zotëve të tyne çmimet si vijojnë:

Çmimi i Irë Fr. ari 100 e nji diplomë.
» IItë » 70 » »
» IIItë » 60 » »

Rendi Vtë, Lopët fituese në provë kuantitative të lartë, e që kan shum tlyne në qumshtin e tyne (prova bahet me methodin Gerber).

Konkurentavet fitues të lopëvet u jepet çmimet si vijojnë:

Çmimi i Irë Fr. ari 100 e nji diplomë.
» IItë » 70 » »
» IIItë » 60 » »

Art. 3.

Në konkursin e lopëvet mund të marrin pjesë dhe lopët e rracës të huej, me konditë qi këto të jenë të linduna e të rrituna në Shqypni, si edhe zotnuesi i tyne të jetë shtetas Shqyptarë.

Lopët e Instituteve Qeveritare ose privat e të hueja mund të marrin pjesë në konkurs pa të drejtë çmimesh në të holla, por u jepet vetem nga nji diplomë.

Art. 4

Blegtoret me lopët e tyne qi dishrojnë të marrin pjesë në

konkurs janë të detyruem t'i sillen Zyres së Veterinaris së vendit tuej lypë pranimin verbalisht ose me shkrim, deri 10 ditë para ditës të caktueme qi do të bahet konkursi. Në kerkesat duhet të shenohet sasia e lopëve qi ka dhe mosha e tyne.

Mbas kësajë kohe kerkesat nuk merren parasyesh.

Marrja pjesë në këtë konkurs nuk ngarkohet me as ndonji taksë.

Art. 5.

Lopët konkuruese detyrohen të zotët e tyne t'i sjellin ma të pakten nji ditë para se të bahet konkursi.

Për të ushqye lopët qi sjellen në konkurs ngarkohen të zotët e tyne.

Art. 6

Lopvet qi marrin pjesë në konkurs në 4 rendët e thanuna në Art. 2 të kësaj Rregullore, u jepen çmimet si mbas sasis të qumshtit të dhanun mbrenda 24 orëve, ose të dy mjeljevet të mëngjezit e të mbramjes.

Kur të takojnë dy lopë ose ma tepër qi japin nji sasi t'unjishme qumësht, komisioni gjykues këtyne u jep çmimin asajë lopë qi asht mbajtun ma mirë.

Art. 7

Komisioni gjykues emnohet nga Ministrija e Ekonomis Kombëtare.

Art. 8.

Gjykimet e komisionit janë të pa apelueshme.

Art. 9

Bashkija e Shkodrës detyrohet të japin një lokal të duhun dhe të japi ndihmat e nevojshme për realizimin e qellimit.

Art. 10

Ministrija e Ekonomis Kombëtare ngarkohet me aplikimin e kësaj Rregullore, dhe për emnin e Komitetit të nderit.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. Jashtme
H. Vrioni

Ministri i P. Mbrendëshme
M. Juka

Ministri i Arsimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri Ekonom. Kombëtare
Seid Toptani

Nr. 109

DEKRET-LIGJË 17 Gusht 1931

Mbi disa ndryshime të shperblimeve për personelelin e Ushtris qi ka për qellim me i sjellë disa ndryshime shperblimeve për shërbime e pozita të veçanta të caktueme prej Dekret-Ligjës 10 Gusht 1928 mbi shpërblimet eventuale e shpenzimet e udhtimit për personelin e Ushtris

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 56 datë 25 Gusht 1931

Neni 1.

Pasqyra e parë e Dekret-Ligjës 10 Gusht 1928 mbi shperblimet eventuale e shpenzimet e udhtimit për personelin e Ushtëris asht ndryshue si vijon:

PASQYRA I.

Shperblime për sherbime e pozita të posaçme.

Komandant' i Mbrojtjes Kombëtare	Fr.	ari	400	muejor	
Kryetar' i Shtatit-Madhuer	»	»	300	»	
Inspektori i pergjithshem i Ushtëris	»	»	300	»	
Komandant' i Divizionit	»	»	100	»	(1)
Komandant' i Grupit të perziem	»	»	50	»	
Drejtor' i Intendancës së Përgjithshme	»	»	50	»	
Oficerat mjekë, farmacista e Veterinar	»	»	50	»	
Adjutant' i Komandantit të Mbrojtjes Komb.	»	»	50	»	
Komandant' i Gardës Mbretnore	»	»	200	»	
Kapiten i Kl. I. e II. i Gardës Mbretnore	»	»	120	»	(2)

Togeri	»	»	100	»	
Nentogeri	»	»	60	»	(2)
Aspiranti	»	»	40	»	

(1) Nuk asht e bashkueme (nën e sumulabile) me shperblimin e parapame për Komandantin e Mbrojtjes Kombtare, per Kryetarin e Shtatit Madhuer dhe, per Inspektorin e Pergjithshem t'ushtëries.

(2) I perket vetem oaficerave që bajnë sherbim efektiv në Garden Mbretnore.

Neni. 2.

Dispozita transitore

Kryetarit të tashem të Shtatit Madhuer ka me vazhdue me i dhanë për deri sa aj ka me mbajtë këtë barë, shperblimi që tash merrë, prej fr. ari 600 në vend të asaj të caktueme prej pasqyrës së nenit të ma-parëshem.

Neni 3.

Ky Dekret-Ligjë hynë në fuqi me datë 1 Gusht 1931.

Neni 4.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e këtij Dekret-Ligji.

Kryeministri e
Zav. Ministri Ekonomis Kombtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri P. të Jashtme:
H. Vrioni

Ministri P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit
Hil Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1118-I datë 26-VII-931

Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 21.VII.931,

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit qi ka per qellim me i sjellë disa ndryshime shperblimeve per sherbime e pozita të veçanta të caktueme prej Dekret-Ligjes 10 Gusht 1928, mbi shperblimet eventuale e shpenzimet e udhtimit për personelin e Ushtëris.

Durrës, me 17 Gusht 931.

ZOG.

Nr. 110

DEKRET-LIGJË 14 Gusht 1931

Mbi krijimin dhe funksionimin e Ekonomatit të Përgjithshëm

(Botue në Fletoren Zortare Nr. 57 datë 29 Gusht 1931)

Neni 1.

Pranë Ministries së Financavet krijohet një Ekonomat i Përgjithshem nen drejtimin e një Drejtori.

Përsoneli i nevojshem për funksionimin e Ekonomatit të Përgjithshem ka me u caktue në kuadrin që do t'i lidhet gjendjes së parapamjevet të shpenzimeve të Ministries së Financavet.

Neni 2.

Ekonomatit të Përgjithshem i ngarkohet detyra me u-kujdesue, n'interesë t'Administratave të ndryshme të Shtetit:

a) Për blemjen, ruejtjen dhe shpërdamjen e shtypshkrimeve, rregjistrave, letravet, sendevet të kancelaris, veglave, mobiljave, makinavet shkrimi dhe llogarije, vesh-mathjes së përsonelit të sherbimit dhe të çdo sendi tjetër qi duhet per funksionimin dhe pajimin e zyravet të ndryshme;

b) për blemjen dhe mbajtjen e gjith materjaleve, të ç'do natyre qofshin të nevojshme për zjarrë e dritë.

c) për blemjen, mbajtjen ruejtjen dhe sherbimin e automobilave për Ministritë, tue perfshie edhe pagen e shoferavet:

ç) Për caktimin e shpenzimeve të vogla, që nuk perfshihen në gërmen e sipër-tregueme a), të nevojshme për zyrat e qendrës dhe të qarqevet;

d) per me urdhënue shtypjen e shtypshkrimeve, t'aktevet dhe

të botimevet qi lypsen here-pas-here ose periodikisht, tue përfshie edhe botimin e «Fletores Zyrtare».

Për sa i u përket administratavet ushtarake (Ushtëri — Gjandarmeri) Ekonomati i Përgjithshem ka me u kujdesue vetem për blemjen ruejtjen dhe shperndamjen e shtypëshkrimevet, regjistrave, sendeve kancelarisë, letrave, dhe maqinave shkrimi dhe llogarie.

Neni 3.

Fondet për sherbimet e shenueme në nenin 2 të sipër-treguem caktohen në nji ose ma shumë kapituj të gjendjes vjetore të parapamjevet të shpenzimeve të Ministris së Financavet tue, suprimue kapitujt analogë për «shpenzime Zyre» për Ministriet e ndryshme dhe pjesërisht për Administratat Ushtarake.

Gjestimi i fondeve t'autorizuem si ma sipër asht në kompetencë t'Ekonomatit të Pergjithshem, nen drejtimin e Ministrit të Financavet dhe, ushtrohet simbas dispozitave të ligjës me datë 28 Maj 1929 si edhe të Rregullores 7 Fruer 1930, mbi administrimin e Pasunis e të Kontabilitetit të Përgjithshem të Shtetit.

Neni 4.

Mbrenda muajit Dhetuer të ç'do vjeti, Ministrit e ndryshme dhe Administratat Ushtarake i komunikojnë Ekonomatit të Përgjithshem nga nji listë, e cila përmban sasin dhe kualitetin e gjith sendevet që i-u duhen për sherbimet e qëndres edhe për atë të qarqevet gjatë ushtrimit Financiar, që fillon me 1 Prill të vjetit qi vjen.

Asht në fakultet t'Ekonomatit për me caktue llojin dhe tipet e letres, të shtypshkrimeve, të mobiljavet, të prodhimevet dhe të sendeve të tjera që kerkohen, dhe do të përkujdesohet të mbahet nji uniformitet prej të gjitha administratat që të kenë sende të nji-llojshme.

Ekonomati, mbasi të ketë kufizue të gjitha kerkesat e Ministrinave të ndryeshme, mbrenda kufijeve ngushtësisht të nevojshme, proponon fondet që do t'i shtihen në gjendjen vjetore të pa rapamjeve të shpenzimeve të Ministries së Financavet.

Në rast të kundershtimeve të ç'do natyre në mes t'Ekonomatit dhe t'Administratave të ndryeshme të Shtetit, persa i perket kualitetit, sasis dhe llojit të sendevet dhe të materjalevet që do të blehen, çeshtja i paraqitet Këshillit Ministruer, i cilli jep vendimet e tija definitive.

Neni 5.

Ruejtjen dhe shperndamjen e shtypshkrimeve dhe të materjaleve të ndryeshme, Ekonomati i Përgjithshm ka me i ba me anen e nji Magazinës kryesore të krijueme në kryeqytet në rast nevoje, me anen e Magazinave të dyta që kanë me u krijue pranë Drejtorinave të Finances, për t'i sherbye të gjitha Zyrave të qarkut.

Neni 6.

Magazina kryesore drejtohet prej nji magazinjxeri marrë në dorëzim, i cilli asht përgjegjës për sasin dhe për mirë-mbajtjen e shtypshkrimeve dhe të gjanave të tjera që hyejnë në magazinë, gjithashtu asht përgjegjës edhe për damet që mund të vërtetohen në gjanat e depozitueme, nga pa kujdesija ose gabimi të përsonelit që mvaret prej tij.

Përveç kësaj, magazineri duhet të përkujdeset që të gjitha shtypshkrimet, materialet, dhe sendet e tjera këso-dore, të rreshtohen me rregull, në mënyrë që të mund të bahet me lehtësi levizja dhe numrimi i tyne.

Magazinari kujdesohet për gjestimin e fondevet që mund të ketë në dispozicion të vet, për përpilimin e llogarivet, për të shtimunit në Magazinë të Shtypshkrimeve dhe të sendeve të tjera, për dorëzimet dhe për dergesat e tyne.

Neni 7.

Të shtimit e fornituravet në magazinen kryesore bahet vetem në bazë të nji urdhen-ngarkimi të dhanë prej Ekonomatit, e mbasi ky të ketë deklarue pranimin e tyne.

Prej Magazinës kryesore nuk mund të dalë jashta kurgja pa urdhënin e Ekonomatit.

Magazina mban nji llogari të veçantë ngarkim-shkarkimi dhe u nenshtrohet vertetimeve të urdhënueme prej Ministris së Financavet.

Neni 8.

Mirëmbajtja e mobiljeve dhe e veglave të tjera q'u jepen për përdorimin Administratave të ndryshme të Shtetit, u ngarkohet nepunësave të posaçem që marrin në dorëzim, si mbas dispozites së nenit 11, paragraf 2 i Rregullores me datë 7 Fruer 1930 mbi administrimin e pasunies dhe të Kontabilitetit të Përgjithshem të Shtetit; por shpenzimet e mirëmbajtjes duhet kurdoherë të jenë t'autorizueme prej Ekonomit, i cili mund t'urdhë-

nojë gjithë transferimet e mobiljevet, kuer e shef t'arsyeshme për nji përdorim ma të mirë.

Neni 9.

Gjith mobiljet, veglat dhe materjalet e tjera që u përkasin Administratave të ndryeshme të Shtetit, të cilat për çfarëdo shkak bahen të pa përdorueshme, duhet të vehen në dispozicion t'Ekonomatit të Përgjithshem, i cili vendos, me bashkpunim me Administratat përkatëse në se mund të vehen në ndonji përdorim të ri ose në duhet të shiten.

Neni 10.

Shpërndamja e shtypshkrimeve, e sendeve të kancelerisë dhe e materialeve të ndryshme ka me u ba prej Magazinës në mënyrat dhe në kohen e caktueme prej Ekonomatit të Përgjithshem, në bazë të nevojavet vjetore të caktueme si mbas nenit 4.

Neni 11.

Analogisht në Magazinen kryesore, dhe si mbas instruksioneve të dhana prej Ministris së Financavet, kanë me funksjonue Magazinat të tjera që mund të krijohen pranë Drejtorive të Financavet si mbas dispozitave të nenit 5.

Neni 12.

Shumat që nevojiten për me pague shpenzimet e vogla të zyrave për Administratën e Qendrës dhe ato të qarqevet, caktohen vjet për vjet prej Ekonomatit të Përgjithshëm në bazë të preventiveve të pregatitun prej Ministrive kompetente mbrenda kohës së caktueme në nenin 4.

Në rast që gjatë ushtrimit shifet se shumat e caktueme janë ma të nalta ose ma t'ulta se nevoja, Ekonomati i Përgjithshem ka të drejt me autorizue zbritjen ose shtimin e nevojëshem.

Neni 13.

Kryetarët e Zyrave duhet t'i përmbajnë shpenzimet mbrenda kufijve që u janë caktue dhe, nuk kanë me pasë të drejtën me kërkue pagesën në rast se kalojnë ato kufi. Gjithashtu janë të detyruem të dokumetnojnë shpenzimet e bame në përmbledhjet e llogarive që cakton Neni 138 i Rregullores së Kontabilitetit.

Neni 14.

Në fund të ushtrimit Financiar, shumat që rezultojnë të prelevueme dhe që mbeten pa u shpenzue, passi të jenë ba pagesat që i përkasin ushtrimit Financjar, duhet t'i këthehen Ar-

kës së Shtetit, e cila i llogarit në kapitullin «T'ardhuna të ndryshme».

Neni 15.

Për shpenzimet që përmenden në nenin 12, Ekonomati i Përgjithshem ka të drejtë me caktue nji shumë të preme për secilen Zyre t'interesueme.

Në këtë rastë kryetarët e zyrave përkatëse përkujdesen për gjith nevojat e zyrës në fondin e dhanë për atë qëllim, pa qenë të detyruem me dhanë llogari për shumat që marrin dhe ato që shpenzojnë.

Neni 16.

Shitja e botimeve Zyrtare bahet përgjithsisht prej Ekonomatit të Përgjithshem, dhe Administratat e ndryshme ose privatet qi kanë nevojë për këto, duhet t'i drejtojnë atij kerkesat përkatëse.

Të hollat e shitjeve e botimeve derdhen n'Arken e Qendrës ose n'Arkën e Drejtorive e Nën-Drejtorive të Financës, të cilat i llogarisin në Kapitullin «t'Ardhuna të ndryshme».

DISPOZITA TRANSITORE E TË FUNDSHME

Neni 17.

Shumat qi do të jenë të disponueshme me 31 Shtatuer 1931 të rrjedhuna nga kredit e autorizueme në ligjin e budgetit t'ushtrimit vazhdues nën kapitullin «Shpenzime Zyre etj». të Ministrive të ndryshme kanë me u transferue në nji kapitull të veçantë, që do të krijohet në gjendjen e parapamjeve të shpenzimeve të Ministris së Financavet.

Ministri i Financavet autorizohet me kryem, në marrëveshtje me Ministrat e tjerë vërtetimet e duhuna, për me vue me zbatim këtë masë.

Neni 18.

Ekonomati i Përgjithshem dhe Magazina Kryesore kanë me fillue funksionimin e tyne prej ditës 1 Tetuer 1931.

Magazinat e dyta, që do të krijohen, ku të shifet nevoja simbas nenit 5. kanë me funksionue prej ditës 1 Prill 1932.

Neni 19.

Që prej 1 Tetor 1931, suprimohen, nepunsit e Ekonomit, të magazinarit dhe të tjera të gjasësishme të krijueme në kuadrin organik të Ministrive të ndryshme.

Neni 20.

Ministri i Financavet, në marrëveshtje me Ministrat e tjerë, autorizohet me përpilue dispozitat ekzekutive për zbatimin e këtij Dekret-Ligji.

Neni 21.

Këshilli Ministruer ngarkohet me ekzekutimin e këtij Dekreti, i cili ka me i u paraqit Parlamentit për kthimin në Ligjë.

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri P. të Jashtme:
H. Vrioni

Ministri P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Finistri i Financavet
L. Kareco

Ministri i Arësimit:
H. Mosi

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombëtare:
Seid Toptani

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1053-I datë 6-8-931.

Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 1-8-1931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi krijimin e Ekonomatit të Përgjithshëm.

Durrës, 14 Gusht 1931.

ZOG.

BKSH

Nr. 111.

DEKRET-LIGJË 2 Shtator 1931.

Për caktimin e personelit që lypset për funksionimin e Ekonomatit të Përgjithshëm pranë Ministris së Financave

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 61 datë 11 Shtatuer 1931)

Neni 1. Kuadrit të përsonelit bashkalidhun të gjendjes së parapamjevet të shpenzimit të Ministriës së Financavet i shtohen, që prej datës 1 Shtatuer të këtij vjeti, nepunsat që pasojnë me rrogë muejore qi posht-shenohen për sejcilin.

1) Nji Drejtor	Fr. ari 450
2) Nji Sekretar	» » 330.
3) Nji Magazinjer	» » 300.
4) Nji Ndihmes Magazinjeri	» » 250.
5) Nji Kujdestar	» » 150.

Neni. 2 Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimit të Ministriës së Finincavet, për ushtrimin financiar 1931-932, shuma e caktueme në budget të Kap. 40 « Rrogë personeli, zevendësije etj.» «Shtohet me shumen prej Fr. ari 10360; dhe po për ketë shumë paksohet shuma e kapitullit 55 «Fond rezervë për plotsim etj.».

Neni 3 Ky Dekret Ligje ka me i-u paraqit Parlamentit për kthim në Ligje, dhe ka me hye në fuqi po n'atë ditë qi të dotohet, në «Fletoren Zyrtare».

Neni. 4 Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e këtij Dekret-Ligji.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. të Jashtme
H. Vrioni

Ministri P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Financavet.
L. Kareco.

M. P. Botore
Izet. Dibra

Ministri i Ek. Kombtare
Seid. Toptani

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëvet

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1055/IV date 2 -VIII-931

Si ndigjoje dhe pelqejë Vendimin e Këshillit Ministruer me date 14-VIII-931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi caktimin e personelit t'Ekonomatit të Pergjithshme.

Durrës mfe 2 Shtator 1931.

ZOG.

Nr. 112

DEKRET-MBRETNOR 2 Shtator 1931

Mbi bartje fondi prej fr. ari 10.000 në budgetin 1931-32 të Ministris së Financavet

(botue në Fletoren Zyrtare Nr. 61 datë 11 Shtatuer 1931)

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

Tue pamë Vendimin Nr. 585 datë 1.VIII.931 të Këshillit Ministruer, paraqit me shkresen Nr. 674-II datë 30. VIII. 931, të Kryeministries.

DEKRETON

Art. 1. Bartjen e nji fonde prej Fr. ari 10.000 (dhetmij) nga Kap. 55 Fond rezervë të budgetit 1931-932 të Ministriës së Financavet në Kap. 10 « Shpenzime të mëshefta » po të budgetit të Ministris së Financavet.

Art. 2. Me zbatimin e këtij Dekreti ngarkohet Ministria e Financavet.

Art. 3. Në themel t'art 31 të Ligjës mbi administrimin e pasuni-

es e kontabilitetin e përgjithshem të Shtetit ky Dekret ka për t'ju paraqitë Parlamentit për ratifikim.

Durrës, me 2 Shtatuer-931.

Z O G.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 113

DEKRET-LIGJË 7 Shtatuer 1931

Mbi importimin e farës së grunit pa taksë doganore

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 62 datë 16 Shtator 1931)

Neni 1. Autorizohet Ministrija e Ekonomis Kombëtare me importue deri me njizet mije kuintal grunë të seleksionuem per farë për me u a shpernda bujqëve që kanë nevojë, me detyrim qi t'a paguejnë mbas nji vjeti nga data e dorëzimit në vleften e kushtimit për ata që janë në gjendje ekonomike të mirë, dhe në natyrë, prej kualitetit të parë, për ata që janë të vobekët.

Personat që në bazë të këtij neni detyrohen me pague vlefton e farës në të holla, caktohet prej Këshillit Administrativ të vendit.

Mënyra e nxjerrjes se të hollave dhe të produktit në natyrë ka me u caktue me nji Rregullore të posaçme.

Neni 2. Sasia e grunit të nalt-përmendun përjashtohet nga taksa doganore dhe nga ç'do lloj takse tjeter suplementare.

Neni 3. Autorizohet Ministrija e Ekonomisë Kombëtare me importue grunë të selekasionuem për farë edhe në llogari të personave të tretë qi merren me bujqësi.

Neni 4. Gruni i importuem si mbas kësaj Dekret-Ligje destinohet vetëm si farë për mbjellje, Bujqet detyrohen qi grunin e dhanun për farë t'a përdorin vetem për mbjellje dhe t'u shtrohen gjith porosinave teknike t'administratës së bujqësis dhe t'Odës Ekonomis të qarkut tyne mbi disinfektimin e farës ashtu edhe mbi menyre e mbjelljes së sajë.

Disenfektimi do të bahet nga ana e teknikëve të Qeverisë

Ata qi kundervinë urdhënimevet të paragrafit ma parëshem

detyrohen, me vendim të Ministris s'Ekonomis Kombëtare, me pague mbrenda nji mueji vleften e grunit bashkë me tagrin doganuer e gjith taksat e tjera suplementare të ç'far do lloji.

Neni 5. Shpenzimet e nevojshme për blemjen dhe transportimin e grunit në fjalë, do të përballohen prej fondeve përkatëse të Ministris s'Ekonomis Kombëtare.

Neni 6. Ministrija e Ekonomis Kombtare autorizohet me hartue Rregulloren mbi holësinat e nevojshme për zbatimin e këtij Dekret-Ligji.

Neni 7. Kjo Dekret-Ligjë hyne në fuqi që nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 8. Ministrija e Ekonomis Kombëtare dhe, ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësajë Dekret-Ligje.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri P. Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit
Hil Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Seid Toptani

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëvet

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1192-IX datë 2. IX. 931. Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 24. VIII. 931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi importimin e nji sasie gruni për farë pa taksë doganuer.

Durrës, me 7 Shtatuer 1931.

ZOG.

Nr. 114

DEKRET-LIGJË 2 Shtatuer 1931

Mbi vendosjen e Emigrantve

(Botue në Fletoren Zyrtare datë 19 Shtator 1931 Nr. 63)

Art. 1 Gjith ata persona, të lemun jashta kufive të Shqipniës independente, që janë Shqiptarë prej gjaku dhe gjuhe, pa ndryshim feje dhe seksi, të cilët tue u shperngul nga vendet e origjinës tyne, vijnë në Shqipniën e lirë, me qellim vendosje dhe mos këthyerjeje persëri në vendet e tyre, kanë të drejtë m'u instalue si emigrand në Shqipni, në konformitet me dispozitat e kësaj Ligjë.

Art. 2. Emigrandet e treguem në nenin e ma siperm, për sa asht e mundëshme, do t'i drejtohen organeve Konsulluer e Diplomatik të Shtetit Shqiptar ose ç'do autoritetit tjeter Shqiptar kompetent, tue ju paraqitë nji lutje, ku do të tregohet qellimi i shperngulljes prej vendit t'origjinës, me mendim mos këthimi persëri dhe me u vendos në Shqipnië.

Lutjes në fjalë do t'i shoqnohet nji listë, e cila do të permbajë gjith gjendjen civile t'emigrandit dhe t'antarëve të familjes që kryeson, tue i shtue edhe për ç'do person nji fotografië të vogël.

Art. 3. Autoritetet e treguem n'artikullin e siperme, kuer marrin nji kerkesë të tillë dhe konstatojnë se kerkuesi i permbahet të gjitha dispozitave t'art. 1 të kësaj Ligjë, lajmërojnë me nji herë Ministrin prej së cillës mëvaren, e kjo i a njofton Drejtoriës së Përgjithshme të Reformës Agrare.

Autoritetet e kufinit, personat e emigruem kan me i nisë drejt në Kryeqytet ose nder vende që u janë shenjue ma parë prej Drejtorisë kompetente.

Art. 4. Në rasë qi emigrandat nuk kane mjete ushqimi deri sa të mrrijnë në vendin e destinuem per instalim, autoritetet administrative, të cillave u janë drejtue emigrandat, kuer kanë kredi relative në dispozicion, si mbas nevojës qi të çafaqet, detyrohen me u pag'ue shpenzimet e udhtimit si mbas rases me kal ose me automobil, dhe për ushqim e fjetje i epen Fr. ar 1 deri 2 për ç'do personë.

Këto shpenzime, do të llogariten në buxhetin e Drejtoriës së Pergjithshme të Reformës Agrare.

Art. 5. Në rast që emigrandet, për arsye të pranueshme, nuk

kanë krye këto formalitete; as pranë autoriteteve konsulluer e diplomatike Shqiptar, as pranë autoriteteve kufizuer, do t'i drejtohen autoritetit administrativ të vendit të destinimit, të cillët obligohen me perpilue listat e gjendjes civile, me u qitë fotografiët si mbas dokumentavet që mund të kenë, dhe kuer kjo nuk asht e mundëshme, si mbas informatavet të marruna dhe shpjegimeve të dhanuna verbalisht prej t'interesuemvet.

Art. 6. Zyrat e emigrandave ose nëpunsat që perfaqësojnë këto Zyra në Prefektura ose Nenprefektura, që nga data e hymjes t'emigrantave në Shqipni, detyrohen me u dhanë për ç'do frymë Fr. ari 0.40 në ditë. Kjo ndihmë vazhdon një vit, tue paguar në katër kiste të njinjishme.

Art. 7. Organet e Zyres s'Emigrandave janë të detyruar të kërkojnë dhe t'u gjejnë punë emigrandave e të vazhdojnë mirë rrojtjen e tyne.

Art. 8. Mjeksit e Bashkies, detyrohen me i mjeksue emigrandet e vobekët gratis dhe, Zyra e Shëndetësies obligohet me ju dhanë barna pa shperblim.

Art. 9 Teshat, mobiljet, shtresat, enët, veglat, mjetet bulqësore ose industriale, shpendet, shtazët të trasha dhe bagtitë që sjellin emigrandet me vehte, perjashtohen nga tagri doganuer t'importimit si mbas periudhës parë të paragr. VII t'art. 4, dhe të periudhës parë t'art. 5 të Ligjës së tarifës; gjithashtu të gjitha këto sende perjashtohen dhe nga të gjitha taksat e tjera municipale, komunale ose arsimore.

Art. 10 Gjith personat emigrues detyrohen me u rregjistrue në Zyren e gjendjes Civile ku do t'instalohen si shtetas Shqiptarë; letër njoftimet u lëshoahen gratis.

Art. 11 Që nga dita e rregjistrimit, për 5 vjet perjashtohen nga sherbimi ushtarak dhe tre vjet nga detyrimi i punimit në rruga kombtare dhe Komunale;në kohë lufte ky perjashtim s'ka efekt.

Art. 12. Shteti, nga pasunija e vet, u ep gratis emigrandave për truell të shtëpies, (qi do të goditet si mbas planit të pregatitun nga Drejt. e Reformës Agrare), për dipendencat e për kopshtin 2500 m2. tokë; posë kësaj, për ç'do frymë të familjes, u epet edhe 1/2 Ha. (nji gjymës hektari) tokë të pa punueme ose livadhë.

Art. 13 Shtepia dhe tokat e tregueme në nenin e ma siperm, që nga dita e instalimit për pesë vjet rrjeshtas, janë të përjashtueme nga e dheta, nga kontributa e ndertesavet dhe nga ç'do lloj taksë të pasunivet të pa luejteshme.

kafshët e holla dhe të trasha t'emigrandeve, përjashtohen nga taksa perkatëse për tre vjetë t'instalimit.

Art. 14. Toka të punueme, u falen emigrandave qi janë bujq, dhe kanë pas për profesion të perherëshëm bujqësin e blegtorin. Personave të tjerë, qi janë marrë me tregtië të ndryshme, u falet nga nji copë truell sa për me ngreh shpi mbrenda në qytet, n'ato vende ku ka pasuni Shteti. Kjo kategori nuk perfiton nga ndihma që u permendë në nenin e sipërme.

Art. 15. Emigrandet që janë marrë me zeje detare, si barkar, peshkatar ose marinar, instalohen në brigjet e detit të Shqipnis; veglat dhe mjetet e peshkimit, të barkimit dhe t'anijetimit; kuer këto t'i sjellin me vehte të perdoruna, perjashtohen nga tagri doganuer i importimit.

Art. 16 Emigrandet, që janë mësue me punue mendafshin ose duhanë, instalohen nepër vende ku, nga pikpamja e teknikës bujqësore, mundë të zhvillojnë ketë llojë bujqësije, dhe ato që janë marrë ma tepër me ushqimin e kafsheve se sa me livrimin e tokavet, instalohen nepër vende ma të volitshme për jeten e tyne.

Art. 17. Tokat që u akordohen emigrandavet, janë këto qi vijojnë:

a) tokët e punueshme e livadhet që formojnë pasunin e Shtetit.

b) tokët që formojnë pasunin patrimonale rurale të Bashkive ose të katundarive;

c) tokët e çpronesueme prej Zyres Agrare në konformitet me ligjen relative, mbasi të jenë vendosur tanësisht bujqit proletar.

Art. 18 Landa e ndertimit të shpisë dhe të dipendencave të saj, u falen gratis nga pyjet Shtetnore, e në mungeasë të këtyne, nga pyjet municipale ose komunale, ose nga pyjet e ç'pronesueme në konformitet me Ligjen e Reformës Agrare.

Gjith-ashtu, përjashtohen nga të gjitha taksat perkatëse, guroret, furrat-gelqerje, kumit e tullave e të qërpiçëve. Në ketë përjashtim hynë edhe landët që perdoren për fabrikimin e veglave bujqësore, instrumentave zejtarije, industrore dhe detare, (fluga, barka e anije) të bame prej emigrandavet e qe perdoren prej tyne.

Art. 19. Emigrandet që vendosen në nji katund, çiflik ose qytet, përfitojnë nga të drejtat e kullotjes dhe e korrijevet, vetem nder prona Shtetnore e private të çpronsueme, dhe tokët e tyne gëzojnë të drejtat e të gjitha servitutevet qi kan pasë ma parë.

Art. 20. Në rast se emigrandat formojnë katunde të veçanta,

ju akordohe toka gratis për Xhami, për Kishë, Shkolla ,Vorreza e godina pleqsore për nji dyqan, kovaçhane, samarxhihane, nji shesh përmbledhje të përgjithshme, dhe nji fot-boll ose për tjetër sport, nji sasi vend t'arësyeshem për lulishte të katundit, për lamë dhe vend për nji depo të veglavet dhe të materjalevet bujqësore të kooperatives që ka me formue katundi, si edhe për çeljen e rrugavet të katundit.

Art. 21 Kuer e lyp nevoja e instalimit dhe e shëndetsis s'emigrandave, me hirin e të dy palve mund të blehen tokë, livadhe ose kullosa qi ndodhen nën zotnim legjitim të privatve e qi nuk çpronsohen.

Të blemit e tokave për nevojë të nalt-përmenduna, bahet me fondet të posaçme të Zyrës s'Emigrandavet.

Art. 22. Emigrandat, që nuk janë Shqiptar nga gjaku e nga gjuha, nuk përfitojnë nga të drejtat e akordueme prej kësaj ligjë.

Art. 23 § I. Emigrandavet bujq, për veç ushqimit të përmendun në nenin e posaçëm, do t'ju plotsohen kafshet deri nji pendë qè dhe nji lopë me qumësht osa pesë dhen plleja dhe veglat bujqësore. Gjithahtu do t'ju ngrehet ose do t'ju ndihmohet për ngrehjen e shtëpis, në formen ekonomike; fund e krye si mbas preventivit të Drejtoris së Përgjithshme të Reformës Agrare.

§ II. Emigrantat, janë të ndaluem me jetersue shpijat e tokat e akordueme prej Mbretnis Shqiptare. mbrenda 15 pesëmbëdhet vjetve ç'prej ditës së dorëzimait të tyne.

§ III. Shpenzimet e instalimit si edhe ato t'ushtrimit paguhen nga fondi i cakuem në buxhetin për instalimin e emigrandave.

§ IV. Drejtorija e Përgjithshme e Reformës Agrare, me anen e Zyrave t'emigrandve, do të mbajë nji llogari të veçantë për çdo familje t'instalueme, tuej shenjue të gjitha shpenzimet e bamuna për te si mbas Ligjës kontabilitetit të rregullores të posaçme; për ketë shkak, të gjith antarve të familjevet u epet nga nji leter njoftimi me fotografiet e tyne, ku si mbas raset do të shenjohen ndihmat e dhanuna. Këjo lloagri, mbasi të vërtetohet edhe prej Kryetarit të familjes do të mbahet në dy kopje, prej të cilave njana do t'i dergohet Finances ose Bankës Agrare, d.m.th. Zyrës së ngarkueme me mbajtjen e llogarive të shpenzimeve të përgjithshme.

§ V. Shpenzimet e bamuna për istalimin e emigrandevet si mbas artikujvet të siperm, kan me u rimborsue prej emigrandit detyrues mbrenda 15 vjetve e me kiste të njinjishme, tuej fillue 5

vjet mbas ditës s'instalimit; këto do t'i këthehen Arkës së Shtetit ose Bankës Agrare qi ka avancue fondin.

Për këtë qellim, emigrandi detyrues ka për të dhanë nji difte-së detyrimi të posaçme, e cila me anen e Zyrës Agrare ka me u dorzue Arkës së Shtetit ose Bankës Agrare.

IV. Të blemit e të gjitha gjanave për instalim emigrandash, do t'i shtrohet dispozitave të Ligjës së Kontabilitetit e Rregullores relative.

Art. 24. Ligja mbi vendosjen e Emigrndevet me d. 14. VI. 923 bashkë me Rregulloren perkatëse, abrogohen.

Art. 25. Kjo ligjë hynë në fuqi 15 ditë mbas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 26 Me ekzekutimin e kësaj ligjë ngarkohet Këshilli Ministruer.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. të Jashtme
H. Vrioni

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Seid Toptani

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëvet

Mbi proponimin e Kryeministriës Nr. 188-VI datë III. 931.

Si ndigjojë dhe pelqejë Vendimin e Këshillit Ministruer me datë 20-VIII. 931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi vendosjen e Emigrandavet.

Durrës, me 2 Shtatuer 1931.

ZOG.

Nr. 115

RREGULLORE 22 Shtatuer 1931

Mbi zbatimin e Dekret-Ligjës për importimin e farës së grunit pa tagër doganuer

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 65 datë 29 Shtatuer 1931)

Art. 1.

Bujqëve dhe pronarëve Shqipëtarë i jepet farë gruni e destinueme ekskluzivisht për mbjellje dhe si mbas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Fara e grunit shperndahet ndër qendra të Prefekturave dhe të Nenprefekturave.

Art. 2

Në qendrat e Prefekturavet dhe të Nënprefekturavet formohen Komisione për shpërndamjen e farës së grunit për t'ju dhanë bujqëvet e pronarëvet.

Në çdo qender të Prefekutrave formohet nji komision nen kryesin e Prefektit me anëtarë Drejtorin e Financavet, Agronomin e Prefektures, nji përfaqësues t'Odës s'Ekonomis dhe dy përfaqësuës nga populli të zgjedhun prej Këshillit Administrativ.

Në qendrat e Nenprefekturavet komisjonet kryesohen nga Nenprefekti tue pasë anëtar Kryetarin e Bashkisë, N-Drejtorin e Financavet ose Agjentat e Financavet, nga nji të ngarkuem të Ministris s'Ekonomis Kombëtare dhe dy përfaqësues të popullit të zgjedhun nga Këshilli Administrativ.

Nder vende ku ndodhen Shoqënina Bujqësore të njoftuna zyrtarish si përfaqësuesa të popullit merret dhe nji antar nga Këshilli administrativ të këtyne.

Këto komisione janë përgjegjes për çdo çrregullim qi mund të ngjajnë në shpërndamjen e farës.

Art. 3.

Detyra e Sekretarit i ngarkohet njanit prej anëtarëvet qi shef të arësyeshme Kryetari i Komisionit.

Art. 4

Kryetarët e Administratave të vendit lajmërojnë Kryepleqtë për me i paraqitë listat e bujqëve nevojtar të katundeve e të lagjeve të tyne, të vertetueme prej Kryepleqësis qi kanë pregatitë para mbjelljes së farës token e përshtatëshme për mbjelljen e grunit d.m.th. tokë pjellore e të kullueme nga ujnat e dimnit.

Art. 5

Komisioni në bazë të gjendjes bujqësore të ç'do katundi, caktojnë sasinat e farës qi kanë me i dhanë katundit e mandej, tue studjue listen specifikuese paraqitun prej kryepleqve të sejcilit katund, caktojnë sasinë e farës qi duhet t'i jepet çdo bujku.

Për caktimin e farës të ç'do bujku duhet të merret parasysh, vobeksija, kapaciteti në punë bujqësore, punimi ose jo i tokave të destinueme për mbjelljen e grunit, tue u preferue në ç'do rast ata qi kanë gati tokat ma të përshtatëshme për t'u mbjellë.

Art. 6

Në rasë se fara e sjellun nga Ministrija e Ekonomis Kombëtare nuk do të jetë e mjaftueshme për nevojat e sejcilit rreth, komisjonet në caktimin e farës duhet të përjashtojnë përsonat qi kanë posibilitet financiare të blejnë faren me të holla në dorë.

Art. 7

Komisjonet e formueme si ma sipër ngarkojnë dy nga antarët e komisionit për marjen në dorëzim të sasies së përgjithshme të farës së caktueme për çdo qender Prefekturë, ose Nenprefekturë dhe këta do të jenë pergjegjës për shpërndamjen në rregull si mbas listavet të vertetueme nga Komisionet.

Art. 8

Fara e grunit e sjellun nga jashtë merret në dorëzim për heren e parë nga komisjoni i deleguem prej Ministris s'Ekonomis Kombëtare, i cili asht përgjegjes për sasinë e marrun në dorëzim deri sa t'ja u dergojë përfaqësuesvet të sejcillit komision, si mbas sasies së caktueme.

Art. 9

Bashkiët e çdo rrethi detyrohen të sigurojnë depo për mirëruejtjen e farës deri në çastin e shpërndamjes së farës bujqëve.

Art. 10

Antarët e komisjosit të deleguem me shpërnda faren e grunit, kanë me i dorëzue përsonavet të shenueme në listen përkatëse sasien e farës qi i përket, kundrejtë nji leter-detyrimi të nenshkrueme prej marrësit e të vertetueme nga Kryepleqësija dhe nga Komisioni shpërndasë.

Art. 11

Leter-detyrimet e bujqëvet të vertetueme rregullisht prej komisionit nji proces-verbal dhe nji listë specifikuese i dorëzohen financës qi i lidhet, dhe nji kopje e listavet qi përmban emnat e mbiemnat, banimet, sasinë e farës marrun për sejcilin bujk, dhe

procesi i komisionit i dergohet Ministris s'Ekonomis Kombëtare dhe njana ruhet në arkiven e Prefekturës ose Nënprefekturës së vendit.

Art. 12

Komisjonet e shperndarjes së farës së gruni janë të detyruem me paraqitun listat në Këshillin administrativ të sejcilit rreth, para shperndarjes për me caktue personat qi do të detyrohen me pague vleitën e farës në të holla si mbas Art. 1. të ligjit përkatëse

Art. 13

Nxjcreja e të hollavet të vleftës së kushtimit të farës ose mbledhja e farës në natyrë, bahet nga zyrat financiare përkatëse.

Art. 14.

Marrësit e farës detyrohen qi n'afatet e caktuem në letër detyrimet të sjellin farën në depot qi ka me caktue financa.

Art. 15.

Personat qi nuk sjellin farën në depon e financës së vendit në kohën e caktueme humbin të drejtën me sjellë vleftën e farës në natyrë, por financa ka të drejtë me nji vendim të Këshillit me kërkue vleftën e farës në të holla.

Art. 16.

Vlefta e farës caktohet nga Këshilla Teknike e Ministris s'Ekonomis Kombëtare.

Art. 17.

Fara qi katundarët do të sjellin në depo të financës duhet të jetë e qirueme dhe të dorës së parë.

Art. 18.

Personat ose Shoqnit bujqësore që dëshirojnë të sjellin farë gruni pa tagër doganor, duhet qi të marrin ma parë pelqimin e Ministris s'Ekonomis Kombëtare, tue tregue sasinë dhe shtëpiet tregtare nga të cillat asht blerë farë dhe, policat duhet t'i drejtoher zyrës së bujqësis së qarkut ku do ç'doganohet fara, Zyra e bujqësis me shpejti e xhiron në emerin të urdhnuem për ç'doganimin e farës.

Art. 19.

Me të mritunit e farës në doganë Drejtorija e doganës asht e detyrueme me u kujdesue për mirë-ruejtjen e farës deri në dorëzim antarve te komisjonevet të ç'do rrethi.

Art. 20.

Fara në koher e shpërndarjes do të disenfektohet nga ana e

personalit të ngarkuem prej komisionit.

Art. 21.

Çdo llojë shpenzimi qi do të bahet për ngarkim, shkarkim transport deri në qendrat e sejcilit rreth si dhe mjekimi i ngarkohet Ministris s'Ekonomis Kombtare.

Art. 22.

Pleqsija e Katundeve janë të detyruem me raportue në Komune bujqit qi nuk kanë mbjellë farën e marrun dhe qi e kanë perdorun për qëllime të tjera.

Në rast heshtje, Kryepleqët denohen me vendim të Këshillit Komunal si mbas dispozitave të Ligjit mbi Komunet, në bazë të raportimevet t'Agronomit.

Art. 23.

Agronomet detyrohen me kontrollue mbjelljet edhe me i a raportue Ministris, kundra-vajtësit t'Art. 3 të ligjës përkatëse, e cila me nji herë vendos dënimin si mbas nenit të sipërme dhe i a dergon financës përkatëse për ekzekutim.

Përjashtohen nga dënimi bujqit, ose pronarët qi për shkaqe të forcave madhore nuk kanë mundur të mjellin.

Art. 24.

Ministrija e Ekonomis Kombëtare, e Financavet dhe ajo e P. të Mbrendshme ngarkohen me zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Art. 25

Kjo Rregullore hynë në fuqi diten e shpalljes në fletoren Zyrtare.

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri P. të Jashtme:
H. Vrioni

Ministri P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri Ekonom. Kombëtare
Seid Toptani

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve

Mbi proponimin e Kryeministriës Nr. 1192-XI datë 10-IX-931.

Si ndigjojë dhe pelqejë Vendimin e Këshillit Ministruer me datë 7-9-931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Rregullores mbi zbatimin e Dekret-Ligjit për importimin e farës së grunit pa tagër doganuer,

Durrës, me 22 Shtatuer 1931.

ZOG.

Nr. 116

DEKRET-LIGJË 22 Shtatuer 1931

Mbi lidhjen e nji rroge jetike Z. Dr. Ruzhdi Bobratit

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 66 datë 10 Tetuer 1931)

Art. I.

Tue marë parasysh sherbimet qi ka ba Z. Dr. Rushdi Bobrati, Inspektor i Shëndetsis, si edhe moshën e tij të kalueme dhe gjendjen shëndetsore të keqe, i lidhet këti nji rrogë jetike prej fr. ari 340 (treqind e dyzet) në muaj.

Art. II.

Ky Dekret-Ligjë hyne në fuqi qysh nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. III.

Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e këtij Dekret-Ligji.

Kryeministri:
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit:
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri Ekonom. Koambëtare
Seid Toptani

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 13-41 datë 17-IX-931.

Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 5-IX-931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-ligjit mbi lidhjen e nji rroge jetike prej fr. ari 340 në muaj Z. Dr. Ruzhdi Bobrati, Inspektor i Shëndetsis.

Durrës, me 22 Shtatuer 1931.

ZOG.

Nr. 117

RREGULLORE 22 Shtatuer 1931

Për shtesë e ndryshim t' art. 1. të Rregullores s' Administratës

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 66 datë 10 Tetuer 1931)

Art. 1 Mas germës a) me u shtue:

b) Forca bujtëse e përbame prej Ushtarakve (nen-Oficiera, graduat e Ushtar) qi janë të transferuem përkohësisht prej repartit me qendra në garnizone të ndryshme.

Bujtësat me gjith qi janë të shenjuem veçanërisht me dokumenta të ndryshme Administrativ e llogaritjet, i marrin në repartin ku janë bujtës po të gjitha njato të drejta qi u nepen ushtarakëve efektiva.

Me ndryshue germen b) ne

c) Forca në susistence e përbame prej ushtarakësh, nen-Oficierave, graduat e Ushtar) qi janë të trasferuem përkohësisht prej nji reparti në tjetrin qi gjinden në nji qënder.

Ushtarakët në susistencë marrin vetem ushqimin prej repar-

tii pranë të cillit janë në susistencë e për të drejtat e shpenzime të tjera i sjellen repartit ku janë efektiv.

Germa c) në d)

» d) në e)

» e) në f)

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit:
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Seid Toptani

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1598-I-datë 7.IX.931.

Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 24.VIII.931,

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Rregullores mbi modifikimin e Nenit 1 të Rregullores për administrimin e Trupave Ushtarake.

Durrës, me 22 Shtatuer 931.

ZOG.

Nr. 118.

DEKRET-MBRETNUER 22 Shtator 1931

Mbi pranimin e Çifliqeve të dhurueme prej N. M. së Tij Mbretit

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 66 datë 10 Tetuer 1931)

VENDIM

Nr. 732 datë 7.XI.1931

Këshilli Ministruer me mbledhjen e tij të sotshme të mbajtur

nen kryesinë e Z. Pandeli Evangjeli, Kryeminister, me antar Z.Z Milto Tutulani, Minister i Drejtësis, Hysen Vrioni, Ministri i P. të Jashtme, Musa Juka, Ministri i P. të Mbrendëshme, Hil Mosi Ministri i Arësimit, Lame Kareco, Ministri i Financavet, Izet Dibra, Ministri i P. Botore, Said Toptani, Minister i Ekonomis Kombëtare, mbi proponimin e bamun me shkresen Nr. 134-20 datë 11 VIII 1931 të Ministrisë Financavet, mbassi studijoi dhe vendimin Nr. 807 datë 20-VIII-31 të Këshillit të Shtetit.

V e n d o s s i:

Pranimin në emën të Shtetit të çifliqeve private Divjake, Karavasta, Çakajas, Rremas me Përves, tue përjashtue Pylli i Divjakës qi N.M. e Tij Mbreti ka çfaqë dëshirën me i adhurue Shtetit në bazën e § II. të Art. 659, të Kodit Civil.

Ky vendim i paraqitet N. M. së Tij Mbretit për dekretim.

Z O G U I.

Mbreti i Shqiptarve

DEKRETON

Aprovimin e vendimit të sipër-përmendun, dhe Urdhunon zbatimin e tij.

Durrës, me 22 Shtatuer 1931

Z O G.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i Ekonomis Koambëtare
Seid Toptani

Nr. 119

DEKRET-MBRETNUER 13 Tetuer 1931

Mbi krijimin e Kap. Nr. 61 ter «Shpenzime të çdo natyre për funksjonimin e Komisjonit të Huas

(Botue në Fletoren zyrtare Nr. 67 datë 22 Tetuer 1931)

Z O G U I.

Mbreti i Shqiptarve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 1178-35 datë 23-IX-31, të Kryeministris,

DEKRETON

Art. 1. — Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet të Mi-

nistris së Financavet për ushtrimin financiar 1931-32, krijohet kapitulli N. 61 ter «Shpenzime të çdo natyre për funksionimin e Komisionit të Huas, i themeluem në bazë të Rregullores s'aprovueme me Dekret Mbretnuer 30 Qershuer 1931» me shumen Fr. ari 35.000 tridhet e pesmijë.

Art. 2. Shuma e përmendun në nenin e sipërtreguem prelevohet nga fondi i rezervës emertue në kapitullin 55 në gjendjen e parapamjeve të shpenzimeve të Ministris së Financavet të sipërtregueme.

Art. 3. Ky Dekret ka me i u paraqitun, në bazë të nenit 31 parag. i fundit të ligjit 28 Maj 1929, Parlamentit për ratifikim.

Art. 4. — Ministri i Financavet ngarkohet me zbatimin e këtij Dekreti, që ka me hye në fuqi që prej ditës të shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Z O G.

Tiranë, më 13 Tetuer 1931.
Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 120

DEKRET-LIGJË 13 Tetuer 1931

Mbi bartje fondesh prej fr. ari 46.000 në budgetin e ushtrimit 1931-32 të Ministris P. të Jashtme

(botue në Fletoren Zyrtare Nr. 67 datë 22 Tetuer 1931)

Art. 1. Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financiar 1931-32 të Ministrive pakësohen fondet që vijojnë:

Ministrija e Financavet

Nga Kap. 32-2 Shpenzime gjithëfarësh për funksjonimin e Zyrës Agrare:

Rrogë personeli me kontrat	fr. ari	6000
Nga Kap. 30 shpenzime zyre etj.	» »	1000

Ministrija e P. të Mbrendshme

Nga Kap. 1 Rrogë personali zavendësije etj.	fr. ari	23.000

Ministrija e P. Botore

Nga Kap. 1 Rrogë personali etj	fr. ari	6000.

Ministrija e Ekonomisë Kombëtare
Nga Kap. 8 Punime të ndryshme dhe shpenzime gjithëfarësh për stasjone zooteknike fr. ari 10.000

» » 46.000

Art. 2. Fondet e pakësueme prej fr. ari 46.000 (dyzetegjashtëmijë) si mbas Art. 1 të kësaj Dekret-Ligje, i shtohen Kap. 6 «Shpenzime të mëshefta» të gjendjes së parapamjevet t'ushtrimit 1931-32 të Ministris së P. të Jashtme.

Art. 3. Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. Me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje ngarkohet Ministrija e Financavet, Ministrija e P. Mbrendshme, Ministrija e P. të Jashtme, Ministrija e Ekonomisë Kombëtare.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekon. Kombëtare
Seid Toptani

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1974, datë 26-IX-1931.
Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 24-IX-1931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës për bartjen e nji fondi prej fr. ari 46.000 për të plotësue me këtë, fondin e Kap. 6 «Shpenzime të mëshefta» të budgetit udhtues të Ministris së P. të Jashtme.

Tiranë, më 13 Tetuer 1931

ZOG.

BKSH

Nr. 121

DEKRET-LIGJË 7 Tetuer 1931

Mbi importimin e Misrit për të vobektët

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 67 datë 22 Tetuer 1931)

Art. 1

Autorizohet Ministrija e Ekonomisë Kombtare me importue 20.000 kuintal misër për t'ja u shpërnda bujqëve të vobekët gratis.

Art. 2

Misri në fjalë do të përjashtohet nga tagri doganuer dhe nga çdo taksë tjetër, që nxirret prej autoriteteve doganorë n'importimin e tij.

Art. 3

Shperndamja e misrit do të bahet prej Ministris së Mbrendëshme si mbas Rregullores së posaçme.

Art. 4

Shpenzimet e nevojshme për blemjen e misrit në fjalë do të përballen prej fondeve të Ministris s'Ekonomisë nga fondet e Huas.

Art. 5

Me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje ngarkohet gjithë Trupi Ministruer.

Art. 6

Kjo Dekret Ligjë hynë në fuqi qysh mbas ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit:
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Seid Toptani

BKSH

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve

Mbi proponimin e Kryeministrisë Nr. 1192-XIV datë 30. 9. 1931.

Si ndigjojë dhe pelqejë Vendimin e Këshillit Ministruer me datë 29. 9. 1931,

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi përjashtimin nga tagri doganuer të misrit, që do t'importohet prej Ministrisë së Ekonomis Kombëtare.

Durrës, më 7 Tetuer 1931.

ZOG.

Nr. 122

DEKRET-LIGJË 12 Tetuer 1931

Mbi trasferim fondesh në budgetin udhtues të Ministrive të ndryshme

(Botuen në Fletoren Zyrtare Nr. 68 datë 29 Tetuer 1931)

Art. Në budgetin e ushtrimit financiar 1931-32 paksohen këta fonde:

Prej kap. 1 «Rrogë personeli» të Budgetit të Ministris së Drejtësis	Fr. ari 2000
Prej kap. 1 «Rrogë personeli» të Budgetit të Ministris s'Ekonomis Kombëtare	» » 1500
Prej kap. 56 bis «Spenzime për të vue në dorë pasunit e grabituna të Shtetit»	» » 1000
Prej kap. 4 «shpenzime zyre» të budgetit të Drejtoris së P. të Reformës Agrare	2500
Shuma	Fr. ari 7000

Art. 2 Shuma e fondeve prej Fr. ari 7.000, pakësue si mbas artikullit I të kësaj Dekret-Ligje, i shtohet kap. 2 «Misione të Jashtzakonësme» të budgetit udhtues të Ministris së P. të Jashtme.

Art. 3. Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi prej ditës që shpallet në Fletoren Zyrtare.

Art. 4 Ministrija e P. të Jashtme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. Jashtme
H. Vrioni

Ministri P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit
Hil Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri Ekonom. Kombëtare
Seid Toptani

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1714-II datë 9-X-1931.

Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 9-X-1931,

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi transferim fondesh në budgetin udhtues të Ministrive të ndryshme.

Tiranë, më 12 Tetuer 1931

ZOG.

Nr. 123

DEKRET-LIGJË 12 Tetuer 1931

Mbi krijimin e Kap. 16 „Shpenzime çdo natyre për blemjen e shpërndamjen e misrit Popullsis së vobekt, si dhe për blemjen e shpërndamjen e farës së grunit» në budgetin 1931-32 të Ministris s' Ekonomis Kombëtare

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 68 datë 29 Tetuer 1931)

Art. 1. Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet të Minis-

tris s'Ekonomis Kombtare për ushtrimet 1931-32 krijohet kapitulli 16 «shpenzime ç'do natyre për blemjen e shpërndamjen e misrit populisis së vobekët, si dhe për blemjen e shperndamjen e farës së grunit» me nji fond prej fr. ari 400.000 (katërqindmijë).

Art. 2 Fondi i caktuem n'Art. 1 të kësaj Dekret-Ligje përballohet me huan e autorizueme me Ligjë datë 30 Qershuer 1931

Art. 3. Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi me ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. Me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje ngarkohet Ministrija e Ekonomis Kombtare e Ministrija e Financavet.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri P. të Jashtme:
H. Vrioni

Ministri P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri Ekonom. Kombëtare
Seid Toptani

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1178-31, datë 11-IX-931

Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me da të 8-IV-1931,

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi krijimin e Kap. 16. « Shpenzime ç'do natyrë për blemjen e shpërndamjen e misrit popullsis së vobektë, si dhe për blerjen e e shperndamjen e farës së grunit » me nji fond prej fr. ari 400000 (katërqindmijë

Tiranë me 12 Tetuer 1931.

ZOG.

BKSH

Nr. 124

SHTOJCË-DEKRET-LIGJË 12 Tetuer 1931

Mbi zbatimin e Shtojcë Dekret-Ligjës me datë 7-X-1931 mbi importimin e misrit për të vobektët

(Botue në Fletorën Zyrtare Nr. 68 datë 29 Tetuer 1931)

Art. 1.

Misri, që ka me importue Ministrija e Ekonomis Kombtare për Q. 1.2000 për me u shpernda gratis bulqëve të vobekët, ka me i u-dhanë edhe atyne, që nuk merren me bujqësi.

Art. 2.

Personat, që kanë me përfitue prej misrit, që ka me u shpernda gratis, të cilat mbas ligjës përkatëse kanë cilsinat e lypuna për me punue ndër rruga kombtare, detyrohen, në rast që nuk ka posibilitet të përdoren ndër rrugat e sipërthanuna, të punojnë ndër rruga Komunale si mbas urdhnave të Ministris së P. Botore dhe, në bazë të nji Rregulloreje përkatëse, që ka me u-pregatit për këtë qëllim.

Art. 3.

Kjo Shtojcë-Dekret-Ligjë hynë në fuqi qysh nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e saj ngarkohet Trupi Ministruer.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit:
Hil Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Seid Toptani

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeminitsris Nr. 1192-XVI datë 13-X-931,
Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 12-X-931,

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Shtojcë-Dekret-Ligjës mbi importimin e misrit për të vobekët me datë 7 Tetuer 1931.

Tiranë, me 12 Tetuer 1931

ZOG.

Nr. 125

LIGJË 10 Nanduer 1931

Mbi bartjen e nji fondi prej 5000 fr. ari në budgetin 1930-31 të Drejt. P. të Post-Telegrafave

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 72 datë 18 Nanduer 1931)

Art. 1.

Bartet nji fond prej Fr. ari 5.000 (pesëmijë) prej Kap. 10. «Taksa telegramesh, pjes' e huej» në Kap. 11 «Shpenzime udhtimi e djete» në budgetin 1930-31 të Ministris së P. Botore, Degë e « Post-Telegrafavet ».

Art. 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi me ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministrija e P. Botore dhe ajo e Financavet.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartjen e nji fondi prej fr. ari 5.000 (pesëmjë) në budgetin 1930-31 të Ministris së Punëve Botore, degë e Post-Telegrafavet, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 124-I datë 3 XI-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, më 10 Nanduer 1931.

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
L. Kareco.

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Nr. 126

RREGULLORE 10 Nanduer 1931

Mbi shpërndàmjen e misrit gratis të vobektvet Shqyptar

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 72 datë 18 Nanduer 1931)

Art. 1.

Popullit të vobekët Shqyptar i nepet miser gratis si mbas dispozitave të kësaj Rregulloreje. Misri shperndahet ndër qendrat e Prefekturave e të Nenprefekturave, ku shkon automobili.

Art. 2

Për caktimin e shperndarjen e sasis së misrit për t'i udhanë gratis popullit të vobekët formohen ndër qendra të Prefekturave e të Nenprefekturave Komisjone të posaçme si vijon:

Në qendrën të Prefekturave formohen Komisjone nën Kryesin e Prefektit me antare Drejtorin e Financavet, Kryetarin e Bashkis e katër vetë nga parsija e vendit ose nga Këshilli i Bashkis, të zgjedhun nga Këshilli Administrativ.

Në qendra të Nenprefekturave formohen nën Kryesin e Nenprefektit me antarë Kryetarin e Bashkis, Kryenëpunësin e Financës ose Agjentin Financjer e dy vetë nga parësija e vendit ose dy anëtarë të Këshillit të Bashkis.

Këta Komisjone janë përgjegjes drejt për drejtë për ç'do ç'rregullim e abuzim, që të ngjasi në shperndarjen e misrit.

Art. 3.

Mbi ftesën, që t'u bahet nga organet administrative të vendit, pleqsit e katundeve e të lagjeve detyrohen me pregatitun në dy kopje të njinjishme listat e të vobektve (të familjeve e të numrit t'antarve të tyne) të katundit ose të lagjes së tyne, të cillat, mbassi t'i vërtetojnë me vulen zyrtare të Kryepleqsis e t'antarve, ja u paraqesin Komuneve përkatëse.

Art. 4.

Ç'do Komune, mbassi të mbledhë listat e të gjithë katundeve të rajonit të saj, i vërteton duherisht adhe ja çon (të dy kopjet) Prefekturës, nga e cila mvaren; Nenprefekturat ja u sjellin këto Prefekturave të tyne, të cilat ja parashtrojnë të gjitha Komisjonit përkatës, të formuem si mbas art. 2 të kësaj Rregullorje, për kompetencë.

Art. 5.

Komisjoni i Prefekturës i shqyrton e i verteton listat, q'i paraqiten, tue ba mbi to (mbi të dy kopjet) verejtjet relative; në bazë të tyne cakton sasinë e misrit për Prefekturën përgjithsisht e për ç'do Nenprefekturë pjesërisht. Misri ka me u dhanë kg. 10 për ç'do person.

Sasia e përgjithshme për Prefekturë e pjesore për çdo Nenprefekturë caktohet në bazë të numrit të vobekvet e të sasis së misrit të caktuem për kokë. Këto përfundime i komunikohen Ministris së P. të Mbrendëshme e Ministris s'Ekonomis Kombtare, të cilat disponojnë dergimin e misrit të nevojshem.

Art. 6.

Nga nji kopje të listave të shqyrtueme e të vërtetueme me mënyrë e nalt-tregueme ruhet n'Arkivat e Prefekturave, e tjerat u sjellen o u mbeten Komisjoneve të Prefekturave e të Nenprefekturave, si bazë për shperndarjen e misrit.

Art. 7.

Nder Nenprefektura, ku nuk ka rrugë automobili, misri depozitohet e shperndahet në qendren e Prefektures e të Nenprefektures ma t'afërme, ku ka rrugë automobili, dhe listat e tyne të vërtetueme në bazë t'art. 5 të kësaj Rregullorje mbesin o u sjellen për veprim Komisjoneve të këtyne Prefekturave o Nenprefekturave.

Art. 8.

Komisjonet e Prefekturave e të Nenprefekturave delegojnë herë mbas here nga tre antarë për me marrë në dorzim misrin, q'i dergohet në bazë të kerkesës së bamun Ministris së P. të Mbrendëshme, si edhe për me ja shpërnda këtë të vobektve të caktuem në listat relative.

Art. 9.

Personat e delegueme me shpernda misrin kanë me u dorzue personave të shenjuem në listë o Kryetarve të familjeve përkatëse sasin e misrit, q'i përket si mbas sasis së caktueme për kokë,

kundrejt nji diftesë të nenshkrueme të marrësit o të shenjueme me gjishtin e tij. Vetëm kur vend-banimi i të vobektve asht tepër larg nga qendra, ku shperndahet misri, Komisjonet e caktuem në artikullin 2, munden me vendue dorëzimin e nji sasis së misrit Kryepleqsis përkatëse, e cilla i nep diftesën e vet komisjonit për me marrë përsypri nen përgjegjsin e vet shperndamjen ekzakte të misrit ndermjet të vobektve të vendit të vet. Diftesat shperndamjes kontrollohen e ruhen nga Komisjonet përkatës dhe i dorzohen herë mbas here Prefekturës o Nenprefekturës bashkë me listat e tyne, e kështu deri sa të përfundohet shperndarja e misrit Prefekturat e Nenprefekurat janë përgjegjëse për mirë-ruejtjen e këtyne dokumentave.

Art. 10.

Transportimi i misrit prej Limaneve ndër qendrat e Prefekturave dhe të Nenprefekturave ka me u ba me sipërmarrës të posaçme mbas një adjudikate ose lidhate të rregulltë.

Art. 11.

Personat, që kanë me përfitue prej misrit gratis dhe të cilët, si mbas ligjës përkatse, janë në moshen ligjore, janë të delegueme me punue ndër rrugë kombëtare e Komunale, si mbas Ligjës përkatëse.

Art. 12.

Ministrija e P. të Mbrendëshme e Ministrija e Ekonomis Kombëtare ngarkohen me zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Art. 13.

Kjo Rregullore hynë në fuqi që ditën e shpalljes në Fletore Zyrtare.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i P. të Jashtme
Hysen Vrioni

Ministri P. të Mbrendshme:
Musa Juka

Ministri i Arësimit:
Hil Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Seid Toptani

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve
Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1192-XX. datë 6-XI-1931,
Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 30-X-1931,

DEKRETON
Aprovimin dhe zbatimin e Rregullores mbi shperndamjen e misrit të vobektëve.
Tiranë, më 10 Nanduer 1931.

ZOG.

Nr. 127

LIGJË 5 Nanduer 1931

Mbi gjykimin e shpejtë të padinave posedimore

(Botue në Eletoren Zyrtare Nr. 72 datë 18 Nanduer 193)

Titulli I.

Gjykimi i padinave posedimore, të denoncimit të veprës dhe të damit të kercnuem

KAPTINA I.

Dispozita të përgjithshme

Neni 1.

Padinat posedimore të themelueme në nenet 1052 e 1053 të Kodit Civil ngrehen me kerkesë ose me procesverbal përpara gjykatës Paqtuese kompetente.

Neni 2.

Kur, pas ngrehjes së padisë së zotnimit pranë nji gjykate, ngjajnë fakte të parapam në nenin e ma sipermë, këta gjykohen po prej kësaj gjykate, që shef padinë e zotnimit.

AQSH

KAPTINA II.

Gjykimi i padies së dorë-mbajtjes dhe të rivuemjes

Neni 3.

Në rast t'ushtrimit të padinave të permenduna në nenin 1 Gjykata kompetente, me t'u-paraqitun kerkesa ose me t'u redaktue proces-verbali, passi të jenë pague shpenzimet e padisë, urdhënon komunikimin e kopjes së kerkesës ose të procers-verbalit mbrenda nji kohe nga nji deri më tri ditë, dhe cakton audiencën për gjykim në njanen nga pesë ditët, që vijnë pas komunikimit.

Me anë të këtij akti do të porositet i paditunі që n'atë ditë të ketë gati mjetet provuese, qe i quen të nevojshme për me provue mbrojtimet e veta me permendje se, në rast të kundertë, mund të mjaftohet vetem me provat, që ka me parashtrue paditësi.

Porosina analoge do t'i bahen edhe paditësi mbas marrjes së kerkesës ose të redaktimit të proces-verbalit dhe, për këto do të bahet shenim veçanërisht në fund t'aktit të padisë, tue u-marrë nenshkrimi i tij.

Neni 4.

Në vendimin, që epet mbi padinat e permenduna në nenin 1, mund t'urdhënohet ekzekutimi i perkohshem, tue u-marrë ose jo garanci prej anës gjyq-fituese.

Ekzekutimi i perkohshem vazhdon deri sa vendimi të marrë formen e gjasë së gjykueme, por Gjykata e Diktimit, tue prishun vendimin, mund t'urdhënojë edhe kryesisht sjelljen në gjendjen e ma-parëshme.

Neni 5.

Afati i Diktimit për vendimet e dhanun faqësisht asht pesë ditë që prej datës së deklarimit të Vendimit.

Ato të dhanun në mungesë janë të kundershtueshem mbrenda tri ditëve që prej të nesërmes se komunikimit, dhe të diktueshëm mbrenda 5 ditëve që prej të nesermes së mbarimit t'afatit të kundershtimit.

Aktet në fjalë shtohen për shkak distance si mbas nenit 19 të Shtojcës Irë të Procedures Civile.

Neni 6.

Afatet e caktuem në nenin 3 të kësaj Ligjë aplikohen dhe në rast, që kundershtohet vendimi mungimor.

Neni 7.

Në rast, qe çashtja diktimohet, Sekretari me kujdesin e gjyq-

tarit detyrohet me impostue aktet për në Gjykaten e Diktimit mbrenda pesë ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës diktimore, dhe, gjykata e Diktimit asht e detyrueme me përfundue shqyrtimin me shpejtësinë ma të madhe, tue e preferue nga çashtjet e tjera.

KAPTINA III.

Padija e denoncimit të veprës së ré dhe të damit të kërcënuem

Neni 8.

Në çeshtjet e denoncimit të veprës së rè ose të kercnimit Gjyqtari paqtues ose gjykata, pranë së cilës asht mvarë gjyqi, që ka lidhje me objektin e denonacimit, tue u konformue me kaptinen e IItë të Titullit XIX të Shtojcës IItë të Procedurës Civile, mund t'urdhënojë me nji herë pezullimin e vazhdimit të punimevet, dhe vendimin detyrohet t'a japë mbrenda pesë ditëvet nga data e paraqitjes së kerkesës.

Neni 9.

Gjyqtari, mbassi të marrë vendimin mbi denoncimin e veprës së rè, vazhdon në shqyrtimin e themelit të çashtjes në rast që asht kompetent, tue e detyrua me i sjellë deftesën e ngrehjes së padisë mbrenda dhetë ditëvet prej datës, me të cilen vendimi merr formen definitive.

Mos sjellja e diftesës mbrenda afatit të sipërtreguem shkakton rrëzimin e masës provizore të marrë në favor të denoncuesit, edhe kuer asht marrë garanci, bjerjen e kësaj.

Titulli II.

Masa provizore në padien e posedimit

KAPTINA I.

Dispozita të Përgjithshme

Neni 10.

Në rast t'ushtrimit të padinavet posedimore të themelueme në nenet 1052 e 1053 të Kodit Civil, paditësi njikohësisht me paraqitjen e padijës, ose në vazhdimin e procedimit të padinavet në fjalë, ka të drejtë të kerkojë marrjen e masave provizore në konformitet me nenin 398 të Shtojcës IItë të Procedurës Civile dhe të dispozitave të këtij Titulli.

Bujku nuk mund të kerkojë masa provizore, as nuk mund të quhet posesor, veç se, si mbas Kodit Civil, duhet qe qellimin (animus-in), që e ka mbajtun me mirëbesim, t'a provojë me nji shkresë, e cila të ketë kuptimin e nji titulli zotnimi.

KAPTINÀ II.

Nënyra e marrjes së masave provizore

Neni 11.

Gjyqtari, kur kerkohet marrja e masave provizore, pa vonesë detyrohet me anen e nji ordinance të caktojë vendin dhe kohen për bisedimin e çashtjes; kopja e kësaj ordinance, e cila shkruhet në fund të kerkesës ose proces-verbalit të padies, i komunikohet anës kundershtare dhe, afati për prezantim nuk mund të jetë ma tepër se tri ditë nga dita e drejtimit, tue u marrë para syesh ngutësija e çashtjes, dhe, kuer distanca e vendit të kontestuem asht ma se tridhet km. nga qendra e gjykatës, afati zgjatet dhe deri në tri ditë të tjera.

Neni 12.

Kur çfaqen ndergjyqëset në vendin e caktuem për gjykimin e çashtjes, gjyqtari kryesisht dhe me nji herë mbledh provat e nevojshme për formimin e vendimit të tij, pa qenë i detyruem të ndjekë rregullat e caktueme në Procceduren Civile dhe në shtojcat e saja mbi administrimin e provavet; dhe për ketë qellim pyet ndergjyqësit në rast, qe janë çfaqun personalisht, si dhe deshmitarët e prezantuem prej ndergjyqësve, ose dhe persona të tjerë, pyetja e të cilëvet do të shifet e dobishme nga vazhdimi i procedimit, ban kqyrje direkte të sendit të kontestuem dhe ç'do tjetër veprim, qe ka me pa t'arsyeshem.

Vetëm deferimi i besë decizore dhe plotësore asht i ndaluem.

Neni 13.

Gjyqtari vendos mbas çmimit të lirë provat të mbledhuna si mbas nenit të sipermë dhe vendimin e shqypton atë çast, ose, tue u ndalue të dy palët, e çpall mbrenda 24 orëvet; vendimi duhet të jetë i arësyetuem ligjërisht, dhe asht i ekzekutueshem për-njiheresh.

Ekzekutimi i vendimit mund t'i ngarkohet dhe autoritetit të Sigurimit Publik.

Neni 14.

Në rast shumë të ngutëshem, ose kur mund të shkaktohet rrezik imediat nga vonesa, gjyqtari me t'u paraqitun ose me t'u

bá kerkimi, dhe pa u-bisedue çashtja, si mbas nenit 12 të kësaj Ligje, dhe pa u-thirrun i padituni, mundet me nji herë të vendosë marrjen e masave provizore me nji vendim pa pulla, i cili me kujdesinë e ftuesit, ose të organave të sigurimit publik, u komunikohet ndergjyqësvet.

Ekzekutimi i këtij vendimi bahet në konformitet me nenin e sipermë.

Neni 15.

Gjyqtari, kur vendos marrjen e masave provizore, ka tagrin t'urdhënojë me vendim çdo masë për rregullimin e përkatëshem të posedimit dhe posaçërisht:

të ndalojë çdo cytje të re;

të lejojë njanin nga ndergjyqësit me ba veprime posidimore, tue i marrë ose jo garanci;

të ndalojë njanin nga ndergjyqësit me ba veprime posidimore, tue i marrë ose jo garanci anës tjetër;

të vendosë, qe t'i lihet për-kohësisht posedimi njanës nga anët ndërgjyqëse, tue i marrë ose ajo garanci;

t'urdhënojë sekuetron gjyqsor në konformitet me nenet 1787 të Kodit Civil dhe, 388 të Shtojë. IItë të Procedurës Civile.

Neni 16.

Në qoftë se ay, kundra të cilit kundrejtohet kerkesa e masavet provizore, nuk çfaqet, gjyqtari shqyrton në se komunikimi asht bamun në kohen e duhun dhe në gjithë rregullat e formës, dhe në ketë rast procedon në mungesen e tij, tue i konsiderue të pranueshëm kerkime e anës paditëse në konformitet me nenin 553 të Shtojc. IItë të Procedurës Civile.

Në qoftë se komunikimi anës kundershtare nuk i asht bamun rregullisht, përsëritet, tue caktuem nji ditë t'aferme për gjykimin e çeshtjes, si mbas nenit 11 të kësaj Ligje.

KAPTINA III.

Dispozita të përbashkëta

Neni 17.

Komunikimet, për të cilat bahet fjalë në titujt e kësaj Ligjë, bahen me mjetet, qe do t'i shofi t'arësyeshëm, si mbas rastit, gjykata, tue pasun para sysh kurdoherë, qe të sigurohet dhe të provohet rregullisht komunikimi.

KAPTINA IV.
Dispozita Ndeshkimore

Neni 18.

Ç'do kundervajtje e ndergjyqësvet kundër mendimit të dhanun, i cili ka regullue masat provizore pamvarësisht nga konsekuencat e tjera civile, dënohet me burgim nga 15 ditë deri në 6 muej, ose me gjobë nga 200 deri 1000 fr. ari.

Neni 19.

Gjyqtari, që pa shkaqe me randësi të justifikueme vepron kundra dispozitave të neneve 3, 6, 8, 9, 11, 13 të kësaj Ligje, dënohet për herën e parë me pezullim nga rroga nga dhetë ditë deri nji muej; dhe, në rast persëritjeje, me pezullimin nga nëpunësija nga dy deri gjashtë muej, dhe, në rast ripërsëritjeje, pushohet nga puna.

Neni 20.

Ndeshkimet, të caktuem në nenin e sipërme, aplikohen dhe kunder Sekretarit, i cili vonon dergimin e akteve në Gjykaten e Diktimit n'afatin e caktuem në prani të kësaj Ligje dhe, përgjithsisht nuk kujdesohet për kryemjen e formaliteteve të komunikimevet, të kompozimit të proces-verbalevet, në redaktimit t'akt-gjymeve dhe për veprimet e tjera, vonojnë qellimi e gjykimit dhe përfundimin e çashtjes dhe t'ekzekutimit t'akt-gjykimit.

Po me këto ndeshkime ndeshkohet dhe ftuesi, që nuk kryen komunikimet në kohen e duhun dhe në konformitet me Ligjen.

Neni 21.

Dënimet e sipër-treguem për gjyqtarin vendosen prej Këshillit t'Epërme gjyqsuer mbi propozimin e Ministris së Drejtësis, të Kryetarit të Diktimit, ose të Kryeprokurorit të Shtetit, dhe për Sekretarin e ftuesin prej Ministrit të Drejtësis mbi propozimin e gjyqtarit ose kryesisht.

Neni 22.

Gjykata e Diktimit detyrohet m'e lajmërue Ministrin e Drejtësis me një herë, kur në shqyrtim t'akteve konstaton nji kundervajtje të dispozitave të kësaj Ligje; po kete detyrim ka edhe Gjyqtari persa i takon Sekretarit dhe ftuesit.

KAPTINA V.
Të drejtat e Gjyqtarit dhe të Sekretarit

Neni 23.

Shpenzimet e udhtimit të Gjyqtarit dhe të Sekretarit, posë djeteve të caktueme në Ligjë, janë (2) dy fr. ari për ç'do km., por jo ma pak se (5) pesë fr ari.

Shpenzimet e djetet e permendun në § e ma sipërmë, depozitohen prej t'interesuemit në Sekretarin e Gjykatës kundrejt nji dëftese dhe përfundimisht i ngarkohen anës gjyq-bjerse.

KAPTINA VI.
Dispozita Tranzitore

Neni 24.

Të gjitha çeshtjet, qe rregullohen prej kësaj Ligje dhe që me daten e hymjes në fuqji të sajë ndodhen të pa-mbarueme, perfundohen në konformitet me ketë Ligjë.

Afati prej nji vjeti i permendun n'Art. 1052, 1053 të Kodit Civil fillon qysh nga data e hyemjes në fuqi të kësaj Ligje për sa u perket konflikteve posedimorë, që kanë rrjedhë para asaj datë.

KAPTINA VII.
Dispozita të veçanta

Neni 25.

Ç'do dispozitë, që asht në kundershtim me ketë Ligjë, mbetet pa fuqi.

Neni 26.

Kjo Ligjë hynë në fuqi prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 27.

Ministrija e Drejtësis ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi gjykimin e shpejtë të

padinavet posedimore, t'aprovueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 94-1, datë 26-X-1931, të Kryesis së Tij.

Tiranë, më 5 Nanduer 1931.

Z O G.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Nr. 128.

LIGJË 10 Nanduer 931.

Mbi bartjen e një fondi prej fr. ari 2500 në budgetin 1930-31 të Ministris së Drejtësis

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 73 datë 10 Nanduer 931)

Art. 1.

Autorizohet bartja e Fr. ari 2.500 (dymijëpesqind) nga Kapitulli 1 «Rrogë personeli mbas kuadrit etj» në kapitullin 5 «Shpenzime hetimesh e dëshmitarësh» të Budgetit të Ministris së Drejtësis t'ushtrimit 1930-31.

Art. 2

Kjo Ligjë hynë në fuqi qysh nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministrija e Drejtësis.

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarëvet
DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartjen e nji fondi prej Fr. ari 2.500 (dymij e pesëqind) nga Kap. 1 në Kap. 5 të budgetit 1930-31 t ë Ministris së Drejtësis, e vetueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 128-I datë 3-XI-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, më 10 Nanduer 1931.

Z O G.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 129

LIGJË 10 Nanduer 1931

Mbi transferimin e nji fondi prej fr. ari 13.000 në budgetin 1930-31 të Komandës së Mbrojtjes Kombtare

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 73 datë 23 Nanduer 1931)

Art. 1.

Prej Kapitullit 10 (Hese e kashtë për kafshë etj» pakësohet nji shumë prej fr. ari 13.000, tue i u mveshë Kap. 5 «Shpenzime për mbajtjen e nxanësave ndër shkolla ushtarake» etj.

Art. 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi qysh nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Trupi Ministraer ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëvet
DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi transferimin e nji fondi prej fr. ari 13.000 (trembdhjetmij) në budgetin 1930-31 të Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, e vetueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 129-I datë 3-XI-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 10 Nanduer 1931.

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 130

LIGJË 10 Nanduer 1931

Mbi shtimin e nji fondi prej fr. ari 32.000 në budgetin e ushtrimit 1930-31 për shpenzimet e Oborrit Mbretnuer

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 73 datë 23 Nanduer 1931)

Art. 1.

Në budgetin 1930-31 të Ministis së Financavet bahen këto shtesa fondesh:

Kap. 2 Shpenzime Pallati	Fr. ari 14.000
Kap. 8 Shpenz. udhtimi e djetë	» » 9.000
Kap. 16 Shpenz. udhtimi e djetë	» » 9.000
Gjithësejt (tridhetedymijë)	» » 32.000

Art. 2.

Shtesa e fondit të përmendun n'art. 1 të kësaj Ligje përballohet me paksimin e fondit fr. ari 8.700 (tetëmijeshtatëqind) nga Kap. 11. «rrogë personali» t'Inspektoris së Përgjithshme pranë Oborrit Mbretnuer, e pjesa tjetër përballohet me t'ardhunat e realizueme ma tepër se parapa në budgetin e t'ardhunavet 1930-31 nen Kap. 45 mbi takse 2% për Arsim fr. ari 18.000 (tetëmbëdhetëmijë), dhe nen Kap. 11. «Tatim mbi shtazë të shtrasha»' fr. ari 5300 (pesëmij e treqind).

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministrija e Financavet.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi shtimin e nji fondi prej fr. ari 32.000 (trdhetedymjë) në budgetin 1930-31 për shpenzimet

BKSH

e Oborrit Mbretnuer, e vetueme pre Parlamentit si mbas shkresës Nr. 126-I datë 31-XI-1931 të kryesisi së Tij.

Tiranë, me 10 Nanduer 1931

Z O G.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 131

LIGJË 10 Nanduer 1931

Mbi bartjen e nji fondi prej fr. ari 400 në budgetin e ushtrimit 1930-31 të Ministris së Financavet

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 73 datë 23 Nandner 1931)

Art. 1.

Në budgetin e ushtrimit 1930-31 të Ministris së Financavet pakësohen fr. ari 100 (njiqind) prej Kap. 36 «Qira të Këshillit Kontrollues», fr. ari 300 (treqind) prej Kap. 47 «Kthim tatimesh e taksash» e shtohen në Kap. 34 «Shpenzime Zyre» (Këshilli Kontrollues).

Art. 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministrija e Financavet.

Z O G U I.

Mbreti i Shqiptarëvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartjen e nji fondi prej fr. ari 400 (katërqind) në budgetin 1930-31 të Ministris së Financavet, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 125-I d. 3-XI-1931 të Kryesis së Tij.

Z O G.

Tiranë, më 10 Nanduer 1931.
Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 132

LIGJË 17 Nanduer 1931

Mbi bartjen e nji fondi prej fr.ari 10.000 prej kap. 32 «Rrogë personeli» në kap. 54 «Fond Sekret» të budgetit 1931-32 të Ministris së Financavet.

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 73 datë 23 Nanduer 1931)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit 1930-31 të Ministris së Financavet pakësohet nji fond prej Fr. ari 10.000 (dhetëmijë) nga Kap. 32-I «Rrogë personeli si mbas kuadrit për nëpunësa në dorëzim e për ata n'udhtim, rrogë zavendësije» e bartet në Kap. 54 «Fond Sekret».

Art. 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministrija e Financavet

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartjen e nji fondi prej Fr. ari 10.000 në budgetin 1931-32 të Ministris së Financavet, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 243-I, datë 13-XII-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, më 17 Nanduer 1931.

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
L. Kareco

BKSH

Nr.133

LIGJË10Nanduer 1931

Mbi shtesën e nji fondi prej fr. ari 82.000 nën kap. N. 20 »Taksa Aerore» të budgetit 1930-31 të Ministris së P. Botore (Dega e Post-Telegrafave)

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 73 datë 23 Nanduer 1931)

Art. 1.

Shtohet në budgetin 1930-31 të Ministris së P. Botore (Degë e Post-Telegrafavet) nji fond prej fr. ari 82.000 (tetëdhetedymijë) nën Kap. 20 «Taksa Aerore» (pjesë e huaj).

Art. 2.

Shtesa e këtij fondi përballohet me t'ardhunat e efektueme ma tepër se parapa nen Kap. 34 «T'ardhuna poste» të budgetit e t'ardhunave t'ushtrimit udhtues.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministrija e P. Botore.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi shtesën e nji fondi prej fr. ari 82.000 (tetëdhetedymijë) nen Kap. 20 «Taksa aerore» të budgetit 1930-31 të Ministris së P. Botore (Degë e Post-Telegrafave, e vetueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 131-I datë 3-XI-1931, të Kryesis së Tij.

Tiranë, më 10 Nanduer 1931.

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Nr. 134

LIGJË 17 Nanduer 1931

Mbì shtimin e nji fondi prej fr. ari 200.000 në gjendjen e parapamjevet t' ushtrimit 1931-32 të Min. së Ekonomis Kombëtare

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 73 datë 23 Nanduer 1931)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit 1931 32 të Ministris s'Ekonomis Kombtare shtohet nji fond prej Fr. ari 200.000 (dyqindmijë) nen Kap. 16 «Shpenzime të çdo natyre për blemjen e shperndamjen e misrit popullsis së vobektë, si edhe për blemjen e shperndamjen e farës së grunit, krijuem me Dekret-Ligje datë 12-X-1931».

Art. 2.

Shtesa e fondit mbas Art. 1 të kësaj Ligjë perballohet me hua[?] e marrun në bazë të Ligjës me datë 30 Qershuer 1931.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministrija e Financavet e Ministrija e Ekonomis Kombëtare.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëvet
DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi shtimin e nji fondi prej Fr. ari 200.000 në gjendjen e parapamjevet t'ushtrimit 1931-32 të Ministris s'Ekonomis Kombëtare, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 148-I datë 13-XI-1931, të Kryesis së Tij.

Tiranë, më 17 Nendor 1931.

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Seid Toptani

Nr. 135

LIGJË 17 Nanduer 1931

Mbi shtimin e nji fondi prej fr.ari 1.437.000 në gjendjen e parapamjeve të shpenzimevet t' ushtrimit 1931-32 të Ministris së P. Botore

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 73 datë 23 Nanduer 1931)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1931-32 të Ministris së P. Botore, nen rubrikë të re «Administrata e P. Botore» krijohet Kap. 24 «Shpenzime të ç'do natyre për ndertime e mirë-mbajtje të veprave botore me ngarkim të fondit të huas s'autorizume me Ligjen d. 30 Qershuer 1931», me nji fond prej Fr. ari 1.437.000 (njimiljon e katerqind e tridheteshtatë mijë).

Art. 2.

Fondi i shtuem si mbas Art. 1 të kësaj Ligje, përballohet me huan e marrun në bazë të Ligjës d. 30 Qershuer 1931.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpallјes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministrija e Financavet e Ministrija e Punve Botore.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëvet
DEKRETON

Aprovimin e Ligjës mbi shtimin e nji fondi prej Fr. ari 1.437000. në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit 1931-32 të Ministris së P. Botore, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 247-I, datë 13-XI-1931, të Kryesis së Tij.

Tiranë, më 17 Nenduer 1931.

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Nr. 136

DEKRET-MBRETNUER 10 Nanduer 1931

Mbi bartjen e nji fondi prej fr. ari 6.000 nga kap. 55 në kap. 13 që krijohet në Titullin II. të budgetit të Min. s' Arsimit për blemjen e kopjes së helmít të Skenderbeut

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 73 datë 23 Nanduer 1931)

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 1760-II datë 29-X-931 të Kryeministris.

DEKRETON

Art. 1. Në budgetin e ushtrimit 1931-32 të Ministris s'Arsimit nën Titullin II «Shpenzime të parendëshme» krijohet Kap. 13 «Blemje e kopjes së helmit të Skenderbeut».

Art. 2. Në kapitullin e krijuem si mbas Art. 1 të këti Dekreti bartet nji fond prej Fr. ari 6.000 (gjashtëmijë) nga Kap 55. «Fonde rezervë» të budgetit vijues të Ministris së Financavet.

Art. 3. Me zbatimin e këtij Dekreti ngarkohet Ministrija e Financavet e Ministrija e Arësimit.

Art. 4. Ky Dekret do t'i dergohet Parlamentit për ratifikim.

Tiranë, më 10 Nanduer 1931,

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Arësimit:
Hil Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 137

INTERPRETIMI AUTENTIK 10 Nanduer 1931

I art. 4 të Shtojcës II. të ligjës mbi kategorizimin e Arsimtarve

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 73 datë 23 Nanduer 1931)

Profesorëvet dhe mësuesavet të karierës, që emnohen si nëpunës në qendren e Ministris s'Arësimit, koha e sherbimit n'atë

nëpunësi u llogaritet për të drejtat e shtesavet katërvjetore, dhe u paguhen këto shtesa edhe për sa kohë që do të vazhdojnë ato nëpunësi.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëvet
DEKRETON.

Aprovimin dhe zbatimin e interpretimit të nenit 4 të Shtojcës II të Ligjës mbi Kategorizmin e Arsimtarëvet, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 136-I datë 3-XI-1931 të Kryesis si Tij.

Tiranë, më 10 Nanduer 1931

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Arësimit
Hil Mosi

Nr. 138

LIGJË 21 Nandor 1931

Mbi bartje fondesh prej fr. ari 30.000 në budgetin ushtrimit 1930-31 të Min. së P. ë Mbrendshme

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 74 datë 4 Dhetuer 1931)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet t'ushtrimit 1930-31 të Ministris së Financavet pakësohen fondet nga kapitujt si vijon:

Kap.	11. Rrogë personeli	Fr. ari	8.700.—
»	12. Shpenzime udhtimi e djetë	»	813.65
»	21. Shperblim Paris e trupit të Deputetvet	»	823.60
»	23. Shpenzime udhtimi e djetë	»	2.334.90
»	25. Rrogë personeli	»	6.799.55
»	27. Qira	»	1.925.—
»	32. bis, Shpenzime të përgjithshme të Reformës Agrare	»	1.573.30
»	37. bis-a Shperblim e merita patriotike	»	1.030.—
»	46. Shpenzime per mbajtjen e Masvet	»	2.000.—

» 54. Blemje kinine » 4.000.—

» 30.000.—

Art. 2.

Fondet e paksueme prej fr. ari 30.000 (tridhetmijë) si mbas Art. 1. të kësaj Ligje i shtohen Kap. 7 «Mbajtje burgjesh, ushqim, qira e shpenzime tjera, ushqim e transportim, dhe qira per t'internuemit dhe, shperblim për vrasje t'aratisunish» të gjendjes së parapamjeve të shpenzimeve t'ushtrimit 1930-31 të Ministris së P. të Mbrendshme.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministrija e Financavet e Ministrija e P. të Mbrendëshme.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartje fondesh prej fr. ari 30.000 në budgetin 1930.931 të Ministris së P. të Mbrendshme, t'aprovueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 241-I datë 16. XI. 1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 21. Nendor 1931.

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 139

LIGJË 10 Nëndor 1931

Mbi shtesën e nji fondi prej fr. ari 10.000 në budgetin e Min. P. të Mbrendshme t' ushtrimit 1930-31

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 73 datë 4 Dhetuer 1931)

Art. 1.

Në budgetin e ushtrimit 1930-931 të Ministris së P. Mbren-

deshme nën kap. 1. «rrogë personeli» shtohet nji fond prej fr. ari 10.000 (Dhetmijë)

Art 2.

Shtesa e fondit si mbas art. 1 të kësaj Ligje përballohet me t'ardhunat e realizueme ma tepër se parapa nen Kap. 10 «Tatim mbi derra e thi» të budgetit t'ardhunavet t'ushtrimit 1930-931.

Art. 3.

Kjo Ligje hynë në fuqi që me daten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Për zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministrija e Financavet dhe ajo e P. të Mbarendëshme.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi shtesen e nji fondi prej fr. arij 10.000 (dhetëmij) në budgetin 1930-1931 të Ministris së P. të Mbrendëshme, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 122-I, datë 3. XI. 1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 10 Nanduer 1931.

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 140

LIGJË 10 Nandor 1931

Mbi bartjen e nji fondi prej fr. ari 12 000 në budgetin e ushtrimit 1931-32 të Ministris së Financavet

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 74 datë 4 Dhetuar 1931)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1931-932 të Ministrisë së Financavet pakësohet nga Kap. 11 «Rrogë personali e alokasion» (Rubrik «Inspektori») nji fond prej fr. ari 12.000 (dymbëdhetmij), e barten në Kap. 8 «Shpenzime udhtimi e djetë» (Rubrike «Shpija Civile») fr. ari 3.000 (trimij) e në Kap. 16 «Shpenzime udhtimi e djetë» (Rubrik «Adjutantura») fr. ari 9.000 (nandëmij).

Art. 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministrija e Financavet.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjes mbi bartjen e nji fondi prej fr. ari 12.000 (dymbëdhetemijë) në budgetin udhtues të Ministris së Financavet, e aprovueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 242-I datë 19.XI.1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 10 Nanduer 1931.

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 141

LIGJË 21 Nëndor 1931

Mbi bartje fondi prej fr.ari 4811.60 prej kap. 7 në kap. 3 të budgetit 1930-31 të Ministris së P. Botore

(Botue në Flatoren Zyrtare Nr. 74 datë 4 Dhetuer 1931)

Art. 1.

Bartet nji fond prej fr. ari 4811.60 (katermijetetëqindenjimbëdhetë e 60%) prej Kap. 7 «ndertime e mbajtje udhash e urash, e blemje e mbajtje kamjonash» në Kap. 3 «Shpenzime udhtimi e djetë» të budgetit t'ushtrimit 1930-931 të Ministris së P. Botore.

Art. 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

BKSH

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartjen e nji fondi prej fr. ari 4811.60 në budgetin 1930-931 të Ministris së P. Botore, t' aprovueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 230-I datë 14-XI-1931 të Kryesis së Tij.

Tirenë, me 21 Nanduer 1931.

ZOG.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financave
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Nr. 142

LIGJË 21 Nanduer 1931

Mbi perjashtimin e rrushit nga e dheta

(Botue në Fletoreh Zyrtare Nr. 75 datë 5 Dhetuer 1931)

Neni 1.

Perjashtohet rrushi pergjithësisht nga e dheta qi merret në bazë të ligjës përkatëse.

Neni 2.

Ky perjashtim shenjohet në leter-adjudikaten e të dhetave.

Neni 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi në vjetin 1932.

Neni 4.

Per zbatimin e kësaj Ligje asht e ngarkueme Ministria e Financavet.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi përjashtimin e rrushit

BKSH

nga e dheta e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 249-I datë 14-XI-931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, 21 Nanduer 1931

ZOG

Kryeministri :
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 143

LIGJË 27 Nanduer 1931

Mbi importimin e farës së grunit pa taksë doganore

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 75 datë 5 Dhetuer 1931)

Neni 1.

Autorizohet Ministrija e Ekonomis Kombëtare me importue deri me njizet mij kuintal grunë të seleksionuem për farë me u a shpernda bujqëve qi kanë nevojë, me detyrim qi t'a paguejnë mbas nji vjeti nga data e dorëzimit me vleftën e kushtimit për ata qi janë në gjendje ekonomike të mirë, dhe në natyrë, por kualitetin të parë për ata qi janë të vobekët.

Personat qi në bazë të këtij neni detyrohen me pague vleftën e farës në të holla, caktohet prej Këshillit Administrativ të vendit.

Mënyra e nxjerrjes së të hollave dhe të produktit në natyrë ka me u caktue me nji Rregullore të posaçme.

Neni 2.

Sasija e grunit të nalt-përmendun përjashtohet nga taksa doganore dhe nga ç'do lloji takse tjetër suplomentare.

Neni 3.

Autorizohet Ministrija e Ekonomis Kombëtare me importuem grunë të seleksionuem për farë edhe në llogari të personave të tretë, qi merren me bujqësi.

BQSH

Neni 4.

Gruni i importuem si mbas kësaj Dekret-Ligje destinohet vetëm si farë për mbjellje. Bujqët detyrohen qi grunin e dhanun për farë t'a përdorin vetëm për mbjellje dhe t'u shtrohen gjithë porosinave teknike të administratës së bujqësis dhe t'Odës s'Ekonomis të qarkut të tyne mbi desinfektimin e farës ashtu edhe mbi mënyrën e mbjelljes së sajë.

Desinfektimi do të bahet nga ana e teknikëve të Qeveriës.

Ata, q'u kundervinë urdhnimevet të paragrafit të ma parëshëm detyrohen, me vendim të Ministries s'Ekonomis Kombëtare, me pague mbrenda nji mueji vleftën e grunit bashkë me tagrin doganuer e gjith taksat e tjera suplementare të çfar do lloji.

Neni 5.

Shpenzimet e nevojëshme për blemjen dhe transportimin e grunit në fjalë do të përballohen prej fondeve përkatëse të Ministriës s'Ekonomis Kombëtare.

Neni 6.

Ministrija e Ekonomis Kombëtare autorizohet me hartue Rregulloren mbi hollësinat e nevojëshme për zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

Neni 7.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi që nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 8.

Ministrija e Ekonomis Kombëtare dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret Ligje.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri P. të Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit
Hil Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i Punëve Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Seid Toptani

ZOGU I.

Mbreti Shqiptarvet

Mbi proponimin e Kryeministriës Nr. 1192-IX datë 2-IX 1931,

Si ndigjoj dhe pëlqeu vendimin e Këshillit Ministruer me datë 24-VIII-1931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi importimin e nji sasije gruni për farë pa taksë doganore.

Durrës, me 7 Shtatuer 1931.

ZOG

ZOGU I.

Mbreti Shqiptarvet

DEKRETON

Zbatimin e kësaj Dekret-Ligje t' aprovueme prej Parlamentit, dhe urdhnon shtimin e saj në Kodet e Mbretniës si Ligjë.

Tiranë, me 27 Nenduer 1931.

ZOG

Nr. 144

LIGJË 27 Nanduer 1931

Mbi syprimimin e shpërblimeve për graduatët me rrogë t' Armës së Artileris parapa prej Ligjës 2 Qershuer 1928 mbi rrogat e graduatve dhe ushtarve

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr, 75 datë 5 Dhetuer 1931)

Neni 1.

Shperblimi për graduatët me rrogë t' Armës s' Artileriës, parapa prej Artikullit 6 të Ligjës 2 Qershuer 1928, mbi rrogat e graduatëve e ushtarve syprimohet.

Meni 2.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi me 1 Gusht 1931.

Neni 3

Të gjiih Ministrat ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret Ligje.

Kryeministrin e
Zav. Ministri i Ekonomis Kombtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis e
Zav. Ministri Arësimit
M. Tutulani

Ministri i P. të Jashtme
H. Vrioni

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

ZOGU I.
Mbreti Shqiptarvet

Mbi proponimin e Kryeministriës Nr. 1274, datë 3-VII-1931, si ndigjoi dhe pelqeu vendimin e Këshillit Ministruer me datë 30-VI-1931

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi syprimimin e shperblimeve té graduatëve me rrogë t' Artileriës.

ZOG

ZOGU I.
Mbreti Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e kësaj Dekret-Ligje t'aprovueme prej Parlamentit, dhe urdhuon shtimin e saj në Kodet e Mbretënis si Ligjë.

Tiranë, me 27 Nanduer 1931

ZOG

Nr. 145

LIGJË 21 Nanduer 1931

Mbi bartjen e fondit "Shpenzime Zyre„ të Ministrive të ndryshme në Kap. 42 "Shpenzime Zyre„ të budgetit 1931-1932 të Ministris së Financavet

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 75 datë 5 Dhetuer 1931)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit 1932-1932 të Ministrive të ndryshme, pakësohen fondet e mbetuna disponibel me 1 Tetuer 1931 nga kapitujt "Shpenzime Zyre„ si vijon:

Kap.	9	Shpija Civile	Fr. ari	5.587.70
„	13	Inspektorija	„	724.60
„	17	Adjudantura	„	3.582.—
„	19	Shpija Ushtarake	„	3.040.—
„	26	Këshilli i Shtetit	„	440.80
„	32	Drejt. e P. e Ref. Agrare	„	13.710.15
„	30	Kryeministrija	„	9.582.65
„	34	Këshilli Kontrollues	„	1.125.—
„	3	Ministria e Drejtësis	„	11.760.75
„	3	Ministria e P. të Mbrend.	„	11.599.95
„	14	Drejtoria e P. e Shëndetsis	„	899.10
„	3	Ministria e P. të Jashtme	„	11.792.25
„	4	Ministria e P. Botore	„	6.262.80
„	12	Drejtoria e P. Post-Telegr.	„	18.378.60
„	4	Ministria e Ekonomis Kombtare	„	12.188.25
„	4	Ministria e Arësimit	„	14.479.50
		Gjithsejt	Fr. ari	125.144.10

Art. 2.

Prej shumës Fr. ari 125.144.10 paksue si mbas art. 1, të kësaj Ligje, barten Fr. ari 116.644.10, në Kep. 42 "Shpenzime Zyre„ të gjendjes së parapamjeve të shpenzimevet t' ushtrimit 1931-1932 të Ministriës së Financavet; emertimi i të cilit ndryshohet si vijon:

BKSH

"Shpenzime Zyre,,: blemje e mbajtje mobiljesh e maqinash shkrimi, mbajtje automobili e pagë shoferi, blemje mbajtje biçikletash, shkresina zjarm e dritë, blemje botimesh, shtypshkrime, botime revistash, transport, mirëmbajtje e pastrim lokalësh, veshje e mbathje sherbëtorësh e shoferash, përkëthime e përshkrime, instalim elektrik, të vogla, "mbajtje lulishteje,,.

Art. 3.

Emertimi i Kap. 4 i gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit 1931-1932 të Ministriës se P. të Jashtme, ndryshohet si vijon: shpenzime të ndryshme për përfaqësinat e Jashtme: qira, kançelerie, kartë, dritë, zjarm, botime, pagë sherbëtorësh e shpenzime të vogla, Shpenzime përfaqësimi për Ministri, tue i shtue këtij nji fond prej Fr. ari 7.000 (shtatëmijë).

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit udhtues të Ministris s'Arësimit krijohet Kâp. 2 bis "çmime auktorë librash,, me nji fond prej Fr. ari 1.500 (njimijpesëqind).

Art. 4.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nge dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 5.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Trupi Ministruer.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartjen e fondit "Shpenzime Zyre,, të Ministrieve të ndryshme, në Kap. 42 "Shpenzime Zyre,, të budgetit 1931-1932 të Ministris së Financavet, aprovue prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 229-I datë 16-XI-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 21 Nenduer 1931.

ZOG

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. të Jashtme
H. Vrioni

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Said Toptani

Nr. 146

LIGJË 2 Dhetuer 1931

Mbi anulimin e adjudikatës me datë 20-XI-1929 për blemjen e kinines së Shtetit

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 76 datë 9 Dhetuer 2931)

Neni 1.

Qeverija autorizohet me heqë dorë nga zbatimi i dispozitës s' Art. 8, të letër-adjudikatës së Kininës së Shtetit me datë 12-VIII-1929, qi flet mbi humbjen e garancis, tue konsiderue adjudikatën t' anulueme.

Neni 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi qysh prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 3.

Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i P. të Jashtme e Zv. Min. i P. të Mbrendshme
R. Fico

Ministri i Drejtësis
V. Avrami

Ministri i Arësimit e Zv. Ministri i P. Botore
H. Mosi

Ministri i Financavet
K. Thaçi

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Mehdi Frasheri

BKSH

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 325-IV, datë 14-V-1930, si ndigjoi dhe pelqeu vendimin e Këshillit Ministruer me datë 8-V-1930.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi anulimin e adjudikatës me datë 20-XI-1929 për blemjen e Kininës.

ZOG

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Zbatimin e Dekret-Ligjës me datë 17 Maj 1930, t' aprovueme prej Parlamentit, dhe urdhnon shtimin e tij në Kodet e Mbretnies si Ligjë.

Tiranë, me 2 Dhetuer 1931.

ZOG

Nr. 147

LIGJË 11 Dhetuer 1931

Mbi shtimin e nji fondi prej fr. ari 37.000 në budgetin 1931-1932 të Ministris së Financavet për pensione Ushtarake

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 77 datë 12 Dhetuer 1931)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimeve të ushtrimit 1931-1932 të Ministris së Financavet shtohet nji fond prej fr. ari 37.000 (tridhetështatëmijë) nën Kap. 39 "Pensione Ushtarake.,,

Art. 2.

Shtesa e fondit si mbas Art. 1. të kësaj Ligje, përballohet me t' ardhunat e vertetueme ma tepër se parapa në Kap. 11 "Tatim (Xhelep) mbi shtazë të trasha,, të gjendjes së parapamjevet të ardhunavet t' ushtrimit 1931-1932.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbattmin e kësaj Ligje ngarkohet Ministrija e Financavet.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi shtimin e nji fondi prej fr. ari 37.000 në budgetin 1931-1932 të Ministris së Financavet për "Pensione Ushtarake,,, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 313-I datë 25-XI-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, 11-XII-1931.

ZOG

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financave
L. Kareco

Nr. 148

LIGJË 11 Dhetuer 1931

Mbi amnistien e fajeve të kryeme prej disa të pandehunve të burgosun, qi vuejnë nga tuberkulozi

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 78 datë 15 Dhetuer 1931)

Art. 1.

Amnistohen fajet e kryeme para ditës të hymjes në fuqi të kësaj Ligje prej të pandehunvet të burgosun qi vuejnë nga tuberkulozi, 1) Dervish Avdija nga Ujmijshti; 2) Bajazit Bajrami, nga Golemi, dhe 3) Ramazan Hasani, nga Martaneshi.

Art. 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Ministrija e Drejtësis dhe ajo e P. të Mbrendëshme ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligjë.

BKSH

ZOGG I.

Mbreti i Shqiptarvet

D K E R E T O N

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi amnistiën e fajeve të kryeme prej disa të pandehunve të burgosun, prej tuberkulozit, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 322-I, datë 2-XII-931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 11-XII-1931

ZOG

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Nr. 149

LIGJË 11 Dhetuer 1931

Mbi bartje fondesh në budgetin e ushtrimit financjar 1931-932

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 78 datë 15 Dhetuer 1931)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t' ushtrimit financjar 1931-32 pakësohen fondet që vijojnë:

Ministrija e Drejtësis

Kap. 1.	Rrogë personali mbas kuadrit	Fr. ari 10.000
„ 6.	Shpenzime të ndryshme per instalimin e funksionimin e rregjistrit të gjendjes gjyqsore	„ 8.000

Ministrija e P. Botore

Kap. 1.	Rrogë personali për Nep. në rasë dorëzimi Zyrej etj.	„ 6.000
„ 2.	Rrogë personeli me kontratë	„ 19.000

Ministrija e Ekonomis Kombëtare

Kap. 6. Blemje benzine voji etj.	Fr. ari	12.000
„ 8. Punime të ndryshme dhe shpenzime gjithëfaresh për Stasione Zooteknike	„	10.000

Ministrija e Arësimit

Kap. 11. Kërkime dokumentasht historike e shperblime për përkëthim të tyne	„	3.000
„ Taksa shtetnore e doganore për landët e nevojshme për shkollat e ndryshme	„	5.000
Gjithësejt	Fr. ari	73.000

Art. 2.

Fondet prej fr. ari 73.000 (shtatëdhetetrimij) paksue si mbas Art. 1 të kësaj Ligje, i shtohen Kap. 5 "Subvencion Komnneve,, të gjendjes së parapamjeve të shpenzimevet t'ushtrimit 1931-1932 të Ministris së P. të Mbrendshme.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligjë ngarkohet Trupi Ministruer.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartje fondesh në budgetin e ushtrimit financjar 1931-1932 të Ministrive të ndryshme në ate të Ministris së P. të Mbrendshme "Subvencion Komuneve„ e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 300-I, datë 25-XI-931 të Kryesis së Tij.

Tiranë me, 11-XII-1931

ZOG

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. Mbrendshme
Musa Juka

BKSh

Ministri Arsimit
H. Mosi

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombtare
Said Toptani

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 150

LIGJË 11 Dhetuer 1931

Mbi shtimin e nji fondi prej Fr. Ari 93.375 në kap. 5 "Subvension Komuneve„ të budgetit 1931-1932 të Ministris së P. të Mbrendshme

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 78 datr 15 Dhetuer 1931)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjeve të shpenzimevet t'ushtrimit 1931-32 të Ministris së P. të Mbrendshme, shtohet nji fond prej Fr. Ari 93.375 (nandëdhetëtrimijë e treqindeshtatdhetëpesë) nën kap. 5 "Subvencion Komuneve„.

Art. 2.

Shtesa e fondit si mbas art. 1. të kësaj Ligje, përballohet me t' ardhunat e vertetueme ma tepër se parapa nën Kap. 10 "Tatim (Xhelepi) mbi berra e thij kap. "Tatim (Xhelep) mbi shtazë të trasha„ e nen kap. 14 "Tatim fitimi të gjendjes së parapamjevet të t' ardhunavet t' ushtrimit 1931-32.„

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministrija e Financavet e Ministrija e P. të Mbrendshme.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

D E K R E T O N

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi shtimin e nji fondi

prej Fr. ari 93.375 në kap. 5 "Subvension Komuneve„ të Budgetit 1931-32 të Ministris së P. të Mbrendshme, e votuem prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 300 datë 25-XI-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 11 Dhetuer 1931.

ZOG

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i P. të Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 151

LIGJË 11 Dhetuer 1931

Mbi bartje fondesh prej Fr. ari 10623.47, në budgetin e ushtrimit 1930-31, për plotësim të fondit për subvencion Komuneve

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 78 datë 15 Dhetuer 1931)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t' ushtrimit 1930-31, të Ministrive të posht-shenueme pakësohen fondet si vijojnë :

Ministria e Drejtësis

Kap. 1.	Rrogë personeli mbas kuadrit etj.	Fr. ari	31.306.31
„ 2.	Shpenzime e udhëtimi e djetë për emnime e transferime nëpunësa dhe inspektimesh	„	4.984.45
„ 3.	Shpenzime Zyre	„	836.54
„ 4.	Qira ndërtesash	„	1.330.—

Ministria e P. Mbrendshme

Kap. 1.	Rrogë personeli etj.	„	2.600.—
„ 2.	Shpenzime udhtimi e djetë	„	410.—
„ 3.	Shpenzime Zyreje	„	25.—
„ 4.	Qira	„	1.200.—
„ 5.	Mbajtje burgjesh e tjera	„	843.—

Kap. 10.	Shpenzime për të kremte kombtare	Fr. ari	1.038.—
„ 12.	Rrogë personeli "Shëndetësie„	„	7.770.—
„ 15.	Qira	„	296.80
„ 16.	Blemje barnash e të tjera	„	140.—
„ 17.	Spitale	„	3.140.—
„ 18.	Ambulancë e Dispanseri	„	2.309.65
„ 19.	Çmendinë	„	482.45
„ 20.	Laboratori i baktriollogjisë etj.	„	20.—
„ 22.	Shpenzime për katër shtretën t'angazhuem në Klinikën e Barit	„	940.—
„ 24.	Bursa studimi	„	600.—
„ 25.	Regjistrim popullësije e shperblim Organizatori	„	50.—

Ministri e P. Botore

Administrata e P. Botore

Kap. 1.	Rrogë personeli mbas kuadrit etj.	„	1.790.25
„ 2.	Rrogë personeli me kontratë	„	16.505.—
„ 6.	Blemje veglash teknike e material revizimí	„	513.95
„ 7.	Ndertime e mbajtje udhash e urash	„	1.241.95
„ 8.	Shpenzime puntorësh të vramë e të mbytun invalid	„	2.464.80

Administrata e Post-Telegrafavet

Kap. 9.	Rrogë personeli	„	693.35
„ 14.	Bartje postash të jashtëzakonëshme	„	16.11.55
„ 15.	Blemje material post-telegrafonik	„	113.40
„ 18.	Taksa ndërkombëtare	„	2.391.75
„ 19.	Taksa telegramesh (pjesë e huej)	„	5.000.—
„ 21.	Taksa të Kryqit të Kuq	„	856.70
„ 22.	Shperblim për humbje dergesash	„	870.—

Ministri e Ekonomis Kombëtare

Kap. 2.	Rrogë personali me kontratë	„	1.250.80
„ 3.	Shpenzime udhëtimi e djetë	„	2.159.95
„ 4.	Shpenzime Zyreje	„	973.65
„ 6.	Blemje benzine voji e tjera	„	1.495.30
„ 7.	Shpenzime të ndryshme dhe vegla të nevojshme per grupin e punimeve bujqësore	„	355.60

Kap. 8.	Ngrefje blektorësh mënafsh avikultur etj.	Fr. ari	1.212.60
„ 9.	Shpenzime për indnstrin e zunkthave	„	346.35
„ 11.	Ushqim veshje e mbathje e shpenzime tjera për Shkollën e Bujqësis	„	1.800.80
„ 13.	Subvencion për industrina të vogla	„	200.—
„ 14.	Fonde për instalim emigrandesh	„	994.40

Ministri i Arësimit

Kap. 3.	Shpenzime udhtimi e djetë	„	775.18
„ 4.	Shpenzime Zyreje	„	229.—
„ 5.	Qira	„	400.45
	Gjithsejt	Fr. ari	106.623.47

Art. 2.

Fondet prej Fr. ari 106.623.47, (njiqind e gjashiëmijë e gjashtëqindë e njizet e tre e 47%) pakësue si mbas Art. 1 të kësaj Ligje, i shtohen Kap. 5 "Subvencion Komuneve,, të gjendjes së parapamjeve të shpenzimevet t'ushtrimit 1930-31, të Ministris P. të Mbrendshme.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Trupi Ministruer.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartje fondesh prej fr. ari 106.623.47, në budgetin e ushtrimit 1930-31, për plotësimin e fondit për Subvencion Komuneve, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 299 I datë 25-XI-1931, të Kryesis së Tij.

Tiranë 11 Dhetuer 1931.

ZOG

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. të Jashtme
H. Vrioni

Ministri i P. të Mbrendshme
Musa Juka

Ministri í Arësimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Said Toptani

Nr. 152

LIGJË 11 Dhetuer 1931

Mbi shtesën e nji fondi prej Fr. ari 70.000 nen Kap. 8 mbajtje burgjesh etj. të budgetit 1931-32 të Ministris së P. të Mbrendëshme

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 79 datë 23 Dhetuer 1931)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t' ushtrimit 1931-932 të Ministris së P. të Mbrendëshme shtohet nji fond prej Fr. sri 70.000 (shtatdhetmijë) nën Kap. 8 "Mbajtje burgjesh, ushqim, qira e shpenzime tjera për burgje, ushqim dhe transportim e qira për të internuemit, shperblim per vrasje t' aratisunish,,.

Art. 2.

Shtesa e fondit si mbas Art. 1 të kësaj Ligje përballohet me t'ardhunat e realizueme me tepër se parapa nën Kap. 10 "Tatim (Xhelep) mbi berra e thij,, të gjendjes së paramjeve t'ardhunavet t'ushtrimit 1931-32.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohen Ministria e Financavet e Ministria e P. të Mbrendëshme.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi shtesën e nji fondi prej Fr. ari 70.000 nën Kap. 8 "Mbajtje burgjesh etj.„ të buxhetit 1931-32 të Ministris së P. të Mbrendëshme, e aprovueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 305/I datë 25-XI-931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 11 Dhetuer 1931

ZOG

Kryeministri
Pendeli Evangjeli

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 153

LIGJË 2 Dhetuer 1931

Mbi përjashtimin nga taksa doganore e të tjera të misrit qi ka me importue Ministrija e Finanacvet

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 79 datë 23 Dhetuer 1931)

Neni 1.

Ministrija e Financavet autorizohet me importue, me përjashtim nga takse doganore e të tjera taksa suplementare, nji sasi misër që ajo ka me gjykue të nevojshme për me i ba ballë nevojave ushqimore të popullit të qarqeve Vlonë dhe Gjinokastër.

Neni 2.

Misri i importuem ka me u shit në shkelën e shkarkimit jo më tepër se fr. 20 ç' do kuintal. Bashkive munt t'i nepet në rasa nevoje me kredi me nji afat nji muejt.

Neni 3.

Ministrija e P. të Mbrendëshme ngarkohet me regullue me anën e Bashkive përkatse çpërndarjen dhe shitjen e misrit nga

skelet e shkarkimit në qarkun e Prefekturës Gjinokastrës dhe të Vlonës.

Neni 4.

Për blemjen e misrit, qi do t' importohet, në budgetin e Ministris së Financavet dhe në pjesën e shpenzimeve, krijohet Kapitulli "59 bis„ me emërtim «Shpenzime për blemjen dhe importimin e misrit» të cilit i caktohet nji fond i parapamë prej fr. ari 60.000 (gjashtëdhetmijë). Këtij shpenzimi i bahet ballë me t' ardhunat, qi kanë me rezultue nga shitja e misrit, dhe për këtë qellim krijohet në budgetin dhe në pjesën e t' ardhunave Kapitulli 57 me emërtim "Të hyme nga shitja e misrit,,, të cilit i cakrohet nji fond i parapamë prej fr. ari 60.000.

Neni 5.

Fitimet neto eventuale, qi kanë me rrjedhë prej importimit dhe shitjes të misrit, kanë me shkue në favor të Bankës Agrare Kombëtare.

Neni 6.

Ministrija e Financavet dhe ajo e P. të Mbrendëshme ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

Neni 7.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi që nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri dhe
Zev. Ministri i Ekonomis Kombëtare
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis e
Zev. Ministri i Arësimit
M. Tutulani

Ministri i P. të Jashtme
H. Vrioni

Ministri P. të Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
L. Kareco

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e Kryeministriës Nr. 1192-I datë 24-6-1931,

si ndigjoi dhe pëlqeu vendimin e Këshillit Ministruer me datë 24-VI-1931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi përjashtimin nga taksat doganore dhe të tjera tagra suplementare të misrit, qi ka me importue Ministrija e Financavet.

Tiranë, me 30 Qershuer 1931. ZOG

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës me datë 30 Qershuer 1931, t'aprovueme prej Parlamentit, dhe urdhnon shtimin e saj në Kodet e Mbretniës si Ligjë.

Tiranë, me 2 Dhetuer 1931. ZOG

Nr. 154

RREGULLORE 2 Dhetuer 1931

Mbi importimin dhe eksportimin e koronave të hueja dhe mbi abrogimin e Rregullores me datë 2-II-1929

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 79 datë 23 Dhetuer 1931)

Neni 1.

Abrogohet Regullorja me datë 2 Fruer 1929 mbi mënyrën e vuemjes me qarkullim të monedhave metalike sermi dhe mbi eksportimin e koronave të hueja.

Neni 2.

Importimi dhe eksportimi i koronave të hueja lehet i lirë për të gjithë.

Neni 3.

Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Rregullloreje.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

BKSH

Ministri i P. të Jashtme
H. Vrioni

Ministri i P. të Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri Financavet
L. Kareco

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 2255/IV datë 25-VI-1931, Si ndigjoi dhe pëlqeu vendimin e Këshillit Ministruer me datë 23-XI-1931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Rregullores mbi importimin dhe eksportimin e koronave të hueja dhe mbi abrogimin e Rregullores me datë 2 Fruer 1929.

Tiranë, me 2 Dhetuer 1931

ZOG

Nr. 155

DEKRET-MBRETNUER 23 Qershuer 1930

Mbi transferimin e shumës prej fr. ari 5000. në buxhetin e Ministris s' Arsimit

(Botue në Fletoıen Zyrtare Nr. 80 datë 31 Dhetuer 1931)

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1536-I, datë 14-VI-1930, mbasi pá vendimin e Këshillit Ministruer Nr. 487. datë 5-VI-1930.

DEKRETON

Transferimin e shumës së Fr. ari 5000 prej fondit rezerv të bndgetit të Ministris së Financavet në Kap. 9 "Subvencion e ndihmë për Institutet private, Shkolla Teknike", të budgetit të Ministries s' Arsimit,

Durrës, me 23 Qershor 1930.

ZOG

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
K. Thaçi

Nr. 156

DEKRET-MBRETNUER 11 Gusht 1930

Mbi transferimin e shumës prej fr. ari 26.976 e 75°/₀ të budgetit 1930-931 të Ministris së P. të Jashtme

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 80 datë 31 Dhetuer 1931)

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1982-I, datë 7-VIII-1930. mbassi pa vendimin e Këshillit Minìstruer Nr. 672, datë 2-VIII-1930,

D E K R E T O N

Transferimin e shumës së Fr. ari 26.976.75°/₀ prej Kap. 53 "Fond rezerv„ të budgetit 1930-31 të Ministries së Financavet, në Kap. 6 "Shpenzime të mëshefta„ të budgetit udhtues të Ministries të Punëve të Jashtme.

Durrës, me 11 Gusht 1930.

ZOG

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i P. të Jashtme
R. Fico

Zav. Ministri i Financavet
H. Mosi

Nr. 157

SHTOJCE-LIGJË 11 Dhetuer 1931

Të ligjës me datë 7-X-1931 mbi importimin e misrit për të vobekët

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 80 datë 31 Dhetuer 1931)

Art. 1.

Misri, qi ka me importue Ministria e Ekonomis Kombëtare

për K. 20.000 për me u shpërda gratis bujqëve të vobektë, ka me ju dhanë edhe atyneve, qi nuk merren me bulqësi.

Art. 2.

Përsonat, qi kanë me përfitue prej misrit, qi ka me u-shpërndae gratis, të cilat mbas ligjës përkatëse kanë cilësinat e lypuna për me punue ndër rrugat kombëtare, detyrohen, në rast, qi nuk ka posibilitet qi të përdoren ndër rrugat e sipër-thanuna, të punojnë ndër rruga komunale, si mbas urdhunave të Ministris së P. Botore dhe në bazë të nji Rregulloreje përkatëse, qi ka me u-pregatit për ketë qellim.

Art. 3.

Kjo Shtojcë-Dekret Ligjë hynë në fnqi qysh prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e saj ngarkohet Trupi Ministruer.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tutulani

Ministri i P. Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri P. Jashtme
H. Vrioni

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i P. Botore
Izet Dibra

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Said Toptani

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1192-11 datë 13-X-1931, si ndigjoi dhe pelqeu vendimin e Këshillit Ministruer me d. 12-X-1931.

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Shtojcë-Dekret-Ligjës mbi importimin e misrit për të vobekët me datë 7 Tetuer 1931.

Tiranë, me 12 Tetuer 1931.

ZOG

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës me datë 12 Tetuer 1931, e votueme prej Parlamentit, dhe urdhnon shtimin e saj në Kodet e Mbretnis si Ligjë,

Tiranë me, 11 Dhetuer 1931.

ZOG

Nr. 158

LIGJË 11 Dhetuer 1931

Mbi përjashtimin e misrit nga tagra doganuer i të hyemit

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 80 datë 31 Dhetuer 1931)

Neni 1.

Misri qi importohet, me hyemjen në fuqi të kësaj Dekret Ligje, përjashtohet nga tagrat doganore e të hyemit, të caktueme në numrin 32 të Tarifës Doganore, si dhe nga taksat e tjera suplementare.

Neni 2.

Misri, qi importohet pa tager doganuer në bazë të kësaj Dekret Ligjë, randohet me nji taksë konsumi 3 Fr. ari ç'do nji qind kilogram brutto, e cila mblidhet nga doganat në rast të hymjes së misrit në vend.

Neni 3.

Kjo Dekret Ligjë hynë në fuqi ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 4.

Ministria e Finaucavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Drejtësis
M. Tufulani

Mintstri i P. të Jashtme
H. Vrioni

Ministri i P. të Mbrendshme
Musa Juka

Ministri i Arësimit
H. Mosi

Ministri i Financavet
L. Kareco

Ministri i F. Botore
Izet Dibra

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1192-V datë 8-VII-1931. si ndigjoi dhe pëlqeu vendimin e Këshillit Ministruer me datë 9-VII-1931.

D E K R E T O N

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi përjashtimin e misrit nga tagret doganore e të hyemit.

Durrës, me 14 Korrik 1931.

ZOG

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

D E K R E T O N

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret Ligjës me datë 14 Korrik 1931, e votueme prej Parlamentit, dhe urdhnon shtimin e saj në Kodet e Mbretnis si Ligjë.

Tiranë, me 11 Dhetuer 1981.

ZOG

Nr. 159

DEKR⌴T-MBRETNUER 11 Dhetuer 1931

Mbi Interpretimin autentik mbi nenet 1 dhe 22 të Ligjës së Tatimit mbi t' Ardhunat

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 80 datë 31 Dhetuer 1931)

"Deri sa që të dyja Ligjat të unifikohen, vazhdon të takso-

hen veçanërisht fitimet si mbas dispozitave të Ligjës mbi tatim fitimesh, dhe veçanërisht të taksohen t'ardhunat si mbas dispozitave të Ligjës së tatimit mbi t' ardhunat.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e "Interpretimit autentik mbi nenet 1 dhe 22 të Ligjës së Tatimit mbi t' Ardhunat,, , e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 123-I, datë 23-XI-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 11 Dhetuer 1931.

ZOG

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i Financavet
L. Kareco

Nr. 160

LIGJË 11 Dhetuer 1931

Mbi krijimin e Nepunësis se nji Asistenti Operator në Spitalin e Shtetit të Tiranës

(Botue në Fletoren Zyrtare Nr. 80 datë 31 Dhetuer 1931)

Art. 1.

Krijohet nëpunsija e nji Asistenti Operator në Spitalin e Shtetit, të Tiranës me rrogë mujore Fr. ari 300.

Art. 2.

Pagesa e rrogës së tij, pa u ngarkue Arka e Shtetit, do të përballohet nga kursimet e Kap. 12 të budgetit financjar 1931-1932 të Drej toris P. të Shëndetsis.

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi qi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Ministria e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligje.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi krijimin e nëpunësisë se nji Asistenti Operator në Spitalin e Shtetit, të Tiranës, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 266-I datë 30-XI-1931 të Kryesis së Tij.

Tiranë. me 11 Dhetuer 1931

ZOG

Kryeministri
Pandeli Evangjeli

Ministri i P. të Mbrendëshme
Musa Juka

Ministri i Financavet
Lame Kareco

BKSH

Indeksi kronologjik i landës

Nr. renduer	Data e Dekretimit	LIGJË, DEKRET-LIGJË dhe RREGULLORE	Botimi në Flet. Zyrt. Nr.	Botimi në Flet. Zyrt. Data	Faqe e librit
1	2-I-931	Ligjë mbi transferimin e nji kredije prej fr. ar. 11.500 në Buxhetin e vjetit financjar 1930-31 të Instituteve të Nalta të Ministris së Financavet.	1	8-I-931	1
2	2-I-931	Ligjë mbi përjashtimin nga taksa doganore dhe e magazinazhit si dhe nga ç'do taks tjetër Shtetnore ose Bashkiet, e të gjithë materialit qi i nevojitet për lidhjen e Hekurudhës Durrës-Tiranë, dhe që ka arrijtun ose do arinë në Doganën e Durrësit.	2	12-I-931	2
3	15-XII-930	Rregullore mbi aplikimin e Ligjës d. 8. Prill, 1930 të Statistikës s'Ekonomis Kombtare	3	15-I-931	4
4	5-I-931	Ligjë mbi shtimin e fjalës "Blemje,, në kap. 3, në budgetin e vjetit financjar 1930-31 të Ministris P. Jashtme, dhe të kapitujve 4 po të këtij budgeti të Ministris s'Ekonomis Kombtare dhe t'Arësimit, dhe shtimin e fjaleve "Blemje e mbajtje,, kap. 40 të budgetit të Ministris së Financavet	3	15-I-931	13
5	5-I-931	Ligjë mbi bartjen e nji fondi prej fr. ari 10.000			

Nr. renduer	Data e Dekretimit	LIGJË, DEKRET-LIGJË dhe RREGULLORE	Botimi në Flet. Zyrt. Nr.	Data	Faqe e librit
		prej kap. 1 në kap. 2 të buxhetit të Ministries së Drejtësis t'ushtrimit 1930-31.	3	15-I-931	15
6	5-I-931	Ligjë mbi bartjen e nji fondi prej fr. ari 6050 të budgetit 1930-31 të Ministris s'Ekonomis Kombtare.	3	15-I-931	16
7	2-I-931	Ligjë mbi zgjatimin e afatit të Ligjës Ndeshkimore për faje politike me datë 23-XII-1925.	3	15-I-931	17
8	2-I-931	Ligjë mbi Interpretimin autentik të nenit 63 të ligjës mbi Reformën Agrare.	3	15-I-931	17
9	2-I-931	Ligjë mbi ndryshimin e pikës 4 të nenit 3 dhe të nenit 26 të ligjës mbi themelimin e Odave t'Ekonomis me datë 14. Mars 1929.	3	15-I-931	18
10	2-I-931	Traktat miqësie dhe tregtije midis Shqipnis dhe Japonit.	3	15-I-931	20
11	2-I-931	Ligjë Shtojce e ligjës mbi detyrimin e punimit me vegla moderne bulqësore me datë 19. Prill 1929.	4	17-I-931	22
12	2-I-931	Ligjë mbi bartjen e një fondi prej fr. ari 60.000 në budgetin 1930-31 prej kap. 1. të Komandës së Mbrojtjes Kombtare nën kap. 26 bis, të Ministris së P. të Mbrendëshme.	4	17-I-931	23

BKSH

Nr. renduer	Data e Dekretimit	LIGJË, DEKRET-LIGJË dhe RREGULLORE	Botimi në Flet. Zyrt. Nr.	Botimi në Flet. Zyrt. Data	Faqe e librit
13	2-I-931	Ligjë mbi zgjatimin e dytë t'afatit të kërkimeve për voj-gurit Grupit Franko-Shqiptare që ka Konçesionin me Konvension me datë 18. Dhetuer 1925.	4	17-I-931	24
14	12-VI-930	Ligjë mbi zbatimin e P. Kontratës mbi shfrytzimin e Pyllit "Mollung"	5	17-I-931	25
15	20-I-931	Ligjë mbi transferim kreditash të budgeteve të Ministris së P. Mbrendëshme, të Drejt. P. të Shëndetsis, të Komandës Mbrojtjes Kombtare e të Gjindermarisë dhe të Ministris P. Botore ushtërimi 1930-1931.	5	21-I-931	30
16	20-I-931	Ligjë mbi bartje fondesh në budgetin e Komandës së P. të Gjindarmerisë për ushtërimin financjar 930-931.	6	26-I-931	32
17	20-I-931	Ligjë mbi krijimin e nji Zyre Organizatori.	7	29-I-931	32
18	2-I-931	Ligjë mbi transferimin e nji fondi prej fr. ari 300 në Buxhetin udhtues të Ministris së Financavet "Rubrike Këshilli Kontrollues".	7	29-I-931	34
19	22-I-931	Ligjë mbi shtimin e nji Kryekonsulli në kuadrin numerik të Ministris P. Jashtme.	7	29-I-931	35

BKSH

Nr. Renduer	Data e Dekretimit	LIGJË DEKRET-LIGJË dhe RREGULLORE	Botimi në Flet. Zyrt. Nr.	Botimi në Flet. Zyrt. Data	Faqe e librit
20	—	Rugullore mbi nji konkurs në mes të lopeveve me provë mjeljeje.	7	29-I-931	36
21	24-I-931	Ligja e Shtypit.	8	31-I-931	38
22	15-I-931	Ligjë mbi rregullimin e Shkollës së nxensave për Oficera Plotësimi.	9	4-II-931	53
23	26-I-931	Dekret-Mbretnuer mbi mënyrën e fillimit t'aplikimit të Reformës Agrare.	11	12-II-931	58
24	13-III-931	Ligjë mbi bartje fondesh prej fr. ari 15.000 në budgetin 1930-31 të Ministris së Financavet.	16	14-III-931	58
25	13-III-931	Ligjë mbi krijimin e kap-26 ter. "Subvansion e shpenzime gjithfarësh për të damtuemit prej tërmetit Korçë e rrethe, në budgetin e ushtërimit 1930-931 të Ministris së P. Mbrendëshme.	16	14-III-931	59
26	13-III-931	Ligjë mbi shtimin e një fondi prej fr. ari 86.150 (tetdhetegjashtëmij e njiqint epesëdhet) nën kap .37 bis B. "Pensione Ushtarake" të budgetit 1930-931 të Ministris së Financavet.	16	14-III931	61
